



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

KONVENTA PËR TË DREJTAT E FËMIJVE

Raporti i Dytë, i Tretë, i Katërt Periodik

Gusht 2009

PËRMBAJTJA

HYRJE

III. PARIME TË PËRGJITHSHME

Mos-diskriminimi (neni 2)

Interesi më i lartë i fëmijës (neni 3)

E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit (neni 6)

Respektimi i mendimit të fëmijës (neni 12)

IV. TË DREJTAT DHE LIRITË CIVILE

Emri dhe kombësia (neni 7)

Ruajtja e identitetit (neni 8)

E drejta e shprehjes (neni 13)

E drejta për informacion të përshtatshëm (neni 17)

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (neni 14)

Liria e organizimit dhe mbledhjes paqësore (neni 15)

Mbrojtja e jetës private (neni 16)

E drejta për t'iu mos nënshtruar torturës, trajtimeve, apo dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese (neni 37/a)

V. MJEDISI FAMILJAR DHE KUJDESI ALTERNATIV

Kujdesi prindëror (neni 5)

Përgjegjësitë prindërore (neni 18, parag. 1-2)

Ndarja nga prindërit (neni 9)

Ribashkimi familjar (neni 10)

Kujdesi për fëmijët (neni 27, parag. 4)

Fëmijët e privuar nga mjedisi familjar (neni 20)

Birësimi (neni 21)

Transferimi i paligjshëm dhe mos-kthimi (neni 11)

Abuzimi dhe neglizhenca (neni 19), duke përfshirë rikuperimin fizik dhe psikologjik dhe riintegrimin social (neni 39)

Rishikimi periodik i vendbanimit (neni 25)

VI. SHËNDETI BAZË DHE MIRËQENIA

Mbijetesa dhe zhvillimi (neni 6, parag 2)

Fëmijët e paaftë (neni 23)

Shëndeti dhe shërbimet shëndetësore (neni 24)

Sigurimi shoqëror, shërbimet dhe lehtësitë e kujdesit për fëmijën (neni 26 dhe 18 paragrafi 3)

Standarti i jetesës (neni 27, paragrafët 1 dhe 2)

VII. ARSIMI, KOHA E LIRË DHE AKTIVITETET KULTURORE

Arsimimi, duke përfshirë trajnimin profesional dhe administrimin (neni 28)

Objektivat e arsimit (neni 29)

Koha e lirë, aktivitetet rekreative dhe kulturore (neni 31)

VIII. MASAT E VEÇANTA TË MBROJTJES

Fëmijët me status refugjati (neni 22)

Fëmijët në konflikte të armatosura (neni 38), duke përfshirë rikuperimin fizik dhe psikologjik, si dhe riintegrimin shoqëror (neni 39)

Administrimi i drejtësisë për fëmijët (neni 40)

Fëmijët e privuar nga liria, duke përfshirë çdo formë ndalimi, burgosjeje, apo vendosje në ambiente të mbikqyrura (neni 37 (b), (c))

Dënimi i fëmijëve, në veçanti ndalimi i dënimit kapital dhe burgimit të përjetshëm (neni 37 (a))

Shfrytëzimi ekonomik, duke përfshirë punën e fëmijëve (neni 32)

Abuzimi me drogat (neni 33)

Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual (neni 34)

Forma të tjera shfrytëzimi (neni 36)

Shitja, trafikimi dhe rrëmbimi (neni 35)

LISTA E SHKURTIMEVE

AP	Avokati i Popullit
BE	Bashkimi Evropian
CRC	Komiteti për të Drejtat e Fëmijës
CPT	Komiteti për Parandalimin e Torturës i Këshillit të Evropës
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DA	Drejtoria Arsimore Rajonale
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DMDBD	Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Personave të Veçantë
IEV Penale	Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale
KNDF	Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijës
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
LSMS	Anketa për Matjen e standartit të Jetesës 2002-2005
MKPT	Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MD	Ministria e Drejtësisë
MB	Ministria e Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MPCSSHB	Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MTKRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MICS	Studimi i Grupit të Indikatorëve të Shumëfishtë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
NDF	Nënseksioni për të Drejtat e Fëmijëve
OJF	Organizata jo Fitimprurëse
PKZMSA	Plani Kombëtar i Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
RSH	Republika e Shqipërisë
SKF	Strategjia Kombëtare për Fëmijët
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
STF	Sekretariati Teknik për Fëmijët
SIDA	Agjensia Suedeze për Vendet në Zhvillim
SPAK	Strategjia e Personave me Aftësi të Kufizuar
ZA	Zyrat Arsimore
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
UNDP	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë

HYRJE

1. Konventa për të Drejtat e Fëmijës u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin nr.7531 datë 11.12.1991 “Për Ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës”. -Bazuar në nenin 44/1 të Konventës, në 5 korrik 2004 Shqipëria ka paraqitur pranë Komitetit CRC, Raportin Fillestar dhe të Parë¹ i cili përmbante informacion lidhur me masat ligjore, ekzekutive, administrative etj, për zbatimin e dispozitave të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, për periudhën 1992-2000.

Në kuadrin e shqyrtimit të Raportit Fillestar, Komiteti CRC ka paraqitur një listë çështjesh duke kërkuar të dhëna plotësuese dhe informacion të përditësuar lidhur me zbatimin e dispozitave të Konventës², informacion i cili është dorëzuar nga Shqipëria në muajin dhjetor 2004³. Pas shqyrtimit të këtij Raporti në janar 2005, Komiteti CRC ka miratuar Vëzhgimet përfundimtare për Shqipërinë⁴.

2. Bazuar në nenin 44 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe rekomandimin 81 të Vëzhgimeve Përfundimtare të Komitetit CRC, Shqipëria paraqet Raportin e Dytë, të Tretë dhe të Katërt Periodik, i cili është hartuar në përputhje me Udhëzimet e Përgjithshme të Komitetit CRC⁵, lidhur me formën dhe përmbajtjen e Raporteve Periodike dhe Anekseve të këtyre Udhëzimeve.

Ky Raport përmban informacione lidhur me masat që ka ndërmarrë Shqipëria në zbatim të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga neni 44/1/b/2. Në këtë kuadër, Shqipëria paraqet progresin e bërë gjatë periudhës pas paraqitjes së Raportit të parë (2001-aktualisht), ndryshimet e bëra në aspektin ligjor dhe administrativ për zbatimin e dispozitave të Konventës dhe masat për zbatimin e Vëzhgimeve Përfundimtare të Komitetit CRC.

Me qëllim marrjen e një informacioni sa më të plotë lidhur me zbatimin e Konventës dhe Vëzhgimeve Përfundimtare të Komitetit CRC, në këtë Raport janë trajtuar dispozita të kuadrit ligjor (sipas fushave specifike), të cilat nuk janë evidentuar në Raportin e parë të paraqitur nga Shqipëria.

3. Në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 201, datë, 05.12.2007 “Për Ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e Raporteve Kombëtare në kuadër të Marrëveshjeve Ndërkombëtare në të cilat RSH-së është palë” është ngarkuar Ministria e Punëve të Jashtme me detyrën e hartimit të Raporteve Kombëtare Periodike në bashkëpunim me institucionet shtetërore, me qëllim që raportet të pasqyrojnë situatën aktuale, progresin e arritur, si dhe problemet në fushën e të drejtave të fëmijës. Raporti i Dytë, i Tretë dhe i Katërt Periodik lidhur me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, është përgatitur nga Ministria e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe të pavarura sipas fushës së kompetencës së tyre mbi çështjet që trajton kjo Konventë. Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit u ngrit Grupi Ndërinstitucional i Punës, në të cilin morën pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore (Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë), të institucioneve të pavarura (Gjykata e Lartë, Prokuroria e Përgjithshme, Avokati i Popullit) dhe institucione të tjera si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Komiteti i Birësimeve etj.

¹ Raporti fillestar i Shqipërisë CRC/C/11/Add 27.

² Lista e çështjeve CRC/C/Q/ALB/1, datë 14 tetor 2004.

³ Përgjigjet me shkrim CRC/RESP/77, datë 16.12.2004.

⁴ Vëzhgimet Përfundimtare, CRC/C/15/Add.249, datë 28.01.2005.

⁵ Udhëzimet e Përgjithshme (General Guidelines), CRC/C/58/Rev.1.

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

4. Shqipëria ka patur dhe vazhdon të ketë një angazhim të përhershëm, përta i përket përmirësimit të vazhdueshëm të standarteve, lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Shprehje e qartë e angazhimit të Shqipërisë është ratifikimi apo aderimi në pothuaj të gjitha Konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës. Gjithashtu Shqipëria ka aderuar në dy protokollat opsionale të Konventës për të Drejtat e Fëmijës: Protokollin Opsional “Mbi shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin me Fëmijë dhe Pornografinë” (miratuar me ligjin nr.9834, datë 22.11.2007; Protokollin Opsional “Mbi Përfshirjen e Fëmijëve në Konfliktet e Armatosura (miratuar me ligjin nr.9833, datë 21.12.2007).

5. Konventa për të Drejtat e Fëmijës, e cila pas ratifikimit në bazë të Kushtetutës së RSH-së është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm, përbën bazën për marrjen e masave të nevojshme për respektimin e të drejtave të parashikuara nga Konventa, gjithashtu për një reformë të përgjithshme të politikave sociale për të krijuar një mjedis mbrojtës për fëmijët, që nënkupton mjedisin familiar, institucionet, sistemet dhe shoqërinë që rrethojnë fëmijën.

6. Kushtetuta e RSH-së, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara që janë pjesë e sistemit ligjor të brendshëm, ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave dhe aktet nënligjore, garantojnë mbrojtje të përshtatshme dhe kujdes të posaçëm për fëmijët. Kuadri ligjor për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, është përmirësuar vazhdimisht, si dhe janë hartuar politika sociale duke u përafëruar me standartet ndërkombëtare. Objektiv i rëndësishëm mbetet marrja e masave të nevojshme për zbatimin në praktikë të akteve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, të rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare, si dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian.

7. Gjatë periudhës kohore, të cilës ky Raport i referohet, prioritet i politikave të qeverisë ka qënë integrimi i Shqipërisë në strukturat euro-atlantike, duke mbështetur plotësimin e standarteve për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, proceseve transformuese politike, ekonomike dhe sociale, përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë komunitar, etj. Negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit u hapën zyrtarisht për Shqipërinë, më 31 janar 2003 dhe në 12 Qershor 2006 Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian. Kjo Marrëveshje përfaqëson kuadrin strategjik të hartimit të politikave ekonomike e sociale të vendit. Me qëllim zbatimin e detyrimeve ndaj Marrëveshjes, qeveria shqiptare hartoi dhe miratoi Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integritimit. Nënshkrimi i Marrëveshjes shënon një hap të ri përpara drejt procesit të integritimit evropian të Shqipërisë dhe përbën një sfidë për të gjithë shoqërinë shqiptare, për plotësimin e angazhimeve që rrjedhin prej kësaj marrëveshje, pjesë e të cilave është dhe mbrojtja dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

8. Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, (i miratuar me VKM nr. 463, datë 5.07.2006, ndryshuar me VKM nr.577, datë 5.09.2007 dhe VKM nr.1317, datë 1.10.2008) konsideron si pjesë e rëndësishme ndërmarrjen e reformave ligjore, institucionale, reformën në sistemin e drejtësisë për garantimin dhe realizimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, sipas standarteve ndërkombëtare. Ky dokument përcakton dhe prioritetet e politikës së Qeverisë Shqiptare, lidhur me respektimin e të drejtave të të njeriut (përfshirë edhe të drejtat e fëmijës).

10. Si rezultat i reformave të ndërmarra në përmbushjen e angazhimeve ndërkombëtare, Shqipëria në muajin prill 2009 është anëtarësuar në NATO, angazhim, i cili nxit edhe më shumë realizimin e reformave në të gjitha fushat konform angazhimeve dhe detyrimeve ndërkombëtare.

I. MASAT E PËRGJITHSHME TË ZBATIMIT (nenet 4, 42, 44 të Konventës)

a) Follow-up. Masat për zbatimin e Vëzhgimeve Përfundimtare të Komitetit CRC.

Legjislacioni, zbatimi i tij. Reforma juridike, ngritja e kapaciteteve: Rekomandimi 7 i Komitetit CRC.

11. Kuadri ligjor shqiptar në të gjitha fushat përfshirë edhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve gjatë periudhës 2000- aktualisht është përmirësuar dhe plotësuar vazhdimisht. Promovimi, garantimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve përbën një ndër prioritetet e programeve dhe analizave legjislative e institucionale të ndërmarra dhe të realizuara gjatë periudhës 2000 – 2009 duke synuar përjasjen e me parimet dhe normat e Konventës.

12. Në muajin maj 2008 Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB), ka ndërmarrë iniciativën për hartimin e ligjit kuadër “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”. Qëllimet e këtij ligji janë miratimi dhe zbatimi i politikave ekzistuese që ndikojnë mbi të drejtat e fëmijëve, duke i përshtatur ato me standartet ndërkombëtare, si dhe vendosjen e një sistemi efektiv monitorimi lidhur me garantimin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve në nivel qendror dhe vendor. Për hartimin e ligjit janë ngritur 2 grupe pune me përfaqësues të ministrive të linjës dhe parlamentit.

13. Qeveria Shqiptare është angazhuar në zbatimin e reformave në sistemin e drejtësisë të sugjeruara dhe të mbështetura nga partnerët ndërkombëtarë, në bashkëpunim me institucionet e tjera kushtetuese, që përfshihen në sistemin e drejtësisë, si dhe në përputhje me angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i MSA-së. Bazuar në PKZMSA⁶, reforma në fushën e drejtësisë ka si qëllim rritjen e eficiencës të këtij sistemi, nëpërmjet garantimit të pavarësisë së organeve gjyqësore, rritjes së përgjegjshmërisë ndaj shoqërisë, dhe njëkohësisht përpjekje të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për mirëfunksionimin e tij. Kjo reformë ka si objektiva final përmbushjen e kërkesave për vendosjen e një sistemi drejtësie bashkëkohore nëpërmjet: a) konsolidimit të shtetit të së drejtës; b) garantimi i plotë i ndarjes dhe balancës ndërmjet pushteteve, duke synuar rritjen e pavarësisë së gjyqësorit nëpërmjet rritjes dhe forcimit të përgjegjshmërisë së gjyqësorit në dhënien e drejtësisë. c) përmirësimi i mekanizmave dhe procedurave ligjore që parandalojnë dhe luftojnë korrupsionin në mbrojtje të të drejtave të njeriut. d) sigurimi i transparencës në sistemin e drejtësisë dhe rritja e profesionalizmit eficiencës. e) sigurimi i bazave për bashkëpunim gjyqësor dhe integrimin në parimet e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë; f) funksionimi i plotë institucional dhe legjislativ në përputhje me sistemet evropiane gjyqësore dhe me *acquis communautaire*; kufizimi i imunitetit të gjyqtarëve dhe zyrtarëve të lartë shtetërorë, me qëllim lehtësimin e procedimit penal për vepra korruptive; g) forcimin dhe përmirësimin e sistemit penitenciar në përputhje me standartet ndërkombëtare; h) mbrojtja e viktimave dhe riintegrimi social i të dënuarve. Reforma në prokurori (si institucioni i akuzës) do të ketë si qëllim rritjen e efektivitetit të këtij institucioni në kryerjen e detyrave ligjore, në luftën ndaj krimit dhe korrupsionit. Iniciativat legjislative të parashikuara në zbatim të angazhimeve të ndërmarra në kuadrin e PKZMSA-së, synojnë rishikimin e kuadrit ligjor, që rregullon elementë të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë dhe organeve të ndryshëm që veprojnë në këtë sistem. Këto iniciativa ligjore kanë si qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor, si dhe harmonizimin e tyre, detajimin dhe ndarjen e qartë të kompetencave të secilit organ.

14. Në kuadrin e reformës në sistemin të drejtësisë është miratuar ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH-së”, i cili ka si qëllim realizimin e pavarësisë së sistemit

⁶ Miratuar me VKM nr.463, datë 5.07.2006, i ndryshuar me VKM nr.577, datë 5.09.2007 dhe VKM nr.1317, datë 1.10.2008.

gjyqësor me objektiv vendosjen e kushteve dhe garantimin e kriterëve të rekrutimit të gjyqtarëve në sistemin gjyqësor, në përcaktimin e masave disiplinore në rastet e thyerjes së rregullave të etikës morale dhe profesionale si dhe në promovimin dhe ngritjen në karrierë nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës.

15. Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë, realizon nëpërmjet projekteve trajnuese, trajnimin e gjyqtarëve, prokurorëve mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë për mbrojtjen efektive të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut⁷. Shkolla e Magjistraturës në aktivitetet e organizuara (trajnimin fillestar për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë, në sesionet trajnuese për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë) ka trajtuar tema të ndryshme, lidhur me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në kuadrin e PKZMSA-së Shkolla e Magjistraturës ka ndërmarrë këto angazhime: 1) Zhvillimi i sesioneve trajnuese në fusha të ndryshme të së drejtës për gjyqtarët dhe prokurorët dhe konkretisht edhe në fushën e të drejtave të njeriut, drejtësia për të miturit etj. 2) Trajnimin e Administratës Gjyqësore; 3) Përmirësimi i metodologjisë së mësimdhënies në trajnimin fillestar dhe vazhdues në Shkollën e Magjistraturës.

Koordinimi për zbatimin efektiv të Konventës: Rekomandimet 9, 10 të Komitetit CRC.

16. Strategjia Kombëtare për Fëmijët (miratuar me VKM nr. 368, datë 31.5.2005) përcakton objektivat strategjike në fushën e mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve, duke nxitur dhe forcuar bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me të gjithë institucionet përgjegjëse në nivel qendror, vendor, shoqërisë civile dhe me pjesëmarrjen aktive të komunitetit dhe të individit në këtë proces. Institucionet e nivelit qendror, të përfshira direkt në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët janë: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale e Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë si edhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Duke u mbështetur në informacionet administrative dhe ato që rezultojnë nga studime të ndryshme, këto institucione raportojnë në qeveri për realizimin e të drejtave të fëmijëve. Në Strategjinë Kombëtare për Fëmijët, theksohet se duhet të ngrihet mekanizmi institucional për monitorimin e realizimit dhe efektivitetin e politikave kombëtare dhe rajonale për realizimin e të drejtave të fëmijëve. Në nivel qendror është krijuar si organi më i lartë vëzhgues Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve, i cili funksionon si organ këshillimor pranë Këshillit të Ministrave dhe garanton përfshirjen e politikave për respektimin e të drejtave të fëmijëve në politikat e zhvillimit. Ky Komitet drejtohet nga Zëvendëskryeministri dhe në përbërje ka si anëtarë ministrat e linjës dhe 2 përfaqësues të OJF-ve për të drejtat e fëmijëve. Aktiviteti i Komitetit Ndërmintor mbështetet nga Sekretariati Teknik për Fëmijët, strukturë në Ministrinë e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, i cili ka përgjegjësinë të ndjekë zbatimin e objektivave të Strategjisë. Gjithashtu misioni i Sekretariatit Teknik të Fëmijëve është vlerësimi dhe raportimi me qëllim informimin e opinionit publik, si edhe të vendimmarrësve në nivel qendror e vendor lidhur me problemeve më kritike në lidhje me të drejtat e fëmijëve⁸.

17. Procesi për ngritjen e mekanizmit institucional për monitorimin dhe realizimin e politikave kombëtare dhe rajonale për të drejtat e fëmijëve ka përfunduar në nivel qendror dhe janë hedhur hapa për shtrirjen e tij në nivel rajonal. Në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe me mbështetjen e donatorëve janë ngritur Njësitë për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Konkretisht duke filluar nga viti 2006 ka filluar puna për ngritjen e njërive për të drejtat e fëmijëve, në nivel qarku dhe bashkie dhe aktualisht këto njësi funksionojnë në 4 qarqe dhe 11 bashki. Gjithashtu janë vlerësuar të

⁷ Informacion më i detajuar lidhur me trajnimet jepet në komentet mbi rekomandimin 20.

⁸ Informacion lidhur me detyrat e këtyre institucioneve paraqitet me poshtë, në pjesën "Mekanizmat e krijuara për zbatimin e të drejtave të parashikuara nga Konventa".

nevojshme përmirësime në legjislacion për të krijuar hapësira në ngritjen e strukturave të reja për fëmijët, por edhe për të siguruar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe vendosur mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet strukturave në nivel vendor, qendror dhe shoqërinë civile. Përmirësimet e mëtejshme të legjislacionit si edhe të skemës institucionale synojnë të reflektojnë kërkesat dhe standartet e akteve ndërkombëtare, të ratifikuara nga qeveria shqiptare, si dhe rritjen e efektivitetit për zbatimin e politikave sociale. Këto çështje do të gjejnë zgjidhje nëpërmjet hartimit të ligjit kuadër për të drejtat e fëmijëve.

Roli dhe përgjegjësitë e pushtetit vendor- Rekomandimi 10 i Komitetit CRC

18. Megjithëse zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Fëmijët konsiderohet si detyrim ligjor i strukturave të qeverisjes qendrore, me decentralizimin e kompetencave, edhe pushteti vendor është përfshirë në procesin e institucionalizimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Strukturat e pushtetit vendor gradualisht po ndërmarrin dhe ushtrojnë përgjegjësitë e tyre për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm, në disa bashki dhe qarqe janë ngritur njësitë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, duke synuar që dalëngadalë të plotësohet kuadri i plotë i mekanizmit. Struktura të tilla janë ngritur në 4 qarqe (Elbasan, Vlorë, Kukës, Korçë) dhe në 11 bashki (Elbasan, Pogradec, Korçë, Fier, Gjirokastrë, Kukës, Kuçovë, Durrës, Sarandë, Peshkopi, Shkodër). Strukturat e reja miratohen nga Këshilli i Qarkut/Bashkiak dhe mbështeten e kualifikohen nga OJF-të që zbatojnë projektet përkatëse, duke u mbështetur në një Memorandum Bashkëpunimi, të nënshkruar nga Kryetari i Qarkut/Bashkisë dhe OJF-së. Këto struktura janë mbështetur kryesisht nga UNICEF, USAID dhe një grup OJF-sh (fondacioni Terre des hommes, Save the Children, World Vision, Partnerë për Fëmijët, Shoqata për Viktimat e Minave).

19. Sekretariati Teknik i Fëmijëve në bashkëpunim me OJF që po pilotojnë këto struktura të reja, po punon për modelimin dhe unifikimin e konceptit dhe metodikës së punës së Njësive për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Pas vlerësimit të fazës së pilotimit të këtyre njësive, është synuar që eksperiencia të shtrihet në të gjithë vendin. Aktualisht është në proces hartimi dhe diskutimi i protokollit të punës së njësive në bashki, për mbrojtjen e fëmijëve. Protokollin përbëhet nga kapitujt si: 1) Detyrat e punonjësit të mbrojtjes së fëmijëve në bashki; Identifikimi dhe menaxhimi i rastit; 2) Vlerësimi i situatës së fëmijës nëpërmjet përcaktimit të nivelit të rrezikut; 3) Hartimi i Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës dhe zbatimi i tij. Ky dokument është e rëndësishëm të pasqyrohet në legjislacion për të siguruar mekanizmin që do të koordinojë dhe monitorojë zbatimin e politikave për respektimin e të drejtave të fëmijëve.

20. Njësia për të Drejtat e Fëmijëve (NJDF), është ngritur brenda strukturës administrative të qarkut dhe ka për detyrë: a) Të identifikojë dhe koordinojë referimin e rasteve të shkeljeve apo abuzimit, keqpërdorimit të të drejtave të fëmijëve në nivel rajonal. b) Të vëzhgojë dhe vlerësojë mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe politikave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në nivel rajonal. c) Të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacion me zyrën e Statistikave, Drejtorinë Rajonale të Shëndetit Parësor, Drejtorinë Rajonale të Arsimit, Zyrën e Regjistrimit të Gjendjes Civile, Seksionin e Ndihmës Ekonomike dhe pagesës së paafëtisë në Bashki dhe Komuna si edhe çdo institucion tjetër të qeverisjes vendore apo shoqërisë civile. d) Të raportojë në Këshillin e Qarkut për ecurinë e procesit të respektimit të të drejtave të fëmijëve në rajon.

21. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF), është ngritur brenda strukturave administrative të shërbimeve sociale në bashki në bazë të një memorandumi mirëkuptimi mes bashkisë përkatëse dhe OJF-së zbatuese. Në kuadër të këtij Memorandumi, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve financohet në

mënyrë të përbashkët nga bashkia dhe OJF për një periudhë kalimtare 3-vjeçare. Në përfundim të kësaj periudhe njësia do të financohet dhe do të administrohet vetëm nga bashkia Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve kanë këto funksione kryesore: a) Identifikimin e menaxhimin e rasteve në mënyrë multidisiplinare. b) Vlerësimin, monitorimin e situatës së familjeve dhe fëmijve në rrezik. Koordinimin e mbrojtjes dhe referimin e rasteve në nivel lokal. c) Sensibilizimin e komunitetit.

22. Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve bashkëpunon me administratorët shoqërore sipas ndarjeve administrative të bashkisë, psikologët e shkollave, mjekun e familjes, policinë anti-trafik dhe policinë e rendit, punonjësit social të qendrave të shërbimeve publike e jopublike në territorin e Bashkisë. Për çdo fëmijë të identifikuar si fëmijë në rrezik, punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve organizon një ekip multidisiplinar sipas nevojave dhe situatës së fëmijës. Ekipi vlerëson rastin, nivelin e rrezikut, përcakton hapat që do të ndiqen dhe detyrat e secilit aktor. Fëmija dhe familja e tij monitorohen në mënyrë të vazhdueshme nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve deri atëherë kur fëmija konsiderohet “jo në rrezik”. Strukturat për Mbrojtjen e Fëmijëve në bashki shërbejnë edhe si drop - in center, ku fëmijët dhe familjet mund të marrin informacion apo të referohen tek shërbime të tjera mbështetëse, sipas nevojave.

Plani Kombëtar i Veprimit. Rishikimi i Strategjisë Kombëtare për fëmijët;- Rekomandimi 12:

23. Duke marrë parasysh Rekomandimet e Komitetit CRC, në vitin 2005, qeveria shqiptare miratoi Strategjinë Kombëtare për Fëmijët 2005-2010 dhe Planin e saj të Veprimit, të bazuar në strategjitë sektoriale të arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale. Po në vitin 2005 qeveria shqiptare miratoi sistemin e integruar të planifikimit strategjik, i cili u pasua nga një proces dy vjeçar për hartimin e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale në të cilat u mbështet edhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013. SKZHI do të shërbente si një vision afat-mesëm për planifikimin e politikave dhe për zbatimin e të gjithë strategjive sektoriale, ndërsektoriale, planifikimin e buxhetit duke pasur parasysh përfshirjen e objektivave dhe masave të përcaktuara në MSA dhe në Planin e Veprimit për Partneritetin në NATO (Membership Action Plan- MAP).

Në këtë kontekst rishikimi i Planit të Veprimit të Strategjisë për Fëmijët u drejtua nga domosdoshmëria për të siguruar harmonizimin e kësaj Strategjie me programet politike strategjike të Qeverisë, SKZHI, MSA.

24. Ndonëse SKF është 5 vjeçare, analiza e arritjes së objektivave të saj krijon kushtet për rivlerësimin e këtyre objektivave dhe synimeve, si edhe të mekanizmave zbatues. Prej vitit 2006, STF ka hartuar disa raporte 6 mujore dhe tre raporte vjetore, në të cilat është analizuar dhe vlerësuar ecuria në zbatimin e objektivave të SKF, si dhe janë paraqitur rekomandime për përmirësime të mëtejshme për zbatimin e strategjisë. Raportet periodike të hartuara nga Sekretariati i Fëmijëve synojnë: 1) Analizimin e nivelit të realizimit të Strategjisë nëpërmjet matjes dhe vlerësimit të treguesve të pranuar me qëllim që të sigurohet një pasqyrë e situatës reale të zbatimit të të drejtave të fëmijët në nivel kombëtar. 2) Identifikimin e çështjeve kritike në përmbajtjen e strategjisë si edhe në zbatimin e saj, me qëllim hartimin e rekomandimeve për përmirësime në politikat që lidhen me të drejtat e fëmijëve në të ardhmen. 3) Propozime mbi drejtimit në të cilat nevojitet mbështetje institucionale apo financiare, nga qeveria qendrore, donatorët apo shoqëria civile.

Me qëllim për të diskutuar për rishikimin dhe përmirësimin e dokumentave të strategjisë dhe planit të saj të veprimit, Sekretariati Teknik i Fëmijëve në muajin mars 2007, mbledhi në një tryezë të rrumbullakët të gjitha pikat e kontaktit në ministritë e linjës, përgjegjëse për zbatimin e strategjisë dhe disa OJF që bashkëpunojnë me Sekretariatit në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve. Gjatë vitit 2007 është krijuar grupi i punës për rishikimin e këtij dokumenti.

25. Në mbledhjen e parë të Komitetit Ndërministror për të Drejtat e Fëmijëve (korrik 2007), u analizua veprimtaria e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e politikave mbi të drejtat e fëmijëve. Me qëllim rritjen e efektivitetit të politikave sociale për të realizuar objektivat e SKF, Komiteti rekomandoi: 1) Rishikimin e Planit të Veprimit të Strategjisë në drejtim të hartimit të mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit, duke përcaktuar tregues monitorimi të matshëm, të shoqëruar me zërat buxhetore përkatës. 2) Buxhetet e domosdoshme për zbatimin e politikave që lidhen me realizimin e objektivave të SKF të përfshihen tek Plani i Veprimit të Strategjisë, duke përcaktuar edhe fondet që aktualisht akordohen nga buxheti i shtetit për këtë qëllim. 3) Zgjerimi i partneritetit me shoqërinë civile për të rritur solidaritetin shoqëror për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

26. Gjatë periudhës 2007-2008 u arrit rishikimi i planit të veprimit të Strategjisë në dy drejtime: 1. Hartimi i sistemit të treguesve të domosdoshëm për të matur dhe vlerësuar ecurinë në zbatimin e planit të veprimit duke iu referuar sistemit të treguesve të SKZHI-së. 2. Buxhetimi i politikave që lidhen me të drejtat e fëmijëve, duke u mbështetur në Planin Afat Mesëm të Buxhetit.

Realizimi i këtyre dy komponentëve siguroi përfshirjen e Planit Kombëtar të Veprimit për Fëmijë në SKZHI, duke institucionalizuar përfshirjen e të drejtave të fëmijëve në planet strategjike afatgjata të Qeverisë, si edhe duke sanksionuar buxhetimin e tyre. Konkretisht hartimi i Planit të Ri të Veprimit të Strategjisë u mbështet në strategjitë sektoriale të shëndetit, arsimit, mbrojtjes sociale, të ndryshuara në kuadër të SKZHI, Planin Buxhetor Afatmesëm 2008-2010, programet e ministrive të linjës dhe në Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Llogaritja e kostove të politikave që garantojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve, si edhe buxhetimi i tyre është bazuar në kostot për njësi të paraqitura në PBA-në 2008-2010. Për politikat për të cilat informacioni për kostot për njësi mungon, është bërë vlerësimi i buxhetit të alokuar duke konsideruar treguesin e raportit të fëmijëve ndaj totalit të popullsisë. Projektet e hartuara nga donatorë dhe të zbatuar në bashkëpunim me qeverinë kanë shërbyer si burim informacioni për të llogaritur koston e politikave specifike. Realizimi i komponentëve të mësipërm, siguroi përfshirjen e Planit Kombëtar të Veprimit për Fëmijë në SKZHI, duke institucionalizuar përfshirjen e të drejtave të fëmijëve në planet strategjike afatgjata të Qeverisë, si edhe duke sanksionuar buxhetimin e tyre. Plani i veprimit me kostot dhe me tregues specifikë monitorimi do të shërbejë si dokument bazë për vlerësimin e ecurisë së procesit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët nga Sekretariati Teknik i Fëmijëve.

Këto reforma duke u harmonizuar edhe me miratimin e ligjit për të Drejtat e Fëmijëve edhe institucionalizimin e procesit të matjes e vlerësimit të ecurisë në realizimin e të drejtave të fëmijës.

27. Në zbatim të disa objektivave të Strategjisë Kombëtare për Fëmijë përcaktohet ngritja e sistemeve të referimit apo menaxhimit të rasteve të fëmijëve të dhunuar, abuzuar apo trafikuar⁹.

Strukturat e pavarura monitoruese: Rekomandimi 14 i Komitetit CRC:

28. Nënseksioni për të Drejtat e Fëmijëve (NDF) pranë Avokatit të Popullit është krijuar në prill 2004 në bazë të një marrëveshjeje mirëkuptimi midis organizatës “Save the Children” në Shqipëri dhe Zyrës të Avokatit të Popullit¹⁰. Mandati i NDF-së ishte të “shërbejë si një avokat, një katalizator dhe një organ monitorues i të drejtave të fëmijëve sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Detyra kryesore e këtij Nënseksioni, në përbërje të Seksionit të Përgjithshëm, pranë Avokatit të Popullit është mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, në përputhje me Konventën, si dhe instrumenteve të tjera ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare. Më konkretisht veprimtaria e

⁹ Informacion më i detajuar jepet në vijim në komentet për nenet dhe rekomandimet përkatëse.

¹⁰ Kjo marrëveshje aktualisht ka përfunduar.

nëseksionit është përqendruar në: 1) Mbikqyrjen e veprimtarisë së administratës publike, si dhe të organizatave të tjera në shërbim të fëmijëve në Shqipëri me qëllim mbrojtjen e të drejtave të tyre. 2) Trajtimin e ankesave, kërkesave apo njoftimeve që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të fëmijëve. 3) Paraqitjen e rekomandimeve mbi përmirësimin e legjislacionit ekzistues mbi të drejtat e fëmijëve. 4) Promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe të veprimtarisë të organeve të administratës publike mbi mënyrën e ushtrimit të detyrimeve të tyre ndaj fëmijëve. 5) Ndërgjegjesimin e shoqërisë shqiptare në përgjithësi për të drejtat dhe detyrimet ndaj fëmijëve, ndërgjegjësimi i mediave dhe bashkëpunimi me OJF-të që kanë objekt të punës së tyre fëmijët.

29. Projekti i përbashkët 3 vjeçar i Nënseksionit për të Drejtat e Fëmijve me organizatën “Save the Children”.

Organizata “Save the Children” aplikoi në vitin 2004 pranë SIDA-s (Agjensisë Suedeze për Vendet në Zhvillim) për financimin e ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe forcimin e këtij Nënseksioni. Ky projekt u miratua në janar 2006, për një periudhë kohore prej tre vjetësh dhe përfshinte shumë aktivitete për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si rritje të ndërgjegjësimit të opinionit publik për misionin dhe rolin e Nënseksionit; ndërtim kapacitetesh dhe trajnim të burimeve njerëzore, asistencë teknike, mbështetje infrastrukturore, punë kërkimore, ndërhyrje direkte në rast shkelje të të drejtave të fëmijëve, pjesëmarrje të fëmijëve, etj. Disa nga aktivitetet më të rëndësishme të projektit ishin krijimi i një ambjenti vetëm për fëmijët pranë Zyrës së Avokatit të Popullit në Tiranë, ngritja e dy qendrave rajonale në Shkodër dhe Korçë për fëmijë, bashkëpunim dhe koordinim i punës me institucionet e tjera shtetërore dhe shoqërinë civile, monitorim i legjislacionit aktual dhe propozime për ndryshime etj. Nënseksioni pati tre zyra konkretisht pranë Zyrës Qendrore të Avokatit të Popullit dhe dy zyra Rajonale, një në Shkodër dhe një në Korçë në vitin 2005. Stafit të Institucionit të Avokatit të Popullit, iu bashkangjiten pesë juristë, të cilët u paguan nga Save the Children për vitet 2006-2007. Kurse për 6-mujorin e parë të vitit 2008 u paguan vetëm dy; një në Shkodër dhe një në Korçë nga buxheti i institucionit. Tashmë ato zyra janë mbyllur për mungesë buxheti. Embrioni i Nënseksionit vepron vetëm në zyrën qendrore në Tiranë, ku një ndihmëskomisioner merret vetëm me problemet e fëmijëve.

30. Gjatë vitit 2006 Nënseksioni për të Drejtat e Fëmijve (NDF) ka punuar kryesisht në drejtim të ngritjes së zyrave rajonale të NDF-së, plotësimit të stafit të tyre dhe promovimit e Nënseksionit në nivel kombëtar e rajonal. Funkcionet kryesore të Zyrave Rajonale kanë qenë: a) marrja e ankesave për shkeljet e të drejtave të fëmijëve; b) monitorimi i zbatimit të të drejtave të fëmijëve në institucionet publike rajonale; c) vendosja dhe forcimi i bashkëpunimit me aktoret kryesore rajonale për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e një sistemi bashkëpunimi të ndërsjellë me OJF-të vendore që punojnë për fëmijët; promovimi i të drejtave të fëmijëve në rajonin përkatës.

31. Rezultatet e arritura nga projekti me “Save the Children” kanë qënë: 1. Fuqizimi dhe kualifikimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Zyrës së Avokatit të Popullit dhe në veçanti të Nënseksionit për të realizuar mbrojtje me të mirë të të drejtave të fëmijëve. 2. Grumbullimi i informacionit mbi praktikën më të mira ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. 3. Studimi i legjislacionit shqiptar dhe puna parapërgatitore për të bërë rekomandime për përmirësimin e legjislacionit në favor të fëmijëve. 4. Nxjerrja e disa konkluzioneve, për t’i raportuar Kuvendit të Shqipërisë nevojën e forcimit të institucioneve shtetërore që merren me mbrojtjen e fëmijëve. Hapja e zyrave rajonale lehtësoi procesin e ankimit të qytetarëve edhe për çështje të tjera pranë Institucionit të Avokatit të Popullit. Megjithë kohën e shkurtër rreth 2-vjeçare të funksionimit të këtyre zyrave, pati një rritje të ankesave të depozituara në Zyrat Rajonale (Korçë, Shkodër).

32. Fushata sensibilizuese për të drejtat e fëmijëve: Institucioni i Avokatit të Popullit ka zhvilluar një fushatë të gjerë sensibilizimi për njohjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve, jo vetëm në korrespondencat ndërinstitucionale, por edhe në mediat elektronike dhe të shkruara. Veprimtaria e NDF-së është prezantuar në mediat kombëtare dhe lokale, si dhe janë publikuar artikuj në gazetat e përditshme kombëtare etj. Gjatë vitit 2007 janë përgatitur dy spoteve publicitare informuese për krijimin e NDF-së, të cilat janë transmetuar në mediat kryesore kombëtare dhe lokale. Si rezultat i fushatës sensibilizuese, ka patur një rritje të ndjeshme të numrit të ankesave.

33. Shqyrtimi i ankesave: Në vitin 2005 janë shqyrtuar nga NDF 39 ankesa apo kërkesa, nga shqyrtimi i të cilave 10 kanë marrë zgjidhje pozitive.

Në vitin 2006 janë shqyrtuar 46 ankesa për shkelje të të drejtave të fëmijëve, nga të cilat 8 ankesa kanë marrë zgjidhje pozitive.

Megjithëse ka patur një rritje të numrit të rasteve të trajtuara, vazhdojnë që ankesat për fëmijët të vijnë nga prindërit ose të afërmit e tyre dhe vetëm 1 ankesë është bërë nga fëmijët. Rastet e trajtuara gjatë vitit 2006 kanë qënë të fushave të ndryshme, por kryesisht objekt i këtyre ankesave në përgjithësi ka qënë mbi trajtimin e veçantë të fëmijëve, me te drejt[n e prezencës së prindit gjatë pyetjes së tyre, gjendjes fizike të dëmtuara të shkollave, me mosregjistrimin e fëmijëve nga Zyrat e Gjendjes Civile pranë Bashkive, mos prezenca e psikologut/punonjësit social gjatë intervistimit të fëmijëve nga organet e policisë, fëmije të humbur jashtë territorit të Shqipërisë, probleme të mospërfitimit të së drejtës së kujdestarise për fëmijët me aftësi të kufizuara, probleme të mospërfitimit të pensionit familjar për fëmijët e mbetur jetimë pas vdekjes së një prindi, mostrajtimin e duhur mjekësor për fëmijët e sëmurë, mosekzekutim vendimesh gjyqësore që kanë lidhje me fëmijët, etj.

Në vitin 2007 ka patur një rritje të ndjeshme të numrit të ankesave. Nga 136 ankesa të trajtuara , 43 janë zgjidhur pozitivisht. Kurse për 9-mujorin e vitit 2008 janë paraqitur pranë Avokatit të Popullit 61 ankesa, nga të cilat 20 janë zgjidhur pozitivisht, kurse 4 janë në shqyrtim.

Rastet e trajtuara gjatë 2007 kanë qënë të fushave të ndryshme, por kryesisht objekti i ankesave ka qënë i lidhur me trajtimin e veçantë të fëmijëve, me përmirësimin e kushteve në shkolla dhe trajtimin e nxënësve, mosdhënien e ndihmës ekonomike nga bashkia dhe përfitimin e statusit të jetimit, mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor të prindërve, vendosjen e fëmijëve jetimë në qendra rezidenciale, përmirësimin e kushteve të strehimit, shkeljen e të drejtave të fëmijëve nga organet e administratave të shteteve të huaja, mosregjistrimin e fëmijëve, dhe moszbatimin e procedurave ligjore për rastet e fëmijëve në konflikt me ligjin, etj. Vihet re një rënie e ankesave për keqtrajtim e fëmijëve në komisarate.

Në vitin 2008 Zyra e Avokatit të Popullit duke përfshirë dhe Nënseksionin për të Drejtat e Fëmijëve, ka shqyrtuar gjithsej 96 raste ankesash që kanë patur lidhje me të drejtat e fëmijëve. Nga këto, 36 kanë rezultuar jashtë juridiksionit apo kompetencës së Avokatit të Popullit, 33 ankesa apo kërkesa të pabazuara, janë në shqyrtim 7 ankesa dhe 38 ankesa të zgjidhura në mënyrë pozitive, 11 ankesa janë konkluduar me rekomandime apo propozime të pranura nga organet e administratës.

34. Në muajin mars 2005 Avokati i Popullit i dërgoi Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë dhe Kryeministrit një informacion lidhur me rekomandimet e Komitetit të të Drejtave të Fëmijës, si dhe detyrat që i dalin Nënseksionit për të Drejtat e Fëmijëve, duke kërkuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre.

Në kuadrin e masave me karakter ndërgjegjësues që rekomandoi Komiteti CRC, në Konferencën vjetore në dhjetor 2005, ka zënë një vend të rëndësishëm situata e mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri dhe rolit të Nënseksionit për këtë qëllim. Konkluzionet dhe rekomandimet e kësaj Konference, ju dërguan të gjitha institucioneve kryesore, puna e të cilave ndikon në politikat e mbrojtjes dhe zhvillimit të të drejtave të fëmijëve në vendin tonë. Gjithashtu edhe në konkluzionet

dhe rekomandimet e disa Konferencave të tjera vjetore, që ka zhvilluar Avokati i Popullit si p.sh “Në mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar” (viti 2006), etj, në fokus dhe një kapitull i veçantë i është kushtuar gjithmonë mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve.

Avokati i Populli, ka dërguar në Kuvendin e Shqipërisë Raportin e Posaçëm (Mbi të drejtat e fëmijëve) për të bërë të njohur më në thellësi gjendjen e fëmijëve, veprimtarinë e institucionit në këtë fushë, si dhe nevojën për krijimin e bazës së nevojshme ligjore për institucionalizimin dhe forcimin e punës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ky synim i fundit arrihet ose nëpërmjet shtesave e ndryshimeve në ligjin “Për Avokatin e Popullit” ose nëpërmjet krijimit të një Institucioni të posaçëm të pavarur. Objektivi themelor i krijimit të një institucioni të veçantë e të qëndrueshëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, është ngritja e standardeve të përmirësimit të të drejtave dhe shërbimeve për fëmijët, për të ndikuar më shumë në politikat dhe praktikat e qeverisë, në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët, si dhe të Strategjisë Kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktima të trafikimit.

Shpërndarja e burimeve financiare. Rekomandimi 16 i Komitetit CRC.

35. Në bazë të ligjit nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për Ndhimën Ekonomike dhe Shërbimet Sociale”, familjet e varfëra me të ardhura të pakta ose pa të ardhura (dhe nëpërmjet tyre edhe fëmijët e varfër) mbështeten nga programi i ndihmës ekonomike. Në bazë të këtij ligji familjet e varfëra (dhe nëpërmjet tyre edhe fëmijët e varfër) apo individë me të ardhura të pakta ose pa të ardhura mbështeten nga programet e mbrojtjes sociale: 1) Programi i Ndhimës Ekonomike; Ndhima ekonomike është programi kryesor për mbështetjen e familjeve të varfëra, me të ardhura të pakta ose pa të ardhura. Sipas programit të ndihmës ekonomike, pushteti qendror, në bazë të kërkesave për fonde, u shpërndan bashkive dhe komunave bllok grante të kushtëzuara për mbulimin e nevojave të familjeve të varfëra. Njësitë e qeverisjes vendore i administrojnë këto fonde nëpërmjet marrjes dhe kontrollit të aplikimeve sipas rregullave që përcakton pushteti qendror për pranimin dhe përfitimin e ndihmës ekonomike (megjithatë pushteti vendor ka të drejtë të vendosë kritere të veçanta për të mbështetur familjet e varfëra nga burimet e veta). 2) Programi i Pagesës së Paaftësisë; 3) Programi i shërbimeve shoqërore. Dy programet e para ofrojnë mbështetje në kesh. Gjatë këtyre viteve është synuar që të përmirësohen kriteret e përzgjedhjes së familjeve duke bërë të mundur që ndihma ekonomike të shkojë të familjet e varfëra, të ulet numri i rasteve abuzive dhe të rritet pagesa mesatare mujore për familje¹¹.

36. Gjatë periudhës 2007-2008 u arrit rishikimi i Planit të Veprimit të Strategjisë për Fëmijët në dy drejtime: 1) Hartimi i sistemit të treguesve të domosdoshëm për të matur dhe vlerësuar ecurinë në zbatimin e planit të veprimit duke iu referuar sistemit të treguesve të SKZHI. 2) Buxheti i politikave që lidhen me të drejtat e fëmijëve, duke u mbështetur në Planin Afat Mesëm të Buxhetit 2008-2010 të ministrive të linjës. Realizimi i këtyre dy komponentëve siguroi përfshirjen e Planit Kombëtar të Veprimit për Fëmijë në SKZHI, duke institucionalizuar përfshirjen e të drejtave të fëmijëve në planet strategjike afatgjata të Qeverisë si edhe duke sanksionuar buxhetimin e tyre.

37. Planifikimi i burimeve financiare për politika sociale në mbrojtje të grupeve të përjashtuara mbështetet mbi analizën e nevojave, por kufizohet nga mundësitë që ka buxheti i shtetit. Në nivel vendor, burimet financiare për politika sociale janë të kufizuara, megjithëse procesi i decentralizimit mbetet prioritet i qeverisë. Ligji mbi decentralizimin nuk qartëson çështjen se si do të alokohen buxhetet lokale për qëllime

¹¹ Të dhëna mbi numrin e familjeve, fondet vjetore dhe masën e ndihmës ekonomike në vite jepen në anekset bashkëlidhur këtij Raporti.

sociale. Megjithatë ekzistojnë hapësirat ligjore për përfshirjen e pushtetit vendor në administrimin dhe drejtimin e shërbimeve publike ekzistojnë.

Parandalimi dhe eliminimi i korrupsionit.

37. Kuadri ligjor mbi luftën kundër korrupsionit. Me ligjin nr. 9275, datë 16.09.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal”, u synua parashikimi i dispozitave ligjore mbi korrupsionin në administratën publike, por edhe në sektorin privat, duke parashikuar elementet bashkëkohore dhe karakteristike për format e korrupsionit aktiv dhe pasiv, të kryer nga funksionarë publike apo në sektorin privat, duke bërë përshkallëzimin sistematik të sanksioneve me burgim kundër fajtorëve për këto vepra penale nisur nga lloji dhe natyra e subjektit dhe funksionit publik, përfshirë edhe dënimin e e njëkohshëm me gjobë të tyre. Gjithashtu është rishikuar edhe përmbajtja e sanksioneve të dënimeve plotësuese që zbatohen ndaj tyre si p.sh. për heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike, etj. Në Kodin Penal janë parashikuar një sërë dispozitash që parashikojnë veprën penale të korrupsionit, si dhe sanksionet penale përkatëse (kundravajtje penale, apo burgim). Në bazë të KP, korrupsioni parashikon premtimin, propozimin ose dhënien, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tretë, për të siguruar të mira ose përfitime, ose për të refuzuar kryerjen e detyrimeve). Konkretisht në KP janë parashikuar këto dispozita: 1) Neni 164/a - Korrupsioni aktiv në sektorin privat. 2) Neni 164/b - Korrupsioni pasiv në sektorin privat. 3) Neni 244 - Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike. 4) Neni 245 - Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendore. 5) Neni 245/1 - Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që mbajnë funksione publike. 6) Neni 248 - Shpërdorimi i detyrës. 7) Neni 259 - Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike. 8) Neni 260 - Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë. 9) Neni 312 - Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit. 10) Neni 319 - Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë. 11) Neni 319/a - Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë.

Në ligjin nr. 10005, datë 23.10.2008 “Për një shtesë në ligjin “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, është parashikuar një dispozitë lidhur me përgjegjësinë e organeve të administratës shtetërore për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë apo juridikë privat, në rastin e kryerjes së një akti korruptiv.

Ligji 10053, datë 29.12.2008 “Për një shtesë në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, parashikon pavlefshmërinë e akteve të nxjerra për masa apo sanksione administrative, të dhëna si pasojë e një akti korruptiv. Ky ligj plotëson kuadrin ligjor mbi parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe realizon detyrimin e shtetit shqiptar si shtet anëtar në Konventën e Këshillit të Evropës “Për Korrupsionin Civil”.

Është amenduar ligji për parandalimin e Konfliktit të Interesave, është miratuar ligji për bashkëpunimin e qytetarëve dhe shpërblimin e atyre që denoncojnë korrupsionin, ligji për përgjegjësitë penale të personave juridikë etj.

Gjithashtu është ratifikuar Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit.

38. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit sipas Transparency International ka njohur përmirësim të ndjeshëm, nga 2,4 në vitin 2005, është ngritur në 2,6 në vitin 2006, në 2,9 në vitin 2007 dhe në 3.4 për vitin 2008. Si rrjedhojë e përmirësimit të indeksit Shqipëria ka një përmirësim në renditjen e vendeve. Për vitin 2007 Shqipëria është renditur në vendin e 85-të ndër 180 vende, kurse në vitin 2005 renditej e 126-ta midis 158 vendeve.

39. Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO): Në lidhje me raundin e 2 të vlerësimit mbi: Identifikimin, kapjen, konfiskimin e procedurave të korrupsionit, Parandalimin dhe gjetjen e korrupsionit në administratën publike dhe Parandalimin e personave ligjore (koorporatave etj) të përdorura si mjete për korrupsion, Shqipëria ka plotësuar plotësisht 7 nga 13 rekomandimet e GRECO-s të lëna nga Raporti i Vlerësimit (dhjetor 2007) dhe po punon për plotësimin edhe të dy rekomandimeve të papërbushura dhe 4 të përbushura pjesërisht. Është punuar për përgatitjen e udhëzuesve për tipologjinë e korrupsionit dhe trajnime për stafet e institucioneve.

40. Instrumentat e luftës kundër korrupsionit. Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit dhe Qeverisjen Transparente (2008 – 2013), si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim (e miratuar me VKM nr. 1561, datë 3.10.2008) përcakton objektivat, masat dhe afatet që duhet të ndërmarrin institucionet e përfshira në luftën kundër korrupsionit për parandalimin dhe eliminimin e këtij fenomeni. Për zbatimin e strategjisë, është miratuar Plani i integruar i veprimit për vitin 2009.

Grupi Ndërmintorror i Punës është struktura përgjegjëse për mbikqyrjen, rishikimin e Strategjisë kundër korrupsionit si dhe hartimin e planeve vjetore të integruara të veprimit.

Task Force Antikorrupsion e drejtuar nga Kryeministri është struktura institucionale përgjegjëse në luftën kundër korrupsionit dhe synon të aktivizojë kapacitetet e institucioneve shtetërore për të reaguar dhe vepruar ndaj shfaqjeve të praktikave korruptive, abuzimeve, etj.

Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Bizneseve është ngritur sipas parimit one-stop-shop, e cila ka shkurtuar procedurën e regjistrimit të bizneseve në një ditë.

Është krijuar sistemi i pagimit të taksave on-line për bizneset e mëdha, e cila ndikon në minimizimin e korrupsionit. Është instaluar sistemi për prokurimin elektronik. Si dhe është ngritur institucioni i Avokatit të Prokurimeve, i cili shërben si garant i procesit prokurues.

Gjithashtu janë forcuar strukturat e kontrollit të brendshëm administrativ dhe financiar (Departamenti Antikorrupsion në Kryeministri, Strukturat e parandalimit të krimit ekonomik në Ministrinë e Brendshme, Njësia e Përbashkët e hetimit në Prokurinë e Përgjithshme).

41. Qeveria, nëpërmjet "Maturës shtetërore" ka reformuar sistemin e vlerësimit të maturanteve dhe të pranimit të studentëve në universitete, duke i dhënë fund praktikave të mundshme të korrupsionit, mbi pranimin në universitete, praktike që mund të kishin një ndikim negativ në edukimin e brezit të ri. Futja e "Altertekstit", liberalizimi i botimit të teksteve shkollërore, ka bërë që të eliminohet korrupsioni në subvencionimin e prodhimit, shpërndarjes së teksteve mësimore në shkolla.

42. Në çdo institucion janë ngritur dhe funksionojnë zyrat e informimit të publikut, të cilat japin informacion për procedurat, vendimet/aktet, shërbimet e administratës. Në institucionet shtetërore janë vënë në dispozicion të qytetareve, linja telefonike të hapura që mundësojnë denoncimin e rasteve të abuzimeve dhe praktikave korruptive.

Mbledhja e të dhënave nga INSTAT: - Rekomandimi 18 i Komitetit CRC.

43. Prej kohësh është evidentuar nevoja që kanë institucionet shqiptare dhe hartuesit e politikave për të siguruar përmirësimin e cilësisë së informacionit statistikor që lidhet me fëmijën. Informacioni statistikor do të ishte një mjet i fuqishëm për vendimmarrjen dhe hartimin e politikave, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me çështjen e të drejtave të fëmijëve. Në këtë kontekst, përpjekja për zhvillimin e kapaciteteve të brendshme, që do të kontribuonte në prodhimin dhe analizën e të dhënave, në informimin e opinionit publik, si dhe të shpërndarjen e informacionit që lidhet me çështjen e të drejtave të fëmijëve, solli krijimin e Qendrës për Kërkime Sociale. Kjo Qendër u ngrit pranë Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT), si institucioni kryesor përgjegjës për prodhimin

e statistikave nëpërmjet mbështetjes së UNICEF-it. Objektivi kryesor qendrës është i lidhur me përmirësimin e cilësisë së informacionit mbi fëmijën, të mbështesë prodhimin e të dhënave mbi treguesit sociale kryesorë, në nivel nacional dhe lokal për këtë grup të popullsisë, si dhe të zhvillojë kapacitetet lokale për kërkime dhe anketa. Gjithashtu Qendra e Kërkimeve Sociale ka qënë shumë aktive në Informimin e rregullt të institucioneve hartuese të politikave dhe aktorëve kryesorë rreth rezultateve të anketave dhe kërkimeve, si dhe në shpërndarjen e të dhënave të grumbulluara dhe të ruajtura në një bazë të dhënash, të krijuar për këtë qëllim. Gjatë vitit të fundit është parashikuar të kryhen një sërë aktivitetesh në funksion të transformimit të Qendrës në një observator kombëtar për monitorimin e të drejtave të fëmijës, si një zhvillim i rëndësishëm insitucional, i cili do të mundësojë: 1) Ngritjen dhe Stabilizimin e Observatorit të Fëmijëve në nivel qendror dhe më pas lokal. 2) Insitucionalizimin e sistemit të monitorimit (treguesit) e varfërisë së fëmijve.

Trajnimet dhe përhapja e Konventës Rekomandimi 20 i Komitetit CRC.

44. Trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Shkolla e Magjistraturës në programin e formimit të vazhdueshëm profesional për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, në Shkollën e Magjistraturës gjatë viteve të fundit janë zhvilluar një sërë aktivitetesh për trajtimin e tematikave mbi të drejtat e njeriut¹². Këto trajnime janë organizuar me pjesëmarrjen e ekspertëve të Këshillit të Evropës dhe shqiptarë. Gjithashtu në këtë program janë parashikuar trajnime mbi Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, mbi respektimin e të drejtave të njeriut gjatë procedimit penal. Në kuadër të programit të V-të të bashkëpunimit të Komisionit European dhe Këshillit të Evropës dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës ka realizuar trajnimin e administratës gjyqësore. Një fushë e rëndësishme në veprimtarinë e Shkollës është ajo e botimeve dhe studimeve juridike. Shkolla boton revistën e saj “Jeta Juridike” çdo 3-mujor, e cila është një botim shkencor që trajton tema të ndryshme si : njohja me legjislacionin e ri, njohje me praktikën gjyqësore, njohje me përvojën ndërkombëtare teorike dhe praktike, shkrime nga juristë, promovime të librave, informacion mbi aktivitetet e Shkollës me organet e drejtësisë etj.

45. Trajnimi i strukturave të Policisë¹³. Akademia e Policisë ka përfshirë në kurrikulat e saj për herë të parë, në vitin 2005, tema të veçanta për njohjen dhe respektimin e standarteve ndërkombëtare dhe kombëtare në fushën e respektimit të të drejtave të fëmijëve gjatë procedimit policor. Temat kryesore trajtojnë në mënyrë të sintetizuar standartet ligjore (sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale) në frymën e dokumentave ndërkombëtare, përfshirë Konventën për të Drejtat e Fëmijës, rregullat standarte etj. Përveç temave të veçanta për të drejtat e fëmijëve, në tema të tjera si intervistimi i dëshmitarëve, viktimave, reagimi ndaj dhunës në familje, trafikimi i qënieve njerëzore etj, i kushtohet vëmendje edhe rasteve kur janë të përfshirë të miturit.

46. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në bashkëpunim dhe partneritet me UNICEF, ka realizuar një cikël trajnimesh në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Ky projekt pati si qëllim rritjen më tej të kapaciteteve të punonjësve të Policisë së Shtetit të rolit të lartë dhe të mesëm për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, duke zbatuar rigorozisht procedurat e shoqërimit, marrjes në pyetje, trajtimit nëpër ambientet e policisë, si dhe sensibilizimin për t’i kushtuar atyre vëmendjen e duhur. Në partneritet me PNUD-in, gjatë vitit 2008 janë zhvilluar sesione trajnuese me struktura të policisë të të gjitha niveleve, në të gjitha Drejtoritë e Policisë në Qarqe, lidhur me rolin e policisë në zbatim të ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

¹² Informacion i detajuar lidhur me trajnimet e zhvilluara jepet në anekset bashkëlidhur Raportit.

¹³ Informacion i detajuar lidhur me trajnimet e punonjësve të policies jepet në ankeset bashkëlidhur Raportit.

47. Në drejtim të rritjes së Partneritetit në fushatat sensibilizuese të organizuara në mbrojtje të fëmijëve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ka bashkëpunuar edhe me institucione të tjera dhe me organizata jofitimprurëse që kryejnë veprimtari në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, “Terre des Hommes”, “Fondacioni për Zgjidhjen e Konfliktëve”, Bashkë Kundër Trafikimit të Fëmijëve (BKTF)) etj. Në këtë kuadër strukturat e policisë janë përfshirë në të gjitha projektet dhe aktivitetet sensibilizuese të organizuara në mbrojtje të fëmijëve.

48. Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI), ka organizuar një sërë trajnimesh mbi “Teknikat e Përshtatshme të Investigimit të Fëmijëve dhe të Drejtave të Fëmijëve, sipas Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”. Kjo Qendër në bashkëpunim me UNICEF janë organizuar trajnime me punonjës të policisë në lidhje “Mbi Kontributin Sistemik në Drejtësinë Penale për të Mitur”.

49. Trajnimi i punonjësve të shëndetësisë: Ministria e Shëndetësisë gjatë periudhës 2004-2009 ka zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme trajnime me personelin shëndetësor në të cilat evidentohet se Konventa për të Drejtat e Fëmijës është një detyrim për të siguruar një shëndet më të mirë për fëmijën dhe adoleshentin. Këto trajnime janë zhvilluar lidhur me shëndetin e fëmijës, shëndetin riprodhues dhe seksual, shëndetin amtar.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar çdo vit trajnime të vazhdueshme, me personelin shëndetësor të shërbimeve të kujdesit për fëmijët në lidhje me shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve. Qendra për Edukimin e Personelit mjekësor (krijuar në vitin 2008) po punon lidhur me trajnimin periodik të personelit shëndetësor, përcaktimin e kurrikulave të trajnimit, etj.

Në kuadrin e trajnimeve për parandalimin e dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve, personeli shëndetësor dhe punonjësit social që ofrojnë shërbime në rrethe pranë Drejtorive të Shëndetit Publik, janë trajnuar edhe mbi Konventën e të Drejtave të Fëmijës si pjesë e këtyre trajnimeve.

50. Konventa për të drejtat e fëmijës është shpërndarë që para viteve 2000 në të gjitha qendrat shëndetësore, dhe shërbimet e këshillimores së nënës dhe fëmijës të vendit.

Në zbatim të Konventës, MSH-së miratoi Kartën e të Drejtave të Fëmijëve të Shtuar në Spital (me Urdhrin nr 115, datë 29/03/2006). Në këtë kartë e cila është shpërndarë dhe njihet nga të gjitha spitalet pediatrike dhe maternitetet e 36 rretheve të vendit përcaktohen të drejtat e çdo fëmije të sëmurë në 13 pika, si p.sh të drejtën për të patur pranë njërin prej prindërve, ose kujdestarin ligjor gjatë gjithë kohës së qëndrimit në spital, të drejtën për prindët dhe fëmijët që të informohen mbi sëmundjen dhe trajtimin, të drejtën për pjesmarrje të prindërve dhe fëmijëve në të gjitha vendimet lidhur me kujdesin shëndetësor që ju ofrohet, mbrojtjen ndaj çdo lloj ekzaminimi dhe trajtimi të panevojëshëm, të drejtën për të patur një ambient të parashikuar posaçërisht, të pajisur, të sigurtë për tu plotësuar jo vetëm nevojat mjeksore por edhe ato për lojra, zbavitje dhe aktivitete edukuese në përputhje më moshën dhe gjëndjen e tyre shëndetësore. Kjo kartë gjendet në të gjitha spitalet pediatrike dhe maternitetet të cilat për zbatimin e saj po bëjnë rregullimet e përmirësimit e duhura në ambiente, rregullore, trainim personeli.

51. Në fushën e arsimit¹⁴: Ministria e Arsimit ka ndërmarrë veprime afatgjata për njohjen, ndërgjegjësimin dhe edukimin me të drejtat e njeriut të fëmijëve dhe nxënësve në të gjitha institucionet mësimore edukative të sistemit tonë parauniversitar. Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit si institucioni përgjegjës për realizimin e politikave të MASH, në drejtim të reformimit të përmbajtjes së shkollës dhe trajnimit të mësuesve, çdo vit programon dhe realizon prodhimin e

¹⁴ Informacion i detajuar lidhur me trajnimet e personelit në institucionet arsimore jepet në anekset e Raportit

materialeve në ndihmë të mësuesit për zbatimin e të drejtave të fëmijëve dhe seanca trajnimi me mësues nga i gjithë vendi për të drejtat e fëmijëve (sistem kaskadë). Një rol të rëndësishëm në procesin e edukimit me të drejtat e fëmijëve ka luajtur shkolla dhe në veçanti reformimi i kurrikulës.

52. Politikat zhvillimore të MASH janë mbështetur edhe nga donatorë të huaj, si dhe janë realizuar një sërë projektesh me donatorë të huaj të zbatuar nga OJF të vendit. Në kuadrin e Projektit të Qendrës Shqiptare të të Drejtave të Njeriut që është zhvilluar në bashkëpunim me MASH, projekt i cili zgjati 10 vjet, janë trajnuar mësues nga i gjithë vendi. Gjithashtu në kuadër të këtij projekti janë realizuar botime në ndihmë të nxënësve dhe mësuesve për njohjen dhe zbatimin e të drejtave të fëmijëve (botime për fëmijët e kopshtit, dhe nxënësve të klasave I - XII, si dhe manualet për mësuesit); u krijuan shkollat pilot për të drejtat e njeriut në 37 në të gjitha Drejtoritë Arsimore (DA) dhe Zyrat Arsimore (ZA) të vendit. Ky projekt u shtri edhe në Fakultetet e Mësuesisë në Elbasan dhe Shkodër, i cili ndihmoi në futjen e studimit të të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve në kurrikulën e këtyre Fakulteteve.

53. Në periudhën 2004 - 2008, një ndër projektet tjetër, i rëndësishëm në drejtim të forcimit të edukimit dhe ndërgjegjësimit me të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve ka qenë projekti i UNESCO-s i financuar nga Qeveria Italiane “Promovimi i edukimit cilësor me të drejtat e njeriut dhe arsimit demokratik në Shqipëri”. Realizimi i këtij projekti u mbështet në arritjet në këtë fushë në drejtim të stafit të trajnuar, hartimit të botimeve për të drejtat e njeriut, jo vetëm në kuadër të projekteve, por dhe në kuadër të punës kualifikuese të Institutit të kurrikulës dhe Trajnimit dhe botimeve të shumta të bëra në ndihmë të mësuesve. Rezultatet më të spikatura të këtij projekti kanë qenë: 1) trajnimi i mësuesve nga i gjithë vendi, trajnimi i trajnerëve lokalë dhe trajnerëve kombëtar; 2) krijimi i shkollave model për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe edukimit demokratik; 3) përgatitja e 6 manualeve për të gjitha ciklet e arsimit parauniversitar.

54. Në lidhje me rekomandimin 20, përsa i përket ndërgjegjësimit të fëmijëve për të drejtat e tyre, në SKF është përcaktuar si objektiv (objektivi 13) “Pasqyrimi i të drejtave të fëmijëve në veprimtarinë e shkollës”. Për vitin shkollor 2007-2008, është përgatitur dhe shpërndarë në të gjitha DAR dhe ZA, Udhëzimi nr.23, datë 23.08.2007, “Për zbatimin e planeve, programeve dhe teksteve mësimore të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2007–2008”. Në këtë udhëzim krahas sqarimeve të nevojshme për zbatimin e dokumentacionit të ri, me theks të veçantë janë trajtuar problemet edukative që lidhen me njohjen dhe zbatimin e të drejtave të fëmijëve në shkollë dhe jashtë saj; sigurimin e pjesëmarrjes së nxënësve në vendimmarrje nëpërmjet fuqizimit të “Qeverive të nxënësve”; rritjes së numrit të veprimtarive jashtëshkollore të nxënësve. Udhëzimi synon të përgatisë bazën ligjore për realizimin e elementeve të autonomisë së shkollës që lidhen me: funksionimin e bordeve të shkollës, zbatimin e kurrikulës në bazë shkolle, realizimin e projekteve nga vetë shkollat nëpërmjet graveve shkollore etj. Këto masa synojnë të krijojnë hapësirën e nevojshme që të drejtat e fëmijëve jo vetëm të mësohen por dhe të zbatohen. Për të siguruar një zbatim konkret dhe të dobishëm të Udhëzimeve, janë zhvilluar veprimtari kualifikuese dhe sqaruese me drejtues dhe specialistë të MASH, IKT, si dhe Drejtorë dhe specialistë të DAR/ZA. Janë trajnuar rreth 2000 drejtues shkollash dhe të gjithë Kryetarët e Bordeve të shkollave, për mirëfunksionimin e këtij të fundit, si organ që punon për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

55. Në 37 qytete ka shkolla pilot të Edukimit të të Drejtave të Njeriut (EDNJ), që mbështeten vazhdimisht me materiale dhe produkte pedagogjike. Në kuadër të një projekti të mbështetur nga UNESCO, në Tiranë janë krijuar 4 shkolla të tjera pilot, të cilat merren me Edukimin e të drejtave të Njeriut dhe demokracinë. Përfshirja e EDNJ-së në kurrikulën e arsimit të detyruar, do të thotë që në kurrikulat lëndore të edukatës shoqërore, edukatës qytetare, në gjuhën amtare, gjuhë e huaj, histori,

gjeografi, biologji, arte, edukim fizik përfshihen natyrshëm të drejtat e fëmijëve. Koha e kurrikulës së lirë, që në total është 10% të orëve mësimore, menaxhohet krejtësisht nga shkolla e nga mësuesit ku shumë prej tyre kanë zgjedhur që të zhvillojnë veprimtari që lidhen me edukimin e të drejtave të fëmijës për interesat dhe nevojat reale të fëmijëve. Në kuadër të programit kombëtar të “Reduktimit të përdorimit të dhunës nga mësuesit si formë disiplinore”, ka përfunduar studimi në të gjithë vendin për identifikimin e 6 llojeve të dhunës më të përdorur në shkollë. Në vijim janë përgatitur dy libra nga “Save the Children” dhe UNESCO-s mbi metodat e disiplinimit pozitiv të fëmijëve në shkolla, që do të shërbejnë si materiale bazë për trajnimet që do të vijnë mbi këto metoda.

56. Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit në bashkëpunim me UNESCO-n ka përgatitur dy libra “Edukimi ndërkulturor në arsimin bazë” dhe “Edukimi ndërkulturor dhe me të drejtat e njeriut në arsimin e mesëm”. Mbi bazën e tyre po trajnohen të gjithë mësuesit përmes rrjetit të trajnerëve të përgatitur nga secili rreth.

b) Zbatimi i programeve kombëtare dhe monitorimi i tyre.

57. Strategjia Kombëtare për Fëmijë është një dokument, i cili përcakton drejtimet kryesore të zhvillimit të politikave të mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve për periudhën 5 vjeçare, 2005-2010, programet të cilat do të mundësojnë arritjen e objektivave, si edhe burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore. Strategjia paraqet një plan të detajuar pune, në të janë konkretizuar dhe harmonizuar përgjegjësitë e institucioneve vendimmarrëse dhe zbatuese si edhe të shoqërisë civile. Në Strategjinë dhe Planin e detajuar të Veprimit janë parashikuar objektiva të integruara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Objektivat e Strategjisë, janë përqëndruar në katër fusha e drejtime kryesore, që kanë të bëjnë kryesisht me: i) Mbijetesën e fëmijëve. ii) Mbrojtjen e fëmijëve; iii) Zhvillimin e tyre. iv) Pjesëmarrjen e fëmijëve. Objektivat e SKF janë detajuar konkretisht: 1) Ngritja e strukturave dhe sigurimi i burimeve financiare e njerëzore, për të realizuar detyrimet e Konventës dhe SKF. 2) Sigurimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga mosha, gjinia, etnia, aftësia e kufizuar, statusi i lindjes etj. 3) Vazhdimësia e procesit që siguron respektimin e të drejtës së informimit, lirisë së shprehjes dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në çështjet që lidhen me ta në familje, në shkollë dhe në institucione të tjera. 3) Ngritja e sistemit të institucioneve për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjithë format e dhunës, të shfrytëzimit dhe nga keqtrajtimet. 4) Sigurimi i jetesës së fëmijëve në mjedis familjar. 5) Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e birësimeve. 6) Përmirësimi i kujdesit shëndetësor për nënën dhe fëmijën. 7) Ndërtimi i sistemit arsimor bashkëkohor, që garanton arsimimin e të gjithë fëmijëve. 8) Reduktimi i numrit të fëmijëve që punojnë, fëmijëve të rrugës dhe garantimi i sistemit të mbrojtjes së tyre. Në SKF dhe Planin e Veprimit për realizimin e saj, janë përcaktuar masa organizative, strukturore dhe konceptuale, për krijimin e strukturave specifike, që kanë detyrë realizimin e përgjegjësive, me të cilat i ngarkon ky dokument i rëndësishëm.

• Mekanizmat e krijuara për zbatimin e të drejtave të parashikuara nga Konventa, si dhe për monitorimin e saj.

58. Këshilli i Ministrave ka miratuar krijimin e mekanizmave institucionalë, përgjegjës për vëzhgimin e zbatimit të strategjisë për fëmijët, si edhe raportimin. Institucionet që mbikqyrin dhe vlerësojnë mënyrën e realizimit të të drejtave të fëmijëve nëpërmjet përfitimit të shërbimeve shoqërore sipas programeve të mirëqënies shoqërore (arsim, shëndetësi, mbrojtje shoqërore) janë:

59. Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve (i krijuar në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.24, datë 21.03.2007), është autoriteti më i lartë që monitoron zbatimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe ka këto detyra: 1) Garanton përfshirjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në politikat e institucioneve. 2) Siguron angazhimin e pikave të kontaktit në

organet e qeverisjes qendrore për realizimin e planit të veprimit të Strategjisë për Fëmijë dhe për raportimin e tyre periodik pranë Sekretariatit Teknik të Fëmijëve. 3) Shqyrton propozimet për projektligje dhe projektvendime, të rëndësishme në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Fëmijë. 4) Shqyrton projekte dhe programe të rëndësishëm, për mbrojtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të të drejtave të fëmijëve.

60. Sekretariati Teknik për Fëmijët (STF) (i krijuar në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 162, datë 24.07.2006), në MPCSSHB, ka si detyra: 1) Ndjekjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Fëmijë dhe Planit të saj të Veprimit. 2) Grumbullimin e informacioneve, vlerësimin dhe raportimin për problemet në lidhje me të drejtat e fëmijëve. 3) Koordinon bashkëpunim me ministritë, institucione të tjera qendrore, qarqet, bashkitë, komunat, organizatat dhe ofruesit e shërbimeve për fëmijë, etj. 4) Përgatitjen e raporteve 6-mujore dhe vjetore të progresit për zbatimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Fëmijë, që paraqiten dhe shqyrtohen nga Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve. Raporti vjetor lançohet edhe për opinionin publik në konferencën kombëtare që tashmë mbahet çdo 1 qershor, ditën ndërkombëtare të fëmijëve. 5) Koordinon takimet e KNDF-së. 6) Organizimin e studimeve, analizave mbi gjendjen e fëmijëve.

62. Institucionet e nivelit qendror, të përfshira direkt në zbatimin e SKF janë Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale e Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Këto institucione raportojnë lidhur me realizimin e të drejtave të fëmijëve, bazuar gjithashtu edhe në studime të ndryshme.

63. Strukturat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel vendor. Në nivel vendor, strukturat përgjegjëse për zbatimin e SKF janë: Drejtoritë Arsimore Rajonale /Zyra Arsimore, Drejtoritë e Shërbimit Social Shtetëror Rajonal, Drejtoritë e Rajonale të Shëndetit Publik, Drejtoritë Rajonale të Policisë, si edhe Njësitë e qeverisjes vendore (Qarqet, Bashkitë).

64. Struktura të pavarura për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Pranë institucionit të Avokatit të Popullit (Ombudsman), i krijuar në vitin 2000 si një institucion i pavarur i cili mbikqyr edhe mënyrën e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, në vitin 2004 është krijuar NënSeksioni për të Drejtat e Fëmijëve si pjesë e Seksionit të Përgjithshëm të Ankesave, pranë Avokatit të Popullit. Institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në grupin e punës për hartimin e SKF-së dhe Planit të Veprimit të saj dhe ka një rol të rëndësishëm për zbatimin e saj, duke patur si mision të shërbejë si një avokat dhe trup monitorues i të drejtave të fëmijëve, në përputhje me Konventën.

- ***Masat ligjore, administrative, gjyqësore etj, për zbatimin e të drejtave të parashikuara nga Konventa.***

65. Republika e Shqipërisë është shtet palë me të drejta dhe detyrime në një sërë aktesh ndërkombëtare:

- Konventa e Hagës “Për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe bashkëpunimin për Birësimet jashtë vendit”, (ratifikuar me ligjin nr. 8624, datë 15/06/2000).
- Konventa Nr. 182 “Për Format më të këqija të punës së fëmijëve” dhe Rekomandimi nr.190, “Format më të këqija të punës së fëmijëve”, (është ratifikuar me ligjin nr. 8774, datë 23.4.2001).
- “Karta Sociale Europiane”, e ndryshuar” (është ratifikuar me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002).

- Konventa Europiane “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”, Strasburg, më 24.11.1983, (ratifikuar me ligjin nr. 9265, datë 29.7.2004).

Në kuptim të paragrafit të parë të nenit 18 të Konventës, RSH-së deklaroi se rezervon të drejtën të përcaktojë, në përputhje me legjislacionin shqiptar, se termi “person i varur” nënkupton “fëmijët e mitur, bashkëshorten dhe prindërit e paaftë për punë, që kanë qenë plotësisht ose pjesërisht në ngarkim të të vdekurit, si dhe të personave që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit”.

- “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH-së dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, për ripranimin e personave dhe të Protokollit të saj”, (ratifikuar me ligjin nr. 9350, datë 3.3.2005).

Qëllimi i kësaj marrëveshje është që këto shtete të japin kontributin e tyre për të parandaluar dhe luftuar kalimin e paligjshëm të kufirit me qëllim migracionin, si dhe të lehtësojnë ripranimin dhe tranzitin në rastet e dëbimit të personave, hyrja ose qëndrimi i të cilëve është i paligjshëm në territoret e shteteve të tyre.

- Konventa Europiane “Mbi marrëdhëniet me fëmijët”, (ratifikuar me ligjin nr. 9359, datë 24.3.2005). Konventa Europiane “Mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve” e nënshkruar në Hagë (aderuar me ligjin nr. 9446, datë 24.11.2005).
- Konventa e Hagës “Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, ekzekutimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”, (aderuar me ligjin nr. 9443, datë 16.11.2005).
- “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktimat të trafikimit”, (ratifikuar me ligjin nr. 9544, datë 29.05.2006). Kjo marrëveshje ka si qëllim nxitjen e bashkëpunimit për të luftuar trafikimin dhe çdo formë të shfrytëzimit të fëmijëve.
- Protokollin Opsional i Konventës “Për të drejtat e fëmijës”, “Mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijët”, (aderuar me ligjin nr. 9834, datë 22.11.2007).
- Protokollin Opsional i Konventës “Për të drejtat e fëmijës”, “Mbi implikimin e fëmijëve në konfliktet e armatosura”, (aderuar me ligjin nr. 9833, datë 22.11.2007).
- “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Islandës, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar” (ratifikuar me ligjin nr. 10 015, datë 6.11.2008).

Në bazë të kësaj marrëveshje, RSH-së do të ripranojë, fëmijë të mitur e të pamartuar, pavarësisht vendlindjes ose kombësisë, nëse nuk kanë lejqëndrimi të pavarur në Islandë.

- Konventa e Këshillit të Europës “Për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual”, (ratifikuar me ligjin nr.10071, datë 9.02.2009).

Gjithashtu, të drejtat e fëmijëve trajtohen edhe në disa akte të tjera ndërkombëtare të cilat i referohen mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në përgjithësi:

- Konventa Europiane “Për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore”, (ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996).
- Konventa e Këshillit të Europës “Për Masat kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore” (është ratifikuar me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006).

➤ Legjislacioni shqiptar¹⁵.

66. Kushtetura e RSH-së, e miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ka parashikuar dispozita të veçanta në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve dhe të të rinjve. Si pjesë e lirive dhe të drejtave të

¹⁵ Aktet ligjore janë paraqitur sipas rrjedhës kronologjike të miratimit të tyre.

njeriut, Kushtetuta i njuh fëmijëve liritë dhe të drejtat vetjake (mbrojtja e jetës), politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Në këtë kuadër brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, shteti nëpërmjet nismave të tij ligjore siguron plotësimin e nevojave të fëmijëve për mirëqënie, mirëritje, arsimim, punësim, si dhe zhvillimin intelektual të tij. Në kuadër të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, shteti ka detyrimin të garantojë procedura lehtësuese gjatë gjyqimit të fëmijëve në proceset gjyqësore, si dhe të sigurojë mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal (sikurse parashikon neni 54 i Kushtetutës). Në dispozitat e mëposhtme kushtetuese, me termin “kushdo/çdo person” përfshihen edhe fëmijët, mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të cilëve duhet të përbëjë prioritet dhe angazhim maksimal politik dhe shoqëror në krahasim me nismat e ndërmarra për grupmoshat e tjera të shoqërisë.

67. Në nenin 25 të Kushtetutës parashikohet shprehimisht se askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës. Dispozitat kushtetuese garantojnë një sërë të drejtash për individin (përfshirë edhe fëmijën gjatë procesit penal.

68. Kodi i Familjes, i miratuar me ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003, trajton gjerësisht dhe hollësisht mbrojtja e të drejtave të fëmijëve. Në këtë Kod përfshihen parimet e përgjithshme të Konventave, akteve dhe instrumentave ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve dhe veçanërisht dispozita të Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Ky Kod i kushton kujdes të veçantë trajtimit dhe kujdesit të të miturve si dhe detyrimeve të prindërve, ushtrimit të përgjegjësisë prindërore për administrimin e pasurive që vijnë nga puna e të miturve, lejimit të punës së të miturve, kujdesi kur ata punojnë. Kodi përcakton gjithashtu detyrimet institucionale të shtetit ndaj fëmijëve jashtë kujdesit prindëror, si edhe mënyrën e zbatimit të tyre.

69. Kodi Penal i RSH-së (i miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995), me ndryshimet përkatëse) në ndryshimet gjatë periudhës 2000 – 2008, ka parashikuar vepra të reja penale të cilat kryhen kundër fëmijëve/të miturve, si dhe ashpërsimin e dënimit të dhënë ndaj personave të cilët me vendim të formës së prerë shpallen fajtor për një vepër penale të kryer kundër fëmijëve.

70. Kodi i Procedurës Penale (i miratuar me ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995) i ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.06.2002 dhe me ligjin nr. 9276, datë 16/9/2004, parashikon se gjykimi i të miturve bëhet nga seksionet përkatëse, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, të përcaktuara me dekret të Presidentit.

71. Kodi Civil i RSH-së (i miratuar me ligjin 7850, datë 29.07.1994, me ndryshimet përkatëse), parashikon mbrojtjen juridike të fëmijëve dhe njohjen e të drejtave të tyre.

72. Kodi i Punës i RSH- së (i miratuar me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar me ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003) i kushton një kapitull i veçantë mbrojtjes të të miturve, ku trajtohet mosha minimale e punës, kohëzgjatja e punës, punët e lehta dhe të vështira, kontrolli mjekësor etj.

73. Ligji nr. 8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”¹⁶ parashikon se RSH-së u njuh të drejtën për azil a mbrojtje të përkohshme të gjithë të huajve që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, qofshin këta refugjatë apo persona të tjerë dhe që kërkojnë azil në përputhje me

¹⁶ Ky ligj është ndryshuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009.

dispozitat e këtij ligji dhe me konventat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë. Gjithashtu, ligji rregullon kushtet dhe procedurat për dhënien dhe heqjen e azilit në RSH-së, si dhe të drejtat e detyrat e refugjatëve dhe të personave nën mbrojtje të përkohshme.

74. Ligji nr. 8528 datë 23.09.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji” ka si qëllim mbrojtjen e të drejtës së fëmijës për t’u ushqyer me gji. Nëpërmjet masave të veçanta, nxitet ushqyerja me qumështin e gjirit si një element i pazëvendësueshëm që ndikon drejtpërsëdrejti në mbijetesën dhe në zhvillimin e plotë dhe të mirë të fëmijës së porsalindur.

75. Ligji nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH-së”, garanton të drejtën e parashikuar në Kushtetutë, për arsimim dhe formim profesional gjatë gjithë jetës, mundësinë e kryerjes së arsimimit profesional, si dhe të fitimit të njohurive profesionale të nevojshme për punësim.

76. Ligji Nr. 8876, datë 4.4.2002 “Për shëndetin riprodhues” parashikon se veprimtaria e shërbimeve për kujdesin ndaj shëndetit riprodhues përfshin: a) kujdesin para, gjatë dhe pas lindjes; b) kujdesin për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës 0-6 vjeç; c) kujdesin për shëndetin e adoleshentëve;

77. Ligji nr. 9098, datë 3.7.2003 “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në RSH-së”, parashikon procedurat për realizimin e të drejtave për arsimimin, punësimin, kujdesin shëndetësor e shoqëror, strehimin dhe bashkimin familjar të personave, që kanë përfituar azil në RSH-së.

78. Në ligjin nr. 9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në RSH-së”, i ndryshuar me ligjin nr. 9999, datë 25.9.2008, përcaktohen rregullat për kryerjen e shërbimit ushtarak në RSH-së, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shtetasve, të organeve shtetërore e subjekteve private për mobilizimin dhe shërbimin ushtarak.

79. Ligji nr. 9205, datë 15.3.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, rregullon masat e posaçme, mënyrën dhe procedurat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe organizimin, funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara me propozimin, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes, duke parashikuar edhe rastet kur personi i mbrojtur është i mitur.

80. Në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, parashikohen masa për të siguruar ndihmë dhe shërbime shoqërore individëve dhe grupeve në nevojë, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore, duke përfshirë edhe fëmijët.

81. Ligji nr. 9381, datë 28.4.2005 “Për kompensimin e burgimit të padrejtë”, parashikon ndër të tjera se të drejtën e paraqitjes së kërkesës për përfitimin dhe të kompensimin për burgim të padrejtë, përfshirë arrestin në shtëpi për personin e mitur këtë të drejtë e ushtron kujdestari ligjor.

82. Me ligjin nr. 9398, datë 12.05.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, (i ndryshuar me ligjin nr.8600, datë 10.4.2000”) rriten dhe forcohen më shumë kompetencat e Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri. Në ligjin nr.9398, datë 12.05.2005 parashikohet shprehimisht se në rastet kur Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet dhe kur

kujdestari ose përfaqësuesi ligjor i të miturit nuk vepron, nuk kërkohet pëlqimi i të dëmtuarit kur është i mitur.

83. Ligji nr. 9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, ka për qëllim parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumi i alkoolit, nëpërmjet përdorimit të pijeve alkoolike nga të miturit. Ky ligj parashikon ndërmarrjen e masave për ndalimin e përdorimit të pijeve alkoolike nga të miturit.

84. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, parashikon masat ligjore kundër dhunës dhe krijimin e një mekanizmi apo rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje, në veçanti për të parandaluar dhunën dhe keqtrajtimin e fëmijëve.

85. Ligji nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”¹⁷, siguron kushtet e përshtatshme për respektimin e të drejtës së fëmijës për t’u rritur në ambient familiar. Ky ligj përcakton procedurat e realizimit të birësimit, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Komitetit Shqiptar të Birësimeve, me qëllim që fëmijët që janë të privuar nga mjedisi familjar, t’i sigurohet një familje alternative, me të drejta dhe detyrime të njëjta me prindërit biologjikë.

86. Në ligjin nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e shtetit”, parashikohen masat që ndërmerr policia e shtetit për garantimin e të drejtave të shtetasve. Në masat që ndërmerr policia e shtetit për ruajtjen e rendit parashikohet se nëse cënimi i rendit dhe sigurisë publike ka ardhur si pasojë e veprimeve të një personi të mitur nën 14 vjeç, përveç masave të marra ndaj tij, punonjësi i Policisë njofton prindin ose kujdestarin e të miturit nën 14 vjeç për ndërprerjen e veprimeve të paligjshme të të miturit. Gjithashtu, në kontrollin që kryhen nga punonjësit e policisë parashikohet se për kontrollin e të miturve kërkohet edhe prania e prindit ose e kujdestarit. Ligji parashikon se punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në mjediset e Policisë ose në organin urdhërdhënës, për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent.

87. Ligji nr. 9888, datë 10.3.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” (të ndryshuar), parashikon se në institucionet e paraburgimit ndalohet mbajtja e të miturve në një dhomë me të rriturit, ose vendosja e të miturve vajza me të mitur djem në një dhomë. Gjithashtu, në ndryshimet e këtij ligji parashikohet se të miturit vendosen në dhoma e seksione të veçuara, duke u krijuar mundësinë e një trajtimi të veçantë. Të miturat vajza mbahen nën mbikëqyrjen dhe kujdesin vetëm të një personeli femëror.

88. Në ligjin nr. 9952, datë 14.7.2008 “Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it”, parashikohen rregullat për parandalimin dhe kontrollin në marrjen e masave për HIV/AIDS-in, kujdesin, trajtimin dhe mbështetjen për personat që jetojnë me HIV/AIDS. Në nenin 3 të këtij ligji jepen përkufizimet e braktisjes nga prindërit e fëmijës së mitur, të infektuar me HIV, të braktisjes nga kujdestari ligjor i fëmijës, nën kujdestari, të infektuar me HIV.

89. Me ligjin nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, përcaktohet mekanizmi konkret i zbatimit të dënimeve alternative dhe raporteve që ai krijon me institucionet shtetërore dhe me gjykatën.

¹⁷ Ky ligj ka shfuqizuar ligjin nr. 7650, datë 17.12.1992 “Për birësimet e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes”.

Ndryshimet e reja në ligjin nr. 8331, 21.4.1998 nuk janë specifike vetëm për të miturit, por në hartimin e dispozitave mbi ngritjen dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe masave alternative që do të mbikqyrë ky Shërbim, kryesisht janë marrë në konsideratë mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin dhe ri-integrimi social e shoqëror i tyre.

90. Ligji nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, përcakton kushtet, llojin, mënyrën dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti, për mbrojtjen e lirive e të të drejtave themelore të individit, si dhe të interesave të tjera të ligjshme të tij. Në këtë ligj është parashikuar dhënia e ndihmës juridike të miturve në konflikt me ligjin.

91. Në ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8432, datë 14.12.1998 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, në dispozitën e përkufizimeve jepet termi “të mitur të pashoqëruar”¹⁸.

92. Ligji nr. 10139, datë 11 05 2009 “Për Shëndetin Publik”, ka si qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe promovimin e jetesës së shëndetshme të popullatës. Në ligj janë parashikuar dispozita në mbrojtje të shëndetit të fëmijës.

93. Ligji Nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”¹⁹, përcakton kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë dhe personave pa shtetësi, si dhe organizimin e funksionimit e shërbimit të gjendjes civile në RSh-së. Ky ligj rregullon në mënyrë më të plotë dhe të detajuar të drejtën për t’u regjistruar në momentin e lindjes, e drejtë nga e cila burojnë të drejtat të tjera si e drejta për arsim, për kujdes shëndetësor, etj.

94. Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 5351, datë 11.06.2007 “Për krijimin e seksioneve të veçanta penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore”, i cili është miratuar në zbatim të nenit 13/4 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilën përcaktohet se gjykimi i të miturve bëhet në seksione të veçanta të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore.

➤ **Akte nënligjore**²⁰:

95. Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 205, datë 9.05.2002, “Për disa ndryshime në VKM nr. 384, datë 20.05.1996 “Për Mbrojtjen e të Miturve në Punë”, parashikon kushtet e punës për punëmarrësit nën moshën 18 vjeç, si dhe përcakton kriteret e punëve të lehta, kohëzgjatjen maksimale dhe kushtet e kryerjes së punës, si dhe kryerjen e periudhës së pushimit.

96. VKM nr. 327, datë 15.05.2003 “Për kalimin e sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë”, përcakton se sistemi i paraburgimit, mjediset dhe pajisjet, nga administrimi i komisariateve të Ministrisë së Punëve të Brendshme kalojnë në administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në Ministrinë e Drejtësisë (duke përfshirë edhe seksionet e paraburgimit për të miturit).

97. VKM nr. 633, datë 18.9.2003 “Për miratimin e Strategjisë për përmirësimin kushteve të jetesës së minoritetit rom”, përcakton drejtimit kryesore politike në përmirësimin e kushteve të jetesës së

¹⁸ Kjo dispozitë do të trajtohet në komentet lidhur me Sesionin II, neni 1 “Përkufizimi i fëmijës”.

¹⁹ Ky ligj ka hyrë në fuqi në datën 27 qershor 2009.

²⁰ Aktet nënligjore janë pasqyruar sipas rrjedhës kronologjike të miratimit të tyre.

minoritetit rom, për zbutjen e varfërisë, përfshirjen e tyre në jetën publike, ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre etnik, etj, duke përfshirë edhe fëmijët.

98. VKM nr.171, datë 11.2.2005 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit dhe për një shtesë në VKM nr. 8, datë 5.1.2002 “Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore”, përcakton drejtimet kryesore të luftës kundër trafikimit të fëmijëve nëpërmjet koordinimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe organizmave qeveritare, ndërkombëtare dhe lokale, si dhe shoqërisë civile.

99. VKM nr. 368, datë 31.5.2005 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët” përcakton objektivat strategjike në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve ndaj çdo lloj forme të dhunës, abuzimit dhe diskriminimit, duke nxitur dhe forcuar bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me të gjithë aktorët përgjegjës, që nga niveli qendror, vendor, aktorët e shoqërisë civile dhe me pjesëmarrjen aktive të komunitetit dhe të individit, në këtë proces.

100. VKM nr. 564, datë 12.08.2005 “Për liçencimin e ofruesve të shërbimeve shoqërore”, i cili mundëson liçencimin e OJF-ve që ofrojnë shërbime sociale grupeve në nevojë.

101. VKM nr. 659, datë 17.10.2005, përcakton standartet e shërbimeve për fëmijët në Institucionet Recidenciale”

102. VKM nr. 463, datë 5.7.2006 “Për miratimin e Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit” (i ndryshuar), parashikon si një pikë të veçantë trajnimin për metodat e mësimdhënies për fëmijët dhe për mënyrën e kryerjes së studimit.

103. VKM nr. 913, datë 19.12.2007 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, 2007-2010, dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, parashikon objektivat dhe masat konkrete të strukturave qeveritare të ngarkuar me zbatimin e ligjit për barazinë gjinore dhe dhunën në familje.

104. VKM nr. 786, datë 4.6.2008, “Për miratimin e Rregullores së Disiplinës së Policisë së Shtetit”, parashikon detyrimin dhe normat e sjelljes gjatë detyrës/shërbimit, të punonjësit të policisë për trajtimin e veçantë të të miturve.

105. VKM nr. 80, datë 28.1.2008 “Për miratimin e strategjisë sektoriale të mbrojtjes sociale dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” parashikon marrjen e masave konkrete për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, kryesisht fëmijëve jetimë.

106. VKM nr. 1083, datë 23.7.2008 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore, 2008-2010, si dhe të dokumentit plotësues “Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktima të trafikimit” parashikon masat për bashkëpunimin, bashkërendimin mes të gjithë aktorëve, rolet dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse, për të arritur në një qasje efikase, të harmonizuar kundër këtij fenomeni.

107. VKM nr. 1104, datë 30. 7. 2008 të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa në VKM nr. 80, datë 28.1.2008 "Për miratimin e strategjisë sektoriale të mbrojtjes sociale dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, parashikon mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve jetimë, nëpërmjet përcaktimit të kritereve të familjes kujdestare.

108. VKM nr. 302, datë 25.03.2009, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”, i cili përcakton rregulat për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Shërbimit të Provës dhe rolin e këtij institucioni në çdo fazë të procedimit penal.

109. VKM Nr. 303, datë 25.03.2009, “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve” përcakton mënyrën e realizimit të të drejtave dhe detyrimeve të të burgosurve, të dënuar me burgim apo të paraburgosur, organizimin e jetës së tyre, mënyrën dhe kushtet e ekzekutimit të vendimeve penale me burgim, zhvillimin e aktivitetit të punës dhe shpërblimin për punën e kryer etj.

110. Urdhri i Kryeministrit nr. 203, datë 19.12.2005 “Për ngritjen e Njesisë Antitrafik pranë Koordinatorës Kombëtare për Antitrafikimin”, përcakton se Njësia Antitrafik harton masat dhe udhëzimet konkrete në organizimin dhe funksionimin efektiv të luftës kundër trafikimit.

111. Urdhri i Kryeministrit nr. 139, datë 19.06.2006 “Për krijimin e Komiteteve Rajonale kundër Trafikimit të Qënive Njerëzore”, përcakton se këto Komitete do të kontribuojnë në evidentimin e rasteve, parandalimin dhe zvogëlimin e numrit të trafikimit.

112. Urdhri nr. 4763, datë 08.06.2009 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Komitetit Shqiptar të Birësimeve”, i cili parashikon rregulla mbi funksionimin dhe orgaznimin e brendshme të Komitetit, në lidhje me mbarëvajtjen e zhvillimit të procedurave të birësimit.

113. Aktualisht, janë duke u hartuar një sërë aktesh të reja ligjore në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, konkretisht:

1) Projektligji “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve”, do të jetë një ligj integral në këtë fushë dhe do të përfshijë parimet, institucionet dhe masat konkrete në mbrojtjen dhe repektimin e të drejtave të fëmijëve. Ky projektligj mendohet të jetë një transpozim i Konventës “Për të drejta e fëmijës” në një akt të vetëm ligjor. 2) Projektligji “Për masat kundër keqtrajtimit të fëmijëve”, hartimi i të cilës është iniciativë e shoqërisë civile.

114. Gjithashtu, janë duke u hartuar akte nënligjore në përmirësimin e kuadrit ligjor për sa i përket kujdestarisë së fëmijëve. Iniciativa e hartimit të këtyre akteve është ndërmarrë nga shoqëria civile. Procedurat për miratimin e projektligjit “Për masat kundër keqtrajtimit të fëmijëve”, si dhe për aktet nënligjore në fushën e kujdestarisë për të miturit, do të ndiqen nga ana e strukturave shtetërore kompetente gjatë vitit 2009.

- **Objektivat dhe afatet e këtyre masave dhe ç`farë impakti kanë patur ato në gjendjen aktuale, ekonomike, sociale.**

115. Kushtet e përgjithshme në vend. Shqipëria, me një popullsi prej 3.1²¹ milion banorë, është një nga vendet me popullsinë më të re në Europë (mosha mesatare e popullsisë është 32.2 vjeç, ndërsa numri i fëmijëve 0-19 vjeç është 1,091,509²²). Prej vitit 1991, Shqipëria ka përjetuar një tranzicion të shpejtë dhe të thellë. Reformat makroekonomike kanë kontribuar në arritjen e një rritje ekonomike relativisht të qëndrueshme, reduktimin e varfërisë si edhe mbajtjen nën kontroll të

²¹ INSTAT, Vjetari Statistikor, 2007

²² INSTAT, Vlerësim, Burimi: Treguesit e Zhvillimit Botëror

inflacionit (3-6 përqind)²³. Rritja ekonomike vjetore llogaritet rreth 6 % prej vitit 1998, ndërsa niveli i varfërisë është zvogëluar rreth 7 % gjatë tre viteve të fundit. Të ardhurat mesatare vjetore janë rritur nga \$1,390 në 2002 në \$2,930 në 2006²⁴ (AKF), megjithatë Shqipëria mbetet një nga vendet me të ardhura më të ulta për frymë në Europë. Emigracioni i pas vitit 1990 ka ndikuar në zvogëlimin e popullsisë afërsisht me 3 përqind²⁵. Gjithashtu lëvizjet masive të popullsisë nga zonat rurale drejt zonave urbane kanë ndikuar në lindjen e fenomeneve negative për familjen në përgjithësi dhe fëmijët në veçanti, të kushtëzuara edhe nga dobësia e rrjeteve të mbrojtjes shoqërore. Një nga pasojat më të dukshme të emigracionit dhe imigracionit është rritja e numrit të divorceve (22 %) si edhe rritja e dhunës në familje. Një studim i realizuar nga UNICEF në 2006/2007 tregoi se vajzat dëshirojnë të migrojnë për t'i shpëtuar dhunës në familje (44 përqind) ndërsa 32 përqind e tyre migrojnë për një jetë më të mirë. Megjithatë migrimi si edhe dërgesat shoqërore në para kanë shërbyer për përmirësimin e nivelit të jetesës së shqiptarëve si edhe uljen e varfërisë. Studimet dhe analizat ekonomike dhe sociale tregojnë se pabarazitë në zhvillimin rajonal kushtëzojnë edhe pabarazitë në shpërndarjen e mirëqënies sociale. Nivelet e zhvillimit socio-ekonomik në rajonet e ndryshme të vendit, bëhen përcaktues për mirërritjen, zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve.

116. Vlerësimi i ecurisë së procesit të institucionalizimit të të drejtave të fëmijëve. Reforma e ndërmarrë nga qeveria për institucionalizimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, e shprehur nëpërmjet Strategjisë Kombëtare për Fëmijë (SKF) dhe Planit Kombëtar të Veprimit, po zbatohet në përputhje me planin vjetor të Komitetit Ndërmintor dhe të Sekretariatit Teknik për Fëmijët (STF). Në periudhën 2007 – 2008, është arritur forcimi i kapaciteteve të institucioneve qeveritare, përgjegjëse për hartimin e politikave që garantojnë të drejtat e fëmijëve, vëzhgimin e zbatimit të tyre dhe raportimin. Fillimisht puna e Sekretariatit është fokusuar në ngritjen e rrjetit të pikave të kontaktit në ministritë e linjës, përfaqësues të shoqërisë civile që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve si dhe ndërtimin bashkëpunimit me këta aktorë. Krijimi dhe forcimi i STF-së ka bërë të mundur: 1) Ndjekjen e zbatimit të SKF-së dhe Planit të Veprimit. 2) Rishikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit në përputhje me prioritetet e qeverisë. 3) Mbledhjen e informacionit mbi zbatimin e politikave sektoriale. 4) Vëzhgimin e zbatimit të politikave kombëtare dhe lokale që garantojnë të drejtat e fëmijëve. 5) Koordinimin ndërsektorial të zbatimit të politikave. 6) Raportimin në Komitetin Ndërmintor për zbatimin e politikave si edhe për realizimin e të drejtave të fëmijëve. 7) Ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Komitetit Ndërmintor për çështje që lidhen me rishikimin/përshtatjen e politikave që ndikojnë mbi të drejtat e fëmijëve.

117. Në nivel rajonal dhe lokal, janë forcuar kapacitetet institucionale qeveritare përgjegjëse për koordinimin, vëzhgimin dhe raportimin e zbatimit të politikave, të cilat garantojnë/sigurojnë realizimin e të drejtave të fëmijëve. Krijimi i njësive për të drejtat e fëmijëve në nivel rajonal (pranë Këshillit të Qarkut) në Kukës, Vlorë, Elbasan dhe Korçë si edhe në nivel lokal (Tiranë e Durrës) mundësoi: 1) Vëzhgimin mbi mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe politikave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në nivel rajonal. 2) Identifikimin e rasteve të shkeljeve apo abuzimit, keqpërdorimit të të drejtave të fëmijëve. 3) Mbledhjen e informacionit vazhdimisht dhe periodikisht mbi treguesit e matjes dhe vlerësimin të të drejtave të fëmijëve në nivel rajonal. 4) Forcimin e bashkëpunimit ndër institucional në nivel rajonal ndërmjet institucioneve të tilla si Zyra e Statistikave, Drejtoria Rajonale e Shëndetit parësor, Drejtoria Rajonale e Arsimit, Zyra e Regjistrimit të Gjendjes Civile, Zyra e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale në Bashki dhe Komuna, si edhe çdo institucion tjetër i qeverisjes vendore apo shoqërisë civile, me qëllim njohjen dhe

²³ Banka Qendrore e Shqipërisë, Raporti Vjetor 2004-2007

²⁴ Vlerësim i Bankës Botërore, Burimi: <http://devdata.worldbank.org>

²⁵ UNICEF&IBF, Ndikimi i emigracionit dhe dërgesave mbi fëmijët, Studim, viti 2006.

identifikimin e çështjeve ligjore dhe institucionale që lidhen me të drejtat e fëmijëve. 5) Raportimin periodikisht dhe në mënyrë të vazhdueshme tek Kryetari i Këshillit të Qarkut apo Këshillit bashkiak mbi çështjet më kritike që lidhen me të drejtat e fëmijëve.

c) Alokimi i buxhetit dhe i burimeve të tjera.

118. Llogaritja e drejtëpërdrejtë e shpenzimeve publike për realizimin e të drejtave të fëmijëve është e vështirë, pasi jo në të gjitha rastet ministrinë buxhetojnë politikat e tyre sipas grupeve të ndryshme të interesit. Megjithatë në vitin 2008, bashkëpunimi me specialistët e Ministrisë së Financave krijoi kushte të përshtatshme për të përlogaritur shpenzimet e përgjithshme publike për fëmijët në nivel qendror dhe vendor.

119. Në tabelat e mëposhtme paraqiten shpenzimet e përgjithshme publike për fëmijët në nivel qendror dhe vendor dhe sipas sektorëve të veçantë.

Tabela 1: Shpenzimet publike për fëmijët sipas buxhetit qendror, 2006-2008.

Vitet	Buxheti Qendror			Total (000 lekë)
	Total (000 lekë)	Pjesa për fëmijët (000 lekë)	Raporti (% ndaj totalit)	
2006	183,400,198	39,046,563	21.29%	22,706
2007	196,171,594	42,736,365	21.79%	22,273
2008	239,200,429	51,964,942	21.72%	22,294

Burimi: Ministria e Financave, 2006-2008

Tabela 2: Shpenzimet publike për fëmijët sipas buxhetit lokal, 2006-2008

Buxheti lokal			Buxheti lokal + qendror	
Pjesa për fëmijët (000 lekë)	Raporti (% ndaj totalit)	Total (000 lekë)	Pjesa për fëmijët (000 lekë)	Raporti % ndaj totalit
3,958	17.43%	183,422,904	39,050,521	21.29%
4,042	18.15%	196,193,867	42,740,407	21.78%
8,783	39.40%	239,222,723	51,973,726	21.73%

Burimi: Ministria e Financave, 2006-2008

Tabela 3: Pjesa e shpenzimeve publike që i përket fëmijëve në raport me popullsinë e vendit, 2006-2008

Vitet	Nr. Popullsisë gjithsej	Nr. i fëmijëve (g/mosha 0-13 vjeç)	Nr.Fëm/ Nr. popullsisë (%)	Buxheti Qendror + Lokal		
				Total (000 lekë)	Pjesa për fëmijët (000 lekë)	Raporti (% ndaj totalit)
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d = (c/b) %</i>	<i>e</i>	<i>f</i>	<i>g = (f / e) %</i>
2006	3,149,147	1,060,284	33.67%	183,422,904	39,050,521	21.29%
2007	3,162,030	1,039,547	32.88%	196,193,867	42,740,407	21.78%
2008	3,170,048	1,016,610	32.07%	239,222,723	51,973,726	21.73%

Burimi: Ministria e Financave, 2006-2008

Tabela 4: Raporti i buxhetit që shpenzohet për fëmijë ndaj PBB, 2006-2008

Vitet	PBB nominale	Buxheti për fëmijët	Raporti
	(000 lekë)	(000 lekë)	(% ndaj PBB)
<i>a</i>	<i>e</i>	<i>f</i>	<i>g = (f / e) %</i>
2006	899,700,000	39,050,521	4.34%
2007	979,000,000	42,740,407	4.37%
2008	1,078,000,000	51,973,726	4.82%

Burimi: Ministria e Financave, 2006-2008

Informacioni i përdorur tregon se shpenzimet publike janë rritur si në vlerë absolute edhe në përqindje ndaj PBB. Sidoqoftë, ky dokument është një përpjekje për të analizuar shpenzimet publike për fëmijë. Në vitet e ardhshme analiza do të thellohet me tregues të llogaritur të cilët do të sigurojnë informacion për nivelin e plotësimit të nevojave si edhe efektivitetin e fondeve të përdorura.

Tabela 5. Fondet e akorduara të ndihmës ekonomike për familjet gjatë periudhës 2002-2008.

Vitet	Fondet e programuara (miliard lekë)
2002	4.4
2003	4.0
2004	4.0

2005	3.2
2006	2.8
2007	2.6
2008	3.4

Burimi: Përpunuar nga të dhënat administrative të MPCSSHB.

Tabela 6. Buxheti i akorduar në institucionet e perkujdesit publik për fëmijë dhe qendrat e zhvillimit (periudha 2005- 2008):

Buxheti Sipas Viteve	000/lek			
	Viti 2005	2006	2007	2008
Institucionet publike për fëmijë	27,531	36,920	27, 200	30,700
Qendrat e zhvillimit	52,358	53,280	53,500	62,400

d) Të dhënat statistikore.

120. Të dhënat statistikore lidhur me Pjesën I-rë Masat e Përgjithshme të Zbatimit janë janë paraqitur në anekset bashkëlidhur raportit.

e) Faktorët dhe vështirësitë që janë hasur për përmbushjen e detyrimeve të ndërmarra në kuadër të kësaj Konvente.

121. Vështirësitë e hasura për zbatimin e Strategjisë për Fëmijët²⁶. Proçesi i zbatimit të strategjisë është një proces gjithëpërfshirës, i cili kërkon koordinimin dhe harmonizimin e të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces. Në përpjekje për të koordinuar aktivitetet, Sekretariati Teknik për Fëmijët dhe specialistët përgjegjës për vëzhgimin e zbatimit të strategjisë, konstatojnë se ekzistojnë probleme kritike, të cilat vështirësojnë zbatueshmërinë e planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Fëmijë. Në Raportin mbi zbatimin e Strategjisë për Fëmijët për periudhën 2006-2007 është evidentuar se gjatë punës për zbatimin e strategjisë, nga strukturat përkatëse (STF dhe ministritë e linjës) si dhe shoqëria civile, janë identifikuar probleme që lidhen me zbatueshmërinë e planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Fëmijë: 1) Në Planin e Veprimit nuk janë përcaktuar tregues cilësor dhe sasior, që e bëjnë jo të matshëm realizimin e disa masave. 2) Në strategji është parashikuar se afati i realizimit të pjesës më të madhe të masave është viti 2010 dhe nuk ka tregues për periudha të ndërmjetme deri në realizimin e plotë të tyre. 3) Kjo vështirëson punën në hartimin e raporteve të progresit dhe analizën vjetore të punës për implementimin e strategjisë. 4) Në përgjithësi, masat nuk japin informacion për impaktin në jetën e fëmijëve. 5) Disa struktura janë ngarkuar me detyra që nuk kanë kompetencën dhe përgjegjësinë për t'i realizuar.

²⁶ Sipas Raportit lidhur me zbatimin e Objektivave të Strategjisë për Fëmijët 2007-2008.

- **Roli i institucioneve të pavarura për të drejtat e njeriut.**

122. Me miratimin e ligjit nr.9398, datë 12.05.2005 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” (nenet 13 dhe 19/1), këtij institucioni i jepen kompetenca për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si me anë të trajtimit të ankesave individuale apo të hetimit me iniciativën e tij të rasteve të bëra publike, pa pasur kufizimin për të marrë pëlqimin e palës së dëmtuar. Ky institucion katë drejtën e hetimeve dhe inspektimeve dhe të dhënies së rekomandimeve përkatëse.

Gjithashtu neni 19/1 përcakton institucionet shtetërore apo të administratës publike ku Avokati i Popullit apo personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, si në burgje, dhoma paraburgimi, në reparte apo institucione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije.

123. Nënseksioni për të Drejtat e Fëmijëve, në përbërje të Seksionit të Përgjithshëm pranë Avokatit të Popullit ka si qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, në përputhje me Konventën, si dhe instrumenteve të tjera ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare. Veprimtaria e nënseksionit është përqendruar në: 1) Mbikqyrjen e veprimtarisë së administratës publike, si dhe të organizatave të tjera në shërbim të fëmijëve në territorin e Shqipërisë me qëllim mbrojtjen e të drejtave të tyre.

2) Trajtimin e ankesave, kërkesave apo njoftimeve që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të fëmijëve. 3) Rekomandimin mbi përmirësimin e legjislacionit ekzistues lidhur me të drejtat e fëmijëve. 4) Promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe të veprimeve pozitive të organeve të administratës publike për mënyrën se si ushtrohen detyrimet e tyre ndaj fëmijëve. 5) Ndërgjegjësimin e shoqërisë shqiptare në përgjithësi për të drejtat dhe detyrimet ndaj fëmijëve, duke vënë sidomos në lëvizje mediat dhe duke bashkëpunuar në veçanti me OJF-të kryesore që kanë objekt të punës së tyre fëmijët.

124. Funkcionet kryesore të Zyrave Rajonale të NDF-së kanë qenë: a) marrja e ankesave për shkeljet e të drejtave të fëmijëve; b) monitorimi i zbatimit të të drejtave të fëmijëve në institucionet publike rajonale; c) vendosja dhe forcimi i bashkëpunimit me aktoret kryesore rajonale për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e një sistemi bashkëpunimi të ndërsjelltë me OJF-të vendore që punojnë për fëmijët; promovimi i të drejtave të fëmijëve në rajonin përkatës.

Krijimi i Nënseksionit për të Drejtat e Fëmijëve dhe hapja e zyrave rajonale ka ndikuar në lehtësimin e procesin e ankimit të qytetarëve. Gjithashtu është punuar për ngritjen e kapaciteteve të stafit për të punuar me fëmijët në dy drejtime: ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e përditshëm të punës së NDF-së dhe ngritja e kapaciteteve për çështje specifike për të drejtat e fëmijëve.

- **Burimet njerëzore dhe financiare të alokuara për programet për fëmijët në kuadrin e asistencës ndërkombëtare.**

125. Në kuadrin e bashkëpunimit me UNICEF:

1.000.000 USD janë shpenzuar për programin e sistemit edukues (gjatë periudhës 2006-2008) me fokus aksesin dhe cilësinë për studentët e marzhinalizuar.

1.800.000 USD janë shpenzuar për mbrojtjen e fëmijëve.

500.000 USD janë shpenzuar për krijimin dhe forcimin e strukturave monitoruese dhe raportuese, për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

126. Në fushën e shërbimeve sociale është zbatuar Projekti “Shpërndarja e Shërbimeve Sociale në komunitete”, që synonte ngritjen e shërbimeve komunitare për grupe në nevojë si për fëmijët, gratë, të moshuarit, Personat me Aftësi të Kufizuar etj. Ky projekt u financua me: a) 10 milion USD kredi nga Banka Botërore; 2.5 milion USD Grant nga Qeveria Britanike (DFID); 2.5 milion USD

Qeveria Shqiptare. Në mars 2008 përfundoi Projekti dhe u bë një vlerësim i impaktit që ka dhënë ngritja e shërbimeve të reja në kuadër të këtij projekti. Janë ngritur gjithsej 43 shërbime ditore me bazë komunitare për fëmijët, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, vajzat dhe gratë në nevojë, të moshuar. Shërbimet e reja u shtrinë në tetë qarqe (nga 12 qarqe gjithsej) dhe në tre bashki të veçanta duke mbuluar në këtë mënyrë 2/3 e territorit të vendit me modelin e ri të shërbimeve komunitare. Nga ky projekt janë ngritur rreth 20 shërbimet komunitare për fëmijë vlerësohet se kanë përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë 3012 fëmijë dhe 7405 gra me familjet e tyre. Pas përfundimit të projektit, njësitë e qeverisjes vendore (bashkitë /komunat) të mbështetura edhe nga OJF, kanë marrë përgjegjësitë për funksionimin e këtyre shërbimeve, duke siguruar qëndrueshmërinë e këtyre shërbimeve. Duke marrë parasysh se fillimisht Njësitë e Qeverisjes Vendore mund të kenë vështirësi për financimin e këtyre shërbimeve MPCSSHB ka hartuar një Udhëzim ku garantohet mbështetja e politikave të reja dhe zhvillimi i shërbimeve komunitare.

127. Bashkëpunimi me Fondacionin Terre Des Hommes. Duke filluar që nga viti 2001 e deri tani fondacioni Terre des hommes ka filluar zbatimin e projektit TACT (Transnational Action against Child Trafficking) në Shqipëri. Në vite projekti është mbështetur me fonde nga donatorë si USAID, UNICEF, Austrian Development Agency, Hellenic Aid, Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Oak Foundation, SIDA etj.

128. Në periudhën qershor 2003 – maj 2006, Projekti TACT II- Fondi total: 2.5 milion USD
Shpenzimet për mbështetje në mënyrë të drejtpërdrejtë të fëmijëve të trafikuar/rrezik trafikimi dhe familjeve të tyre. Viti 2003 - 60.542 USD; Viti 2004- 115.197 USD; Viti 2005- 144.105 USD.

Në periudhën Qershor 2006 – Shtator 2009, projekti TACT III - Fondi total: 3.3 M USD
Drejtimet kryesore të ndërhyrjes së TACT III : 1) Ndërhyrje direkte në rrugë dhe komunitete në Shqipëri dhe Greqi për të identifikuar fëmijët viktime të trafikimit apo në rrezik trafikimi. 2) Ngritja e kapaciteteve të strukturave shtetërore në nivel qendror dhe vendor në lidhje me trafikimin e fëmijëve. 3) Forcimi i komuniteteve Rom dhe Egjyptianë për të frenuar fenomenin e trafikimit të fëmijëve brenda komuniteteve të tyre. 4. Këshillim për përmirësimin e politikave shtetërore lidhur me mbrojtjen e fëmijëve.

Shpenzimet për mbështetje në mënyrë të drejtpërdrejtë të fëmijëve të trafikuar dhe në rrezik trafikimi dhe familjeve të tyre kanë qënë: Viti 2006 -68,264 USD; Viti 2007 - 105,547 USD; Viti 2008 - 82,719 USD

128. Bashkëpunimi me ILO/IPEK. Që nga viti 2002, ILO/IPEK ka mbështetur MPCSSHB nëpërmjet një sërë projektesh si vijon:

1. Projekti “Rritja e kapacitetit të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale në çështjen e luftës kundër punës së fëmijëve në Shqipëri”.

Kontributi i ILO/IPEC: 18.285 USD

Kontributi i MPCSSHB: 14.000 USD (në natyrë)

2. Projekti “Rritja e kapacitetit të inspektorëve të punës për të luftuar format më të këqia të punës së fëmijëve”.

Kontributi i ILO/IPEC: 22. 700 USD

Kontributi i MPCSSHB: 17.000 USD (në natyrë)

3. Projekti “Mbi rishikimin e legjislacionit kombëtar lidhur me punën e fëmijëve, për harmonizimin e tij me standartet ndërkombëtare ”

Kontributi i ILO/IPEC: 3 500 USD ILO/IPEC

UNICEF: 2 000 USD

4. Projekti “Politikat kombëtare mbi luftën kundër punës së fëmijëve dhe eliminimin e formave më të këqia të saj”

Kontributi i ILO/IPEC: 20.000 USD

Kontributi i MPÇSSHB: 23.355 USD

5. Periudha Prill 2005- Shkurt 2007, Projekti “Sistemi i Monitorimit të Punës së Fëmijëve, Faza e parë.

Projekti synon institucionalizimin e monitorimit të punës së fëmijëve, evidentifikimin, rishikimin dhe raportimin e arritjeve dhe pengesave në luftën kundër praktikave të rrezikshme dhe shfrytëzuese të punës së fëmijëve, forcimit të kapaciteteve në nivel qendror e lokal; pilotimin në bazë- komuniteti në tre rajone Tiranë, Korçë dhe Berat; hartimi i praktikave të mira.

Kontributi i ILO/IPEC: 61.855 USD

Kontributi i MPÇSSHB: 59.000 USD (në natyrë)

6. Periudha shkurt– dhjetor 2009, Projekti “Sistemi i Monitorimit të Punës së Fëmijëve, Faza II-të.

Kontributi i ILO/IPEC: 6.746.200 Lekë

Kontributi i MPÇSSHB: 1.127.000 Lekë (në natyrë)

129. Në fushën e arsimit, për realizimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004 - 2015 (miratuar me VKM Nr. 538, datë 12. 08. 2004), MASH mbështetet nga projekti “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, i financuar nga Qeveria Shqiptare, Banka Botërore, Banka Europiane e Investimeve dhe Banka e Këshillit të Evropës për Zhvillim. Afati i zbatimit të projektit është 4 vjeçar (2006 – 2010) me një financim 75 milion USD.

Në kuadër të zbatimit të politikave arsimore për zhvillimin e arsimit parauniversitar, MASH ka marrëveshje bashkëpunimi me UNICEF, Save the Children, Terre des Home, që në fokus të projekteve të tyre janë mbrojtja dhe edukimi i fëmijëve me të drejtat e njeriut; fuqizimi i burimeve njerëzore dhe trajnimi i mësueseve; fuqizimi i pjesëmarrjes së nxënësve, në arsimin parauniversitar nëpërmjet funksionimit të Qeverive të Nxënësve; konsolidimi i Shërbimit Psikologjik Shkollor, një risi kjo në sistemin tonë arsimor; mbështetja e politikave arsimore të MASH për shtrirjen e institucioneve të fëmijërisë së hershme në gjithë vendin dhe krijimi i alternativave të reja edukative në zonat e thella etj.

Në nivel lokal, bazuara në decentralizimin e kompetencave, Drejtoritë Arsimore Rajonale (DAR) dhe Zyrat Arsimore (ZA), në të gjithë vendin zhvillojnë projekte me OJF të huaja dhe të vendit në mbështetje të realizimit të politikave zhvillimore të MASH dhe politikave lokale të DAR dhe ZA.

- **Masat e ndërmarra, sipas nenit 46 paragrafi 6 i Konventës, për publikimin e Raporteve lidhur me Konventën dhe Vëzhgimet Përfundimtare të Komitetit CRC.**

130. Në faqen zyrtare të MPJ-së (www.mfa.gov.al) janë publikuar Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Raporti i Parë i paraqitur nga Shqipëria, si dhe Vëzhgimet Përfundimtare të Komitetit CRC, lidhur me këtë Raport. Nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Vëzhgimet Përfundimtare të Komitetit CRC u janë dërguar institucioneve përkatëse, në mënyrë për të bërë të mundur marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e rekomandimeve përkatëse. Në zbatim të Neni 44, paragrafit 6 të Konventës, para dorëzimit pranë dorëzimit në Komitetin për të Drejtat e Fëmijës, Raporti Periodik, CRC u është vënë në dispozicion institucioneve shtetërore që kanë marrë pjesë në hartimin e Raportit, si dhe UNICEF në Shqipëri dhe OJF-ve që veprojnë në fuhsën e të drejtave të fëmijës. Ky hap është ndërmarrë me qëllim shpërndarjen e Raportit, si dhe për marrjen e komenteve lidhur me këtë Raport.

II. Përkufizimi i Fëmijës. (neni 1)

a) Zbatimi i Vëzhgimeve Përfundimtare

Përkufizimi i fëmijës sipas legjislacionit shqiptar dhe rishikimi i legjislacionit për të siguruar që të gjithë fëmijët nën moshën 18-vjeç të marrin mbrojtjen sipas Konventës. Rekomandimi 22.

131. Lidhur me zbatimin e nenit 1 të Konventës, “Përkufizimi i fëmijës”, legjislacioni shqiptar përcakton se fëmijë konsiderohet qenia njerëzore e lindur gjallë deri në moshën 18 vjeç, moshë në të cilën fëmija fiton zotësi të plotë juridike për të vepruar. Dispozitat e legjislacionit shqiptar specifikojnë (sipas fushave përkatëse) moshën e fëmijve nën 18 vjeç, me qëllim për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijve²⁷. Gjithashtu në lidhje me rekomandimin 22 të Komitetit CRC, kuadri ligjor i RSH-së është përmirësuar dhe plotësuar vazhdimisht për të siguruar mbrojtjen e fëmijve nën moshën 18 vjeç.

132. Kodi i Familjes i RSH-së (i miratuar me ligjin nr.9062, datë 8.05.2003), në nenin 7 përcakton moshën e lidhjes për martesë dhe konkretisht: 1) martesë mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç. 2) Gjykata e vendit ku lidhet martesë, për shkaqe me rëndësi mund të lejojë martesën edhe përpara kësaj moshe. Sipas nenit 70 të KF në rastin e zgjedhjes së martesës të të miturit sipas nenit 7 paragrafi 2, zbatohet regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore, derisa të mbushë moshën 18 vjeç, çast pas të cilit mund të kërkohet ndryshimi i regjimit ligjor të pasurisë. Në nenin 197 të KF parashikohet se prindërit kanë detyrimin për ushqim ndaj fëmijve, kur fëmijët nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar. Një fëmijë i mitur mund t’u kërkojë prindërve të tij detyrimin për ushqim edhe kur ka pasuri, kur të ardhurat nga pasuria dhe puna e tij nuk përmbushin nevojat e tij. Detyrimi për ushqim vazhdon edhe kur fëmijët madhorë ndjekin shkollën e mesme ose të lartë deri në moshën 25 vjeç.

133. Në nenin 232 të KF parashikohet se prindërit përfaqësojnë fëmijën e tyre të mitur që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç në të gjitha veprimet juridike, me përjashtim të atyre që, sipas ligjit, i mituri mund t’i kryejë vetë. I mituri që ka mbushur moshën 14 vjeç i kryen vetë veprimet juridike, por kurdoherë me pëlqimin paraprak të prindërve, me përjashtim të atyre që, sipas ligjit, mund t’i kryejë vetë. Pasuria e të miturit që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç administrohet nga prindërit në dobi të fëmijës, kurse pasuria e të miturit që ka mbushur moshën 14 vjeç administrohet nga vetë i mituri, por gjithmonë me pëlqimin paraprak të prindërve. Dispozitat e KF lidhur me birësimin e fëmijës, përcaktojnë se kur i birësuar ka mbushur moshën 10 vjeç, merret mendimi i tij dhe në moshën 12 vjeç kërkohet pëlqimi i tij.

134. Në dispozitat e KF që trajtojnë çështjen e kujdestarisë së fëmijës parashikohet se fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore. Neni 264 i Kodit të Familjes parashikon ndër të tjera se të drejtën e paraqitjes së kërkesës në gjykatë për kujdestar mbi të miturin, e ka edhe vetë i mituri që ka mbushur moshën 14 vjeç. Neni 306 i Kodit të Familjes përcakton rastet e mbarimit të kujdestarisë dhe ndër të tjera kur: 1) fëmija bëhet madhor; 2) fiton zotësinë për të vepruar me martesë. Dispozitat e KF që trajtojnë kujdestarinë mbi personat që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, (neni 311) përcaktojnë se i mituri që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç dhe ndodhet nën përgjegjësinë prindërore, kur i hiqet zotësia për të vepruar nuk i caktohet kujdestar, por vazhdon të jetë nën kujdesin e prindërve, si i mituri që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç.

135. Kodi Civil i RSH-së parashikon “zotësinë për të vepruar”, sipas së cilës personi, kur mbush moshën 18 vjeç, i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër

²⁷ Këto dispozita janë trajtuar në Raportin e Parë.

detyrime civile. Ky Kod në lidhje me pazotësinë për të vepruar , ndër të tjera parashikon se i mituri me moshë 14-18 vjeç, që është i pazotë të kujdeset për punën e tij për shkak sëmundjesh psiqike ose zhvillimi të metë mendor, mund t'i hiqet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës. Këto veprime mund të kryhen nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor. Gjithashtu, kur i mituri nuk ka mbushur moshën 14 vjeç, si dhe pa pëlqimin e prindit ose të kujdestarit të tij atëherë veprimet juridike të kryera prej tij konsiderohen të pavlefshme. Pala që ka zotësi për të vepruar detyrohet t'i shpërblejë të miturit dëmin që ka pësuar për shkak se veprimi juridik konstatohet ose shpallet i pavlefshëm. Kodi Civil parashikon se kur i mituri që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç, ka për banim atë të prindërve të tij. Kur prindërit kanë banime të ndryshme, fëmija e tyre nën katërmbëdhjetë vjeç ka për banim atë të prindit pranë të cilit jeton. Personi të cilit i është hequr zotësia për të vepruar dhe fëmijët nën kujdestari kanë për banim atë të përfaqësuesit të tyre ligjor.

136. Në nenin 371 e 373 të Kodit Civil parashikohet se trashëgimtarë të paaftë për punë janë ata që në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit nuk kanë mbushur moshën 16 vjeç, ose 18 vjeç kur vazhdojnë mësimet. Testament mund të bëjë çdo person që ka mbushur moshën 18 vjeç, si dhe gruaja nën këtë moshë kur është e martuar. I mituri nga 14 - 18 vjeç mund të bëjë testament vetëm për pasurinë që ka fituar me punën e tij. I mituri që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç dhe personat që janë krejt të pazotë për të vepruar nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar. Prindërit, kujdestari ose ata të cilëve u janë besuar ose kanë në mbikëqyrje persona të pazotë për të vepruar, janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga veprimet e paligjshme të fëmijëve nën moshën 14 vjeç, të personave nën kujdestarinë e tyre dhe të atyre që i kanë nën mbikëqyrje e me të cilët banojnë, por që nuk kanë zotësi për të vepruar, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit. I mituri që ka mbushur moshën 14 vjeç, përgjigjet për dëmin e paligjshëm të shkaktuar prej tij. Prindërit ose kujdestari përgjigjen për dëmin e mësipërm kur i mituri nuk nxjerr të ardhura nga puna ose nuk ka vetë pasuri, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit. Në rastin e dëmshpërblimit, Kodi parashikon se i mituri i dëmtuar, kur mbush moshën 16 vjeç dhe nuk ka pagë nga puna e tij, ka të drejtë që në vend të shpërblimit që merr për jetesë, të kërkojë të shpërblehet për humbjen e aftësisë së tij për punë me pagën mesatare të një punonjësi, sipas kritereve të këtij Kodi. Me mbushjen e moshës 18 vjeç ka të drejtë që në vend të shpërblimit që merr, të kërkojë të shpërblehet me pagën mesatare të një punëtori të asaj kategorie që do të kishte fituar ose duhej të kishte fituar po të mos ishte shkaktuar dëmtimi i shëndetit.

137. Kodi i Procedurës Civile (i miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 – ndryshuar), në lidhje me procedurën e vendosjes së kujdestarisë ka parashikuar ndër të tjera të drejtën e të miturit që ka mbushur moshën 16 vjeç që t'i drejtohet gjykatës për vendosjen e kujdestarisë.

138. Në përputhje edhe me Kodin e Familjes, në Kodin e Procedurës Civile parashikohet se në zhvillimin e procedurës së kujdestarisë, gjykata, përpara se të procedojë për emërimin e kujdestarit, duhet të pyesë edhe të miturin, kur ai e ka mbushur moshën 10 vjeç. Kujdestaria merr fund kur i mituri mbush moshën 18 vjeç ose kur e mitura martohet para kësaj moshe.

139. Kodi Penal të RSH-së, ka parashikuar se ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën 14 vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën 16 vjeç (neni 12).

Në ndryshimet e Kodit Penal gjatë periudhës 2000 – 2008, janë parashikuar vepra të reja penale të cilat kryhen ndaj të miturve, si dhe ashpërsimin e dënimit të dhënë ndaj personave të cilët me vendim të formës së prerë shpallen fajtor për një vepër penale të kryer kundër fëmijëve.

140. Me ligjin nr. 9125, datë 29.7.2003 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7961, datë 12/7/1995 “Kodi i Punës i RSh-së”, (i ndryshuar), përcaktohet mosha e punës. Konkretisht në këtë

nen parashikohet se ndalohet marrja në punë e të miturve nën moshën 16 vjeç dhe bëjnë përjashtim rastet kur të miturit nga mosha 14 deri në 16 vjeç punësohen ngjatë pushimeve shkollore vetëm në punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin dhe formimin e tyre. Të miturit nga mosha 14-16 vjeç mund të jenë subjekt i këshillimit dhe i formimit profesional. Në lidhje me kryerjen e “punëve të lehta” parashikohet se të miturit nga mosha 16 -18 vjeç mund të punësohen në punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin dhe formimin e tyre (neni 99/1).

141. Legjislacioni për Forcat e Armatosura rregullon shprehimisht mospërfshirjen e fëmijve nën moshën 18 vjeç, duke përbushur detyrimet e Konventës për garantimin e mbrojtjes të fëmijve nën moshën 18 vjeç dhe mospërfshirjen e tyre në Forcat e Armatosura.

142. Me ndryshimet ligjore të miratuara në vitin 2009 në ligjin “Për Azilin në RSH-së”, në dispozitën e përkufizimeve jepet termi “të mitur të pashoqëruar”, që sipas këtij ligji janë shtetasit e huaj apo personat pa shtetësi nën 18 vjeç, të cilët vijnë në territorin e RSH-së të pashoqëruar nga një person madhor, përgjegjës për ta, sipas ligjit ose sipas traditës dhe për sa kohë ata nuk janë efektivisht nën kujdesin e një personi të tillë. Këtu përfshihen edhe të miturit, të cilët janë lënë të pashoqëruar, pasi kanë hyrë në territorin e RSH-së.

III. Parime të përgjithshme (nenet 2, 3, 6 dhe 12).

a) Follow-up. Masat e ndërmarra për zbatimin e Vëzhgimeve Përfundimtare.

Mosdiskriminimi(neni 2). Rekomandimet 24, 25 të Komitetit CRC:- Ndërmarrja e masave për të zhvilluar dhe zbatuar politika me qëllim eliminimin e formave të ndryshme të diskriminimit

143. Kushtetuta e RSH-së garanton barazi para ligjit mosdiskriminimin mbi bazën e racës, gjinisë, etnisë dhe gjuhës. Gjithashtu legjislacioni shqiptar, parashikon dispozita të veçanta lidhur me diskriminimin në fusha të ndryshme. Disa grupe kanë nevojë për përkujdesje të veçantë për shkak të situatës dhe të qëniet të tyre të prekshëm ose vulnerabël. Të qëniet vulnerabël dhe rreziku i përjashtimit social ka bërë të mundur zhvillimin e planeve të veprimit dhe politikave kombëtare ndërsektoriale për fëmijët, romët dhe personat me aftësi të kufizuar. Shteti shqiptar është angazhuar gjithashtu në procesin e zhvillimit të politikave kombëtare dhe planeve të veprimit për mbrojtjen sociale, reduktimin e varfërisë, antitrafikimin, dhunën në familje etj.

145. Kodi Penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, dhe një nga detyrat e legjislacionit penal është “të mbrojtë dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me minoritetet kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale”(neni 1/b). Me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal të RSH-së” (të ndryshuar) është shtuar një rrethanë tjetër rënduese në nenin 50 të Kodit Penal “rrethanat rënduese” dhe konkretisht: “kryerja e veprës e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale”, rrethanë e cila e rëndon dënimin. Kodi Penal (neni 119/a) parashikon si vepër penale shpërndarjen e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik, konkretisht: a) “Ofrimi në publik ose shpërndarja e qëllimshme publikut, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, e materialeve me përmbajtje raciste ose ksenofobike përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet” b) “Fyerja e qëllimshme publike, nëpërmjet sistemit kompjuterik, që i bëhet një personi, për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.”

146. Ligji “Për sistemin arsimor parauniversitar” (i ndryshuar), garanton të drejtën për arsim për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga statusi i tyre social, kombësia, gjuha, gjinia, feja, raca, përkatësia politike, gjendja shëndetësore dhe niveli ekonomik. Ministria e Arsimit ndjek me fokus të veçantë zbatimin e politikave arsimore për eliminimin e formave të ndryshme të diskriminimit të fëmijëve dhe nxënësve në institucionet e arsimit parauniversitar. Në zbatimin konkret të politikave arsimore për eliminimin e formave të ndryshme të diskriminimit të fëmijëve, MASH mbështetet në Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, ku një ndër objektivat kryesore është “Garantimi i aksesit në të gjitha nivelet e arsimit, duke siguruar mosdiskriminimin mbi bazë ngjyre, race, origjinës etnike aftësisë së kufizuar dhe fesë”.

147. Legjislacioni në fushën e shëndetësisë mbështetet shprehimisht edhe në parimin e mosdiskriminimit. Shërbimet shëndetësore për fëmijët, që ofrohen në nivel parësor, ofrojnë shërbime pa asnjë lloj diskriminimi apo për arsye të tjera. Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, i vitit 2002 parashikon se mjeku duhet të ofrojë ndihmë mjekësore të njëjtë për të gjithë pa dallim moshe, seksi, race, kombësie, feje, pikëpamje politike, gjendje ekonomike, pozite shoqërore duke respektuar në të njëjtën kohë të drejtat dhe dinjitetin e çdo individi. Kodi përcakton se në ushtrimin e profesionit të tij mjeku duhet të angazhohet në kujdesin për fëmijët.

148. Gjithashtu në këtë kuadër MSH-së, ka hartuar edhe programe të veçanta për popullsinë rome, familjet e zonave rurale veçanërisht ato në zonat verilindore me fokus parandalimin, ndjekjen e mirërritjes dhe zhvillimit të fëmijërisë së hershme, vaksinimin, kujdesin për gruan shtatzënë, edukimin shëndetësor të familjes, prindërve për shëndetin e fëmijës, etj.

149. Ligji nr.9952, datë 14.07.2008 “Për parandalimin e HIV/AIDS në RSH-së”, e konsideron si akt të ndaluar stigmatizimin dhe diskriminimin e një personi që jeton me HIV/AIDS. Në këtë ligj përcaktohet se institucionet arsimore publike dhe private nuk u lejohet të kundërshtojnë pranimin e një personi me HIV/AIDS në këto institucione, marrjen e masave disiplinore, ose përjashtimin e tij nga institucioni.

150. Ligji nr.8291, datë 25.2.1998 “Kodi i Etikës së Policisë”, parashikon përgjegjësinë e forcave të policisë për veprime të kundërligjshme, si dhe procedurat e ankimit për raste të diskriminimit në polici.

151. Ligji nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” garanton mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut nga punonjësit e Policisë të Shtetit gjatë kryerjes së detyrave sipas legjislacionit në fuqi, si dhe bazuar në aktet nënligjore.

Në ligj parashikohet ndër të tjera ndalimi i marrjes të të dhënave për personat nga punonjësit e Policisë për persona vetëm për arsye të tilla si gjinia, etnia, raca, gjuha, feja, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, prirja seksuale apo përkatësia prindërore.

152. Ligji nr.9888, datë 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”²⁸ ka si objekt mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, në përputhje me aktet ndërkombëtare. Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve parashikon detyrimin e administratës së burgjeve për realizimin e trajtimit njerëzor dhe edukues të të dënuarve nëpërmjet mënyrave efektive moderne të

²⁸ Amendimi i Ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” është realizuar në bashkëpunim me Misionin EURALIUS (European Assistance Mission for the Albanian Justice System) dhe UNICEF.

administrimit, pa diskriminim për arsye race, ngjyre, seksi, gjuhe, feje, mendimi politik, origjinës kombëtare, ose shoqërore, gjendjes ekonomike etj.

153. Ligji i ri nr. 9959 datë 17.7.2008 “Për të Huajt”²⁹ mbështetet në parimin e reciprocitetit, mosdiskriminimit dhe të trajtimit jo më pak të favorshëm se shtetasit shqiptarë. Subjekt i këtij ligji janë të huajt, të cilët hyjnë ose synojnë të hyjnë në RSH-së, me qëllim qëndrimin, transitimin, punësimin, studimin ose ripranimin dhe ky ligj garanton të drejtat dhe detyrimet e të huajve që punojnë dhe jetojnë në Shqipëri.

154. Ligji nr. 8092 datë 21.03.1996 ”Për Shëndetin Mendor” është mekanizmi kryesor për të siguruar kujdes dhe trajtim të përshtatshëm për njerëzit me çrregullime të shëndetit mendor, mbrojtje të tyre, eliminimin e diskriminimit dhe promovimin e shëndetit mendor në popullatë. Rregullorja e Shërbimeve të Shëndetit Mendor, (miratuar me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë nr.118, datë 15.05.2007) përcakton se shërbimet e shëndetit mendor duhet t’u ofrohen të gjithë personave të sëmurë mendorë pa asnjë dallim gjinor, racor, fetar, etnie, moshe, gjuhe dhe duhet të garantohet në çdo rrethanë dhe në çdo moment të ushtrimit dhe respektimit të të drejtave të tyre.

155. Ligji Nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore”³⁰ thekson se skema e funksionimit të ndihmës ekonomike dhe ofrimit të shërbimeve sociale mbështetet në parimin e mosdiskriminimit. Ligji përcakton kriteret dhe mënyrën e përfitimit të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, që nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive, mundësive personale e ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.

156. Një ndër objektivat e Strategjisë për Fëmijët është sigurimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët, pavarësisht gjinisë, racës, etnisë, moshës, gjendjes shëndetësore, statusit të lindjes, aftësisë së kufizuar fizike e mendore, me qëllim realizimin e të drejtës për mbrojtje shoqërore.

157. Parim i rëndësishëm mbi të cilin bazohet Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale (2007- 2013) është parimi i mosdiskriminimit. Në këtë strategji parashikohet se mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, origjina, feja, mosha, aftësitë e kufizuara etj dhe ka si objektiv parandalimin, luftën kundër diskriminimit në përfitimin e shërbimeve.

VKM nr. 1104, datë 30. 7. 2008 “Për disa shtesa në vendimin nr. 80, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave ”Për miratimin e strategjisë sektoriale të mbrojtjes sociale dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, përcakton konkretisht se aplikantët për të qenë prindër kujdestarë nuk duhet të kenë qëndrime diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara apo minoriteteve etnike.

158. Një ndër parimet bazë të Strategjisë Kombëtare “Për Personat me Aftësi të Kufizuar” është parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, që garanton ndër të tjera mosdiskriminimin në asnjë fushë të jetës shoqërore.

159. Strategjia Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”, përcakton si objektiv kryesor eliminimin e çdo lloj forme diskriminimi ndaj këtij minoriteti, duke synuar përmirësimin e kushteve të jetesës, zbutjen e diferencave me pjesën tjetër të popullsisë.

160. Veprimtaritë sensibilizuese për trajtimin e problemeve të diskriminimit kanë qenë dhe janë prioritet i MASH. Në bashkëpunim me UNICEF dhe organizata të tjera janë realizuar fushata

²⁹ Ky ligj ka shfuqizuar ligjin nr. 8492 datë 27.05.1999 “Për të Huajt” dhe ka hyrë në fuqi më 1.12.2008.

³⁰ Ky ligj ka shfuqizuar ligjin nr. 7710, datë 18. 5. 1993 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror”

edukuese për integrimin e fëmijëve romë në shkolla nëpërmjet ngritjes së qendrave komunitare për gjallërimin e jetës së minoritetit rom, zhvillimit të tryezave të rumbullakëta me tematikë përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit me qëllim mirërritjen e fëmijëve dhe sensibilizimin për rëndësinë e shkollimit.

161. Në vitin 2007, për herë të parë, Qendra e Zhvillimeve Humane me financimin e përbashkët të UNCEF dhe Save the Children dhe me mbështetjen e MASH, realizoi studimin “Situata arsimore e fëmijëve romë në Shqipëri”. Gjetjet dhe rekomandimet e studimit kanë ndihmuar MASH të ndërmarrë një plan veprimi për arsimimin e fëmijëve romë. Mbështetur në “Strategjinë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara”, MASH ka ndërmarrë një sërë masash që arsimit special si pjesë përbërëse e sistemit arsimor publik, të sigurojë zhvillimin sa më të plotë të personave me nevoja të veçanta fizike, mendore e shqisore, në përputhje me nevojat e tyre.

162. Në aktivitetet kulturore dhe argëtuese të organizuara për fëmijët mbahet parasysh dhe garantohet e drejta e fëmijve për mosdiskriminim.

163. Në lidhje me miratimin e një ligji kundër diskriminimit, nga ana e OJF-së Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut është ndërmarrë iniciativa për hartimin e draftit të këtij ligji.

Interesi më i lartë i fëmijës (neni 3). *Rekomandimi 27. Kuptimi dhe përfshirja e parimeve kryesore të interesit më të lartë të fëmijës të dispozitat ligjore, në vendimet juridike dhe administrative, në projekte, programe dhe shërbime.*

164. Në Kodin e Procedurës Penale³¹, parashikohet ndër të tjera se organi procedues mund të kryejë veprime dhe të përpilojë akte, për të cilat kërkohet pjesëmarrja e të miturit, pa praninë e prindit apo personave të tjerë të kërkuar nga i mituri, vetëm kur një gjë e tillë është në interes të të miturit, por gjithmonë në praninë e mbrojtësit.

165. Në Kodin e Familjes në pjesën e dispozitave të përgjithshme është parashikuar respektimi me prioritet i parimit të interesit më të lartë të fëmijës sidomos nga prindërit, organet kompetente dhe gjykatat në vendimet dhe veprimtarinë e tyre kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës (neni 2).

166. Në Kodin e Familjes përcaktohen kompetenca për Prokurorin për të garantuar mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës konkretisht: Prokurori ka të drejtë të ngrëjë padi për pavlefshmërinë e martesës kur ajo është lidhur nga personi që nuk ka mbushur moshën për të lidhur martesë sipas KF. Prokurori ka të drejtë të kërkojë në gjykatë ndryshimin e vendimit lidhur me ushtrimin e të drejtës prindërore. Në rast të zgjidhjes të martesës me kërkesë të përbashkët, kushtet e marrëveshjes të miratuara nga gjyqtari, lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, mund të rishqyrtohen për shkaqe me rëndësi edhe me kërkesë të prokurorit. Prokurori ka të drejtë të kundërshtojë njohjen e fëmijës, në raste kur nga të dhënat e akteve të gjëndjes civile, rezulton pavërtetësia e amësisë dhe atësisë së deklaruar. Prokurori ka të drejtë të kundërshtojë në gjykatë njohjen e amësisë. Prokurori ka të drejtë të paraqesë kërkesë - padi në gjykatë për ndryshimin e kushteve të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, për të vendosur që ajo të ushtrohet nga njëri prind ose nga të dy bashkëshortët. Prokurori ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë për heqjen e përgjegjësisë prindërore në rastet kur prindi shpërdoron përgjegjësinë prindërore ose tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, duke ndikuar në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijëve. Prokurori ka të drejtë të ndërhyjë në procesin e birësimit të fëmijës, duke pasur të drejtën e ankimit ndaj vendimit të

³¹ KPP i ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.06.2002 dhe ligjin nr.9276, datë 16.09.2004.

gjykatës Prokurori ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë për të caktuar kujdestar mbi të miturit. Prokurori ka të drejtë që derisa kujdestari të marrë përsipër funksionet e tij, të paraqesë në gjykatë kërkesë për vendosjen e një kujdestari të përkohshëm ose për të marrë masa të tjera urgjente që janë të nevojshme për mbrojtjen e të miturit ose për të ruajtur dhe administruar pasurinë e tij. Prokurori ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë për zëvendësimin e kujdestarit kur ai vëren se kujdestari shpërdoron të drejtat e tij, tregohet i pakujdesshëm në kryerjen e detyrës, ose, vë në rrezik interesat e të miturit ose kur vetë kujdestari kërkon largimin e tij për shkaqe të arsyeshme.

166. Natyra e punës e prokurorisë është e tillë që nëpërmjet verifikimit të kallëzimeve, kërkesave apo ankesave të qytetarëve, të paraqitura me gojë apo me shkrim, hetimit të çështjeve penale e sidomos atyre me të mitur, nëpërmjet kontakteve me organizmat shtetërore apo organizatat shoqërore që merren me çështjet e edukimit dhe luftës kundër kriminalitetit, i dalin edhe detyra që lidhen me familjen, ose që bëhen shkak për ndodhjen e veprave penale, për të cilat duhet ndërhyrë. Kështu, në rastet kur prokurori konstaton se ka pasur parregullsi në ushtrimin e të drejtës prindërore apo atë të kujdestarisë dhe këto janë bërë shkak për futjen e të miturve në rrugën e krimit, do të ishte me vend që të bëhej kërkesë për heqjen ose ndryshimin e përgjegjësisë prindërore ose kërkesë për caktimin apo ndryshimin e kujdestarit. Në këtë mënyrë mund të veprohet edhe me kompetencat e tjera, me qëllim që të parandalohen zgjidhjet e padrejta të problemeve që kanë të bëjnë me familjen në tërësi dhe në mënyrë të veçantë, zgjidhjet që nuk i shërbejnë për mirë edukimit të të miturve.

166. Kodi i Familjes në nenin 234, parashikon se në rastet kur e kërkon interesi i të miturit, mund të kryhet tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të çdo fëmije të mitur deri në moshën 18 vjeç, lënia hipoteke, ngarkimi me një barrë, marrja hua në emër të të miturit, heqja dorë nga trashëgimia apo legu ose mospranimi i një dhurimi, si dhe përgjithësisht veprimet që kapërcejnë kufijtë e një administrimi të thjeshtë të çdo pasurie të të miturit, mund të kryhen vetëm kur e kërkon interesi i të miturit dhe me autorizim të gjykatës së vendbanimit të të miturit.

167. KF parashikon edhe rastin kur nuk deklarohet braktisja, e cila ndodh atëherë kur një anëtar i familjes ka kërkuar të marrë përsipër rritjen e fëmijës dhe kjo kërkesë është konsideruar në përputhje me interesin e fëmijës. Gjykata që e deklaron të braktisur të miturin nisur nga interesi më i lartë i të miturit, cakton në të njëjtin vendim edhe: 1) kujdestarin për mirërritjen, edukimin dhe arsimimin e fëmijës; 2) një institucion të përkujdesjes sociale ose; 3) një person të caktuar. Kodi i Familjes parashikon se kur ka konflikt midis interesave të të miturve, gjykata mund të caktojë edhe një kujdestar tjetër ose disa kujdestarë. Gjithashtu KF përcakton se kujdestari i posaçëm, i cili vendoset nga gjykata përfaqëson të miturin në rastet kur interesi i tij është në konflikt me interesin e kujdestarit.

168. Në ligjin nr. 9205, datë 15.3.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i cili rregullon masat e posaçme, mënyrën dhe procedurat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe organizimin, funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara me propozimin, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes, parashikohet se në rastin kur personi i mbrojtur është i mitur, dhënia e pëlqimit dhe nënshkrimi i marrëveshjes së mbrojtjes bëhen nga prindi ose kujdestari i tyre, i caktuar sipas ligjit, duke respektuar në çdo rast parimet e interesit më të lartë të tij dhe ato të zotësisë për të vepruar, të parashikuara në dispozitat përkatëse ligjore.

169. Ligji nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”, parashikon rregulla dhe norma ligjore të cilat synojnë të sigurojnë që birësimet të bëhen në interesin më të lartë të fëmijëve duke respektuar të drejtat e tyre themelore.

170. Në zbatim të rekomandimit 27 në lidhje me zbatimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës, në fushën e arsimit, vëmë në dukje se Kushtetuta e RSH-së dhe kuadri ligjor për arsimin garantojnë respektimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Bazuar në parimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve, iniciativa më e rëndësishme e ndërmarrë nga MASH në këtë periudhë, është eksperimentimi për 3 vjet dhe më pas institucionalizimi i Shërbimit Psikologjik Shkollor me Urdhrin nr. 170 dhe Udhëzimin nr.18 datë 21.04.2008 “Për funksionimin e Shërbimit psikologjik Shkollor në arsimin parauniversitar”. Aktualisht, shërbimi është shtrirë kryesisht në shkollat e zonës urbane dhe gradualisht po tenton të shtrihet edhe në shkollat e mëdha të zonës rurale. Ky është një shërbim i munguar në sistemin tonë arsimor që në këto vite po fillon të konsolidohet dhe të vlerësohet si shumë i rëndësishëm nga nxënësit, mësuesit dhe vetë prindërit. Roli i psikologut të shkollës është të identifikojë fëmijët në vështirësi për të përparuar normalisht në procesin mësimor edukativ dhe në bashkëpunim me mësuesit, drejtuesit e shkollës dhe prindërit t’ju vijë në ndihmë.

171. Në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, parashikohen një sërë masash mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje përfshirë edhe fëmijët dhe konkretisht ndër të tjera parashikohet vendosja e menjëhershme të të miturit në strehime të përkohshme duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës.

172. VKM nr. 913, datë 19.12.2007 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, 2007-2010, dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj”, parashikon objektivat dhe masat konkrete për zbatimin e ligjit për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, të cilat do të përmbushen duke respektuar në rradhë të parë parimin “interesi më i lartë i fëmijës”.

173. Aktivitetet kulturore për fëmijët organizohen duke mbajtur parasysh interesin më i lartë i fëmijës.

Rekomandimi 29. Masat lidhur me gjakmarrjen dhe praktikat e tjera, të dëmshme për fëmijën.

174. Me ndryshimet e bëra në Kodin Penal, në vitin 2001, pas nenit 83 të Kodit Penal “kanosja serioze për hakmarrje ose për gjakmarrje”, është shtuar neni 83/a, i cili parashikon se: “Kanosja serioze për hakmarrje ose për gjakmarrje, që i bëhet një personi a të mituri për t’u ngujuar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet.”

175. Ligji nr.9389, datë 4.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër Gjakmarrjes” ka për qëllim të organizojë dhe të koordinojë më mirë masat dhe luftën e organeve shtetërore, institucioneve të tjera shoqërore, shkencore, fetare etj, si dhe të përcaktojë një strategji afatgjatë për parandalimin dhe eliminimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri. Bazuar në këtë ligj është krijuar Këshilli Koordinues nën drejtimin e Presidentit të Republikës, me pjesëmarrjen e Zëvendëskryeministrit, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Prokurorit të Përgjithshëm, Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Avokatit të Popullit.

176. Nga ana e strukturave shtetërore (MPCSSH) ka bashkëpunuar me pushtetin vendor dhe shoqërinë civile, për zbutjen e fenomenit të gjakmarrjes. Gjithashtu në praktikë janë bërë përpjekje që familjet në gjakmarrje të përfitojnë nga programi i ndihmës dhe shërbimeve sociale, brenda hapësirave që lejon ligji nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”. Ky institucion është angazhuar: 1) në ndërmarrjen e nismave ligjore për plotësimin e ligjit nr.9389, datë

4.05.2005, lidhur me përfshirjen e MPCSSHB në Këshillin Koordinues; 2) përmirësimin e programeve në fushën e punësimit, migracionit dhe në fushën sociale për të lehtësuar gjendjen ekonomike të familjeve në gjakmarrje. 3) procesin e hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005, duke përcaktuar edhe klauzola të veçanta për të mbështetur familjet e ngujuara me më shumë mjete financiare, shërbime sociale në familje apo lehtësi të tjera për të përfituar nga programet sociale.

177. Gjithashtu nga ana e Ministrisë së Arsimit, janë ndërmarrë iniciativa për të garantuar Brenda mundësive arsimimin e fëmijëve të ngjuar.

Respektimi i mendimeve të fëmijës (neni 12). *Rekomandimi 31. Respektimi i mendimeve të fëmijëve dhe pjesëmarrjes së tyre në çështjet që kanë lidhje me ta brenda familjes, shkollës dhe institucioneve të tjera, në procedurat juridike dhe administrative, etj.*

178. Kodi i Familjes parashikon se në rastet kur nuk është caktuar kujdestar nga prindi që ka ushtruar i fundit përgjegjësinë prindërore, gjykata para se të caktojë kujdestarin, duhet të marrë edhe mendimin e të miturit, nëse ai ka mbushur moshën 10 vjeç. KF parashikon se gjykata për marrjen e vendimit për birësimin, mer mendimin e të birësuarit, kur ka mbushur moshën 10 vjeç.

179. Në zbatim të Rekomandimit 31, në çështje që kanë lidhje me ta brenda shkollës, në SKF janë përcaktuar si objektiva, rritja e pjesëmarrjes dhe respektimit të mendimit të fëmijëve në familje, shkollë dhe komunitet, si dhe përfshirja e fëmijëve në vendimarrje në nivel shkolle.

180. Në fushën e edukimit pjesëmarrja e fëmijëve ka një rëndësi të veçantë, pasi edukimi është procesi i të mësuarit që i jep fëmijës mundësinë të zhvillojë potencialin e tij, vetëvlerësimin, krijimtarinë, tolerancën, bashkëjetësimin me të tjerët për një shoqëri më demokratike. Rritja e përfshirjes së fëmijëve në vendimarrje në nivel shkolle po zhvillohet gradualisht nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të Qeverive të nxënësve.

Dispozitat Normative të Shkollës, të cilat janë përmirësuar theksojnë domosdoshmërinë e ngritjes së Qeverive të Nxënësve dhe garantojnë të drejtën e përfshirjes së fëmijëve në procesin e vendim marrjes, lidhur me procesin mësimor, veprimtaritë jashtë dhe brenda shkollës. Dispozitat Normative të Arsimit Parauniversitar (DNAP) të miratuar në vitin 2002, ndër të tjera rregullojnë gjithashtu marrëdhëniet e prindërve dhe fëmijëve me mësuesit dhe administratën shkollore, të drejtat dhe detyrat e nxënësve, mësuesve, prindërve etj.

Në kreun VIII të DNA, neni 37, "Qeveria e nxënësve", pika 1, parashikohet se "Qeveria e nxënësve" është një strukturë organizative e pavarur e nxënësve në shkollë. Ajo përfaqëson mendimin e nxënësve për çështjet e shkollës, mësimin dhe edukimin të tyre. Nëpërmjet "Qeverisë së nxënësve" sigurohet pjesëmarrja aktive e nxënësve në proceset e ndryshme demokratike në shkollë dhe në komunitet". "Qeveria e nxënësve" ngrihet në bazë shkolle me pjesëmarrjen e gjithë nxënësve të shkollës dhe është çështje e iniciativës së lirë sipas kushteve dhe mundësive konkrete që ka shkolla. Organet e qeverisjes janë përfaqësuese të masës së nxënësve të shkollës. Organi kryesor i qeverisjes është Senati, i cili përbëhet nga senatorët. Parimet e zgjedhjes dhe aktivitetet e organeve të qeverisjes së nxënësve i përcakton rregullorja e miratuar me shumicë votash me votim të fshehtë, të barabartë dhe të përgjithshëm. Qeveria e nxënësve mund t'i paraqesë drejtorit të shkollës apo këshillit të mësuesve kërkesa për të gjitha çështjet e shkollës, në mënyrë të veçantë ato që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave themelore të nxënësve, të tilla si: a) e drejta për t'u njohur me programet mësimore, që zhvillohen në shkollë, përmbajtjen, realizimin dhe kërkesat e tyre; b) e drejta për vlerësim publik dhe të motivuar të përparimit në mësim dhe në sjellje. c) e drejta për organizimin e jetës në shkollë, duke ruajtur raportet e vendosura midis angazhimit mësimor dhe mundësive për zhvillimin e interesave vetjake; d) e drejta për organizimin e veprimtarive kulturore,

arsimore, sportive dhe argëtuese në marrëveshje me drejtorinë e shkollës, duke bashkëpunuar edhe për zbatimin e respektimin e planit vjetor të punës së shkollës. e) e drejta për botimin e gazetës së shkollës; f) e drejta për të zgjedhur mësuesin që do të kryejë rolin e mësuesit koordinator të Qeverisë së nxënësve, në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës; g) e drejta për të mos u keqtrajtuar e diskriminuar në shkollë etj.

181. Një tjetër është Bordi i shkollës është strukturë organizimi për fëmijët në shkolla ku marrin pjesë përveç prindërve, të zgjedhur me votim nga këshilli i prindërve të shkollës, përfaqësuesve të stafit të mësuesve, bëjnë pjesë edhe 1-2 nxënës. Këshilli i klasës merret me çështje dhe probleme mësimore, edukative të mbarëvajtjes së shkollës; të disiplinës, mjekësore, sociale etj, që lidhen me klasën. Pjesëmarrja e dy ose tre nxënësve të zgjedhur nga qeveria e nxënësve në Këshillin e Disiplinës organ këshillimor i drejtorit, që vepron në shkollë dhe merret me shqyrtimin e rasteve të shkeljes së disiplinës nga nxënësit, përbën shprehje të lirisë së organizimit të fëmijëve

182. Gjatë periudhës 2004 - 2008, është rritur numri i shkollave në të cilat funksionojnë Qeveritë e Nxënësve. Kjo padyshim ka rritur pjesëmarrjen e nxënësve në vendimmarrje. Numri i programeve që përgatisin fëmijët për të marrë rol vendimmarrës për çështjet që u përkasin atyre është rritur, si dhe është përmirësuar edhe cilësia e programeve. Përpjekje bëhen për përfshirjen në programin mësimor të temave të cilat jo vetëm trajtojnë të drejtën e fëmijëve për pjesëmarrje, por edhe i ndërgjegjësojnë fëmijët për të qenë nxënës të mirë dhe qytetarë të mirë. Projekti i MASH me Save the Children Albania, që vazhdon aktualisht, ka si qëllim fuqizimin e punës së qeverisë së nxënësve.

183. Në kuadër të fuqizimit të punës së Qeverisë së Nxënësve, vazhdon zbatimi i projektit të MASH me Save the Children Albania.

184. Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar puna kualifikuese me mësues koordinatorë, drejtues shkollash dhe përfaqësues të Qeverisë së Nxënësve. Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit ka zhvilluar një sërë trajnimesh me drejtorët e shkollave lidhur me përdorimin “Manualit të drejtorit dhe mënyrën e përdorimit të tij”. Në këtë manual një vend të veçantë zë dhe funksionimi i qeverisë së nxënësve dhe kushtet që duhet të krijohen në shkollë për mbarëvajtjen e punës.

Fëmijët kanë marrë njohuri në çështje të ndryshme përfshirë dhe teknikat e organizimit dhe komunikimit, duke u bërë pjesë e marrjes së vendimeve në shkollë, por edhe në çështje të barazisë gjinore. Gjatë takimeve në shkolla të ndryshme, drejtorët janë konsultuar me anëtarë të qeverive të nxënësve për të diskutuar vendimet e marra për rregulloren e shkollës, përdorimin e uniformës, mbështetje për fëmijët në nevojë dhe planifikimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare. Gjatë vitit 2007, më shumë se 15000 fëmijë kanë përfituar nga organizimi i aktiviteteve të organizuara nga qeveritë e nxënësve.

Nisur nga kjo eksperiencë, MASH ka nxjerrë disa udhëzime për shkollat, ku i jep rëndësi vendosjes së një personi përgjegjës për monitorimin e qeverisë së nxënësve në mënyrë që të jenë aktivë në përgatitjen e pyetësorëve për dhunën në shkollë dhe për ti dhënë më shumë zë këtyre strukturave gjatë procesit të hartimit të kurrikulave, luftën kundër korrupsionit etj. 100 anëtarë të qeverive të nxënësve kanë marrë njohuri për pjesëmarrjen aktive. Një tjetër shembull pozitiv i pjesëmarrjes së fëmijëve është pjesëmarrja e fëmijëve në këshillin bashkiak të Tiranës. 16 fëmijë, presidentë të qeverive të nxënësve të shkollave 9 vjeçare publike dhe private të kryeqytetit, marrin pjesë në Senatin e Fëmijëve të Tiranës. Senati ka si qëllim shprehjen e pikëpamjeve të fëmijëve dhe mendimeve të tyre në lidhje me vendimet që merren nga Bashkia e Tiranës për fëmijët.

185. Fëmijëve duhet t’u jepet mundësia jo vetëm të shprehin mendimet e tyre, por edhe të mësojnë sesi po trajtohen dhe se sa po merren parasysh këto mendime dhe shqetësime, sepse vetëm në këtë

mënyrë pjesmarrja e tyre do të jetë e vërtetë. Si për fëmijët ashtu edhe për të rriturit, sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijëve është pjesë e procesit të vështirë të njohjes dhe respektimit të njëri – tjetrit, prandaj nuk duhet të jetë thjesht një formalitet. Me shprehjen e mendimeve të fëmijëve duhet të vijë edhe përgjegjësia e të rriturve për t'i dëgjuar e mësuar prej tyre, për t'i kuptuar e marrë parasysh pikëpamjet e fëmijëve dhe për të ndërmarrë zgjidhje që respektojnë dëshirat e tyre.

Rekomandimi 33. Zhvillimi i linjës të ndihmës.

186. Në Konferencën Vjetore për Fëmijët të organizuar në datën 1 qershor 2009 me rastin e ditës ndërkombëtare të fëmijëve, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta promovoi Linjën Kombëtare të Ndihmës për Fëmijë, nëpërmjet të cilit nevojat e fëmijëve nga i gjithë vendi do të vijnë në vëmendje të profesionistëve. Krijimi i kësaj linje është një iniciativë e UNICEF dhe CRCA. Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijët në Shqipëri ka si qëllim që të ofrojë këshillim psiko-social për fëmijët nëpërmjet telefonit, referimin e çdo problemi të fëmijës pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, Njesive të Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashki dhe OJF-ve; të dëgjojë ankesat e çdo fëmije, i cili nuk ka mundësi që t'i shprehë ato në një formë tjetër.

Linja Kombëtare për Fëmijët ka vendosur në përdorim aktiv numrin pan-europian **116** që i është rezervuar kësaj linje nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Numri 116 gëzon cilësitë e një numri si ai i policisë apo urgjencës. Linja do të ofrojë shërbim të hapur, falas për fëmijët dhe e shtrirë në 24 orë/ditë në 7 ditë të javës. Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijët, si një iniciativë e UNICEF, financohet gjatë vitit 2008-2010 nga zyra e UNICEF në Shqipëri.

b) Zbatimi i programeve kombëtare dhe monitorimi i tyre.

Informacion lidhur me masat ligjore, administrative, gjyqësore etj, për zbatimin e të drejtave të parashikuara nga Konventa.

Interesi më i lartë i fëmijës (neni 3).

187. Çështjet që lidhen me krijimin e një ambienti mbrojtës për fëmijët gradualisht janë përfshirë në listën e prioritetëve të qeverive gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Si rezultat i situatës ekonomike dhe shoqërore si edhe i dukurive që lidhen me tranzicionin, fëmijët përballen me shumë dukuri kritike që ndikojnë në mohimin, përjashtimin apo mos respektimin e të drejtave të tyre. Përpjekjet për mbrojtjen shoqërore dhe integrimin e fëmijëve të përjashtuar po bëhen më efektive. Si pjesë e SKZHI-së, qeveria ka hartuar Strategjinë e Përfshirjes Sociale nëpërmjet së cilës synohet të harmonizohen dhe koordinohen politikat të cilat realizojnë përfshirjen sociale të të gjithë fëmijëve. Realizimi i të drejtës për mbrojtje shoqërore në SKF synohet të arrihet nëpërmjet arritjes të një sërë objektivash³², që synojnë të garantojnë mundësi të barabarta për fëmijët.

188. Në lidhje me nenin 3 paragrafi 2 në Kodin e Familjes (neni 235) trajtohet edhe e drejta e prindit për të përdorur të ardhurat nga pasuria e fëmijës që ata administrojnë, për mirërritjen, edukimin dhe arsimimin e tij. Ata mund t'i përdorin këto të ardhura, për të plotësuar nevojat e domosdoshme të familjes, kur nuk kanë pasuri të mjaftueshme për t'i plotësuar vetë ata. Të ardhurat e mbetura kthehen në pasurinë e fëmijës. E drejta e përdorimit të pasurisë së fëmijës, sipas KF është e lidhur me të drejtën e administrimit ligjor. Kjo e drejtë u takon të dy prindërve bashkërisht ose atij që është i ngarkuar me administrimin e pasurisë së fëmijës. Kjo e drejtë e prindit pushon: 1) kur fëmija bëhet madhor; 2) për shkaqet për të cilat merr fund përgjegjësia prindërore ose administrimi ligjor; 3) për të gjitha shkaqet që lidhen me marrjen fund të uzufuktit. Gjithashtu, kjo e drejtë nuk shtrihet mbi

³² Këto objektiva trajtohen më konkretisht në komentet sipas neneve përkatëse.

pasurinë që ai fiton nga puna e tij, as mbi pasurinë që i është dhuruar ose që i ka kaluar me trashëgimi, kur prindi është ndaluar shprehimisht të ketë të drejtën e përdorimit mbi këtë pasuri.

KF parashikon se fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore. Kodi i Familjes përcakton se Kujdestari i të miturit i caktuar nga gjykata, ka këto detyra: 1) kujdeset për të miturin; 2) e përfaqëson të miturin në të gjitha veprimet juridike; 3) administron pasurinë e të miturit në përputhje me dispozitat e caktuara në Kod. Ndërsa detyrimet e të miturit në rastin e vendosjes nën kujdestari janë: 1) të respektojë dhe t'i bindet kujdestarit; 2) nuk mund të braktisë banesën ose institucionin ku është lënë, pa lejen e kujdestarit. Në rastin kur largohet pa leje, kujdestari ka të drejtë ta kërkojë të miturin dhe nëse është e nevojshme, t'i drejtohet gjykatës për kthimin e tij.

189. Kodi i Familjes ka parashikuar edhe rastet kur gjykata vendos caktimin e një kujdestari të posaçëm: 1) ka konflikt interesash midis të miturit dhe prindërve ose midis të miturit dhe kujdestarit të tij, si dhe kur midis tyre duhet të kryhet një veprim juridik; 2) ka konflikt interesash midis të miturve, vëllezër dhe motrave, që kanë të njëjtin kujdestar ose kur duhet të kryhet një veprim juridik midis tyre; 3) për shkak sëmundjeje ose për shkaqe të tjera, kujdestari i caktuar pengohet të kryejë një veprim të caktuar ose të japë pëlqimin për kryerjen e një veprimi. Në rastet e lartpërmendura, kujdestari i posaçëm caktohet nga gjykata mbi bazën e kërkesës: 1) të prindit; 2) të kujdestarit; 3) të afërmeve të të miturit; 4) të miturit që ka mbushur moshën 14 vjeç; 5) personave të interesuar.

190. Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013 është pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe gjithashtu një komponent i rëndësishëm i Strategjisë Ndërsektoriale të Përfshirjes Sociale, e cila paraqet politikat për reduktimin e varfërisë dhe luftën kundër përjashtimit social. Kjo Strategji parashikon se grupe të caktuara, përfshirë fëmijët, duhet të gëzojnë mbrojtje të veçantë në përputhje me të drejtat dhe nevojat e tyre. Fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes nga dhuna, shfrytëzimi, abuzimi dhe neglizhenca, kudo që ata ndodhen.

191. Përsa i përket nenit 3/3, reforma në sistemin e mbrojtjes shoqërore, e ndërmarrë nga MPCSHB, synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara në insitucionet e përkujdesjes shoqërore, duke vënë në qendër nevojat e klientit, fëmijës. Në këtë kuadër janë miratuar dhe po zbatohen: 1) Standartet për shërbimet sociale për fëmijë në qendra rezidenciale, (VKM nr. 659, datë 17.10.2005). 2) Standartet për shërbimet për personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale dhe ditore, miratuar me VKM nr. 822, datë 6.12. 2006. 3) Standartet për shërbimet e përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar apo në rrezik trafikimi, (VKM nr. 195 datë 11.04.2007). Këto standarte ndikojnë në ndryshimin e konceptimit mbi shërbimet për fëmijë, pasi synojnë të mbrojnë të drejtat e fëmijëve duke siguruar mirërritjen e tyre në një mjedis të sigurtë dhe familjar, që respekton individualitetin dhe stimulon zhvillimin dhe integrimin e tyre në shoqëri.

192. Mbështetur në standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale, Inspektoriati i Shërbimeve Shoqërore kryen inspektime periodike në strukturat rezidenciale publike dhe jopublike. Nga monitorimet e realizuara, për vlerësimin e standarteve, arrihet në konkluzionin se strukturat rezidenciale publike dhe jopublike kanë bërë progres në zbatimin e tyre, duke përmirësuar treguesit në të gjitha aspektet.

193. Në kuadër të projektit të UNICEF-it "Mbështetje për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit për fëmijët në institucionet rezidenciale" gjatë periudhës maj-tetor 2007, Shërbimi Social Shtetëror organizoi trajnimin e stafeve të institucioneve rezidenciale të përkujdesit për fëmijët dhe qendrave të zhvillimit për njohjen dhe zbatimin e standardeve të përkujdesit në qendrat rezidenciale. Trajnimet e zhvilluara në rajone të ndryshme të vendit në të cilat trainuan rreth 150

drejtues dhe specialistë të këtyre insitucioneve kishin në fokus: 1) Shqyrtimin e standarteve përkundrejt praktikës aktuale, renditjen e përparësive të standarteve; 2) Përpilimin e procedurave, formularëve, skedave, planeve që lidhen me çdo tregues specifik të standarteve- Plani i përkujdesit individual për çdo fëmijë, plani i largimit nga strukturat rezidenciale, procedurat e ankimit etj.

194. Gjithashtu me miratimin e akteve nënligjore përkatëse krijohen kushtet për punësimin me prioritet të punonjësve socialë dhe psikologëve në institucionet që merren me edukimin, mirërritjen, kujdesin dhe trajtimin e fëmijëve si shkolla, gjykata, komisariate policie, burgje, spitale, qendra komunitare, etj. Drejtoritë Arsimore janë mbështetur me fondin e nevojshëm të pagave, ndërsa punonjësit socialë dhe psikologët kanë filluar të ushtrojnë profesionin në institucionet arsimore.

195. Reforma në kujdesin shëndetësor parësor, e cila ka filluar në dhjetor 2006 ka si qëllim përmirësimin e performancës të kujdesit shëndetësor parësor, përfshin edhe shërbimet e shëndetit të fëmijës ku synohet rritja e aksesit dhe cilësisë ndaj shërbimeve shëndetësore efektive të kujdesit për nënën dhe fëmijën, nëpërmjet: a) Hartimit të një pakete të shërbimeve bazë për kujdesin shëndetësor parësor të cilat do t'i ofrohen falas popullatës. Pjesë e kësaj pakete janë edhe shërbimet parandaluese, trajtuese dhe promocionale për fëmijët. Shërbimi për fëmijët në Kujdesin Shëndetësor parësor ofrohet falas. Në paketë është përcaktuar qartë shërbimi që do ofrohet për fëmijët, qëllimi tij, manaxhimi i gjendjeve të zakonshme në fëmijëri, kujdesi parandalues dhe promovimi fëmijë/familje, aftësitë që duhet të ketë personeli shëndetësor për të ofruar këtë shërbim, sistemi referimit, shërbimet që duhen ofruar në komunitet, standartet që duhet të ketë ky shërbim në përputhje me udhëzuesit e praktikës klinike të përgatitur nga departamentet universitare të mjeksisë familjare dhe pediatri, pajisjet dhe barnat që duhet të ketë qendra për të ofruar këtë shërbim ndaj fëmijës dhe dokumentacioni mjekësor i unifikuar. b) Ngritjen e një sistemi monitorimi që do të kontrollojë ofrimin e shërbimeve të paketës dhe rishikimin e strukturave të shërbimeve të fëmijës në kujdesin shëndetësor parësor në funksion të kushteve të reja; c) Përgatitjen e udhëzuesve, rregulloreve, standarteve të unifikuar për shëndetin e nënës e fëmijës në shërbimet shëndetësore. d) Trajnimin e personelit shëndetësor të shërbimeve të kujdesit për fëmijën për rritjen e njohurive.

E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit (neni 6).

196. Legjislacioni shqiptar sipas fushave përkatëse përcakton një sërë dispozitash të garantojnë të drejtën e jetës së fëmijëve dhe zhvillimin e tij.

Në nenin 3 të Kodit të Familjes, parashikohet shprehimisht se “Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesë ose jashtë martesë. Në dispozitat e tjera trajtohet barazia në të drejta dhe detyrime që kanë fëmijët e lindur jashtë martesë me fëmijët e lindur nga martesë. Çdo fëmijë, për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, ka të drejtë të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi. Në KF trajtohet barazia në të drejta e detyrime që kanë fëmijët e lindur jashtë martesë me fëmijët e lindur nga martesë. Çdo fëmijë, për një zhvillim të plotë e harmonik të personalitetit, ka të drejtë të rritet në një mjedis familjar, atmosferë gëzimi, dashurie e mirëkuptimi.

197. Kodi Penal mbështetet në parimin e barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit (neni 1/c). Ky Kod parashikon si rrethanë rënduese kryerjen e veprave penale ndaj fëmijëve. Në Kodin Penal janë parashikuar një sërë dispozitash, të cilat kanë si qëllim parashikimin e veprave penale dhe sanksioneve përkatëse, me qëllim mbrojtjen e jetës së njeriut përfshirë edhe të fëmijës. Konkretisht janë parashikuar këto vepra penale: Vrasja (nenet 76 – 83, 85 të Kodit Penal); Kanosja (neni 84); Tortura (nenet 86 dhe 87); Plagosja (neni 88/b); Plagosja e rëndë me dashje (neni 88, 88/a); Plagosja e lehtë me dashje (neni 89); Dëmtime të tjera me dashje

(neni 90); Plagosja e rëndë nga pakujdesia (neni 91); Plagosja e lehtë nga pakujdesia; (neni 92) Mosdhënia e ndihmës (neni 97); Shkaktimi i vetëvrasjes (neni 99); Marrëdhënie seksuale (nenet 100-107); Vepra të turpshme (neni 108); Rrëmbimi (neni 109, 109/a); Trafikimi (neni 110/1 dhe neni 114/b, për të miturit 128/b); Dhunimi i banesës (neni 112); Shfrytëzimi i prostitucionit (neni 114); Fyerja (neni 119); Shpifja (neni 120) Braktisja (neni 124) Keqtrajtimi i të miturit (neni 124/b) Mosdhënia e mjeteve për jetesë (neni 125; Marrja e padrejtë e fëmijës (neni 127)

198. Kuadri ligjor në fushën e arsimit përcakton se shtetasit shqiptarë gëzojnë të drejta të barabarta për t'u arsimuar në të gjitha nivelet e arsimit të përcaktuara nga ligji.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (MASH) ka formuluar si drejtim themelor politik afatgjatë të zhvillimit të sistemit arsimor sipas standardeve arsimore europiane. Objektivat specifike të sektorit të arsimit vazhdojnë të mbeten: rritja e rregjistrimeve dhe pjesëmarrjes në arsimin e detyrueshëm e të mesëm, kryesisht profesional dhe në zona të varfëra e të thella të vendit, përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies, zgjerimi i arsimit profesional dhe përshtatja me nevojat e tregut, rritja e efektivitetit të arsimit dhe efikasitetit të sistemit arsimor. Drejtimet themelore të masave të zbatimit të SKZHI për përmirësimin cilësor e sasior të treguesve të arsimit konsiderohen: i) Inkurajimi i pjesëmarrjes së komunitetit, ii) përmirësimi i aksesit dhe barazisë, iii) përmirësimi i cilësisë, iv) përmirësimi i kapacitetit menaxhues, v) përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve.

Strategjia Kombëtare për Fëmijë si dokument politik në përputhje të plotë me objektivat strategjike të SKZHI për arsimin synon rritjen e efektivitetit të administrimit publik dhe të efikasitetit financiar të sistemit arsimor, duke garantuar të drejtën e fëmijëve për arsim cilësor.

199. Legjislati në fushën e shëndetësisë mbështetet në parimet e barazisë, drejtësisë.

Strategjia e Ministrisë së Shëndetësisë synon rishpërndarjen, rehabilitimin e qendrave shëndetësore ekzistuese dhe mbulimin e vendit me qendra shëndetësore dhe ambulanca sipas standardeve.

Strukturat shëndetësore ofrojnë kujdes pas lindjes për nënën dhe foshnjën, e cila përfshin këshillim rreth ushqyerjes me gji, ushqyerjen dhe planifikimin familjar. Me qëllim përmirësimin e cilësisë së kujdesit për gruan shtatzënë kanë përfunduar të gjitha protokollat e kujdesit për gruan shtatzënë për personelin e Kujdesit Shëndetësor Parësor (KSHP) dhe janë duke u përgatitur edhe protokollat për kujdesin e nënës dhe fëmijës gjatë lindjes dhe pas lindjes. Protokollat synojnë të promovojnë kujdesin shëndetësor në periudhën kritike perinatale, që shtrihet nga 22 javë shtatzëni deri në 7 ditë mbas lindjes për t'i siguruar fëmijëve një fillim të shëndetshëm në jetë duke reduktuar sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë amtare dhe perinatale nëpërmjet promovimit të mëmësisë së sigurtë. Planifikimi familjar është një nga ndërhyrjet kosto-efektive për përmirësimin e gjendjes shëndetësore të nënës dhe fëmijës dhe uljen e sëmundshmërisë e vdekshmërisë së tyre.

200. Sipas studimit të fundit të MICS 2005, vdekshmëria foshnjore vlerësohet të jetë 18 për 1000 lindje gjallë dhe vdekshmëria e fëmijëve nën 5 vjeç vlerësohet 19 për 1000 lindje gjallë. Duke u mbështetur në të dhënat administrative të MSH-së, vihet re një tendencë e theksuar drejt zvogëlimit të vdekshmërisë foshnjore nga 17.5 % që ishte në vitin 2002 në 11% në vitin 2008. Treguesi i vdekshmërisë foshnjore monitorohet në mënyrë të vazhdueshme edhe nga strukturat e MSH-së. Vdekshmëria foshnjore është e lidhur ngushtë me nivelin e edukimit të nënës dhe gjendjen ekonomike të familjes dhe konsiderohet si një tregues i rëndësishëm i mirëqenies së fëmijëve.

201. Projektet në fushën e kulturës për fëmijë dhe organizimi i aktiviteteve kulturore, hartohen dhe zbaton duke mbajtur parasysh të drejtën e fëmijëve për zhvillim kulturor.

202. Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013 përcakton se një mjedis favorizues duhet të sigurojë mbijetesën dhe zhvillimin maksimal të individëve, në aspektin e zhvillimit fizik, mendor,

shpirtëror, moral, psikologjik dhe social, në përputhje me dinjitetin njerëzor. Kjo strategji mbështetet në respektimin e të drejtave të individit duke parashikuar se çdo individ në nevojë ka të drejtën të përfitojë të njëjtën ndihmë shoqërore apo shërbime.

Respektimi i pikëpamjeve të fëmijës (neni 12).

203. Kodi i Familjes përcakton detyrimin e organeve shtetërore, kryesisht organeve gjyqësore, që në çdo procedurë që i përket të miturit, ai ka të drejtë të dëgjohej, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, duke ruajtur të drejtën që i japin dispozitat e veçanta që garantojnë ndërhyrjen dhe dhënien e pëlqimit nga ana e tij. Në rastet kur i mituri kërkon të dëgjohej, kërkesa e tij nuk mund të rrëzohet, veçse për shkaqe të rënda dhe me një vendim tepër të motivuar. I mituri mund të dëgjohej vetë, nëpërmjet një avokati ose një personi të zgjedhur prej tij. Në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme për të vlerësuar thëniet e të miturit, në përputhje me zhvillimin mendor dhe situatën e tij sociale. Në nenin 157/b/c të KF parashikohet se gjyqtari, në rastin e vendosjes për mënyrën e përgjegjësisë prindërore, ose për t'i besuar fëmijën një të treti, merr në konsideratë mendimin dhe ndjenjat e shprehura nga fëmija i mitur, duke vlerësuar moshën dhe zhvillimin e tij, si dhe mendimin e psikologut ose të sektorit të shërbimeve sociale pranë Bashkisë, pasi këta të kenë dëgjuar fëmijën. Gjithashtu KF parashikon se gjatë gjykimit duhet të dëgjohej dhe i mituri që ka mbushur moshën 10 vjeç, në praninë e psikologut.

204. Kodi i Familjes në lidhje me birësimin e fëmijës, ka parashikuar që gjatë procedurës me të miturit të jetë i pranishëm edhe psikologu, si edhe fëmija që ka mbushur moshën 10 vjeç të japë mendimin e tij para gjykatës, ndërsa kur është 12 vjeç të japë pëlqimin e tij.

IV. Të drejtat civile dhe liritë (nenet 7,8,13-17, 37 a)

a) Follow-up. Masat e ndërmarra për zbatimin e Vëzhgimeve Përfundimtare.

Regjistrimi i lindjeve (neni 7. Rekomandimi 35. *Regjistrimi i fëmijëve, duke lehtësuar regjistrimin e vonuar, duke i kushtuar vëmendje të veçantë grupeve të marginalizuar dhe vulnerabël.*

205. Me ligjin nr.9929, datë 09.06.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen Civile”, shtetasve shqiptarë, i janë krijuar lehtësi në regjistrimin e fëmijëve, konkretisht: 1) Heqja e vendimeve të gjykatave, i cili shpeshherë për shtetasit, krijonte pengesa në regjistrimin e fëmijëve. 2) Në bazë të këtij ligji të gjitha subjektet shëndetësore shtetërore dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruar që brenda 7 ditëve nga lindja e fëmijës duhet të dërgojnë në Zyrat e Gjendjes Civile, ku prindërit kanë vendbanimin, njoftimet për lindjet e ndodhura pranë institucioneve të tyre, ku për këto institucione lidhur me mosnjoftimin në afat, aplikohen gjoba. Kjo masë shtrënguese është parashikuar, jo ndaj shtetasve si praktikë në zbatim të ligjit të mëparshëm, por ndaj institucioneve përgjegjëse. 3) Për shtetasit, të cilët deklarojnë lindjet brenda afatit 60 ditor, për lindjet brenda vendit dhe 90 ditor për lindjet jashtë shtetit, është vendosur një shpërblim në masën 5 000 (pesë mijë) lekë. 4) Gjithashtu për të gjitha gjitha lindjet e padeklaruara deri në datën 15 shtator 2008 (pavarësisht nga viti i lindjes), u aplikua dhënia e shpërblimit edhe për këtë kategori. Kjo masë lehtësuese u shoqërua dhe me një fushatë sensibilizimi dhe pati efekte pozitive në regjistrimin e lindjeve me kalim afati.

206. Në bazë të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”³³, shtetasve shqiptarë, i janë krijuar lehtësi në regjistrimin e fëmijëve, konkretisht: 1) Heqja e vendimeve të gjykatave, ku shtetasit ishin të detyruar në mënyrë formale të konfirmonin lindjet me kalim afati (n.q.s kishte kaluar afati 45 ditor për lindjet brenda vendit dhe 90 ditë për lindjet jashtë vendit). Kjo masë shtrënguese, e cila ishte parashikuar në ligjin e vjetër nr. 8950, datë 10. 10. 2002 “Për gjendjen civile”, krijonte pengesa në regjistrimin e fëmijëve; 2) Gjithashtu ligji i ri parashikon që të gjitha subjektet shëndetësore shtetërore dhe private që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruar që brenda 7 ditëve nga lindja e fëmijës duhet të dërgojnë në Zyrat e Gjendjes Civile, ku prindërit kanë vendbanimin, njoftimet për lindjet e ndodhura pranë institucioneve të tyre, ku për këto institucione lidhur me mosnjoftimin në afat, janë parashikuar sanksione. Në këtë mënyrë masat shtrënguese aplikohen, jo me ndaj shtetasve si praktikë në zbatim të ligjit të mëparshëm, por ndaj institucioneve përgjegjëse; 3) Në ligjin e ri janë parashikuar shpërblim në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë për të gjithë shtetasit të cilët deklarojnë regjistrimin e lindjeve, (brenda afatit 60 ditor, për lindjet brenda vendit dhe 90 ditor për lindjet jashtë shtetit). Kjo masë lehtësuese u shoqërua dhe me një fushatë sensibilizimi dhe pati efekte pozitive në regjistrimin e lindjeve me kalim afati.

207. Bazuar në ligjin “Për gjendjen civile”, shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në RSH-së, si edhe shtetasit e huaj që kanë përfutur azil në RSH-së kanë të drejtën të kryejnë veprimet pranë zyrës së gjendjes civile që përfshihet në territorin ku ka ndodhur ngjarja. Konkretisht në rast të një ngjarjeje të tillë, çdo i interesuar ka të drejtën të paraqitet pranë zyrës së gjendjes civile me dokumentacionin përkatës dhe të kryejë veprimet sipas rastit. I interesuari deklaron ngjarjen para nëpunësit të gjendjes civile dhe në rastin e mbajtjes së aktit të lindjes prindërit plotësojnë të gjithë përbërësit e gjendjes civile, përfshirë edhe shtetësinë, që në bazë të ligjit nr. 8442, datë 21. 01. 1999 “Për disa ndryshime në ligjin “Për Shtetësinë Shqiptare”, prindërit mund t’i përcaktojnë fëmijës dhe shtetësinë shqiptare. Për fëmijët e lindur jashtë territorit të RSH-së nga shtetas shqiptarë, me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në Përfaqësitë Diplomatike ose Konsullore Shqiptare në vendin ku ka ndodhur ngjarja. Kur kjo është e pamundur regjistrimi bëhet edhe në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi.

208. Lidhur me rekomandimin 35, përsa i përket aksesit të fëmijëve që nuk kanë çertifikatë lindje në shkollë, me heqjen e masave shtrënguese gjithnjë e më tepër po bëhet i mundur regjistrimi i fëmijëve të familjeve romë, të cilët figuronin të paregjistruar në zyrat e gjendjes civile. Me qëllim mënjanimin e barrierave që pengonin fëmijët romë të moshës parashkollore dhe shkollor, të regjistroheshin në institucionet arsimore, pasi nuk ishin të pajisur me çertifikatë lindje, Ministri i Arsimit ka nxjerrë Udhëzimin nr. 6 datë 29.03.200 “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me çertifikatë lindje”. Kjo masë ka lehtësuar procesin e regjistrimit të fëmijëve romë në kopshte dhe shkolla pa çertifikatë. Zbatimi i Udhëzimit të MASH nr. 34, datë 08.12.2004 “Për zbatimin e projektit “Shansi dytë” ka siguruar rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve të shtetasve të marginalizuar në shkollë. Në shkollë vendi funksionojnë mbi 30 klasa të tilla me mbi 500 nxënës. Bashkëpunimi me organizata të ndryshme për zbutjen e varfërisë së familjeve romë me synim sensibilizimin e tyre për tërheqjen e fëmijëve në shkollë, krijimi i qendrave komunitare si në rastin e “Qendrës sociale për fëmijët romë” në rrethin e Kuçovës, hapja e shkollave të posaçme për fëmijët romë në shumë rrethe të vendit, rikonstruksioni i shkollave në mbi 7 rrethe ku është dhe numri më i madh i minoritetit rom, ka krijuar aksesin e nevojshëm të gjithëpërfshirjes së tyre.

Liria e shprehjes (neni 13). Rekomandimi 37.

³³ Ky ligj ka shfuqizuar ligjin nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen Civile” me ndryshimet përkatëse.

209. Siç është evidentuar edhe në Raportin e Parë, Kushtetuta garanton lirinë e informacionit, të shprehjes, lirinë e shtypit, lirinë e radiotelevizionit. Në Kushtetutë në pjesën mbi të drejtat social-kulturore, sanksionohet e drejta e kujtdo (përfshirë edhe fëmijën) për tu informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, të drejtën e arsimit, lirinë e krijimit artistik dhe kërkimit shkencor. Legjislacioni shqiptar sipas fushave përkatëse garanton shprehjen e mendimeve të fëmijës, marrjen shkëmbimin e informacioneve, si dhe pjesëmarrjen në jetën social kulturore. Konkretisht ligji "Për Radio Televizionin publik e privat" në mënyrë të përgjithshme garanton lirinë e informacionit dhe shprehjes edhe për fëmijët. Ligji "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" garanton të drejtën e informimit edhe për fëmijët, pavarësisht se nuk përcaktohet kjo e drejtë shprehimisht, si dhe pjesëmarrjen e fëmijve në komunitet, nëpërmjet shprehjes së mendimeve të tyre.

Aksesi në informacion (neni 17). Rekomandimi 39.

210. Veprimtaria e medias elektronike, e cila përfshin prodhimin dhe transmetimet në territorin e RSH-së regullohet me ligjin nr.8419, datë 30.09.1998 "për radion dhe televizionin publik dhe privat në RSH-së" dhe me ligjin nr.9742, datë 28.05.2007 "Për transmetimet numerike në RSH-së". Në ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 përcakton se në veprimtarinë radio-televizive respektohen në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale dhe ligjore për mbrojtjen e të miturve. Në nenet 36,38, 43 të këtij ligji, theksohet respektimi i dinjitetit, mbrojtja e shëndetit moral dhe mendor të fëmijve dhe adoleshentëve, ndalimi i prodhimit dhe transmetimit të programeve pornografike dhe zbatimi i Kodit të Etikës përmes transmetimit në orare të përshtatshme të programeve të caktuara. Ligji parashikon gjithahstu mbrojtjen e të miturve në fushën e publicitetit. Përmbushja e detyrimeve ligjore dhe atyre që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare është objekt parësor i punës dhe veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Radio-Televizioneve (KKRT). Duke qënë se televizioni është mjeti më i përhapur i komunikimit publik dhe "rreziku mediatik" është gjithmonë i pranishëm për shkak të trysnisë që ai ushtron kryesisht te fëmijët, programet që u kushtohen atyre kanë qënë në qendër të vëmendjes së KKRT-së për monitorimit dhe sondazheve të vazhdueshme. Lidhur me zbatimin e Kodit të Etikës, janë vëzhguar dhe monitoruar disa operatorë radiotelevizivë, duke synuar identifikimin e rasteve, paraqitjen e shembujve ku mund të jetë abuzuar me fëmijët jo vetëm nga neglizhenca, por edhe nga mungesa e përgjegjësisë për zbatimin e ligjit dhe respektimin e normave etiko-morale. Vitet e fundit si rezultat i rritjes së numrit të operatorëve të licensuar kombëtarë dhe lokalë, është përmirësuar struktura programore, është rritur ndjeshmëria dhe ndërgjegjësimi për domosdoshmërinë dhe cilësinë e programeve për fëmijë, të rinj, adoleshentë. Kjo evidentohet jo vetëm në hartimin e dokumentacionit përkatës për licensimin për programe radio-televizive, por edhe në respektimin e kërkesave ligjore gjatë transmetimit të emisioneve. Është përmirësuar gama dhe shumëllojshmëria e programeve për fëmijë dhe emisioneve me mesazhe edukative dhe formuese, me problematikë sipas grupmoshave. Televizioni Publik ka realizuar programe dhe emisione për fëmijë cilësore, me gjuhë televizive të përshtatshme, që kanë arritur audiencën e teleshikuesve të vegjël. Televizionet private kombëtare i janë drejtuar grupmoshave 12-18 vjeç, programeve muzikore dhe argëtuese që në thelb kanë garat dhe konkurset. Por nga monitorimet dhe sondazhet e strukturave të KKRT-së janë vënë re raste të keqtrajtimit të fëmijve, duke përfshirë edicionet informative, emisione të tjera, emisione për fëmijë, përfshirë edhe reklamat. Konkretisht: intervistat me fëmijët pa pëlqimin e prindërve; intervistime të personave që ndodhen në gjendje të rëndë emocionale; cënimi i dinjitetit dhe privatësisë të fëmijve, viktima të shfrytëzimit në familjet me probleme sociale; përdorimi i fëmijve si mjet presioni apo për skupe televizive; keqtrajtim dhe dhunim i personave dhe fëmijve me aftësi të kufizuara, fëmijve të braktisur, të sëmurë, të dhunuar, të trafikuar; viktima të filmimeve të padëshirueshme; përdorimin e fjalorit vulgar që deformon formimin gjuhësor dhe shëndetin mendor të fëmijve. Në të gjitha këto raste, televizioni duhet të paraqitet si një plotësues i edukimit shkollor dhe familjar, duke shmangur mundësinë e efekteve të

tilla, si izolimi i fëmijve nga shoqëria, probleme psikologjike, mungesë integrimi dhe zhvillimi normal psiko-fizik, vështirësi në zgjidhjen e problemeve apo gjenerim të konflikteve të reja. Tendenca e disa operatorëve radio-televizivë për ta patur televizionin më shumë si biznes sesa mjet edukimi për moshat e reja ka shkaktuar nënvlerësimin e programeve të mirëfillta edukative, kulturore, shkencore, argëtuese. Duke vlerësuar situatën programore dhe dukuritë në këtë fushë KKRT-ja ka ndërmarrë edhe nisma sensibilizuese për ndërgjegjësimin e operatorëve radio-televizivë dhe rritjen e ndjeshmërisë së opinionit publik. Për këtë qëllim janë zhvilluar tryeza të rrumbullakta dhe seminare për probleme të etikës televizive dhe komunikimit publik dhe veçanërisht lidhur me trajtimin e mbrojtjes së fëmijve. Në këto veprimtari ku kanë marrë pjesë përfaqësues të Këshillit të Etikës, gazetarë, drejtues të medias elektronike, përfaqësues të shtypit të shkruar, opinionit publik është diskutuar mbi përmirësimin e legjislacionit që mbron fëmijët nga informacioni i dëmshëm dhe i papërshtatshëm, eksperiencat pozitive në këtë fushë, ngritja e kapaciteteve profesionale të gazetarëve në trajtimin e problemeve të kësaj grupmoshe. KKRT ka bërë propozimet përkatëse në projektligjin e ri për mediat elektronike dhe ka miratuar një rregullore për shenjat paralajmëruese në programet televizive për respektimin e normave morale dhe etike në mbrojtje të fëmijve. Bazuar në legjislacionin në fuqi KKRT-ja nga vitit 2004-2008 ka licensuar 24 televizione nga të cilët 22 janë televizione vendore analoge, 1 televizion kombëtar dhe 1 televizion satelitor. Në programet e transmetuesve kombëtarë dhe lokalë një vend të rëndësishëm zënë programet e ndryshme për fëmijë. Në njërin prej rrjeteve numerike transmetojnë 3 kanale dedikuar vetëm fëmijve³⁴.

*Tortura dhe trajtimet ose dënimet e tjera mizore, çnjerëzore, apo degraduese (neni 37/ a).
Rekomandimi 41.*

211. Kushtetuta e RSH-së dhe legjislacioni shqiptar, parashikojnë një sërë dispozitash të cilat garantojnë se askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, si dhe lidhur me parandalimin e akteve të torturës apo keqtrajtimeve. Përcaktimi në Kodin Penal të RSH-së (me ndryshimet përkatëse), i torturës si vepër penale dhe dënimin përkatës përbën një masë kryesore në parandalimin e akteve të torturës. Kodi Penal në nenin 86, i ndryshuar me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007, e përkufizon torturën në përputhje të plotë me nenin 1 të Konventës së OKB-së, "Kundër torturës dhe trajtimeve ose ndëshkimeve të tjera të egra, çnjerëzore dhe degraduese" konkretisht: "Kryerja me dashje e veprave, nëpërmjet të cilave një personi i janë shkaktuar vuajtje të rënda, fizike apo mendore, nga një person, që ushtron funksione publike, ose me nxitjen apo miratimin e tij, të hapur ose të heshtur, me qëllim: a) për të marrë prej tij ose një tjetri informata ose pohime; b) për ta ndëshkuar për një veprim të kryer ose që dyshohet të jetë kryer prej/ose një personi tjetër; c) për ta frikësuar ose bërë presion mbi të ose një person tjetër; ç) për çdo qëllim tjetër të bazuar në çfarëdolloj forme diskriminimi; d) çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtërues; përbëjnë vepër penale dhe dënohen me burgim nga 4 deri në 10 vjet". Gjithashtu Kodi Penal në nenin 87 e parashikon torturën apo çdo akt tjetër çnjerëzor, si dhe rastet kur këto veprime kanë sjellë pasoja të rënda, duke e parashikuar si vepër penale me dënimin përkatës.

212. Në bazë të nenit 7/a të Kodit Penal, paragrafi "d", shtuar me ligjin nr. 9686 datë 26.2.2007, Shqipëria ka juridiksion universal për veprën penale të torturës. Neni 7/a parashikon: "Ligji penal i RSH-së është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj, që ndodhet në territorin e RSh-së dhe nuk është ekstraduar, i cili jashtë territorit të RSh-së ka kryer torturë. Ligji penal i RSh-së është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj, që jashtë territorit të RSh-së kryen ndonjërin nga veprat penale, për të cilat ligje të veçanta ose marrëveshje ndërkombëtare, ku RSh-së është palë, përcaktojnë zbatueshmërinë e legjislacionit penal shqiptar." Kjo do të thotë që pa marrë parasysh se

³⁴ Në anekset bashkëlidhur raportit paraqiten të dhëna të hollësishme mbi transmetuesit e licensuar televizivë.

në cilin territor apo nga kush është kryer vepra penale, shtetas ose jo shtetas, Shqipëria ka juridiksion të gjykojë një person i akuzuar për veprën penale të torturës.

213. Kodi Penal parashikon si vepër penale keqtrajtimin fizik ose psikologjik të të miturit nga personi që është i detyruar të kujdeset për të.

214. Ligji nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, përcakton se Policia e Shtetit ka si mision ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut. Qëllimi i këtij ligji është edhe përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësive të punonjësve të Policisë, për garantimin e një shërbimi policor demokratik dhe profesional. Mbështetur në nenin 4, përgjegjësitë e Policisë janë: a) mbrojtja e jetës së njerëzve, e sigurisë dhe pronës së tyre personale; b) parandalimi, zbulimi, hetimi, në përputhje me ligjin penal dhe me ligjin procedural penal, veprat penale dhe autorët e kryerjes së tyre; c) mbikqyrja dhe kontrolli i kufijve shtetërorë të RSh-së; d) mbrojtja e individëve, nga rreziqe të mundshme; e) kryerja e detyrave të tjera sipas këtij ligji, në ligje të tjera, si dhe në aktet nënligjore, që parashikojnë detyra për Policinë.

215. Në ligj parashikohet se në kontrollet e të miturve që kryhen nga punonjësit e policisë kërkohet edhe prania e prindit ose e kujdestarit. Gjithashtu Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në mjediset e Policisë ose në organin urdhërdhënës, për mbikqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent. Në masat mbrojtëse që merr punonjësi i Policisë për të miturin që nuk mbikqyret më ose është larguar nga prindi apo kujdestari i tij parashikohet rikthimi tek prindërit ose tek kujdestari, ose dërgimi në qendrën e përkujdesit.

216. Në ligjin nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, (me ndryshimet përkatëse), parashikohet ndalimi i përdorimit të forcës fizike ndaj të dënuarve, nëse nuk është e domosdoshme për të ndaluar aktet e dhunshme, tentativat e largimit nga institucioni, si dhe mposhtjen e kundërshtimit edhe kur ai është pasiv në zbatimin e urdhrave të dhëna. Gjithashtu ndalohet përdorimi i mjeteve të forcës dhe atyre shtrënguese, që formojnë armë ose i lëndëve narkotike në kuptim të Kodit Penal dhe ato që kanë natyrë torturuese dhe hipnoze.

217. Ligji nr.9888, datë 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” ka si objekt mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, në përputhje me aktet ndërkombëtare. Me ndryshimet e fundit ligjore në ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” është hequr termi i izolimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve.

218. Një zhvillim i ri pozitiv është edhe angazhimi i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me autoritetet më të larta shtetërore, për përmbushjen e detyrimeve të shtetit shqiptar, në kuadrin e zbatimit të dispozitave të Konventës CAT dhe të Protokollit të saj Opsional, i cili u kërkon shteteve palë të krijojnë Mekanizmat e Pavarur Kombëtare për Parandalimin e Torturës. Me ligjin nr. 9888, datë 10.03.2008 (neni 36), janë miratuar disa dispozita në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” (nenet 74/1,74/2,74/3), të cilat përcaktojnë kompetencat e “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës”, garancitë në ushtrimin e veprimtarisë së tij, si dhe format e mbikqyrjes dhe konkretisht: Neni 74/1 Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit, ose dënimit të egër, çnjerëzor, poshtëruës (MKPT) dhe kompetencat e tij. Avokati i Popullit, nëpërmjet këtij Mekanizmi, që vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e tij, mbikëqyr zbatimin dhe realizimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të dënuarve. MKPT ka këto kompetenca: a) vëzhgon rregullisht trajtimin e individëve që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, me qëllim mbrojtjen e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor poshtëruës; b)

paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës. Neni 74/2 Garancitë në veprimtaritë e MKPT. MKPT, gjatë ushtrimit të detyrës së tij, i garantohet: a) marrja e çdo informacioni në lidhje me numrin e individëve që u është hequr liria, në vendet e privimit të lirisë, si dhe numrin e vendeve dhe vendndodhjen e tyre; b) marrja e të gjithë informacionit për trajtimin e këtyre individëve, si dhe për kushtet e tyre të ndalimit; c) hyrja lirisht në të gjitha vendet dhe mjediset ku është kufizuar liria e individit; d) kryerja e intervistave private, pa dëshmitarë, me individët që u është hequr liria, personalisht ose me një përkthyes kur është e nevojshme, si edhe me çdo individ tjetër që mund të japë informacionin e nevojshëm; e) zgjedhja lirisht e vendeve që kërkon të vizitohet dhe e individëve që kërkon të intervistohet. Neni 74/3 Format e mbikëqyrjes. Mbikëqyrja e MKPT realizohet nëpërmjet: a) pranimit të kërkesave ose ankesave nga të dënuarit ose të paraburgosurit me shkrim ose drejtpërdrejt; b) marrjes së informacionit, ankesave, kërkesave të të dënuarit, ose nga individë që kanë statusin e vizitorit apo të organeve shtetërore ose organizatave joqeveritare, të cilat kanë kontrolluar apo vizituar institucionin, sipas kompetencës që u njihet ligji, si dhe nga avokati i të dënuarit ose të paraburgosurit; c) kërkimit të informacioneve nga administrata e institucionit; d) verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve ose mjediseve, që kanë lidhje me të dënuarin ose me të paraburgosurin, brenda dhe jashtë institucionit. Për realizimin e procesit të mbikëqyrjes, Mekanizmi Kombëtar mund të marrë edhe specialistë të fushave përkatëse. Në çdo rast nëse konstatohen shkelje e parregullsi gjatë verifikimit, specialistët e këtij mekanizmi mbajnë procesverbal, i cili nënshkruhet nga drejtori i institucionit ose i ngarkuari prej tij, me të drejtën e pasqyimit të vërejtjeve.”

219. Në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve përcaktohet se “Personelit të burgut i ndalohet të kryejë ndaj të dënuarve veprime joligjore, ndëshkime apo trajtime çnjerëzore apo denigruese.

220. Rregullorja e Paraburgimit përcakton se “ndalohet përdorimi i çdo forme dhune, trajtimi degradues, jo human apo çnjerëzor në institucionet ose mjediset e paraburgimit”. Në Rregullore theksohet se “trajtimi i të paraburgosurve bëhet pa njëanshmëri apo diskriminim, duke respektuar standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut pa asnjë lloj diskriminimi për shkak të ngjyrës, racës, seksit, etnisë, fesë, gjinisë, moshës. Në çdo institucion ose mjedis paraburgimi ndalohet përdorimi i çdo forme dhune, trajtimi degradues, jo human apo çnjerëzor. Ky ndalim përfshin dhe kërcënimin, fyerjen apo çdo lloj tjetër dhune, apo shprehje verbale, e cila krijon përshtypje se vë në rrezik jetën apo procesin gjyqësor të të paraburgosurit ose të familjes së tij. Në Rregulloren e Disiplinës së Policisë së Burgjeve, është përcaktuar se punonjësit e Policisë së Burgjeve duhet të shmangin çdo akt brutaliteti, sjellje të keqe apo veprime të tjera që çënojnë shëndetin mendor e psikik të të burgosurve.

221. Në SKF është përcaktuar objektivi “Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna dhe keqtrajtimi”, i cili mbështetet në studimin e fenomenit të dhunës mbi fëmijët në familje, në shkollë dhe në institucione, si edhe në analizën e funksionimit të sistemit të drejtësisë për të miturit.

222. Treguesi i dhunës në shkollë vlerësohet nga studimi i vitit 2006, realizuar nga Qendra për Zhvillim Njerëzor. Studimi tregon se 26% e të gjithë fëmijëve përjetojnë dhunë fizike kur janë në shkollë. Në shumicën e rasteve ushtruesi i dhunës është një nxënës tjetër, por edhe mësuesit ushtrojnë dhunë ndaj nxënësve të tyre³⁵.

³⁵ Human Development Centre/UNICEF. Dhuna ndaj Fëmijëve në Shqipëri. Tiranë. 2006.

223. Në lidhje me dhunën në Institucione, rezultojnë se dhuna fizike në institucionet rezidenciale është më e lartë sesa dhuna e ushtruar ndaj fëmijëve në familje apo shkollë. Rreth 50% e fëmijëve në qendrat rezidenciale rezultojnë se kanë pësuar dhunë fizike³⁶. Por studimet nuk përcaktojnë nëse kjo dhunë është ushtruar nga stafi apo fëmijë të tjerë në institucion.

224. Nga ana e shoqërisë civile është ndërmarrë iniciativa për hartimin e projektligjit “Për masat kundër keqtrajtimit të fëmijëve”, procedurat për miratimin e të cilit do të realizohen në vazhdim.

- ***Informacion lidhur me masat ligjore, administrative, gjyqësore etj, për zbatimin e të drejtave të parashikuara nga Konventa.***

Neni 7.

225. Për sa i përket kombësisë, ligji “Për Gjendjen civile” me ndryshimet përkatëse parashikon të gjitha rastet e përcaktimit të kombësisë: a) Fëmija merr kombësinë e prindërve me kombësi të njëjtë të dokumentuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Kjo kombësi nuk mund të ndryshohet, përveç rasteve, kur sipas ligjit vërtetohet pasaktësia e kombësisë së prindërve ose kur ka një vendim gjyqësor të formës së prerë për ndryshimin e atësisë ose amësisë. b) Kur prindërit kanë kombësi të ndryshme, fëmijës i shënohet kombësia e njërit prej prindërve, sipas marrëveshjes ndërmjet tyre. Në rast mosmarrëveshjeje, ose në rast vdekje të njërit prej tyre, shërbimi i gjendjes civile, përkohësisht, shënon si kombësi të fëmijës atë të të atit. Kombësia e fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile shënohet në bazë të vullnetit të të dy prindërve ose kombësia e njërit prej tyre, sipas vullnetit të fëmijës kur ai bëhet madhor. c) Fëmija i lindur jashtë martese, kur nuk dihet atësia e tij, merr kombësinë e nënës. Kjo kombësi mund të ndryshojë me vërtetimin e atësisë. d) Fëmija me prindër të panjohur i lindur në Shqipëri, prezumohet me kombësi shqiptare. Kur njëri ose të dy prindërit gjenden ose kur fëmija arrin moshën madhore, për kombësinë e tij zbatohen përcaktimet e shkronjës “b”. e) I birësuar merr kombësinë e birësuesve, sipas përcaktimeve të shkronjës “b” të këtij neni, por kur ai bëhet madhor, ka të drejtën të rimarrë kombësinë që kishte para birësimit ose ta ndryshojë atë, sipas kombësisë që kanë prindërit biologjikë. f) I linduri me fekondim artificial nga një grua e martuar, merr kombësinë e njërit prej bashkëshortëve, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën “b”. Legjislacioni i gjendjes civile është unik për të gjithë popullsinë brenda territorit të RSH-së. Për sa i përket përcaktimit të kombësisë së fëmijëve që u përkasin minoriteteve kombëtare, legjislacioni parashikon përcaktimin e kombësisë së fëmijës me vullnetin e lirë të prindërve dhe me vullnetin e lirë të fëmijës kur arrin në moshë madhore.

226. Në bazë të ligjit nr.9029, datë 13.3.2003 “Për disa shtesa në ligjin nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”), riautorizohet përfshirja e kombësisë/etnisë në Regjistrin Civil dhe dokumentet e lëshuara nga Zyrat e Gjendjes Civile për identifikimin e brendshëm të personave. Në bazë të këtij ligji ndryshimi i kombësisë mund të bëhet vetëm nga Gjykata me vendim të arsyetuar.

227. Për sa i përket përcaktimit të kombësisë së fëmijëve që u përkasin minoriteteve kombëtare, në nenin 58 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, është parashikuar që në momentin e mbajtjes së aktit të lindjes të bëhet përcaktimi i kombësisë së fëmijës, me vullnetin e lirë të prindërve dhe me vullnetin e lirë të fëmijës kur ai arrin moshën madhore.

228. Nëpunësi i gjendjes civile pasqyron në aktin e lindjes emrin që dëshirojnë prindërit e fëmijës, përveç emrave të papërshtatshëm. Refuzimi i regjistrimit të emrit të caktuar mund të kundërshtohet në organet gjyqësore. Kur prindërit nuk bien dakort, nëpunësi i gjendjes civile cakton një emër të

³⁶ Human Development Centre/UNICEF. Dhuna ndaj Fëmijëve në Shqipëri. Tiranë. 2006.

përkohshëm deri në zgjidhjen e konfliktit nga gjykata. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile kur konstaton një emër të papërshtatshëm ka të drejtën të kërkojë ndryshimin e tij me vendim gjyqësor. Për rastet kur prindërit e fëmijës kanë vdekur, apo nuk janë në gjendje fizike a mendore, ose nuk gjenden, emri caktohet nga pjestarët e familjes, të afërmit e tjerë dhe në mungesë të tyre nga nëpunësi i gjendjes civile. Përsa i përket fëmijëve të gjetur emri e mbiemri vendoset nga shërbimi i gjendjes civile, me miratimin e kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore. Këta fëmije regjistrohen në zyrën e gjendjes civile në territorin e institucionit të perkujdesit ku është vendosur fëmija.

229. Siç është evidentuar në Raportin e parë, ligji “Për shtetësinë Shqiptare”, parashikon se fitimi dhe rifitimi i shtetësisë shqiptare, si dhe heqja dorë prej saj nga të miturit, bëhet me miratimin e prindërve. Çdo ndryshim në shtetësinë e të miturve të moshës 14 – 18 vjeç, bëhet duke marrë edhe pëlqimin e fëmijës. Gjithashtu ky ligj parashikon rastet kur fëmija mund të marrë shtetësinë e të dy prindërve konkretisht³⁷: a) Një fëmijë fiton shtetësinë shqiptare me lindje në rastet kur të dy prindërit në kohën e lindjes së fëmijës janë shtetas shqiptarë. Kur njëri prej prindërve në kohën e lindjes së fëmijës, është shtetas shqiptar dhe fëmija lind në territorin e RSH-së. Kur fëmija ka lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe njëri prej prindërve është shtetas shqiptar, ndërsa prindi tjetër është me shtetësi të panjohur, ose pa shtetësi. Kur fëmija ka lindur jashtë territorit të RSH-së dhe njëri prej prindërve është shtetas shqiptar, ndërsa prindi tjetër ka një shtetësi tjetër, por të dy prindërit bien dakord që fëmija të marrë shtetësinë shqiptare. b) Një fëmijë i lindur ose i gjetur brenda territorit të RSH-së merr shtetësinë shqiptare, në rast se ai është lindur nga prindër të panjohur dhe si pasojë fëmija do të mbetet pa shtetësi. Në rast se prindërit e fëmijës bëhen të njohur përpara se fëmija të ketë arritur moshën 14 vjeç dhe ata janë me shtetësi të huaj, shtetësia shqiptare mund të hiqet me kërkesë të prindërve të njohur ligjërisht, me kusht që fëmija të mos mbetet pa shtetësi, si pasojë e këtij veprimi. c) Një fëmijë i lindur brenda territorit të RSH-së nga prindër me shtetësi tjetër, të cilët janë rezidentë të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë mund të marrë shtetësinë shqiptare, me pëlqimin e të dy prindërve. d) Kushdo që lind duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton automatikisht shtetësinë shqiptare. e) Për të miturit, shtetësia shqiptare mund të mbarojë kur të paktën njëri nga prindërit ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare. Në këtë rast merret pëlqimi i të dy prindërve.

230. Në pjesën e Kodit të Familjes që trajton çështjen e amësisë dhe atësisë parashikohet se nga njohja e amësisë ose e atësisë së një fëmije të lindur jashtë martesë nuk mund të hiqet dorë (neni 167). Gjithashtu, parashikohet se amësia dhe atësia e fëmijës së lindur jashtë martesë mund të vendosen me anë të njohjes vullnetare ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor dhe për prindërit krijon të drejta dhe detyrime të njëjta, në mënyrë prapavepruese, si për fëmijët e lindur nga martesë.

Në lidhje me mbiemrin e fëmijës së lindur jashtë martesë, Kodi parashikon se fëmija i lindur jashtë martesë merr mbiemrin e prindit, amësia ose atësia e të cilit është vendosur më përpara. Në qoftë se amësia dhe atësia vendosen në të njëjtën kohë, prindërit vendosin me marrëveshje se cilin mbiemër do të mbajë fëmija. Në rast mosmarrëveshjeje, fëmijës i vendoset mbiemri i të atit.

Njohja e një fëmije nuk mund të pasohet nga një njohje tjetër, e ndryshme nga e para, në rast se kjo e fundit nuk është kundërshtuar në rrugë gjyqësore. Vendimi i gjykatës që përcakton amësinë ose atësinë ka efekt që nga lindja e fëmijës. Në nenin 175 të Kodit parashikohet shprehimisht se amësia e fëmijës vërtetohet me aktin e lindjes. Kur fëmija është regjistruar në aktin e lindjes me prindër të panjohur, nëna mund ta njohë fëmijën. Njohjen e fëmijës mund ta bëjë edhe vetë nëna e mitur. Njohja mund të bëhet para nëpunësit të gjendjes civile ose me testament. Njohja e bërë nuk mund të revokohet edhe sikur të jetë bërë me testament. Neni 181 i Kodit të Familjes parashikon se ati i fëmijës së lindur jashtë martesë është personi madhor që e njeh fëmijën si të tij. Atësia e një fëmije

³⁷ Këto dispozita nuk janë trajtuar specifikisht në Raportin e Parë.

të lindur jashtë martesë mund të vërtetohet me vendim të gjykatës, në rast se gjatë gjykimit provohet se në kohën e zënies së fëmijës i ati bashkëjetonte me nënën e fëmijës, ose ka kryer marrëdhënie seksuale me apo pa dhunë, ose i ka premtuar martesë, ose nga një gjykim penal apo civil rezulton në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi atësia e fëmijës së lindur jashtë martesë, si dhe kur dihet publikisht se ai e ka njohur fëmijën si të tijin.

231. Kodi i Familjes në lidhje me të drejtën e fëmijës për të qëndruar në familjen biologjike dhe njohjen e atësisë, ka parashikuar në një dispozitë të veçantë dhe konkretisht: “Në rast se gjatë procedurës për birësimin e një fëmije rezulton se është paraqitur një kërkesë në gjykatë, për njohje atësie, procedura pezullohet deri në përfundim të gjykimit për njohjen e atësisë” (neni 256).

232. Përsa i përket atësisë, mëmësisë dhe mbiemrit të fëmijës së birësuar në KF parashikohet se i birësuarit merr mbiemrin e birësuesit dhe në rast të birësimit nga të dy bashkëshortët, mbiemrin e përbashkët të tyre. Në rastin kur bashkëshortët birësues kanë mbiemra të ndryshëm vendosin me marrëveshje se cilin mbiemër do të mbajë i birësuarit dhe në rast mosmarrëveshjeje fëmija merr mbiemrin e të atit. Me kërkesë të birësuesit ose të birësuesve, gjykata mund të ndryshojë emrin e të birësuarit. I birësuarit merr për emër nënë dhe ati atë të birësuesit ose birësuesve të tij.

Ruajtja e dinjitetit (neni 8).

233. Përsa i përket nenit 8, në lidhje me sigurinë e ruajtjes së identitetit të fëmijëve, ligji “Për gjendjen civile”, përcakton procedurën për dhënie të informacionit e dokumentacionit për të miturit dhe për të tretët. Kjo procedurë garanton ruajtjen e të dhënave dhe shmang keqpërdorimin e tyre.

234. Në Kodin e Familjes parashikohet edhe parimi i ruajtjes së konfidencialitetit dhe respektimit të jetës private të të miturit, prindërit biologjikë dhe birësuesit në lidhje me procesin dhe dokumentacionin e birësimit. Kur mosha dhe niveli i pjekurisë e lejojnë, i mituri ka të drejtë të njihet me historinë e tij dhe, nëse është e mundur, me të dhënat për prindërit biologjikë.

235. Në ligjin “Për Gjendjen Civile” (neni 57) janë përcaktuar edhe rastet kur mund të ndryshojë emri, si dhe rastet e papërshtatshmërisë së tij. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile përcakton listën me emrat e papërshtatshëm. Në këtë listë përfshihen dhe emrat e vlerësuar të papërshtatshëm me vendim gjyqësor. Kjo listë i vihet në dispozicion çdo zyre të gjendjes civile.

236. Në ligjin nr.9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”, parashikohet mbrojtja e të dhënave personale në dokumentacionin birësues, në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

237. Ligji nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, përcakton rregullat për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, si dhe parashikon sanksione administrative mbi përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale (duke përcaktuar masa konkrete të gjobës, të vëna nga Komisioneri për Mbrojtjen e të dhënave personale”).

Mbrojtja e privatësisë (neni 16);

238. Fëmijët përfitojnë mbrojtje të këtyre të drejtave dhe lirive në kuadër të mbrojtjes që i akordohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila nuk bën dallime apo specifikime mbi këto të drejta dhe liri. Kushtetuta (neni 35) përcakton se askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

239. Shqipëria është shtet palë me të drejta dhe detyrime të plota në një sërë aktesh ndërkombëtare, në të cilat parashikohet se se çdo person ka të drejtë t'i respektohet jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe korrespondenca e tij (duke përfshirë edhe fëmijët).

240. Kodi i Familjes, parashikon ndër të tjera procedurat e realizimit të procesit të gjyqësor, në lidhje me përgjegjësinë prindërore, kujdestarinë, birësimin e të tjera procedura, në të cilat publikimi i të dhënave të fëmijës lejohet vetëm në rast se është në interesin e lartë të tij duke garantuar respektimin e të drejtave të tij themelore.

241. Në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, objekti dhe qëllimi i të cilit fokusohen në përcaktimin dhe respektimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, duke garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private. Konkretisht, në nenin 7 të këtij ligji përcaktohet se ndalohet përpunimi (grumbullimi, regjistrimi, ruajtja, ... shfrytëzimi, përdorimi), i të dhënave sensitive, të cilat në kuptim të këtij ligji janë të dhënat, që zbulojnë origjinën racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësinë në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimet penale, si dhe shëndetin dhe jetën seksuale. Rastet në të cilat lejohet shfrytëzimi apo përdorimi i të dhënave sensitive listohen në paragrafin e dytë të këtij neni dhe disa prej tyre janë kur: a) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin, që mund të revokohet në çdo çast dhe e bën të paligjshëm përpunimin e mëtejshëm të të dhënave; b) është në interesin jetik të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër dhe subjekti i të dhënave është fizikisht ose mendërisht i paaftë për të dhënë pëlqimin e vet; c) autorizohet nga autoriteti përgjegjës për një interes të rëndësishëm publik; d) lidhet me të dhëna, që janë bërë haptazi publike nga subjekti i të dhënave ose është i nevojshëm për ushtrimin apo mbrojtjen e një të drejte ligjore;...etj. Në nenin 39 të këtij ligji, parashikohen sanksionet administrative për rastet e përpunimit të të dhënave në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji. Konkretisht, në shkronjën a) të paragrafit 1 të këtij neni parashikohet se “përpunimi i të dhënave personale në kundërshtim me Kreun II “Përpunimi i të dhënave personale” (në të cilën përfshihet edhe përpunimi i të dhënave sensitive) dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 30 000 lekë, dhe për personat juridikë vendoset dyfishi i kësaj gjobe. Në zbatim të këtij neni gjoba vendoset nga Komisioneri kur vërehet shkelja e detyrimit. Në këto kushte, në përputhje me legjislacionin shqiptar si dhe aktet ndërkombëtare të fushës, në referim të parimit të respektimit të jetës private dhe familjare të individëve, si dhe parimit bazë të të interesit më të lartë të fëmijës, theksojmë se, fëmijës ligjërisht por edhe institucionalisht i garantohet e drejta e jetës private.

Akresi në informacionin e përshtatshëm (neni 17).

242. Ndër objektivat e SKF është "Dhënia e informacionit të përshtatshëm për fëmijët" , që mbështetet në analizën e vendit që zënë çështjet e fëmijëve në media, si edhe në mënyrën me të cilën ato pasqyrohen. Në ditët e sotme fëmijët po rriten të “zhytur” në media dhe shumë të ekspozuar ndaj ekranit. Në këtë realitet është e nevojshme që të mbrohet zhvillimi fizik, emocional apo psikologjik i fëmijëve, interesat dhe të drejtat e tyre morale nga: pornografia, seksi, dhuna, përdorimi i një fjalori banal dhe deri te vulgarizimi i gjuhës amtare apo përdorimi i formave të humorit, që çenojnë dinjitetin e njeriut.

243. Studimet tregojnë se dhuna e transmetuar nga media ka efekte jo të mira të fëmijët duke sjellë: 1. Rritje e sjelljeve anti sociale dhe agresive. 2) Ulje e ndjeshmërisë së fëmijëve ndaj dhunës dhe atyre që vuajnë. 3) Rritje e ankthit se mos bëhen viktimë në këtë botë kaq të dhunshme. 4) Rritje e dëshirës për të konsideruar dhunën si pjesë të aktiviteteve argëtuese dhe të jetës së vërtetë. 5) Konsiderimi i dhunës si një rrugë të pranueshme për të zgjidhur konfliktet. Në fushën e medias

elektronike, shteti siguron mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna fizike apo mendore nëpërmjet ligjit që rregullon veprimtarinë radiotelevizive.

244. Ligji “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në RSH” jep rekomandime të përgjithshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të miturve. Ndonëse ka disa programe argëtuese dhe të përshtatshme për fëmijë, në përgjithësi televizioni nuk paraqitet ende si një plotësues i edukimit shkollor dhe familjar të fëmijëve. Ka pak mundësi zgjedhjeje për emisione kulturore, zbavitëse dhe shkencore për ta. Sipas një studimi³⁸ të kryer për monitorimin e shtypit të përditshëm (gazetat e mëdha të përditshme) për periudhën korrik-dhjetor 2007, rezulton se ka një larmi më të madhe të temave, në lidhje me fëmijët, në krahasim me monitorimin e vitit 2006. Janë konstatuar përpjekje pozitive për të trajtuar aspekte po aq të rëndësishme dhe serioze, si arsimi, infrastruktura e tij; problemet e shëndetit, sëmundjet që prekin fëmijët (që nga gripi i zakonshëm të HIV, talasemia, shëndeti mendor); gjakmarrja dhe fëmijët e ngjuar; fëmijët e shfrytëzuar, të abuzuar, jetimët dhe fëmijët e varfër; problemet e krimit të të miturit etj. Ndonëse temat pozitive hasen shumë herë më pak, gjithsesi ato janë të pranishme në media. Identifikimi i të miturve në media edhe pse në dukje i thjeshtë, në shumë raste nuk merr parasysh interesin më të mirë të fëmijës. Fëmijët identifikohen me iniciale apo me informacione të tjera të tërthorta. Në temat e zgjedhura për të trajtuar, vërehet një prirje pozitive nga gazetarët për të marrë në mbrojtje dhe për të ndihmuar fëmijët. Pasqyrimi i fëmijëve në media ka qënë më i shpeshtë dhe më larmishëm.

V. Mjedisi familjar dhe kujdesi alternativ (nenet 5, 9-11,18 pg 1,2, 19-21,25, 27 paragrafi 4 dhe 39).

a) Follow-up. Masat për zbatimin e Vëzhgimeve Përfundimtare të Komitetit CRC.

Ribashkimi familjar (neni 10) Rekomandimi 43 i Vëzhgimeve Përfundimtare.

245. Ligji nr. 9098, datë 3.7.2003 “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në RSH-së”, parashikon ndër të tjera procedurat për realizimin bashkimit familjar të personave, që kanë përfituar azil në RSH-së. Në nenin 26 të këtij ligji parashikohet se personi që ka përfituar azil në RSH-së ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me bashkëshortin ose bashkëshorten, fëmijët e pamartuar nën moshën 18 vjeç ose ndonjë person tjetër në ngarkim të tij. Gjithashtu, fëmija i pashoqëruar, që ka përfituar azil në RSH-së, ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me prindërit, motrat, vëllezërit, njerkun, njerken, anëtarë të tjerë të familjes, që bashkëjetojnë me të ligjërisht, ose që janë të mitur dhe të pamartuar. Kur këta persona të familjes, të shkallës së parë, në vijë të drejtpërdrejtë nuk mund të gjenden, fëmija i pashoqëruar ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me kujdestarin ligjor ose me ndonjë të afërm tjetër, jo në vijë të drejtpërdrejtë. Në rastin kur aplikimi për bashkim familjar ka lidhje me një të mitur, të pashoqëruar, vendimi merret jo më vonë se 20 ditë nga dita e paraqitjes së aplikimit.

246. Në ligjin nr.10006, datë 26.01.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8432, datë 14.12.1998 “Për Azilin në RSH-së”, parashikon një dispozitë mbi bashkimin familjar, që njeh detyrimin, për t`i dhënë mbrojtje edhe fëmijve të personave që u është dhënë azil.

Fëmijët e privuar nga mjedisi familjar (neni 20). Rekomandimi 4 i Vëzhgimeve Përfundimtare.

³⁸ Studimi Instituti i Medias dhe Save the Children “Raportimi i Cështjeve të Fëmijëve në Median e Shkruar: Monitorimi i gjashtë gazetave të përditshme korrik-dhjetor 2007”.

247. Në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, parashikohen masa për të siguruar ndihmë dhe shërbime shoqërore individëve dhe grupeve në nevojë, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore, duke përfshirë edhe fëmijët. Në këtë ligj parashikohet se përfitues të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore janë fëmijët, të rinjtë deri në moshën 25 vjeç dhe jetimët mbi moshën 25 vjeç, të papunë, të cilët nuk janë në institucione ose nën kujdestari. Ligji përcakton edhe kriteret e funksionimit dhe organizimit të institucioneve rezidenciale për fëmijët dhe të rinjtë. Shërbimet e përkujdesit shoqëror-mjekësor ofrohen nga personeli i specializuar, në qendra riintegruese dhe rehabilituese rezidenciale, qendra ditore apo në familje, për individët, që nuk janë në gjendje të jetojnë normalisht, për shkak të përkeqësimeve, të përkohshme apo të përhershme, fizike, psikike, mendore dhe sensore.

248. Ligji nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimin shoqëror”, i cili zgjeroi kufijtë e përfitimit për të gjithë grupet në nevojë, krijoi hapësirat e nevojshme për decentralizimin, rritjen e kompetencave të qeverisjes vendore dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

249. Me miratimin e ligjit të mësipërm dhe VKM nr. 564, datë 12.08.2005 “Për liçencimin e ofruesve të shërbimeve shoqërore”, në vitin 2006 filloi liçencimi i OJF-ve që ofrojnë shërbime sociale grupeve në nevojë, ndërmjet tyre edhe fëmijëve. MPCSSH është organi kompetent për liçensimin e tyre. Operatorët socialë liçensohen fillimisht për një periudhë 2 vjeçare dhe gjatë kësaj periudhe inspektohen periodikisht nga Shërbimi Social Shtetëror, që kontrollon nëse OJF respekton standartet e shërbimeve për të cilat është liçensuar. Në përfundim të kësaj periudhe, bazuar edhe në vlerësimin e SHSSH, operatorit të shërbimeve sociale lidhur me rinovimin e licencës.

Deri në fund të vitit 2008 janë liçensuar dhe rilicensuar 89 operatorë të shërbimeve sociale. Proçesi i liçensimit do të vazhdojë për të gjitha subjektet që ofrojnë shërbime sociale për kategoritë në nevojë. Në këtë mënyrë për herë të parë u vendosën marrëdhënie institucionale, bashkëpunuese, midis institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile që operon në këtë fushë.

250. Decentralizimi i kompetencave dhe përgjegjësive në pushtetin vendor synon krijimin e një sistemi shërbimesh, ku individë ndihmohet dhe mbështetet në mjedisin ku ai jeton, duke i respektuar personalitetin, vlerat, aftësitë, veçanësitë, parapëlqimet dhe burimet e tij. Vendosja në institucione shpesh ka krijuar distancë ndërmjet fëmijës, mjedisit familjar dhe social dhe ka ndikuar në formimin dhe aftësinë e tij për t’u rritur i pavarur dhe për të qenë aktiv në zhvillimin e shoqërisë. Politikat për deinstitutionalizimin e fëmijëve kërkojnë, jo vetëm krijimin e shërbimeve të reja alternative, ndaj shërbimit rezidencial, por edhe nxitjen e formave të shërbimeve alternative brenda strukturave rezidenciale të përkujdesit për fëmijë si p.sh: shërbime ditore, shtëpi – familje, këshillim, kurse trajnimi profesional për fëmijë dhe shërbime për nënat dhe fëmijët e komunitetit.

251. Objektivat kryesorë për shërbimet shoqërore janë, të përcaktuara në strategjinë sektoriale të mbrojtjes sociale janë: (i) decentralizimi që përfshin kalimin e të gjitha shërbimeve rezidenciale në administrim të njësisë vendore; (ii) zgjerimi i llojshmërisë së shërbimeve komunitare dhe mbulimi i të gjitha grupeve me shërbime bazë në të gjitha rrethet e vendit; (iii) shtrirja e shërbimeve komunitare deri në vitin 2013 edhe në bashkitë që aktualisht nuk kanë shërbime të tilla; (iv) Pilotimi i shërbimit të kujdestarisë (periudha 2008-2010 në dy bashki në Tiranë, Shkodër) dhe deri në vitin 2013 shtrirja e këtij shërbimi edhe në njësitë e tjera vendore në përputhje me nevojat dhe mundësitë e buxhetit.; (v) de-intitucionalizimi, konsolidimi i modelit të shërbimeve “shtëpi -familje” për fëmijët dhe personatme aftësi të kufizuar, zgjerimi i këtyre shërbimeve edhe për grupet e tjera sociale (përfshirë të rinjtë); (vi) zbatimi i standarteve të shërbimeve dhe rritja e cilësisë së shërbimeve për fëmijët, PAK, të moshuarit; (vii) inspektimi periodik i të gjitha shërbimeve të

përkujdesit rezidencial dhe ditor që ofrohen nga operatorët publik dhe privat; (viii) licensimi i ofruesve të rinj dhe rilicensimi periodik i të gjitha OJF-ve që ofrojnë shërbime të përkujdesit për klientët. (ix) Inspektimi periodik i të gjitha shërbimeve të përkujdesit rezidencial dhe ditor që ofrohen nga operatoret publik dhe privat.

252. Nga monitorimet e realizuara janë evidentuar se janë 13 OJF, të liçensuara nga MPÇSSHB që ofrojnë shërbime rezidenciale për fëmijë në formën e shtëpi- familje dhe forma të tjera shërbimesh alternative për grupe të vogla fëmijësh (3-6 fëmijë) deri në 15 vjeç. Shërbimet alternative ofrohen në qendrat rezidenciale publike dhe jopublike.

Shërbimet mbështetëse për fëmijët mbi moshën 15 vjeç janë me të pakta dhe kryesisht ofrohen në formën e apartamenteve rinore të përkujdesit dhe sistemimin e tyre në konvikte e shkollave të mesme me shërbime gjysëm të pavarura.

Birësimi (neni 21) Rekomandimi 47 i Vëzhgimeve Përfundimtare të Komitetit CRC.

253. Në Kodin e Familjes (nenet 240-262) parashikohet se birësimi lejohet vetëm në rast se është në interesin e lartë të të miturit dhe garanton respektimin e të drejtave të tij themelore. Hartimi i dispozitave të Kodit të Familjes është bërë në përputhje me parashikimet e Konventës për të Drejtat e fëmijës dhe Konventës të Hagës “Për mbrojtjen e fëmijve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit” (ratifikuar me ligjin nr.8624, datë 15.06.2000).

253. Ligji nr.9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të birësimeve”, i cili ka shfuqizuar ligjin nr.7650, datë 17.12.1992 “Për birësimet e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes”) parashikon procedurat e birësimit, si dhe mënyrën e organizimit, funksionimit, detyrat e Komitetit Shqiptar të Birësimeve, në përputhje me detyrimet e parashikuara nga Konventa e Hagës.

254. Në referim të këtyre detyrimeve, si dhe në kontekst të parashikimeve ligjore të Kodit të Familjes dhe ligjit nr.9695, datë 19.03.2007, funksionon Komiteti Shqiptar i Birësimeve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, por që njëkohësisht është autoritet qendror dhe i pavarur në fushën e birësimit në RSH-së (neni 5 i ligjit nr.9695).

Autoritetet kompetente për të autorizuar birësimin në Shqipëri janë Komiteti Shqiptar i Birësimeve dhe gjykatat. Realizimi i birësimit sipas legjislacionit për birësim kalon në dy procedura: a)procedura administrative; b) procedura gjyqësore.

255. Procedura administrative. Autoriteti kompetent për realizimin e procedurës administrative, është Komiteti Shqiptar i Birësimeve. Komiteti shqyrton kërkesat e paraqitura direkt në të, si edhe ato të ardhura nga agjensitë me të cilat ky Komitet ka lidhur marrëveshje për birësimet e fëmijve shqiptarë nga shtetas të huaj. Fëmijët që ndodhen në gjendje për t`u birësuar janë rregjistruar në listat e Komitetit. Në bazë të procedurave të përcaktuara, aplikantët shqiptarë dhe ata të huaj, rezidente prej 2 vjetësh, duhet të përmbushin një sërë detyrimesh për të qënë kandidatë për birësim. Pas pjesëmarrjes në kurset e formimit, plotësimit të dokumentacionit, si dhe hetimit psiko-social të aplikanteve, Komiteti ka parasysh që fëmija ka nevojë për një familje zëvendësuese që ta marrë në ngarkim në mënyrë të vazhdueshme, ta respektojë dhe të përballojë problemeve që mund të ketë fëmija. Pasi aplikantet kanë kaluar nëpër të gjitha këto etapa dhe plotësojnë kushtet bazë në fushën sociale, arsimore, kulturore dhe garantojnë një rritje dhe edukim sa më të mirë të fëmijës, ai vlerësohet si kandidat i përshtatshëm për birësim. Birësimet brenda vendit nuk i nënshtrohen kalimit në autoritete të tjera publike ose organizata private, por bëhen drejtpërdrejt nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve, megjithëse ligji nuk ka pengesa për krijimin e tyre. Për birësimin ndërvendas Komiteti e

merr informacionin për prindërit birësues nëpërmjet autoriteteve publike kompetente ose organizatave private, me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Pas dhënies së pëlqimit nga Komiteti, për fëmijën që do të birësohet, dosja e aplikantit si dhe e fëmijës që do të birësohet përcillet për në gjykatë për vazhdimin e procedurës gjyqësore.

256. Procedura gjyqësore: Kjo procedurë ka si synim mbrojtjen e interesit të fëmijës. Gjatë procedurës së birësimit gjykata ka një rol mjaft aktiv përpara se të vendosë për birësim. Ajo shqyrton dokumentacionin e ardhur nga Komiteti, si edhe rrethanat në të cilat është proceduar. Për të mbrojtur interesat e fëmijës Kodi i Familjes ka parashikuar edhe rastet e ndërhyrjes në procesin e birësimit. Kjo e drejtë i jepet çdo personi që ka interes të ligjshëm për mbrojtjen e të miturit, si edhe prokurorët të cilet kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjykatës.

257. Kërkesat e legjislacionit shqiptar janë në përputhje me Konventën e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit” (paragrafi b i nenit 4 të kësaj Konvente). Sipas Konventës së Hagës dhe legjislacionit për birësimet, Komiteti ka parasysh plotësimin e kushtit kryesor që fëmija të jetë konsideruar i birësueshëm dhe se birësimi i përgjigjet interesit të tij më të lartë. Kodi i Familjes ka parashikuar që një fëmijë që të mund të birësohet, duhet të jetë i deklaruar i braktisur nga gjykata, pasi prindërit e tij, në mënyrë të dukshme nuk kanë patur interes për fëmijën, që vullnetarisht nuk kanë mbajtur me të marrëdhënie të përzemërta, të nevojshme për rritjen e tij dhe kanë ushtruar pakujdesi të rëndë në ushtrimin e të drejtës prindërore.

258. Gjithashtu Kodi parashikon që pëlqimi për birësim i prindërve biologjike, jepet para gjykatës. Duke konsideruar të rëndësishëm rritjen e fëmijës në familjen biologjike, Kodi i Familjes parashikon gjithashtu tërheqjen e pëlqimit nga prindërit biologjike brenda tre muajve nga dhënia e tij. Për të mundur rritjen e fëmijës pranë prindërve biologjike, në Kodin e Familjes, gjykatës i është dhënë një rol i rëndësishëm, e cila para se të vendosë për birësim, duhet të verifikojë nëse janë bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme për kthimin e fëmijës pranë prindërve biologjikë. Birësimi i prodhon efektet e tij që nga data kur vendimi merr formë të prerë. Pas birësimit fëmija i gëzon të gjitha të drejtat që gëzon një fëmijë nga prindërit e tij. Legjislacioni ynë ka parashikuar që birësimi të jetë i paravokueshëm, si dhe fëmija ka të drejtë të njihet me historinë e tij dhe të dhënat për prindërit biologjikë kur moshja dhe niveli i pjekurisë e lejon.

259. Qëllimi kryesor i birësimit është t’i ofrojë fëmijës një sistemim të përhershëm brenda një familjeje dhe kur sistemimi nuk bëhet i mundur në vendin e tij të origjinës, vetëm atëherë ndërhyhet nëpërmjet birësimit ndër vendas për gjetjen e një familjeje birësuese të huaj. Si një instrument i mbrojtjes të të drejtave të të miturve, birësimi vendas ka përparësi ndaj atij ndër vendas. Kjo është e shprehur qartë në legjislacionin shqiptar që rregullon këtë birësim dhe ku theksohet se: birësimi ndër vendas lejohet pasi fëmija ka qendruar në pritje për 6 muaj në Komitetin Shqiptar të Birësimeve dhe se gjatë kësaj periudhe janë ezauruar të gjitha mundësitë për të bërë birësimin vendas (neni 257 i KF). Në respektim të kuadrit ligjor në fuqi birësimi vendas ka përparësi ndaj birësimit ndër vendas, dhe kjo në interesin më të lartë të fëmijës. Në bazë të këtij parimi Komiteti Shqiptar i Birësimeve garanton që birësimi ndër vendas realizohet vetëm pasi është konstatuar pamundësia e gjetjes së një familjeje për të miturin në Shqipëri dhe pasi është studiuar mundësia që birësimi ndër vendas i përgjigjet interesit parësor të fëmijës e garanton respektimin e të drejtave të tij. Aktualisht, Komiteti Shqiptar i Birësimit (i vetmi autoritet që vepron në fushën e birësimit) në bashkëpunim me institucionet e pakujdesit të fëmijëve (publike dhe private), me agjencitë ndërmjetësuese (kryesisht agjenci të huaja pasi deri më tani nuk është licencuar asnjë agjenci ndërmjetësuese vendase për shkak se nuk ka patur kërkesa), si dhe gjykatat në të gjitha rrethet gjyqësore (seksionet familjare) realizon procesin e birësimit brenda dhe jashtë vendit.

260. Në ligjin nr. 9695, datë 19.3. 2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Biresimit në nenin 23 “Përparësia në birësim” parashikohet: 1. Sekretariati ekzekutiv për fëmijën, emri i të cilit është në listat e tij, propozon një familje birësuese shqiptare të përshtatshme. Nëse kjo nuk është e mundur, dhe kur emri i fëmijës ka qenë në listat e Komitetit që prej 6 muajve, aplikant birësues mund të jetë edhe një familje e huaj. 2. Në raste të veçanta, kur nga plotësimi i afatit të sipërpërmendur mund të dëmtohet shëndeti i fëmijës, nisur nga interesi më i lartë i tij, Komiteti mund të japë pëlqimin për birësim edhe pa u përmbushur ky afat, duke e motivuar këtë pëlqim.

261. Në rastet e birësimit ndërvendas fëmija shqiptar gëzon po ato të drejta që gëzon në vendin e origjinës pasi Komiteti Shqiptar i Birësimeve, aktualisht ka marrëveshje bashkëpunimi me ato agjensi ndërmjetësuese, vendet e të cilave kanë ratifikuar Konventën e Hagës. Gjithashtu Kodi i Familjes ndalon rastet kur: a) birësimi nuk njihet në vendin ku banojnë birësuesit; b) arrihet në përfundim se birësimi është me pasoja të rënda për të miturin; c) i mituri në shtetin ku banojnë prindërit birësues nuk gëzon të njëjta të drejta si në Shqipëri.

262. Në kuptim të ligjit nr.9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”, agjensisë ndërmjetësuese në fushën e birësimeve, janë organizatat jofitimprurëse, vendase ose të huaja, të licensuara ose të miratuara nga organet kompetente të birësimit, të cilat sikurse Komiteti Shqiptar i Birësimit me të cilin bashkëpunojnë, e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mbështetje të Kodit të Familjes, Konventës së Hagës.

263. Komiteti Shqiptar i birësimeve mbikqyr veprimtarinë e agjensive ndërmjetësuese për përbërjen, funksionimin dhe gjendjen financiare të tyre. Agjensitë ndërmjetësuese të huaja kontrollohen nga autoritetet kompetente të vendeve të tyre. Komiteti Shqiptar i Birësimeve, përpara nënshkrimit të marrëveshjeve me aghensitë ndërmjetësuese, sigurohet nga autoritetet kompetente përkatëse që ato janë organizata jofitimprurëse, në mënyrë që të mos kenë përfitime të papërshtatshme nëpërmjet birësimit.

Komiteti Shqiptar i Birësimeve, në marrëveshjet e nënshkruara me agjensitë ndërmjetësuese, përcakton periudhën dhe numrin e raporteve pasbirësuese që duhet të vijnë në Komitet në lidhje me ecurinë e fëmijve që birësohen jashtë shtetit. Gjithashtu nisur nga fakti, që të gjitha shtetet me të cilat bashkëpunon Komiteti kanë ratifikuar Konventën e Hagës, edhe birësimet e fëmijve shqiptare janë nën mbikqyrjen e autoriteteve kompetente të këtyre vendeve.

Komiteti Shqiptar i Birësimeve ka marrëveshje dypalëshe në fushën e birësimit ndërvendas me: tre agjensi në Itali, dy agjensi në Amerikë, një agjensi në Francë, një agjensi në Spanjë, një agjensi në Kanada, një agjensi në Maltë, si dhe me Autoritetet Qendrore të disa shteteve të tjera që kanë ratifikuar Konventën e Hagës. Këto agjensi janë të licensuara për birësimet nga Autoritetet Qendrore përkatëse, të cilat gjithashtu kontrollojnë edhe të gjithë aktivitetin e tyre. Në këtë mënyrë procedurat për birësimin e fëmijve shqiptar nga çiftet e huaja ndiqen nga organe kompetente, si dhe janë nën mbikqyrjen e Autoriteteve Qendrore. Komiteti është kufizuar në bashkëpunimin vetëm me ato agjensi ndërmjetësuese, vendet e të cilave kanë ratifikuar Konventën e Hagës.

264. Të gjithë fëmijët e birësuar nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve janë fëmijë të deklaruar të braktisur nëpërmjet vendimit të gjykatës dhe në dosjen e tyre, që përgatitet nga institucioni në të cilin ai ndodhet, ka shumë pak informacion mbi gjendjen e familjes biologjike. Në shumicën e rasteve ata janë fëmijë të braktisur nga nëna që në lindje, e cila gjithashtu nuk jep identitet të vërtetë.

265. Familjet birësuese të huaja janë të gjitha të studjuara fillimisht nga agjensitë të cilave ato u drejtohen dhe pastaj janë Autoritetet përkatëse të cilat i kanë dhënë dekretin “ Të përshtatshëm për birësimin e një fëmije të huaj” .

266. Në ligjin nr. 9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”, parashikohet mbarimi i veprimtarisë së agjensisë ndërmjetësuese në fushën e birësimeve. Një ndër rastet e mbarimit të veprimtarisë së agjensisë, është kur hiqet licenca ose miratimi për shkak të shkeljes së kërkesave të këtij ligji (neni 35).

267. Komiteti Shqiptar i Birësimeve me shërbimet e tij mbështetëse merr të gjitha masat për një studim social mbi të miturin, për jetën e tij, kushtet e tij psikologjike, sociale, shpirtërore, mjekësore, kulturore dhe nëse është e mundur edhe një studim të familjes së origjinës. Puna dhe studimet e realizuara nga Komiteti kanë për qëllim gjetjen e një familjeje sa më të përshtatshme për fëmijën, në mbrojtje të interesit më të lartë të tij.

268. Për rritjen e cilësisë së shërbimit që ofron ky institucion me Urdhrin nr. nr. 4763, datë 08.06.2009 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Komitetit Shqiptar të Birësimeve”, janë miratuar rregullat për organizimin dhe funksionimin e tij në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi por edhe me zhvillimet e fundit në këtë fushë.

Abuzimi dhe mospërfillja (neni 19) Rekomandimi 49/ a *Ndërmarrja e studimeve mbi dhunën në familje, keqtrajtimet dhe abuzimin.*

269. Lidhur me rekomandimin 49/a, në vitet e fundit një numër i madh studimesh ka vënë në dukje pritshmërinë e lartë të dhunës ndaj fëmijëve në familje, shkollë apo edhe në institucione rezidenciale. Studimet në përgjithësi përdorin metodologji të ndryshme në përcaktimin e niveleve të dhunës ndaj fëmijëve, por ato vijnë në një emërues të përbashkët kur konstatojnë se mjedisi ku rriten fëmijët është një mjedis i dhunshëm.

270. Sipas studimit mbi dhunën në familje të kryer nga INSTAT&UNICEF, (MICS 2005) 49 % e të gjithë fëmijëve 2-14 vjeç dhe 59 % e fëmijëve që jetojnë në familjet më të varfëra, kanë përjetuar forma të ndryshme të dhunës psikologjike dhe fizike në familje. Fëmijët tregojnë se janë nënat ato, të cilat ushtrojnë dhunë më shpesh ndaj tyre, por baballarët ushtrojnë dhunë më të rëndë fizike³⁹. Edukimi i nënës është faktor i rëndësishëm, pasi rezulton se 51 % e nënave me nivel të ulët edukimi ushtrojnë më tepër dhunë në krahasim me 44% të nënave me arsim të mesëm apo të lartë.⁴⁰ Ndonëse në familje mbizotëron mendimi se dhuna ndaj fëmijëve duhet të përdoret vetëm kur është e nevojshme, në praktikën e përditshme dhuna fizike dhe psikologjike ndaj fëmijëve janë mënyrat kryesore për vendosjen e disiplinës në familje⁴¹.

271. MPÇSSHB në bashkëpunim me Qendrën e Aleancës Gjinore për Zhvillim (OJF) realizuan studimin “Dhuna në Familje – Situata aktuale”, i cili merrte në analizë situatën në Shqipëri, në lidhje me fenomenin e dhunës në familje⁴². Ky studim u krye nga një grup ekspertësh me përvojë dhe kualifikim në këtë fushë, të cilët në analizën e tyre morrën për bazë të dhënat e periudhës 2000-2005 të siguruara nga organizatat dhe qendrat që ofrojnë shërbime sociale në ndihmë të viktimave të dhunës në familje. Gjithashtu, të dhëna lidhur me përhapjen e dhunës në familje, për vitin 2005 janë marrë edhe nga Ministria e Brendshme. Ky studim i parapriu hartimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit për Veprim Kundër Dhunës në Familje.

³⁹ Human Development Centre/UNICEF. Dhuna ndaj Fëmijëve në Shqipëri. Tiranë. 2006.

⁴⁰ INSTAT&UNICEF, MICS 2005.

⁴¹ Human Development Centre/UNICEF. Dhuna ndaj Fëmijëve në Shqipëri. Tiranë. 2006.

⁴² Të dhënat e këtij studimi mbi rastet e dhunës në familje paraqiten në anekset bashkëlidhur Raportit.

272. Sipas Studimit të Qendrës së Këshillimit për Gra dhe Vajza në Tiranë, për periudhën 2000-2005, u nxorrën dhe disa konkluzione të rëndësishme, në lidhje me format më të përhapura të dhunës, të cilat rezultuan si vijon: a) dhuna emocionale është forma e dhunës në familje e hasur më shpesh; b) dhuna ekonomike takohet më shumë në zonat urbane; c) dhuna fizike raportohet më shumë në zonat rurale; d) dhuna seksuale është forma më pak e raportuar. e) Më të rrezikuara janë gratë me aftësi të kufizuara, gratë migrante, gratë që i përkasin minoritetit rom dhe gratë e zonave rurale; f) grup moshat që përjetojnë më shumë dhunë janë 18-23 vjeç dhe 37- 45 vjeç.

273. Në kuadër të projektit të përbashkët të MPCSSHB dhe UNDP “Dhuna në familje – jo vetëm problem familjar”, INSTAT nëpërmjet një grupi ekspertësh ka kryer një studim për të parë nivelin e dhunës në familje në nivel kombëtar. Ky është studimi i parë që bëhet pas hyrjes në fuqi të Ligjit 9669 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Ka përfunduar anketimi dhe intervistimi i kampionit të studimit, janë përgatitur tabelat specifike me të dhënat e nxjerra nga studimi për nivelin e dhunës në vend, përfundimet e të cilit do të bëhen publike së shpejti⁴³

Rekomandimi 49/b Parandalimi dhe lufta kundër dhunës në familje, keqtrajtimet dhe abuzimet.

274. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”⁴⁴ ka si qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj me anën e masave të përshtatshme ligjore dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjestarëve të familjes, të cilët janë viktimat të dhunës në familje duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara”. Në përputhje me këtë ligj, “dhunë konsiderohet çdo veprim, apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik”. Ky ligj administrativo-civil sanksionon krijimin e rrjetit të koordinuar të institucioneve qeveritare për t’u përgjigjur në kohë rasteve të dhunës në familje, si dhe dhe fut konceptet e nxjerrjes së “Urdhër Mbrojtjeje” dhe “Urdhër i Menjehershëm Mbrojtjeje”.

275. Politika për reduktimin e dhunës në familje. Me iniciativën e MPCSSHB gjatë periudhës 2006-2007 në kuadrin e një procesi gjithëpërfshirës u hartua Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje (2007-2010) (miratuar me VKM nr.913, dt.19.12.2007), e cila synon përfshirjen e çështjeve të dhunës në familje, në politikat publike nëpërmjet planeve konkrete të veprimit për minimizimin e fenomenit të dhunës në familje. Prioritet i këtij dokumenti në bazë të fushave përkatëse është edhe rritja e ndërgjegjësimit ndaj dukurisë së dhunës, mbrojtja ligjore dhe administrative si dhe mbështetje për individë të prekur nga dhuna në familje dhe dhunuesit. Lidhur me dhunën në familje, kjo strategji përqendrohet në disa sektorë kryesorë për parandalimin, luftën dhe mbështetjen e viktimave të dhunës, luftën kundër dhunës dhe mbështetjen e viktimave të dhunës në familje. Në vazhdimësi MPCSSHB ka kryer mjaft aktivitete në kuadrin e Fushatës së Këshillit të Europës kundër dhunës ndaj grave. Kjo ministri, mbështetur nga UNDP ka publikuar posterin “Dhuna ndaj grave shkatërron-Të gjithë së bashku për një familje dhe shoqëri pa dhunë”, duke e shpërndarë atë në të gjithë vendin. Gjithashtu janë organizuar në media (Radio-Tirana), emisione sensibilizuese lidhur me dhunën në familje, si dhe botime në shtypin e përditshëm. Në kuadër të fushatës kundër dhunës në familje, gjatë vitit 2007, janë organizuar një sërë aktivitete në bashkëpunim me shoqërinë civile, si dhe një fushatë sensibilizuese lidhur me ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (zhvilluar në 12 Prefekturat e vendit).

⁴³ Raporti i MPCSSHB “Arritjet vjetore në fushën e Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje, Janar – Dhjetor 2008

⁴⁴ Ky ligj ka hyrë në fuqi në datën 1 qershor 2007.

276. Roli i psikologut të shkollës në mbrojtjen, parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, abuzimit, shfrytëzimit, pakujdesisë etj, ndaj fëmijëve është i konsiderueshëm veçanërisht në konstatimin e problemit. Në zgjidhjen e tij, roli i psikologut rivlerësohet në kontekstin edhe të funksionimit të shërbimeve të tjera në komunitetin ku ndodhet shkolla. Mbrojtja e fëmijëve është një dukuri multidimensionale që kërkon një përqasje gjithashtu multidisiplinare ku krahas shkollës, shërbimit psikologjik të bashkërendohet puna në nivel lokal në lidhje me shërbimin shëndetësor, shërbimin policor, shërbimin social etj. Në sistemin arsimor parauniversitar sigurohet shërbimi psikologjik shkollor për të gjithë nxënësit dhe në veçanti për ata me probleme social ekonomike.

Rekomandimi 49/ c Ngritja e një sistemi gjykimi mbi rastet e dhunës, keqtrajttimeve në familje dhe abuzimeve me fëmijët, brenda familje.

277. Në Kodin Penal një sërë dispozitash, trajtojnë dhunën në familje. Në këtë Kod janë parashikuar konkretisht: veprat penale kundër lirisë së personit; vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit; vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes; krime seksuale. Ky Kod parashikon rrethana rënduese kur viktimat është minoren/e, si dhe pasojat që mund të kenë ardhur nga kryerja e veprës penale. Ndryshimet e vazhdueshme në Kodin Penal kanë parashikuar jo vetëm dispozita specifike për të mbrojtur fëmijët dhe femrat nga keqtrajtimet, abuzimi seksual, trafikimi, prostitucioni, pornografia, veprat e turpshme, por në vazhdimësi zhvillimet ligjore kanë parashikuar rritje të ndjeshme të masave të dënimit ndaj autorëve të kryerjes së veprave penale.

278. Kodi i Familjes, parashikon marrjen e masave urgjente nga gjykata për rastet e dhunës në familje, sipas kërkesës së bashkëshortit tjetër në rastin kur njëri nga bashkëshortët nuk plotëson në mënyrë të dukshme detyrimet e tij dhe vë në rrezik interesat e familjes. Në nenin 62, “Masat kundër dhunës”, parashikohet që, “bashkëshorti ndaj të cilit ushtrohet dhunë ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës me kërkesë për vendosjen si masë urgjente largimin nga banesa bashkëshortore të bashkëshortit që ushtron dhunë”.

279. Kodi i Procedurës Penale (neni 6) parashikon ndihmën falas nga një mbrojtës për të pandehurin, i cili nuk ka mjete të mjaftueshme financiare. Ministria e Drejtësisë po punon për nxjerrjen e akteve nënligjore, që parashikojnë ndihmë ligjore falas për viktimat e dhunës në familje. Në vendin tonë veprojnë një sërë OJF, të cilat ofrojnë ndihmë ligjore falas për subjekte të caktuara.

280. Ligji “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare” përcakton se Gjykata vendos për nxjerrjen e një “Urdhër Mbrojtjeje” në rastet kur ka një bazë të mjaftueshme për të besuar që dhunuesi (kundër të cilit lëshohet urdhri) mund të kryejë një akt dhune familjare dhe nxjerrja e urdhrit është e domosdoshme për të mbrojtur viktimën. Gjykata mund të nxjerrë një “urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje” në rastet kur ka bazë të mjaftueshme për të besuar që dhunuesi ka kryer apo kërcenuar të kryejë një akt dhune familjare, apo paraqet një kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm, dhe që lëshimi i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes është i domosdoshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e viktimës a anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës. Urdhrat e lëshuar të cilët janë veçanërisht të lidhura me mbrojtjen e një fëmije viktimë të dhunës, përfshijnë: 1) largimin e dhunuesit nga banesa për një periudhë të caktuar kohe, të përcaktuar në urdhrin e gjykatës; 2) vendosjen e viktimës dhe fëmijëve apo anëtarëve të tjerë të familjes të cilët nuk ushtruan dhunë në strehime të përkohëshme, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës; 3) heqjen e përkohshme e të drejtave prindërore për dhunuesin (jo për urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes); 4) vendosjen dhe urdhërimin, në varësi të rastit, të ndërhyrjes së

shërbimeve sociale publike ose private apo të një qendre për ndëmjtesim familje apo organizatave qëllimi i të cilave është të mbështesë dhe strehojë viktimat e dhunës në familje;

Në rastin kur është fëmija viktimë e dhunës në familje kërkesa për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet nga (i) prindërit tjetër ose kujdestarët e fëmijës, (ii) përfaqësuesi ligjor i fëmijës, (iii) të afërmit e fëmijës, (iv) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale në bashki ose komunë, ose (v) qendrat dhe shërbimet e mbrojtjes dhe rehabilitimit për dhunën në familje, të njohura apo liçensuara nga MPCSSHB. Prokurori dhe policia kanë kompetencat për të paraqitur kërkesë në rast të një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje.

d) të sigurojë shërbime mbështetëse, si psh. rigjenerim psikologjik, ri-integrim shoqëror.

281. Në lidhje me rekomandimin 49/d, Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (në nenin 10), parashikon ndër të tjera masa mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje, të cilat sigurohen gjithashtu edhe nëpërmjet: 1) përfshirjes së viktimës së dhunës në familje në programe rehabilitimi; 2) urdhërimit të të paditurit/ës (dhunuesin/en) që të marrë pjesë në programe rehabilitimi; nëse i padituri/a (dhunuesi/ja) urdhërohet të shkojë në një program rehabilitimi, përgjegjësve të programit u kërkohet të raportojnë çdo javë në gjykatë nëse dhunuesi e ndjek, apo merr pjesë në të. Nëse i padituri/a (dhunuesi/ja) nuk merr pjesë, atëherë me kërkesë të subjekteve të parashikuara nga neni 13 i këtij ligji, gjykata e thërret këtë përpara saj dhe zbaton dispozitat përkatëse të Kodit Penal, për pengimin e ekzekutimit të vendimeve të gjykatës.

282. Masat e ndërmarra për integrimin dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje. Për integrimin e viktimave të dhunës në jetën e përditshme, në zbatim të ligjit nr. 7995 datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit”, VKM nr. 632, datë 18.09.2003 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërqueseve të papuna femra”, mbështeten finaciarisht punëdhënësit, të cilët punësojnë femra, sidomos të kategorive të tilla: si femra romë, femrat mbi 35 vjeç, femra të divorcuara me probleme sociale, femra të dhunuara dhe me aftësi të kufizuara.

Në Urdhrin nr.394, datë 23.02.2004 të Ministrisë të Punës dhe Çështjeve Sociale “Për tarifën e Sistemit të formimit profesional”, përcaktohet se tarifën e regjistrimit për kategoritë “komuniteti rom, vajzat dhe gratë e trafikuar dhe të dhunuara”, janë falas për kurset e profesioneve të formimit profesional të ofruara nga Qendrat Publike të Formimit Profesional. Këto kurse synojnë kualifikimin dhe rritjen e aftësive profesionale të grupeve të mësipërme, duke u krijuar mundësi më të mëdha në tregun e punës. Ministria e Arsimit dhe Shkencës me Qarkoren nr. 8373, datë, 26.11.2006. “Për marrjen e masave për përmirësimin e punës edukative në shkollë dhe parandalimin e dhunës”, ka përcaktuar masat e nevojshme kundër dhunës në shkollë dhe në familje, në veçanti atje ku pjesë e saj janë vajzat. Në zbatim të kësaj qarkoreje dhe të rekomandimeve të studimit “Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri” të realizuar nga UNICEF u hartua një plan aktivitetesh në shkollë kombëtare siç ishte shpallja e aksionit kombëtar në arsim për t’i thënë “Stop dhunës ndaj fëmijëve në shkollë”.

283. Shërbimet që ofrohen për mbështetjen e viktimave të dhunës në familje, janë kryesisht shërbime të ofruara nga OJF, por ato janë të pamjaftueshme dhe jo të shtrira në të gjithë territorin. Në kuadër të Programit të Kombeve të Bashkuara për Shqipërinë ONE- UN, MPCSSHB me mbështetjen e donatorëve do të ngrejë “Strehëza Kombëtare” për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. Kjo do të jetë iniciativa e parë shtetërore për ofrimin e këtij lloji shërbimi, e cila do të pasohet me të tjera iniciativa, duke synuar përmbushjen e standarteve për ngritjen e një strehëze/7500 banorë. Është hartuar projekti për rikonstruksionin e në bashkëpunim edhe me institucione të tjera të MPCSSHB dhe të pushtetit vendor shumë shpejt do të vihet në funksionim.

Ndëshkimet trupore- Rekomandimi 51.

284. Me qëllim parandalimin e keqtrajtimit të të miturve, Kuvendi i RSH-së ka miratuar ligjin nr.9859, datë 21.01.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i RSH-së”, Neni 124/b i ligjit të mësipërm, “Keqtrajtimi i të miturit” përcakton konkretisht: “Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga personi që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet.

Detyrimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij dënohet me burgim deri në katër vjet dhe me gjobë nga pesëdhjetë mijë deri në një milion lekë. Kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e të miturit, dënohet me burgim nga dhjetë deri në 20 vjet”.

285. Lidhur me rekomandimin 51 me qëllim ndërgjegjësimin e strukturave shtetërore, lidhur me parandalimin e dhunës në familje, gjatë vitit 2008 është realizuar trajnimi i punonjësve të Policisë, shëndetësisë, shërbimeve sociale, etj.. Gjithashtu Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta në MPCSSHB në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare si UNDP, UNFPA, OSBE, ka organizuar një cikël trajnimesh për punonjësit e policisë, punonjësve të shëndetësisë, si dhe punonjësve të shërbimeve sociale. Qëllimi i organizimit të këtyre trajnimeve, në të cilat kanë marrë pjesë rreth 720 punonjës të institucioneve të ndryshme, ka qenë forcimi i kapaciteteve të strukturave të cilat ofrojnë shërbime mbrojtëse e mbështetëse për viktimat e dhunës familjare. Trajnimet për forcimin e kapaciteteve të strukturave do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

286. Gjatë vitit 2008 janë trajnuar rreth 984 punonjës⁴⁵ nga institucionet me përgjegjësi direkte për zbatimin e ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” si psh: a) Punonjës të shëndetësisë, mjekë, infermierë, mami; b) Punonjës të policisë; c) Gjyqtarë e prokurorë, me mbështetjen financiare të UNDP-së.

287. Me qëllim rritjen e kapaciteteve institucionale të punonjësve të policisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, duke zbatuar rigorozisht procedurat e shoqërimit, marrjes në pyetje, trajtimit nëpër ambjentet e policisë, si dhe sensibilizimin për t'i kushtuar atyre vëmendjen e duhur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, në partneritet me “Klinikën Ligjore për të Mitur” në shtator 2008, ka organizuar 2 sesione trajnuese me punonjës të policisë të Drejtorisë së Policisë në qarqe.

288. Si rezultat i masave mbrojtëse që ofron ligji, por dhe fushatave sensibilizuese të Kuvendit të Shqipërisë, Qeverisë Shqiptare dhe shoqërisë civile, vitin e fundit u rrit numri i personave viktimat të dhunës familjare që kërkojnë mbrojtje nga policia.

Gjithashtu, në mjaft media vizive, si TVSH, Vizion-Plus, Top-Chanel, janë prezantuar angazhimet dhe arritjet në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

b) Zbatimi i programeve kombëtare dhe monitorimi i tyre.

Mekanizmat e krijuara për zbatimin e të drejtave të parashikuara nga Konventa (nenet 5, 9-11,18 pg 1,2, 19-21,25, 27 pg 4 dhe 39)), si dhe për monitorimin e saj.

289. Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, garanton dhe mbron me masa ligjore pjesëtarët e familjes të cilët shpesh herë e në mënyrë të përsëritur, janë viktimat të dhunës në familje.

⁴⁵ Projekti i UNDP “Dhuna në familje – jo vetëm problem familjar”.

Në zbatim të këtij ligji, janë miratuar disa akte nënligjore, të cilat kanë të bëjnë me ngritjen e strukturave përgjegjëse për çështjet e dhunës në familje konkretisht:

290. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është autoriteti përgjegjës kryesor për implementimin dhe monitorimin e tij. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 202, datë. 05.12.2007 “Për ngritjen në MPÇSSHB, të strukturës për masat ndaj dhunës në familje”, në këtë Ministri, në Drejtorinë e Shanseve të Barabarta është krijuar Sektori për masa ndaj Dhunës në Familje, ka si mision formulimin dhe zhvillimin e politikave për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe në përgjithësi dhunës me bazë gjinore. Ky Sektor ka si detyra: 1) Hartimi i strategjive dhe politikave për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare. 2) Mbledhja, përpunimi dhe analiza e informacionit të nevojshëm statistikor për dhunën në marrëdhëniet familjare dhe formulimi i politikave në këtë fushë. 3) Programimi i masave për rritjen e kapaciteteve për të gjithë aktorët në nivel qendror e vendor, që janë të angazhuar për kujdesin ndaj viktimave të dhunës në familje. 4) Krijimi i një database dhe vendosja e lidhjeve të bashkëpunimit me OJF-të që veprojnë në këtë fushë. 5) Sigurimi i programeve sociale, parandaluese, dhe mbrojtëse si dhe masave për reduktimin e dhunës në familje.

291. Ministria e Brendshme është një nga autoritetet përgjegjës për krijimin e sektorëve të veçanta për parandalimin, luftën kundër dhunës në familje, ndjekjen e rasteve të dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave të saj (neni 7/1/a, i ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”), detyrim të cilin Drejtoria e Përgjithshme e Policisë e ka përmbushur. Në zbatim të këtij detyrimi, në muajin korrik 2007 ka filluar ngritja e strukturave të veçanta në nivel qendror dhe rajonal, të cilat aktualisht janë në procesin e vënies së tyre në efikasitet. Në nivel qendror, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në Departamentin për Hetimin e Krimeve (Drejtoria Kundër Krimeve të Rënda) është krijuar Sektori për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunën në Familje, kurse në Drejtoritë e Policive në Qarqe, në nivel rajonal janë krijuar Seksionet për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunën në Familje. Ndër objektivat kryesore të këtyre strukturave, të ngritura në fund të vitit 2007, janë masat për zbatimin me efikasitet të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe vënia në efikasitet të plotë e tyre. Këto struktura kanë si funksion parandalimin dhe goditjen e dhunës në ambientet familjare, dhunën ndaj të miturve, si dhe mbledhjen në mënyrë sistematike të të dhënave statistikore lidhur me këtë fenomen. Për t’i paraprirë ndryshimit strukturor, por edhe në zbatim të disa rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, edhe para miratimit të ligjit të lartpërmendur ka kërkuar nga strukturat vendore të policisë, që krahas punës për parandalimin e dhunës në familje, të ndjekë me përgjegjësi të plotë ligjore të gjitha denoncimet për akte dhune brenda familjes.

292. Ministria e Shëndetësisë ka filluar punën për përgatitjen e ndërhyrjeve konkrete, të cilat synojnë në parandalimin e pasojave imediate dhe afat gjata të dhunës në familje dhe në veçanti të dhunës ndaj grave, vajzave dhe fëmijëve, ku prioritet ka parandalimi i dëmtimeve, i sëmundjeve dhe i pasojave shëndetësore që vijnë nga keqtrajtimi i grave, vajzave dhe fëmijëve. Të gjitha Drejtoritë e Shëndetit Publik janë udhëzuar që të ngrejné ekipin përgjegjës të përbërë nga mjekë (Inspektori i Shëndetit Riprodhues), infermier (Specialisti i Kujdesjeve infermiore) si dhe punonjësi social, ose psikologu kur ata i kanë në strukturë. Ky ekip ka për detyrë të manaxhojë dhe supervizionojë zbatimin e ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe akteve nënligjore, rregulloreve të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë. Në sistemin shëndetësor po ngrihen struktura të shërbimit psikosocial për dhënien e ndihmës viktimave të dhunës në familje.

Informacion lidhur me masat ligjore, administrative, gjyqësore etj, për zbatimin e të drejtave të parashikuara nga Konventa.

Neni 9. Ndarja nga prindërit.

293. Kodi i familjes parashikon se “Shteti dhe shoqëria duhet t’u oftojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes” (neni 3).

Sipas këtij Kodi prindit, që nuk i është dhënë fëmija për rritje dhe edukim, ruan të drejtën të mbikëqyrë mbajtjen dhe edukimin e fëmijës e për pasojë të informohet dhe të konsultohet për zgjedhjet e rëndësishme që lidhen me jetën e tij. Ai kontribuon në raport me burimet e tij dhe ato të prindit tjetër. E drejta e vizitës dhe e banimit, sipas kushteve të përcaktuara nga gjykata, nuk mund t’i refuzohen, veçse për arsye të rënda që dëmtojnë interesat e fëmijës.

294. Në nenin 156 të KF parashikohet se gjykata vendos për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, ose për t’i besuar fëmijën një të treti, mbi bazën e kërkesës së njëres prej palëve, pjesëtarëve të familjes ose prokurori, në rast se ka shkaqe të rënda të cilat janë të lidhura me ushtrimin abuziv të përgjegjësisë prindërore. Prindit që nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, ruan të drejtën të mbikëqyrë mbajtjen dhe edukimin e fëmijës dhe për pasojë të të informohet dhe konsultohet për zgjedhjet e rëndësishme që lidhen me jetën e tij. Ai kontribuon në raport me burimet e tij dhe ato të prindit tjetër. E drejta e vizitës dhe banimit sipas kushteve të caktuara nga gjykata, nuk mund t’i refuzohen vetëm për arsye të rënda, që dëmton interesat e fëmijës.

295. Në Kod përcaktohen edhe rastet kur hiqet përgjegjësia prindërore, të cilat janë: 1) kur prindi shpërdoron përgjegjësinë prindërore ose; 2) tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, ose; 3) me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijëve. Në këto raste me kërkesën e prindit tjetër, të të afërmeve të fëmijës ose të prokurorit, mund t’i hiqet përgjegjësia prindërore. Heqja e përgjegjësisë prindërore bëhet me vendim të gjykatës, duke u thirrur si i paditur prindi, për te cilin kërkohet kjo heqje. Gjykata vendos që heqja e përgjegjësisë prindërore të shtrihet mbi të gjithë ose mbi disa nga fëmijët e lindur para vendimit të gjykatës për heqjen e përgjegjësisë.

296. Kodi i Familjes trajton çështjen e kujdestarisë ndaj fëmijve dhe konkretisht nenet 263 - 267, 271 – 275, 278, 299, 306) parashikojnë se fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore, për shkak se: 1) të dy prindërit kanë vdekur ose; 2) nuk njihen; 3) janë shpallur si të pagjetur; 4) u është hequr përgjegjësia prindërore ose; 5) u është hequr zotësia për të vepruar, si dhe; 6) për çdo shkak tjetër të pranuar nga gjykata. Gjykata kompetente për vendosjen në kujdestari të të miturit është ajo e vendbanimit ose vendqëndrimit të të miturit.

297. Në nenin 264 të Kodit parashikohet se të drejtën për paraqitjen e kërkesës në gjykatë për kujdestar mbi të miturin e kanë: 1) të afërmit e fëmijës së mitur; 2) cilido që merr njoftimin për mbetjen e fëmijës pa prindër ose për lindjen e fëmijës me prindër të panjohur; 3) vetë i mituri që ka mbushur moshën 14 vjeç; 4) prokurori; 5) noteri, i cili në çeljen e një testamenti vihet në dijeni për caktimin e një kujdestari. Gjykata vendos si kujdestar personin: 1) e caktuar nga prindi; 2) që ka ushtruar i fundit përgjegjësinë prindërore; 3) e caktuar me testament ose deklarate noteriale ose; 4) e caktuar nga vetë gjykata kur kujdestarët e caktuar nga pikat e mësipërme nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në Kod. Gjithashtu, Kodi i Familjes parashikon se gjykata me qëllim që t’i mundësojë fëmijës një mjedis familjar, kushte për mirëritje, përkujdesje fizike dhe mbështetje emocionale i ofron një familje alternative ose një familje kujdestare. Evidentimi i familjeve kujdestare është përgjegjësi e sektorit të ndihmës dhe shërbimit social pranë bashkisë ose komunës ku banon i mituri,

e cila realizohet me firmosjen e një deklaratë gatishmërie nga familja për të marrë fëmijë në kujdestari. Ndër të tjera Kodi parashikon se numri i fëmijëve që i jepen në kujdestari një familjeje kujdestare duhet të jetë i kufizuar, duke u dhënë prioritet në këtë vendosje fëmijëve që janë vëllezër dhe motra me njëri-tjetrin. Në neni 267 të Kodit të Familjes parashikohet se në rastet kur nuk është caktuar kujdestar nga prindi që ka ushtruar i fundit përgjegjësinë prindërore, gjykata i jep prioritet zgjedhjes së kujdestarit midis paraardhësve, personave të afërt të të miturit, një familjeje kujdestare dhe, si alternativë të fundit, institucionin publik ose privat. Gjykata, në çdo rast, merr mendimin e sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës së vendit ku zhvillohet gjykimi, i cili përmban ekzaminimin e zhvillimit të personalitetit të fëmijës në kontekstin familjar edukativ e social dhe ekzaminimin e kushteve dhe përshtatshmërisë së fëmijës me personin kujdestar të ardhshëm, të familjes kujdestare ose institucionit të përkujdesjes. Caktimi i kujdestarit nga gjykata bëhet duke parë cilësitë e personit kujdestar, të familjes kujdestare të zgjedhur ose të institucionit të përkujdesjes, sikurse përcaktohet më lart, si dhe pasi ka dëgjuar mendimin e një psikologu, që duhet të jetë i pranishëm gjatë gjykimit.

298. Kodi i njeh të drejtën gjykatës që në rast se i mituri nuk ka të afërm të njohur ose të aftë për të ushtruar detyrën e kujdestarit, mund t'i jepet nga gjykata një institucioni publik ose privat të licencuar për përkujdesjen e fëmijëve. Drejtuesi i institucionit i delegon njërit nga punonjësit e tij të drejtën e ushtrimit të funksioneve të kujdestarit. Në këtë rast drejtuesi i institucionit, brenda 10 ditëve nga caktimi i personit që merr funksionet e kujdestarit, i dërgon gjykatës aktin përkatës, i cili depozitohet në dosjen gjyqësore dhe pasqyrohet në regjistrin e kujdestarisë. Në nenin 299 të Kodit të Familjes përcaktohen përgjegjësitë e kujdestarit dhe kujdestarit të posaçëm, të cilat janë: 1) të administrojë pasurinë e të miturit me kujdesin e një prindi të mirë; 2) të shpërblejë të miturin për të gjitha dëmet që i ka shkaktuar në kryerjen e parregullt të detyrës, ose për shkak të lënies pa arsye të detyrës së tij si kujdestar apo kujdestar i posaçëm.

Në nenin 306 të Kodit parashikohen rastet e mbarimit të kujdestarisë, të cilat janë kur i mituri: 1) bëhet madhor; 2) vdes; 3) fiton zotësinë për të vepruar me martesë.

Neni 18. Përgjegjësitë prindërore.

299. Në një kapitull të veçantë, Kodi i Familjes trajton të drejtat dhe detyrimet që lindin nga martesa mbi të dy bashkëshortët, të cilët kanë detyrimin për të mbajtur, arsimuar dhe edukuar fëmijët, duke pasur parasysh aftësitë, prirjet natyrore dhe dëshirat e fëmijëve.

300. Në lidhje me pasojat e zgjidhjes së martesës për fëmijët, parashikohet se zgjidhja e martesës nuk prek të drejtat dhe detyrimet që kanë prindërit ndaj fëmijëve të tyre, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë Kod. KF përcakton si detyrim për gjykatat që para se të marrë një vendim të përkohshëm ose përfundimtar lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës njërit ishbashkëshort, duhet të thërrasë një psikolog ose punonjës social, i cili, para se të japë mendimin, duhet të marrë të dhëna për gjendjen materiale dhe morale të familjes, kushtet në të cilat jetojnë dhe ku është më e përshtatshme të jetojë fëmija.

Gjykata vendos për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ose për t'i besuar fëmijën një të treti, mbi bazën e kërkesës së njëres prej palëve, pjesëtarëve të familjes ose prokurorit, në rast se ka shkaqe të rënda që janë të lidhura me ushtrimin abuziv të përgjegjësisë prindërore.

301. Në nenet 215 – 239 të Kodit trajtohet gjerësisht çështja e përgjegjësisë prindërore, e cila u përket dhe ushtrohet së bashku nga të dy prindërit në lidhje me fëmijën e lindur gjatë martesës së tyre ose jashtë martese, nëse është njohur nga të dy prindërit.

302. Në referim të këtyre neneve parashikohet se përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqënien emocionale, sociale dhe materiale

të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirëritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij. Fëmija ndodhet nën përgjegjësinë prindërore deri në arritjen e moshës madhore.

Gjithashtu, në lidhje me ushtrimin e të drejtës së përgjegjësisë prindërore, prindërit mund të kërkojnë nga gjykata kthimin e fëmijës së tyre të mitur, kur nuk jeton pranë tyre dhe mbahet pa të drejtë nga persona të tjerë. Gjykata, për rrethana të rënda, mund të mos vendosë kthimin, në qoftë se ky vjen në kundërshtim me interesin më të lartë të fëmijës. Gjykata merr edhe mendimin e fëmijës kur ka mbushur moshën dhjetë vjeç.

Prindërit e fëmijës mund të humbasin përgjegjësinë prindërore nëpërmjet një vendimi penal që i ka dënuar ata si autorë ose si bashkëpunorë për një vepër penale ndaj fëmijës së tyre si bashkëpunorë në një vepër penale të kryer nga fëmija i tyre ose nëse janë dënuar për ndonjë nga shkaqet e braktisjes së familjes, për sa kohë që ata nuk kanë marrë përsipër detyrimet që kanë ndaj saj.

Kodi i Familjes parashikon edhe rastet e pamundësisë së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të cilat janë: 1) kur prindërit e fëmijës kanë vdekur; 2) për shkak të pazotësisë për të vepruar; 3) të mungesës ose për arsye veçanërisht të rënda.

303. Në rastet e lartpërmendura fëmija mund t'i besohet një anëtari të familjes, një personi të caktuar si kujdestar, një familjeje kujdestare ose edhe një institucioni të përkujdesjes. Në këto raste merret mendimi i sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale, sipas dispozitave për kujdestarinë. Në qoftë se njëri nga prindërit është para pamundësisë së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ose kur njëri nga prindërit ka vdekur, Kodi parashikon se përgjegjësia prindërore ushtrohet nga prindi tjetër.

304. Në rastin e fëmijës së lindur jashtë martese Kodi parashikon se përgjegjësinë prindërore e ushtron prindi që e ka njohur fëmijën si të tij. Në qoftë se ai është njohur nga të dy prindërit, përgjegjësinë prindërore e kanë të dy prindërit.

Gjithashtu, në Kod parashikohet se me kërkesë të të atit, të nënës ose të prokurorit, gjykata mund të ndryshojë kushtet e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe të vendosë që ai të ushtrohet nga njëri prind ose nga të dy bashkërisht. Gjykata në këtë rast vendos se me cilin prind do të banojë fëmija. Gjykata vendos për të drejtën e vizitës dhe të mbikëqyrjes së prindit, me të cilin fëmija nuk banon.

305. Në Kod janë parashikuar dispozita të veçanta në lidhje me përgjegjësinë prindërore për pasurinë e fëmijës. Prindërit e fëmijës kanë të drejtën e administrimit dhe të përdorimit të pasurisë së fëmijës së tyre. Në lidhje me administrimin i pasurisë së fëmijës, KF parashikon se ushtrohet nga të dy prindërit bashkërisht, në rastin kur ata e ushtrojnë përgjegjësinë prindërore bashkërisht dhe në rastet e tjera ose nga i ati apo nga nëna, nën kontrollin e gjykatës (në përputhje me nenet 234 dhe 235).

Neni 19. Abuzimi dhe neglizhenca.

306. Dhuna në marrëdhëniet familjare në kuptim të ligjit nr.9669 datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, konsumuar si figurë në legjislacionin penal të RSH-së, përcaktohet në dispozita konkrete në Kodin Penal.

307. Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (në nenin 10), parashikon një sërë masash mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje, të cilat sigurohen në këto mënyra: 1) duke urdhëruar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë vepër të dhunës në familje ndaj paditësit/es (viktimitës) apo pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimitës, siç përcaktohen në nenin 3, apo siç emërtohen në urdhër; 2) duke urdhëruar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt apo tërthorazi me viktimitën apo pjesëtarë të familjes së viktimitës siç përcaktohen në nenin 3 apo siç emërtohen në urdhër; 3) duke larguar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) nga banesa për një

afat kohor të caktuar me urdhër të gjykatës dhe të mos e lejojë të rihyjë në banesë pa autorizimin e gjykatës; 4) duke ndaluar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës siç përcaktohen në nenin 3, pika 3, apo siç emërtohen në urdhër; 5) duke ndaluar menjëherë të paditurin/ën (dhunuesin/en) që t'i afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës apo banesës së çiftit të ardhshëm apo të personave të tjerë dhe për më tepër shkollës së fëmijëve, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimat, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune; 6) duke vendosur menjëherë viktimën/at dhe të miturit në strehime të përkohshme duke mbajtur parasysh në çdo rast interesin më të lartë, atë të të miturit; 7) duke kufizuar ose duke ndaluar të paditurin/ën (dhunuesin/en) të takohet me fëmijën e viktimës sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme; 8) duke i ndaluar të paditurit/ët (dhunuesit/es) hyrjen ose qëndrimin në banesën e përkohshme a të përhershme të viktimës, ose në ndonjë pjesë të saj, pavarësisht nga të drejtat e pronësisë apo të posedimit të dhunuesit; 9) duke urdhëruar një person të autorizuar nga gjykata (punonjës i rendit ose përmbartues gjyqësor) që të shoqërojë viktimën ose të paditurin/ën (dhunuesin/en) deri në banesën e viktimës dhe të mbikëqyrë largimin e pasurisë personale; duke urdhëruar organet zbatuese të ligjit që të konfiskojnë çdo armë që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo të urdhërojë dhunuesin për të dorëzuar çdo armë që i përket atij; 10) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të lejojë viktimën të posedojë banesën të cilën e përdorin së bashku viktimat dhe dhunuesi/ja ose ndonjë pjesë të saj; 11) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të paguajë qeranë e banesës së përhershme apo të përkohshme të viktimës si dhe detyrimin ushqimor për viktimën, fëmijët apo pjesëtarë të tjerë të familjes që ka në ngarkim; 12) për sa kohë urdhri mbrojtës do të jetë në fuqi, trajtimi i pasurisë do të kryhet në përputhje me Kodin e Familjes; 13) duke i kaluar viktimës të drejtën e kujdestarisë së përkohshme mbi fëmijët dhe duke i hequr përkohësisht përgjegjësinë prindërore të paditurin/ën (dhunuesin/en); 14) duke vendosur dhe duke urdhëruar sipas rastit (në kompetencë të gjykatës) ndërhyrjen e shërbimeve sociale, publike apo private të vendbanimit apo pranë organizatave që kanë si qëllim mbështetjen dhe pritjen e personave të dhunuar në familje. 15) duke urdhëruar të paditurin/ën (dhunuesin/en) që të bëjë një pagesë periodike në favor të personave bashkëjetues, të cilët për efekt të masës së mësipërme, mbeten të privuar nga mjetet e jetesës. Për të siguruar pagesën gjykata mund të vendosë që shuma të derdhet nga punëdhënësi në favor të përfituesit. Një vendim i tillë përbën titull ekzekutiv.

308. Gjatë vitit 2008, nga strukturat e policisë, janë ndjekur me kërkesëpadi “Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhrit të Mbrojtjes” “377 raste”. Pothuajse në të gjitha këto raste, viktimave u është garantuar mbrojtja e nevojshme. Ky proces është zbatuar në mënyrë më efektive nga Drejtoritë e Policisë së Qarkut Tiranë dhe Durrës, ku dhe rastet e denoncimeve kanë qenë më të mëdha. Për shkak të numrit më të madh të banorëve, këto dy qarqe kanë numrin më të lartë të denoncimeve për dhunë në familje, por edhe për shkak të shkallës më të lartë të ndërgjegjësimit të komunitetit të këtyre zonave lidhur me këtë fenomen, si dhe efektit të fushatave sensibilizuese.

309. Braktisja e fëmijës. Kodi i Familjes ka parashikuar edhe rastet kur gjykata e rrethit mund të deklarojë të braktisur të miturin konkretisht: 1) kur i mituri ndodhet pranë një institucioni të përkujdesjes sociale, publik ose privat, ose të personit që e ka në përkujdesje, kur prindërit e tij, në mënyrë të dukshme, nuk janë interesuar për të gjatë një viti, përpara paraqitjes së kërkesës për deklarimin e braktisjes. 2) kur i mituri ka qenë i strehuar që nga lindja e tij në një institucion, afati prej 1 viti kufizohet në 3 muaj. Në rastet e mësipërme në Kod parashikohet se konsiderohen në mënyrë të dukshme të paineduar për fëmijën prindërit që vullnetarisht nuk kanë mbajtur marrëdhënie të përzemërta të nevojshme për rritjen e tij dhe që kanë treguar pakujdesi të rëndë në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore. Në këto raste gjykata i kërkon personit që ka paraqitur kërkesën, shpjegime nëse ka bërë përpjekje për gjetjen e prindërve biologjikë të fëmijës dhe kthimin

e fëmijës në familjen biologjike, nëse kjo është e mundur. Në nenin 251 të Kodit parashikohet se kërkesa për deklarimin e braktisjes bëhet nga: 1) drejtuesi i institucionit ku ndodhet fëmija ose; 2) personi që e ka në përkujdesje. Kërkesa i dërgohet gjykatës, nën juridiksionin e së cilës ndodhet institucioni ose vendbanimi i personit që e ka marrë në përkujdesje të miturit. Çdo person që ka një interes të ligjshëm për mbrojtjen e fëmijës, mund të ndërhyjë në procesin e gjykimit (duke përfshirë edhe prokurorin), të cilët kanë të drejtë të bëjnë ankim kundër vendimit të gjykatës.

310. Gjithashtu, neni 124 i Kodit Penal parashikon si vepër penale braktisjen e fëmijës konkretisht: “Braktisja e fëmijës nën moshën 16 vjeç nga prindi ose personi që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet. Kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e fëmijës, dënohet me burgim nga 3 -10 vjet”.

311. Ligji nr.9952, datë 14.07.2008 “Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS”, parashikon ndër të tjera rregullat për mbështetjen e personave që jetojnë me HIV/AIDS. Në nenin 9 të këtij ligji përcaktohen si akte të ndaluara: 1) braktisja nga prindërit e fëmijës së mitur, të infektuar me HIV; 2) braktisja nga kujdestari ligjor i fëmijës nën kujdestari, të infektuar me HIV.

312. Akte nënligjore lidhur me dhunën në familje. Në zbatim të këtij ligji, gjatë vitit 2008, nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit u përgatitën dhe u miratuan aktet nënligjore të mëposhtme: 1) Urdhri Nr.379, dt.3.3.2008, “Për masat që do të merren nga Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje”. 2) Urdhri nr.981, datë 31.10.2008 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë “Për masat që do të merren nga Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, trajtimin e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare”. 3) Manual i Departamentit për Hetimin e Krimeve dhe Departamentit të Rendit dhe Sigurisë Publike “Mbi procedurat standarde që duhet të zbatohet punonjësi i Policisë së Shtetit, në marrjen e masave për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e kujdesin për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare”. Këto dokumenta janë vënë në dispozicion të strukturave vendore të policisë, dhe janë marrë të gjitha masat për zbatimin e tyre. Me Urdhër Ministrit të Brendshëm, janë miratuar formularët statistikorë që pasqyrojnë të dhënat e rasteve të dhunës në ambientet familjare. Ky formular statistikor, në mënyrë periodike dërgohet pranë MPC&SHB, si autoritet kryesor përgjegjës në zbatim të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

313. Përveç ngritjes së strukturave të vecanta policore në nivel qendror dhe vendor për mbrojtjen e të miturve dhe dhunës në familje, viktimave të dhunës në familje, që janë kryesisht gra dhe fëmijë, u është garantuar mbrojtja konform këtij ligji.

314. Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë janë miratuar: 1) Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr.13, datë 23.01.2008 “Për pajisjen e personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare me raportin mjekësor përkatës”. 2) Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr.14, datë 23.01.2008 “Për evidentimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, në regjistrin dhe kartelën individuale për viktimat e dhunës në familje”. 3) Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr.15, datë 24.01.2008 “Për trajtimin mjekësor në institucionet shëndetësore publike të personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare”, që ka si qëllim ofrimin e shërbimit mjekësor dhe psikologjik për personat e dhunuar në familje. Në zbatim të ligjit të mësipërm janë përgatitur nga MSH-së: 1) Protokollet për depistimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. 2) Kartela klinike individuale për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. 3) Model raporti i posaçëm për pacientët që kanë pësuar dhunë në marrëdhëniet familjare. 4) Fletë Konsensusi i Pacientit për egzaminimin/këshillimin/trajtimin mjekësor, (për pacientin që ka pësuar dhunë në marrëdhëniet familjare. 5) Regjistri kombëtar i shëndetësisë, për regjistrimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare nga punonjësit e kujdesit shëndetësor. Ky set materialesh është shpërndarë në të gjitha institucionet shëndetësore publike

(Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, Maternitetet e Tiranës, në Drejtoritë e Shëndetit Publik dhe Drejtoritë Spitalore të rretheve). Në të gjitha rrethet janë ngritur ekipet përgjegjëse për rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare të përbërë nga mjek, infermier dhe punonjës social ose psikolog (nëse ata kanë në strukturë). MSH-së në bashkëpunim me UNICEF-in, UNFPA- në dhe Shoqatën Kombëtare të Punonjësve Sociale kanë trajnuar gjatë viteve 2007-2008, rreth 500 punonjës shëndetësorë (mjek të familjes, pediatër, obstetër– gjinekolog dhe infermierë) për problemet e dhunës me bazë gjinore. Ka filluar edhe raportimi për herë të parë për rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe për vitin 2008 raportohen rreth 95 raste të paraqitura në institucionet shëndetësore publike (spitale dhe qendra shëndetësore). Gjithashtu po shikohet mundësia për përfshirjen në shërbimet shëndetësore, shërbimin psikosocial, si një mbështetje psikoemocionale edhe për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

315. Në nëntor 2008 është miratuar Marrëveshja e Bashkëpunimit midis autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje krijohet mekanizmi i bashkërendimit dhe koordinimit të përgjegjësive të të gjitha institucioneve përgjegjëse.

316. Një hap tjetër i rëndësishëm për zbatimin e këtij ligji, është organizimi i vazhdueshëm i trajnimeve për punonjësit, të cilët ndeshen me rastet specifike të dhunës në familje.

Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta në MPÇSSHB në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare si UNDP, UNFPA, OSBE, ka organizuar një cikël trajnimesh për punonjësit e policisë, punonjësve të shëndetësisë si dhe punonjësit të shërbimeve sociale. Qëllimi i organizimit të këtyre trajnimeve, në të cilat kanë marrë pjesë rreth 720 punonjës të institucioneve të ndryshme, ka qenë forcimi i kapaciteteve të strukturave të cilat ofrojnë shërbime mbrojtëse e mbështetëse për viktimat e dhunës në familje.

Gjatë vitit 2008 është realizuar trajnimi i punonjësve të Policisë, shëndetësisë, shërbimeve sociale, etj, lidhur me parandalimin e dhunës në familje, trajnime që do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

317. Trajnimi i strukturave të Policisë që trajtojnë rastet e dhunës në familje. Për t'i paraprirë miratimit të ligjit të ri për dhunën në familje, ka patur disa përpjekje, kryesisht me nxitjen e donatorëve të huaj për trajnimin e strukturave të zbatimit të ligjit. Konkretisht, Women's Legal Rights Initiative/ USAID ka realizuar 3 seminare/takime në vitet 2005, 2006 me profesionistë të fushave të ndryshme që do të duhet t'u përgjigjen rasteve të dhunës në familje. Në muajin nëntor 2006, Qendra “Të drejtat e njeriut në Demokraci” nisi zbatimin e projektit “Trajnimi i efektivave të policisë mbi dhunën në marrëdhëniet familjare”, zbatimi i të cilit përkoi dhe me miratimin e ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, projekt që është zbatuar në të gjitha Komisaritet e Policisë së Qarkut Tiranë (Gjashtë Komisaritet e Policisë Tiranë dhe Kavajë).

Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me OSBE-në dhe Këshillin e Evropës gjatë vitit 2007, zhvilluan një cikël trajnimesh “Mbi zhvillimet e reja legjislative në fushën e dhunës në familje, roli i gjyqtarëve, prokurorëve dhe policisë”. Me idenë e krijimit të Skuadrave të Mbrojtjes së viktimave të dhunës familjare, në këto kurse u trajnuan gjyqtarë, prokurorë dhe punonjës policie.

Në shtator 2007, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, realizoi me punonjës policie të niveleve të ndryshme një Trajnim të Trajnuesve, lidhur me “Rolin e Policisë për rastet e dhunës familjare”. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, gjatë vitit 2007, ka përgatitur dhe botuar manualin “Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje”. Ky dokument është vënë në dispozicion të strukturave të policisë, me qëllim të shpjegojë mënyrat e kërkimit dhe ofrimit të mbrojtjes viktimave të dhunës familjare.

318. Departamenti për trajnimin Policor në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ka miratuar zhvillimin e një cikli trajnimesh me struktura të policise vendore lidhur me rolin e policisë në trajtimin e dhunës në familje. Ky program trajnues është zbatuar gjatë periudhës qershor – tetor

2008. Në partneritet me PNUD-in, gjatë vitit 2008, u zhvilluan aktivitete trajnuese me struktura të policisë së të gjitha niveleve, në të gjitha Drejtoritë e Policisë në Qarqe, ku u trajnuan 690 punonjës policie. Duke vlerësuar impaktin pozitiv të fushatave sensibilizuese ndaj këtij fenomeni, personeli i strukturave të Policisë së Shtetit është përfshirë në të gjitha aktivitetet shtetërore dhe të shoqërisë civile, të organizuara për këtë qëllim.

319. Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare të Punonjësve Social po vazhdon trajnimin e punonjësve të shëndetësisë (mjek dhe infermier të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor) mbi dhunën me bazë gjinore, abuzimin seksual, ku vëmendje u kushtohet edhe grupit target të vajzave dhe fëmijëve. Gjatë fazës së parë janë trajnuar 160 personel shëndetësor përkatësisht në rrethet Tiranë, Vlorë, Shkodër, Peshkopi dhe Pogradec. Faza e dytë e trajnimeve vazhdon në rrethet Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë dhe Kukës. Gjatë kësaj faze është parashikuar të trajnohen rreth 400 punonjës të shëndetësisë për dhunën me bazë gjinore.

Neni 20. Fëmijët e privuar nga mjedisi familjar.

320. Kodi i Familjes përcakton se në rast se gjykata arrin në konkluzionin se fëmija, përkohësisht, duhet t'i besohet një personi të tretë ose një familjeje kujdestare, duhet të marrë mendimin e sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale pranë bashkisë së vendit ku zhvillohet gjykimi.

321. Strategjia për Shërbimin e Kujdestarisë (foster care) për fëmijët në nevojë (miratuar me VKM nr. 1104, datë 30.7.2008) parashikon kujdestarinë si shërbim alternativ, i cili bazohet në procesin e decentralizimit dhe ngritjen e shërbimeve komunitare, ku fëmija mbështetet dhe ndihmohet në një mjedis familjar, i cili garanton një cilësi më të lartë shërbimesh dhe të drejtat themelore që burojnë nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve. Në dokument janë përcaktuar fazat për zbatimin e shërbimit të kujdestarisë si: përmirësimi i legjislacionit, ngritja e kapaciteteve të strukturave zbatuese, fushata publicitare, përzgjedhja e familjeve kujdestare, vlerësimi i fëmijëve, monitorimi etj.

322. Përfituesit e Shërbimit të Kujdestarisë: fëmijët të cilët ndodhen në vështirësi: 1) Fëmijë të braktisur nga prindërit biologjikë që në lindje. 2) Fëmijë të cilët janë apo mund të jenë në risk për t'u kthyer në viktime të abuzimit fizik, emocional, seksual, neglizhimit, shfrytëzimit nga personatë ngarkuar me përgjegjësi për kujdesin ndaj tyre. 3) Fëmijë, prindërit e të cilëve e kanë të pamundur të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore. 4) Fëmijë të cilët janë vendosur në institucione. 5) Fëmijë, prindërit (njëri/të dy) e të cilëve janë të dënuar me burgim;

323. Shërbimi i kujdestarisë do të pilotohet fillimisht në 2 qytetet më të medha të Shqipërisë në Tiranë dhe në Shkodër, në periudhën 2009-2010. Nga pilotimi priten të përfitojnë 80 fëmijë në nevojë që do të do të vendosen në familjet kujdestare nga këto: 40 fëmijë në Tiranë; 10 fëmijë me aftësi të kufizuar në Tiranë; 30 fëmijë në Shkodër.

Do të trainohen 24 ekspertë në Tiranë dhe 12 në Shkodër. Pjesëmarrësit në trajnim: Punonjës nga Administrata publike, bashkitë/komunat; Punonjës nga administrata e zyrave rajonale të SHSSH; Ekspertë nga OJF që ofrojnë shërbime sociale; Juristë të pavarur për të vlerësuar regjimin juridik të rasteve; Grupet multidisiplinare të kujdestarisë që do të vlerësojnë rastet në Seksionet e Ndihmës ekonomike dhe Shërbimeve Sociale në Bashki/Komunë. Gjykatat. Pas vlerësimit të ecurisë së pilotimit do të shikohet mundësia e shtrirjes së shërbimit në të gjithë vendin.

324. Aktualisht ka filluar puna për përmirësimin e kuadrit ligjor që rregullon ofrimin e shërbimit të ri. Në projektligjin për ndryshimin e ligjit "Për ndihmën dhe shërbimet Shoqërore" theksohet se në nenin 15 shtohen pikat 3, 4 dhe 5 të cilat mbështesin me fonde kategorinë e fëmijëve që do të vendosen në kujdestari: "Procedura e sistemimit të fëmijës në familje kujdestare, organizohet dhe

mbikqyret nga organet e qeverisjes vendore, të cilat ngrenë pranë tyre komisionet multidisiplinare për vlerësimin paraprak të rasteve. Organizimi dhe funksionimi i komisioneve multidisiplinare, përcaktohet në rregulloren e miratuar nga organet e qeverisjes vendore. Kriteret, dokumentacioni, procedura dhe masën e financimit të shërbimit të kujdestarisë përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nxjerr udhëzim për procedurat dhe zbatimin e standarteve të shërbimeve.”

Janë hartuar dhe do të shkojnë për diskutim në KM: 1) Projekt VKM për dokumentacionin dhe masa e përfitimit të familjes kujdestare: Në këtë projektvendim përcaktohen kriteret e vlerësimit të familjes kujdestare, procedurat e përzgjedhjes së familjeve kujdestare, vlerësimi i fëmijës, masa e financimit të këtij shërbimi, etj. 2) Projekt VKM për Standartet e shërbimit të kujdestarisë.

325. Standartet e Shërbimit të Kujdestarisë synojnë që të sigurojnë dhe të përmirësojnë gjendjen dhe zhvillimin e mundësive për fëmijët dhe të rinjtë në përkujdesjen jashtë shtëpisë. Drafti përbëhet nga 23 standarde që janë të organizuar në bazë të tri seksioneve: Fëmijët dhe të rinjtë, Prindërit kujdestarë, Institucionet dhe strukturat e përfshira në shërbimin e kujdestarisë;

326. Në shtator 2009, me mbështetjen e UNICEF do të fillojë trajnimi i familjeve kujdestare dhe strukturave shtetërore në Tiranë dhe Shkodër. Është përgatitur manuali i trainimeve nga Shoqata Bethani.

327. Buxheti për fazën e pilotimit në rrethet Tiranë dhe Shkodër, llogaritet rreth 10 milion lekë çdo vit. Më pas zgjerimi i këtij shërbimi do të kërkojë kosto të tjera shtese. Masa për çdo person të vendosur në kujdestari është llogaritur 3-USD në ditë ose 50 % më shumë se vija e varfërisë.

Neni 21. Birësimi

328. Dispozitat e legjislacionit shqiptar, në mbështetje të të cilave funksionon Komiteti Shqiptar i Birësimeve, synojnë të realizojnë një proces birësimi efektiv në interesin më të lartë të fëmijës, duke u siguruar në këtë mënyrë fëmijve që janë të privuar nga mjedisi familjar, një familje alternative me të drejta dhe detyrime të njëjta si prindërit biologjikë. Miratimi i Kodit të ri të Familjes në vitin 2003 solli dosmosdoshmërinë e ndryshimit të ligjit 7650 datë 19. 12. 1992 “Për birësimin e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes”. Ligji i ri nr. 9695 datë 19. 03. 2007 “ Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit “ solli shumë avantazhe në drejtim të procedurave të birësimit, pasi rregulloi dhe specifikoi problematikat e shfaqura nga zbatimi i ligjit të mëparshëm. Ky ligj trajton procedurat e birësimit në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, si dhe detajon përmbajtjen e dokumentacionit. Ligji i jep të drejtën Komitetit Shqiptar të Birësimeve për të përzgjedhur e licensuar agjensinë ndërmjetësuese në fushën e birësimit. Miratimi i ligjit zhvillon marrëdhëniet ndërinstitucionale, ofron procedura lehtësuese për realizimin e birësimit nga organet kompetente dhe krijoi një sistem kontrollues mbi situatën e fëmijve dhe mbrojtjen e tyre nga fenomene që paraqesin rrezikshmëri për të ardhmen e tyre.

329. Aktualisht Komiteti Shqiptar i Birësimit në mbështetje të Konventës së Hagës ka kryer dhe kryen procedurat e birësimit, të cilat kanë rezultuar efektive në funksionim, të shpejta në kohë dhe transparente. Në lidhje me sanksionet civile dhe penale të parashikuara në legjislacionin shqiptar në fushën e birësimeve, në referim të Konventës së Hagës, Kodi i Familjes parashikon rastet kur personi nuk mund të birësojë: 1) kur i është hequr nga gjykata përgjegjësia prindërore; 2) kur vuan nga një sëmundje psikike ose ka zhvillim mendor të metë; 3) si dhe vuan nga një sëmundje, e cila mund të verë në rrezik shëndetin dhe jetën e atij që do të birësohet; 4) nuk ka garancinë si person, se

do të kryejë në rregull detyrën e birësuesit në lidhje me mirërritjen, edukimin dhe arsimimin e atij që do të birësohet.

Sipas Kodit, për birësimin e të miturit kërkohet pëlqimi i të dy prindërve të tij. Pëlqimi i prindit tjetër është i mjaftueshëm, në qoftë se njëri nga të dy prindërit: a) ka vdekur; b) nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e tij; ose i është hequr përgjegjësia prindërore.

330. Gjykata vendos nëse fëmija do të birësohet kur: 1) fëmijës i kanë vdekur të dy prindërit; 2) Prindërve u është hequr zotësia për të vepruar; 3) ose janë të panjohur.

Kur birësuesi është i martuar, duhet të merret pëlqimi i bashkëshortit të tij. Kur i birësuarit ka mbushur moshën 10 vjeç merret mendimi i tij dhe në moshën 12 vjeç kërkohet pëlqimi i tij.

331. Kodi i Familjes parashikon edhe marrëdhëniet që ndërtohen ndërmjet ndërmjet birësuesit dhe gjinisë së tij, nga njëra anë, dhe të birësuarit dhe të paslindurve të tij, nga ana tjetër. Në këto marrëdhënie lindin të drejta dhe detyra të njëjta me ato që kanë ndërmjet tyre personat që janë gjini. Të drejtat dhe detyrat ndërmjet të birësuarit dhe të paslindurve të birësuesit, nga njëra anë, dhe të gjinisë së tij, nga ana tjetër, pushojnë. Gjithashtu, në rastin kur njëri nga prindërit e të birësuarit është bashkëshort i birësuesit, i birësuarit nuk i shkapet lidhjet me këtë prind dhe gjininë e tij.

332. Me ligjin nr. 9086, datë 19.06.2003 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Kodin Penal”, është shtuar një dispozitë (neni 124/a) “kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit”, i cili parashikon shprehimisht se “kërkimi, propozimi, dhënia ose pranimi i shpërblimeve dhe përfitimeve të tjara për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me procesin e birësimit të një të mituri, dënohen me burgim deri në 7 vjet dhe me gjobë nga 300 mijë lekë deri në 3 milionë lekë”.

333. Në lidhje me zbatimin e nenit 21 janë hasur vështirësi pasi ka mungesa të strukturave psiko-sociale në nivel rajonal për të bashkëpunuar me Komitetin Shqiptar të Birësimeve në drejtim të përzgjedhjes së aplikantëve, si dhe dhënies së informacionit mbi fëmijët e birësuar.

Neni 27/4. Mbulimi i shpenzimeve për mbajtjen e fëmijës

334. Në lidhje me “detyrimin për ushqimin”, në Kod parashikohet se detyrimin për ushqim e kanë prindërit ndaj fëmijëve të tyre. Gjithashtu, Kodi parashikon se prindërit nuk shkarkohen nga detyrimi për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, edhe sikur t'u jetë hequr përgjegjësia prindërore.

Në nenin 154 të Kodit të familjes parashikohet se zgjidhja e martesës nuk prek të drejtat dhe detyrimet që kanë prindit ndaj fëmijëve të tyre, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ky Kod. Në nenin 197 të KF parashikohet se prindërit kanë detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, kur këta nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar. Një fëmijë i mitur mund t'u kërkojë prindërve të tij detyrimin për ushqim edhe kur ka pasuri, kur të ardhurat nga pasuria dhe nga puna e tij nuk i përmbushin nevojat e tij. Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhorë ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën 25 vjeç. Neni 161 parashikon se në vendimin e zgjedhjes së martesës caktohet edhe kontributi për detyrimin ushqimor dhe për ish bashkëshortin, sipas parashikimeve lidhur me detyrimin për ushqim në këtë Kod.

VI. Kujdesi bazë dhe mirëqenia (nenet 6,18 paragrafi 3, 23,24,26 dhe 27 paragrafët 1-3)

a) Follow-up. Masat e ndërmarra për zbatimin e Vëzhgimeve Përfundimtare.

Fëmijët me aftësi (neni 23). Rekomandimi 53/a -Vëzhgimet Përfundimtare

334. Kushtetuta dhe legjislacioni shqiptar garanton të drejtat dhe liritë themelore të personave me aftësi të kufizuara. Kuadri ligjor për përmirësimin e statusit shoqëror dhe ekonomik, i cili ka si qëllim të ofrojë garantimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara, është duke u përmirësuar gradualisht. Ligji nr. 8092, dt. 21.03.1996 “Për shëndetin mendor”, mbron personat me aftësi të kufizuara mendore.

Në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, parashikohen masa për të siguruar ndihmë dhe shërbime shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore, përfshirë edhe fëmijët. Personat me aftësi të kufizuara mbështeten nga: 1) Programi për pagesën e personave me aftësi të kufizuar. 2) Programi i ofrimit të shërbimeve shoqërore për individët në nevojë.

335. Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara (e miratuar me VKM në janar 2005) ka si objektiv vendosjen e bazave për përmirësimin e jetës së personave me aftësi të kufizuara në fushën e kujdesit social, mjekësor, arsimit, kulturës, sportit, punësimit, informimit, transportit, si dhe përfaqësimit dhe pjesëmarrjes në jetën publike. Kjo strategji ka si qëllim të sigurojë një përmirësim të dukshëm në statusin dhe cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara në RSh-së, në përputhje me Standardet e OKB-së mbi Mundësitë e Barabarta. Një ndër parimet e Strategjisë për PAK është parimi i identifikimit dhe trajtimit të hershëm, i cili ka të bëjë me një numër masash që ndërmerren për të evituar sa të jetë e mundur shfaqjen e aftësisë së kufizuar dhe sëmundjeve kronike në të gjitha grupmoshat dhe në të gjitha fushat e jetës. Ky parim përfshin parandalimin e aftësisë së kufizuar përgjatë fëmijërisë së hershme, nëpërmjet masave si imunizimi etj dhe gjithashtu thekson faktin që sa më herët të identifikohet në fëmijëri një parregullsi, aq më i mirë dhe i shpejtë do të jetë parandalimi i aftësisë së kufizuar ose trajtimi i suksesshëm i saj. Parimi i rehabilitimit qëndron në bazë të procesit, i cili u siguron personave me aftësi të kufizuara mjetet dhe rrugët për një jetesë të pavarur. Ai ka të bëjë me masat që merren për parandalimin, mënjanimin, lehtësimin apo kompensimin e një aftësie të kufizuar, për parandalimin e përkeqësimit e saj, për nevojën për një kujdes afatgjatë dhe mundësimin e jetës normale për personat me aftësi të kufizuara. Parimi i qëllimshmërisë parashikon ndihmën që duhet t’i ofrohet çdo personi me aftësi të kufizuar. Plani i veprimit të Strategjisë për PAK është një instrument i dobishëm për planifikimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë në vazhdimësi. Në masat konkrete në këtë plan evidentojmë: 1) Parandalimi i Aftësisë të Kufizuar, në faza sa më të hershme, nëpërmjet diagnostikimit të hershëm, trajtimit të çrregullimeve emocionale dhe të sjelljes së fëmijëve 0-6 vjeç (debistimit). 2) Sigurimi dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe të përkujdesjes shoqërore në institucionet përkatëse publike e private i shërbimeve për PAK, në përputhje me grupmoshat dhe nevojat për rehabilitim dhe integrim. 3) Shpërndarja e shërbimeve nën kujdesin e njësisë të qeverisjes vendore, sipas ligjit të organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore, politikave sociale dhe nevojave të PAK. 4) Sigurimi i mundësisë së arsimit për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara duke i dhënë prioritet arsimit gjithpërfshirës. 5) Përmirësimi dhe modernizimi i procesit mësimor edukativ në shkollat speciale. 6) Krijimi dhe shtrirja graduale e shkollave e kopshteve të integruara. 7) Krijimi dhe shtrirja graduale e shërbimeve psikopedagogjike dhe psikosociale në shkollat e integruara dhe në kopshtet. 8) Sigurimi i mbështetjes për tërheqjen e PAK në veprimtaritë kulturore e sportive dhe lehtësimi i pjesëmarrjes së tyre në veprimtari të ndryshme.

336. Në kuadër të programeve të përkujdesjes shoqërore, të MPÇSSHB, të financuara nga buxheti i shtetit, fëmijët me aftësi të kufizuar mbështeten me pagesë në kesh dhe trajtohen në 6 qendra rezidenciale zhvillimi, në Tiranë, Durrës, Korçë, Berat, Vlorë e Shkodër, si dhe në 2 qendra ditore në Korçë, Lezhë. Në kuadrin e decentralizimit, kanë kaluar në varësi të njësisë vendore 5 qendra

rezidenciale dhe dy ditore për personat me aftësi të kufizuara. Qendra e Zhvillimit Durrës, nuk është transferuar pasi do të mbetet në nivel kombëtar.

337. Me miratimin e VKM nr. 618 dt 7.09.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara” është rritur masa e përfitimit për personat me aftësisë së kufizuar dhe masa e pagesës së kujdestarit të personit me aftësi të kufizuar.

Në dhjetor 2007, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në bashkëpunim me Drejtorinë e Sigurimeve Shoqërore dhe Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza (me të gjitha departamentet sipas nozologjive), rivlerësuan listën e sëmundjeve për vlerësimin e gjendjes së aftësisë së kufizuar, që përdoret nga Komisioni Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë. Në këtë listë janë përfshirë disa sëmundje të moshës femërore duke i dhënë mundësi më shumë fëmijëve me aftësi të kufizuar për të përfituar nga skemat e mbrojtjes sociale, duke plotësuar më mirë nevojat e tyre për pagesa dhe shërbime.

338. Me mbështetjen e Projektit të financuar nga Banka Botërore, “Shpërndarja e shërbimeve sociale në komunitet”, që nga viti 2006 janë ngritur 11 shërbime të reja për PAK në formën e shërbimeve komunitare. Në vitin 2007 u ngritën dhe filluan të funksionojnë 9 shërbime për PAK: 1) Bibliotekë audio për të verbërit, Durrës; 2) Qendër polifunksionale, Elbasan; 3) Qendër ditore për zhvillimin dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuar në qytetet Prrenjas, Librazhd; 4) Qendër shërbimesh e kujdesit paliativ në qytetin e Gjirokastrës; Qendër komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuar, Tiranë; 5) Qendër e shërbimeve psikosociale për njerëz në nevojë, “Mos vuaj në heshtje” në Tiranë; 6) Qendër ditore për PAK, Shtëpia e Përbashkët, Tiranë; 7) Qendër sociale për PAK në nevojë, Shkodër; 8) Qendër e mbështetjes sociale, në qytetin e Pukës. Me përfundimin e këtij projekti, këto qendra do të administroheshin nga njësitë e qeverisjes vendore. Aktualisht po punohet për lehtësimin e kalimit dhe sigurimit të vazhdimësisë së këtyre shërbimeve të reja.

339. Gjatë vitit 2007 është përmirësuar rregullorja e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, duke përfshirë disa sëmundje të moshës femërore dhe personat që kanë dëmtim ose humbje të anësive të sipërme dhe të poshtme, të cilët nuk përfitonin pagesë për aftësinë e kufizuar. Këto ndryshime të rregullores kanë afruar më shumë fëmijë e persona me aftësi të kufizuar që kanë nevojë për mbështetje në skemat sociale, duke plotësuar më mirë nevojat e tyre për pagesa dhe shërbime.

340. MPCSSHB bashkëpunon me donatorë dhe OJF për ngritjen e shërbimeve komunitare për fëmijët me aftësi të kuafizuar. Në Shkodër është bashkëpunuar me Shoqatën “Projekti Shpresa”, e cila ka ngritur 6 shtëpi familje me 54 fëmijë me aftësi të kufizuar, të cilët janë marrë nga Qendra e Zhvillimit Shkodër dhe Shtëpitë e Fëmijëve. Në bazë të një marrëveshjeje me Kooperacionin Zviceran, nga Projekti “Lira”, në Berat është ngritur një qendër ditore për PAK, atelie pune, si dhe apartamente të mbrojtura për nxitjen e jetës së pavarur.

341. Në kuadër të bashkëpunimit financiar dhe teknik të Qeverisë shqiptare me Gjermaninë, është realizuar gjatë vitit 2007 projekti për mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar. Ky projekt kishte si qëllim përmirësimin e koncepteve të trajtimit dhe shërbimet për kujdesin ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuar fizike dhe/ose mendore në përputhje me standardet evropiane. Duke marrë në konsideratë vlerësimet pozitive të shprehura nga donatori ekzistojnë të gjitha mundësitë që projekti të vazhdojë në të ardhmen.

Fëmijët me paftësi (neni 23). Rekomandimi 53/b

342. Lidhur me rekomandimin 53/b për arsimimin e fëmijëve me aftësi, një ndër objektivat e SPAK është sigurimi i arsimit optimal për personat me aftësi të kufizuara. Ky objektivi ka si qëllim: 1) Të sigurohet që asnjë fëmijë të mos i mohohet e drejta për shkollë për arsye të aftësisë së kufizuar. 2) Të mbështetet zhvillimi i komunikimit efikas duke krijuar mundësinë për arsimim në gjuhën e shenjave në shqip, teknologjitë e komunikimit dhe mjetet ndihmëse të komunikimit. 3) Të mundësohet që mësuesit dhe edukatorët e tjerë të kuptojnë nevojat e mësimit nga studentët me aftësi të kufizuar. 4) Të sigurohet që studentët me aftësi të kufizuara, familjet, mësuesit dhe edukatorët e tyre të kenë qasje të mjaftueshme në burimet e disponueshme në mënyrë që të mund të plotësojnë nevojat e tyre. 5) Të përmirësohet përgjegjësia e shkollimit të nxënësve me aftësi të kufizuara, të përmbushet detyrimi që ata kanë për nevojat e studentëve me aftësi të kufizuar. 6) Të promovohet krijimi i një mjedisi arsimor të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës në mënyrë që të plotësohen nevojat për arsimimin e personave me aftësi të kufizuar.

343. Një problem kritik i një rëndësie të veçantë vazhdon të konsiderohet sigurimi i arsimit optimal për fëmijët me aftësi të kufizuara duke i dhënë prioritet arsimit gjithëpërfshirës. Ligji “Për sistemin arsimor parauniversitar” parashikon hapjen e shkollave ose klasave të posaçme si dhe kualifikimin e personelit për të punuar me persona me aftësi të kufizuara. Në këtë linjë, në Vlorë u hap një degë e posaçme për kualifikimin e personelit arsimor të specializuar. Personat me aftësi të kufizuara mund të studiojnë në shkolla normale, në klasa të posaçme pranë shkollave normale apo në shkolla të posaçme publike.

Institucionet speciale kombëtare përmbushin 80% të nevojave për këtë lloj shkollimi dhe në rrethe 2% për shkollim ditor. Arsimitimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet arsimore publike është falas, nëse kjo është dëshira e prindërve dhe zgjedhja e duhur profesionale. Shteti ndërmerr masa për të garantuar kushtet e domosdoshme për integrimin gradual e fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkolla normale.

Ekzistojnë dy institucione kryesore që mbulojnë nevojat e fëmijëve me humbje të shikimit dhe dëgjimit, që përmbushin afërsisht 80-90% të kërkesës. Institucionet e tjera të specializuara, ato mbulojnë më pak se 2% të kërkesave për trajtim. Për trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, funksionojnë dy shkolla kombëtare, në Tiranë, të cilat ofrojnë dhe shërbimin e konviktit. Frekuentimi i këtyre institucioneve është tërësisht falas, ku përfshihen fjetja, ushqimi, veshmbathja, librat dhe materialet mësimore didaktike. Krahas shkollave speciale dhe qendrave ditore, fëmijët me aftësi të kufizuar përfshihen në klasat normale. Në zbatim të Strategjisë së Personave me Aftësi të Kufizuar, dhe në mbështetje të një prej objektivave të saj që ka të bëjë me gjithëpërfshirjen, vitet e fundit është punuar për ngritjen e kopshteve dhe shkollave pilot për gjithëpërfshirjen. Ky projekt financohet nga Save the Children dhe zbatohet në bashkëpunim me MASH në 6 qarqe të vendit, pikërisht në Tiranë, Gramsh, Berat, Gjirokastrë, Vlorë, Korçë. Përvoja e mirë e krijuar në këto shkolla pilot është një sistem referimi për organizimin e punës dhe në shkollat e tjera.

344. Gjatë këtij vitit shkollor kanë funksionuar 21 kopshte dhe 25 shkolla të integruara për fëmijët me aftësi të kufizuar në Tiranë, Elbasan dhe Berat. Është punuar për përmirësimin cilësor të shkollave speciale dhe kthimin e tyre në qendra burimore për trajnimin e mësuesve të shkollave 9-vjeçare që kanë në klasat e tyre fëmijë me aftësi të kufizuar. Bazuar në rezultatet pozitive të këtij projekti, MASH në bashkëpunim me Save the Children dhe Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, ka shtrirë më tej projektin e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në 10 kopshte, 12 shkolla edhe në DAR të reja (Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë, Korçë).

345. Duke filluar nga viti 2006 dhe në vijim MASH ka ndërmarrë një sërë masash për realizimin e dy objektivave kryesore të Strategjisë të Personave me Aftësi të Kufizuara: 1. shtrirja graduale e

arsimit gjithëpërfshirës; 2. përmirësimi i shkollave speciale dhe kthimi i tyre edhe në qendra burimore për arsimin e zakonshëm.

Në trajnimet që MASH, organizon për mësuesit një vend të rëndësishëm zë promovimi i i metodologjive të reja dhe njohja me programet e reja, në arsimin parauniversitar. Këto metodologji favorizojnë krijimin e mjediseve burimore për punë specifike me grupe fëmijësh dhe për rrjedhojë dhe për punën me nxënësit me aftësi të kufizuara, si dhe shërbejnë si modele pozitive edhe për shkollat e tjera. MASH ka hartuar standardet e ndërtimit të shkollave të reja në të cilat përcaktohet dhe përshtatshmëria për nxënësit me aftësi të kufizuara. Edhe në shkollat që restaurohen, pas hartimit të këtyre standardeve, bëhet përshtatshmëria e tyre.

Bazuar në mundësitë dhe aftësitë konkrete të çdo fëmije, MASH mundëson regjistrimin e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat artistike e profesionale pa konkurruar. Aktualisht rreth 18 fëmijë të tillë studiojnë për muzikë. Bazuar në legjislacionin ekzistues, MASH, krijon mundësinë e shkollimit dhe të mbështetjes me bursë të të gjithë nxënësve të evidentuar nga MPÇS&SHB dhe për të cilët kërkohet zyrtarisht mbështetje nga ky institucion. MASH, ka hequr tarifën e shkollimit në arsimin e lartë për nxënësit e verbër, paraplegjikë e tetraplegjikë. Në bashkëpunim të ngushtë me institucione të tjera, MASH ka punur në sensibilizimin e shkollave për të pranuar fëmijë me aftësi të kufizuar në klasa normale. Sidoqoftë, shkollave u mungon infrastruktura bazë dhe vetë mësuesit nuk kanë trajnimin e duhur për të mbështetur këtë proces.

346. MASH në bashkëpunim me Save The Children dhe FSHDP, ka filluar projektin për pilotimin e shkollave dhe kopshteve gjithëpërfshirëse (që kanë të bëjnë me përfshirjen në klasat normale të fëmijëve me aftësi të kufizuar) në Tiranë, Librazhd, Berat, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë.

Rekomandimi 53/c- Burimet profesionale dhe financiare dhe programet e rehabilitimit në komunitet

347. Mbështetja ekonomike e personat me aftësi të kufizuara ka ardhur duke u rritur. Megjithatë, deri tani shërbimet që kanë pasur për qëllim rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara kanë qenë të pamjaftueshme dhe me karakter afatshkurtër. Pavarësisht nga arsyet ekonomike, fondet shtetërore që kanë mbuluar aftësinë e kufizuar kanë qenë modeste. OJF-të janë përpjekur të ofrojnë disa shërbime rehabilituese, si dhe tipologji të reja shërbimesh. Me gjithë përpjekjet e bëra, shërbimet e ofruara janë të shkëputura dhe jo të integruara.

348. Ngritja e kapaciteteve në fushën e aftësisë së kufizuar është pika e mëtejshme kyçe e kësaj strategjie. Njohuritë e punonjësve të administratës shqiptare, lidhur me legjislacionin në fuqi mbi aftësinë e kufizuar janë fragmentare. Nga ana tjetër, edhe në OJF-të të e aftësisë së kufizuar ka mungesa njohurish mbi legjislacionin dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Qeveria Shqiptare është e angazhuar të administrojë në mënyrë aktive çështjen e aftësisë së kufizuar në Shqipëri duke përditësuar gjithmonë e më shumë të drejtat e PAK në politikat e saj sektoriale.

Për arritjen e këtij qëllimi është i nevojshëm realizimi i një sërë trajnimesh dhe shkëmbim përvojash nga praktikantët e mira të punës të vendeve të tjera. Ekziston nevoja e konsultimit me ekspertë nga vendet me përvoja të përparura në fushën e politikave të aftësisë së kufizuar.

Strategjia përcakton nevojën e trajnimit të kujdestarëve të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që të rritet cilësia e shërbimit ndaj tyre.

Projektet e përfshira në planin afatshkurtër i veprimit të kësaj strategjie përfshijnë trajnime për avokatët, gjyqtarët dhe prokurorët lidhur me aspektet ligjore të aftësisë së kufizuar.

349. Në Shqipëri ekziston një kuadër ligjor lidhur me personat me aftësi të kufizuara, i cili rregullon komisionimin dhe legjislacionin mbi pagesat, të drejtat dhe shërbimet e tyre. Megjithatë, analiza e

situatës aktuale ka treguar se legjislacioni ka natyrë fragmentare, gjë që kushtëzon mungesën e njohurive të plota mbi të si në nivel shtetëror, edhe midis vetë personave me aftësi të kufizuara.

350. Identifikimi i aftësisë së kufizuar që në fëmijërinë e hershme mundëson rehabilitim dhe integrim më të shpejtë të fëmijës në jetën sociale. Qendra Kombëtare për Mirërritjen, Zhvillimin dhe Rehabilitimin e Fëmijës (institucion në varësi të MSH-së), nëpërmjet stafit të saj multidisiplinar i përbërë nga pediatër, edukatorë të specializuar, psikologë, psikiatër dhe fizioterapistë, identifikon dhe trajton aftësinë e kufizuar që në fëmijërinë e hershme. Këta profesionistë pasi bëjnë testimin fillestar të fëmijës, hartojnë plane individuale për trajtimin e çdo fëmije. Kjo qendër zhvillon trajnime të herëpashershme të personelit të këshillimoreve të fëmijës.

351. Qendra Kombëtare për Mirërritjen, Zhvillimin dhe Rehabilitimin e Fëmijës ka si detyrë të diagnostikojë dhe trajtojë fëmijët 0-6 vjeç me probleme të zhvillimit; të përpunojë dhe ndjekë zbatimin e programeve trajnuese, të personelit mjekësor dhe atij edukativo-pedagogjik të të gjitha institucioneve shëndetësore për fëmijët në nivel vendi; në bashkëpunim me Departamentin e pediatriisë të Fakultetit të Mjeksisë të sigurojë kushtet për realizimin e praktikave mësimore të studentëve të Fakultetit të Mjeksisë, psikologjisë dhe punës sociale, infermieristikës. Kjo qëndër ofron ekipe multidisiplinore mjek, punonjës social, psikiatër, psikolog, terapistë të folurit, fizioterapistët, edukatorë zhvillimi, infermiere, etj. Sipas të dhënave të kësaj qëndre për vitin 2008 janë vlerësuar dhe trajtuar gjithsej 3016 fëmijë me probleme të zhvillimit, të ardhur nga gjithë vendi, ku ky numër raste rritet çdo vit me rreth 36%. Gjatë aktiviteteve me fëmijët kjo qëndër punon edhe me prindërit dhe kujdestaret e fëmijëve për këshillimin e tyre lidhur me ushqyerjen, zhvillimin e fëmijës, etj. Sipas raportimeve të kësaj Qendre, kushtet jo të mira social-ekonomike të familjeve ku rriten këta fëmijë, niveli i ulët kulturor dhe arsimor i prindërve, mungesa e informacionit mbi rolin social në zhvillimin e fëmijëve, mungesa e informacionit mbi të drejtat e fëmijëve me paafësi, konfliktet në mjediset familjare, dhuna dhe abuzimi, emigracioni, kanë qënë disa nga problematikat më të shpeshta që ka ndeshur qendra në punën e saj. Një pjesë e detyrës së saj ka qënë edhe referimi i rasteve në shërbimet alternative në qëndrat ditore alternative, qëndrat komunitare të shëndetit mendor, qëndra të tjera që ofrojnë shërbime me aftësi të kufizuar. Po kështu kjo Qendër ndjek dhe referon rastet që janë paraqitur pranë Komisionit Mjekësor të caktimit të paafësisë. Gjatë periudhës 2005-2008 kjo Qendër ka zhvilluar programe trajnime për problemet e mirërritjes dhe edukimit të fëmijës me personelin e këshillimoreve të fëmijëve në 12 qarqet e vendit. Në Tiranë funksionojnë 2 qendra të shëndetit mendor, që trajtojnë fëmijët me paafësi dhe probleme të shëndetit mendor.

352. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën të informohen mbi të drejtat dhe privilegjet që gëzojnë. Qeveria dhe institucionet joqeveritare duhet të bashkohen për të koordinuar masat për ndërgjegjësimin e publikut dhe të botojnë vazhdimisht broshura informative, në të cilat të përmbliidhen, në një gjuhë të kuptueshme, të gjitha të drejtat, pagesat, rimbursimet dhe shërbimet.

Shëndeti dhe shërbimet shëndetësore (neni 24) Rekomandimi 55/ a: Shpërndarjen e burimeve, trajnime të personelit të kujdesit shëndetësor, investime në infrastrukturën e kujdesit shëndetësor.

353. Kujdesi shëndetësor ofrohet përmes një rrjeti të gjerë qendrash të kujdesit shëndetësor parësor, poliklinikash për specialitetet ambulatorë dhe spitalesh në 36 rrethet e vendit. Shërbimet e shëndetit publik dhe promocionit të edukimit shëndetësor ofrohen në kuadrin e shëndetit parësor dhe mbështeten dhe mbikqyren nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Shërbimi për fëmijët në kujdesin parësor fillon që në zonat rurale ku funksionojnë ambulancat me personel të mesëm mami-infermiere, të cilat ofrojnë shërbime bazë shëndetësore lidhur me parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve të popullsisë rurale përfshirë edhe fëmijët. Në paketën e këtyre shërbimeve, e cila u

rishikua në muajin janar të vitit 2009, ofrohet edhe kujdesi për nënën dhe fëmijën. Ky kujdes ofron ndjekjen e rregullt të gruas gjatë shtatzanisë, lindjen normale në shtëpinë e lindjes që mund të ketë qendra, kujdesin pas lindjes, vaksinimet, dhënien e ndihmës së parë urgjente dhe referimin, vizitat në shtëpi, promocionin, edukimin shëndetësor për këto kategori. Në kuadrin e përmirësimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore, MSH e Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor prej muajit janar 2007 nisi shtrirjen e skemës së sigurimeve shëndetësore në shërbimin shëndetësor parësor.

354. Për herë të parë janë krijuar qendra shëndetësore dhënëse të shërbimeve të kujdesit parësor, të cilat funksionojnë si një ekip profesionistësh të kontraktuar me sigurimin shëndetësor kundrejt dhënies së një pakete të mirëpërcaktuar shërbimesh shëndetësore. Qëllimi i Qendrës Shëndetësore është të ofrojë shërbime shëndetësore cilësore për t'i shërbyer popullatës në të gjithë zonën që mbulon qendra. Në zbatim të VKM 857, datë 20.12. 2006, kujdesi për nënën dhe fëmijën dhe promocioni edukimi shëndetësor janë një pjesë e kësaj pakete. Synimi i kësaj reforme është realizimi i shërbimeve shëndetësore efektive dhe cilësore në kujdesin parësor për pacientët. ISKSH ka kontrata me 418 qendra shëndetësore në shkallë vendi, të cilat mbulojnë gjithë shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor.

355. Qendrat shëndetësore, janë të vendosura në nivel komune dhe në to ka zakonisht mjek familje dhe ndonjëherë pediatër si dhe mami-infermiere që ndjekin problematikat e mirërritjes e zhvillimit të fëmijve 0-14 vjeç, vaksinimin, edukimin, promocionin shëndetësor e trajtimin e fëmijës së sëmurë. Në qytete, shërbimi parësor i specializuar për fëmijët mbulohet nga këshillimoret e fëmijëve që ndjekin mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijve 0-6 vjeç, e shërbimet për sëmundjet pediatrike pranë poliklinikave të lagjeve të qyteteve që ndjekin fëmijën e sëmurë deri në moshën 14vjeç.

356. Sipas Udhëzimit të MSH-së, shërbimet e parandaluese të kujdesit shëndetësor për fëmijët, Këshillimoret e Fëmijës, Qendrat Shëndetësore dhe ambulancat në fshat, kryejnë vizita të detyrueshme kontrolli të mirërritjes së fëmijës. Gjatë vitit të parë të jetës është në muajin e parë – 2 vizita në muaj, me tej një vizitë rregullisht në çdo muaj, një vizitë çdo muaj gjatë moshës 12-24 muajsh, një vizitë në çdo gjashtë muaj në moshën 2-6 vjeç. Në këto shërbime për fëmijët duke filluar nga viti 2008, në 12 qarqet e vendit kanë filluar të punojnë ekipet multidisiplinore si punonjës social, psikolog. Pas moshës 6 vjeç fëmijët duhet të ndiqen nga mjeku i shkollës, shërbim ky që nuk është i shpërndarë dhe rregulluar mirë në të gjitha rrethet e vendit . Për vitin 2009, në kuadrin e projektit kombëtar të bashkëpunimit me Qeverinë e Spanjës “Për reformimin e shërbimeve të nënës dhe fëmijës” do të fillojë puna për riorganizimin e këtij shërbimi.

357. Në nivelin dytësor të kujdesit shëndetësor, në të gjitha spitalet e rretheve funksionojnë pavionet e pediatriisë së përgjithshme dhe repartet e materniteteve për kujdes amtar. Numri spitaleve pediatrike aktualisht është 25 me 703 shtretër.

Në kuadrin e reformës së sistemit të kujdesit spitalor që ka filluar në muajin janar 2009, synohet përfshirja e këtij kujdesi në skemën e financimit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe përmirësimi i këtij shërbimi.

Shërbimi spitalor i specializuar i kujdesit shëndetësor për fëmijët, aktualisht në vendin tonë ofrohet nga Spitali pediatrik universitar pranë QSUT “Nënë Tereza” Tiranë.

Kujdesi për të porsalindurin: Shërbimi neonatologjik (fëmijët 0-28 ditë) spitalor përfshin 28 rrethe të vendit, ku janë dhe spitalet obstetrikale të kujdesit shëndetësor dytësor dhe tretësor.

358. Aktualisht MSH ka hartuar një strategji për rishpërndarjen, rehabilitimin e qendrave shëndetësore ekzistuese dhe mbulimin e vendit sipas standarteve të vendosura nga Banka Botërore dhe OBSH me qendra shëndetësore e ambulanca. Çdo vit ndërtohen dhe rehabilitohen 100 ambulanca nëpërmjet investimeve qe M.SH shpërndan në organet e pushtetit vendor në qark.

359. Me qëllim motivimin financiar të personelit janë miratuar akte nënligjore për rritjen e pagave të personelit infermieror dhe për rritjen e pagës së personelit të lartë shëndetësor (VKM nr. 229 datë 19.04.2006, VKM nr. 228 datë 19.04.2006). Në bazë të këtij vendimi, pagat e personelit të shëndetësisë në kujdesin shëndetësor parësor, për periudhën 2005-2008 janë rritur 2 herë më shumë.

360. Politikat dhe strategjitë e MSH synojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të shëndetit të grave dhe fëmijëve dhe të cilësisë së jetës së tyre, duke ndikuar në uljen progresive të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë së tyre. Ndërhyrjet kryesore për të garantuar një shëndet më të mirë për fëmijët kanë konsistuar në: a) përmirësimin dhe integrimin e strukturave të shërbimit shëndetësor të gruas dhe fëmijës në të tre nivelet e kujdesit; b) përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të nënës dhe fëmijës në tre nivelet e kujdesit, nëpërmjet unifikimit të protokolleve standart për ndjekjen e shëndetit të gruas dhe fëmijës; c) përmirësimin e nivelit shkencor dhe teknik të njohurive të personelit shëndetësor nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të gjithë personelit shëndetësor që punon në këto shërbime. d) plotësimin dhe përforcimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e shëndetit të gruas dhe fëmijëve. e) sensibilizimin, edukimin dhe mobilizimin e shoqërisë, mas medias.

370. Trajnimi i personelit të shëndetësisë . Gjatë periudhës 2004 -2008 janë trajnuar rreth 600 mjek dhe 500 infermiere të zonave verilindore të vendit, Kukës, Dibër, Mat, Bulqizë, Burrel, Has, Tropojë, lidhur me Manaxhimin e Integruar të sëmundjeve të fëmijërisë. Janë trajnuar i gjithë personeli i këshillimoreve të fëmijës në 36 rrethet dhe në të gjitha repartet e materniteteve të rretheve lidhur me ushqyerjen me gji. Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me UNICEF-in, UNFPA- në dhe Shoqatën Kombëtare të Punonjësve Sociale kanë trajnuar gjatë viteve 2007-2008, rreth 500 punonjës shëndetësorë (mjek të familjes, peditër, obstetër– gjinekolog dhe infermiere) për problemet e dhunës me bazë gjinore. Qendra Kombëtare e Mirërritjes së Fëmijës ka zhvilluar programe trajnimi për problemet e mirërritjes dhe edukimit të fëmijës me personelin e këshillimoreve të fëmijëve në 12 qarqet e vendit. Gjithashtu janë organizuar një sërë aktivitetesh promocionale për shëndetin e nënës dhe fëmijës: 1) Aktivitete sensibilizuese si për ushqyerjen me gji të fëmijës, ushqyerjen e fëmijës. 2) Aktiviteteve ndërjegjësuere për sigurinë rrugore pranë shkollave, pasi vdekjet e fëmijëve deri në 14 vjeç për shkak të këtyre aksidenteve zënë rreth 13 % të aksidenteve në tërësi. Zgjidhja e vëmendjes së fëmijëve bën që të nxisin politikat që të orientohen më mirë nga ana e të drejtave të tyre dhe të qytetarëve për më shumë siguri në rrugë. 3) Seminare me mediat mbi mënyrën e trajtimit të vetvrasjeve. 4) Trajnime të medias për probleme të ndryshme të shëndetit publik si problemet e duhanit, drogës, alkoolit, shëndetit mendor, sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (IST) etj. 5) Përdorimi i të gjitha formave të mass-medias si, biseda në televizion, në radio, shkrime në gazetat e ndryshme të vendit, revistat e ndryshme për tematika të ndryshme që lidhen me shëndetin e nënës dhe fëmijës. 6) Fletë palosje apo informacione për ushqyerjen me gji, gruaja dhe bebi në bark e saj, broshura për përdorimin e kripës së jodizuar, etj që janë shpërndarë në komunitete dhe shkolla të rretheve të vendit. 7) Janë organizuar konkurse midis nxënësve në shkollat nëntë vjeçare të disa rretheve për kripën e jodizuar. 8) Gjatë vitit 2008 janë zhvilluar trajnime me mësueset e biologjisë sidomos të zonave më të prekura nga deficienca jodike si qarku i Elbasanit dhe Pogradecit. 9) Aktivitete informuese në komunitet në bashkëpunim me USAID, UNICEF, UNFPA, Kryqi i Kuq Amerikan, Kryqi i Kuq Shqiptar, Korpusi i Paqes, Caritasi shqiptar, etj si dhe OJF të ndryshme që veprojnë në fushën e shëndetit. Aktivitet e tyre kryesisht kanë qënë për rëndësinë e ushqyerjes me gji, avantazhet e ushqyerjes me gji, planifikim familjar, kujdesin para lindjes dhe pas lindjes, etj. 10) Trajnimi i personelit të kabineteve të edukimit në 36 rrethet të vendit për problemet e shëndetit të nënës dhe fëmijës. Këtu duhet thënë se ende punonjësit e promocionit nuk mbulojnë të gjitha bashkitë, apo komunat, veçanërisht në ato rurale. 11) Nga viti 2008, botohet Revista e Shëndetit Riprodhues, çdo tre muaj me tematikë për shëndetin e nënës, fëmijës,

adoleshentëve, shtatzaninë, ushqyerjen e tyre, zhvillimin e fëmijës, etj. 12) Trajnime nga personeli i kabineteve të edukimit në 5 qarqe të vendit si në Shkodër, Berat, Korçë, Lezhë, Dibër në bashkëpunim me projektin e Pro shëndetit–USAID në komunitet për probleme të ushqyerjes së fëmijëve, mirrëritjes së tyre dhe planifikim familjar. Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar trajnimi i personelit shëndetësor mjek, infermier në lidhje me çështje të ndryshme të kujdesit për fëmijën, sipas Programeve Kombëtare që MSH-së ka patur në bashkëpunim me organizma e agjensi të Kombeve të Bashkuara.

371. Lidhur me rekomandimin 55/b në lidhje me problemet e kequshqyerjes, të dhënat nga disa studime⁴⁶ tregojnë se fëmijët shqiptarë kanë probleme me kequshqyerjen megjithëse shifrat tregojnë një përmirësim të situatës në drejtim të nënushqyerjes. Rezultatet e studimeve të ndryshme tregojnë që tendenca drejt uljes së niveleve të nënushqyerjes së fëmijëve, ka ndryshuar pak dhe arrihet në konkluzionin se nënushqyerja e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël prek veçanërisht familjet rurale me burime të pakta dhe familjet e mëdha urbane pa burime të rregullta të të ardhurave. Aksesit i ulët në kujdesin e mirë shëndetësor, niveli i lartë i varfërisë në zonat larg infrastrukturës dhe qendrave urbane dhe familjet më të mëdha⁴⁷ evidentojnë se nënushqyerja e fëmijëve është një nga sfidat më të mëdha në zonat rurale veçanërisht në rajonet veriore dhe veri-lindore të Shqipërisë.

372. Një ndër objektivat e SKF është “Përmirësimi i ushqyerjes së fëmijëve”, i cili analizon situatën sipas disa komponentëve: 1) Treguesit e ushqyerjes me gji: Ushqyerja me gji, konsiderohet si një nga treguesit kryesorë të shëndetit dhe mirëritjes së fëmijëve. Përqindja e ushqyerjes ekskluzive me gji ka ardhur duke u rritur krahasuar me studimet para viteve 2004-2005 por ende mbetet në nivele të pakënaqëshme. Gjithashtu për të nxitur ushqyerjen me gji në institucionet tona shëndetësore vazhdon përhapja e "Iniciativës Spitale Mike të Foshnjave (baby friendly hospital)⁴⁸. Gjatë periudhës 2004-2008 janë vlerësuar për t'u bërë spitale mike të fëmijës disa maternitete të spitaleve në rrethet Korçë, Elbasan, Shkodër, Dibër, Kukës, Tropojë, Krujë, Vlorë, Lushnjë.

2) Ushqyerja komplementare: Futja e ushqimeve të tjera përveç qumështit të gjirit mund të jetë një pikë kritike kthese në zhvillimin shëndetësor të foshnjës⁴⁹. Nga të dhënat e mbledhura nga të disa studime të UNICEF, vlerësohet se përqindja e fillimit të ushqyerjes komplementare në kohëdhe të përshtatshme për foshnjat pas moshës 6 muajsh është e kënaqshme, por ende duhet më shumë punë në drejtim të edukimit, këshillimit nënave për ushqyerjen e shëndetshme të foshnjave.

Me qëllim përmirësimit të situatës së ushqyerjes së popullatës dhe fëmijëve në veçanti, Instituti i Shëndetit Publik ka përgatitur e ka shpërndarë materiale informative edukuese lidhur me ushqyerjen e fëmijës për shkollat dhe ka përcaktuar normat dietike për studentët e disa kategorive universitare.

373. Furnizimi me ushqime të sigurta është një domosdoshmëri për mbrojtjen e shëndetit publik. Në këtë kontekst është hartuar Analiza e situatës dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Ushqimin dhe Ushqyerjen për Shqipërinë për periudhën 2003-2008. Ky dokument ka pasur për qëllim të mbrojtjes dhe promovojë shëndetin dhe të pakësojë sëmundjet me origjinë ushqimore, duke kontribuar njëkohësisht në zhvillimin social- ekonomik, mjedisin e qëndrueshëm dhe njëkohësisht do të ndikojë në uljen e kostos për shërbimet shëndetësore. Aktualisht është në proces hartimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Ushqimin dhe Ushqyerjen për Shqipërinë për periudhën 2009-2014.

⁴⁶ Studimi i Grupit të Indikatorëve të Shumëfishtë (MICS i vitit 2005- një studim i UNICEF dhe INSTAT); Studimi i Matjes së Standardeve të Jetesës (LSMS) i vitit 2002 nga INSTAT; Rezultatet e Vlerësimit të Varfërisë në Shqipëri për vitin 2007, i realizuar nga UNICEF.

⁴⁷ Situata e Fëmijëve dhe të Rinjve në Nivel Rajonal në Shqipëri, UNICEF Qendra Kërkimore Innocenti, 2004.

⁴⁸ Iniciativë e OBSH-së dhe UNICEF.

⁴⁹ OBSH dhe UNICEF rekomandon zgjatjen e ushqyerjes me gji dhe futjen në kohë dhe të sigurt të ushqimeve të tjera komplementare jo më vonë se moshë 6 muajshe.

374. Ligji nr. 9863 dt. 28.1.2008” Mbi Ushqimin” ka për qëllim të vendosë bazat për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesat e konsumatorit, dhe vendosjen e normave të sigurisë ushqimore duke filluar nga kërkesat e sigurisë ushqimore, në përcaktimin e sigurisë ushqimore dhe vlerësimin e saj. Siguria ushqimore përfshin tërësinë e masave që synojnë reduktimin e rreziqeve për shëndetin në tërë zinxhirin ushqimor, nga prodhuesi parësor tek konsumatori, tek tavolina e ngrënies. Në bazë të këtij ligji është krijuar Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe pranë MBUMKi, funksionon Drejtoria për Sigurinë Ushqimore dhe për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Ligji nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, ka për qëllim njoftimin e konsumatorit për mallra e shërbime jo konform normave të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit.

Strategjia Ndërsëktoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut, për periudhën 2007-2013 ka si prioritetet strategjike: 1) Të fuqizojë konsumatorët shqiptarë (zgjedhje reale e bazuar mbi një informacion të saktë, vetëvendosje e fortë, besim që rrjedh nga mbrojtja efektive).

2) Të mbrojtë interesat ekonomike të konsumatorëve në çështjet e sigurisë, zgjedhjes, cilësisë, çmimit, llojshmërisë, disponibilitetit etj. 3) Të ofrojë për konsumatorët mbikëqyrje bashkëkohore dhe transparencë të tregut. 4) Të mbrojtë konsumatorët në mënyrë efektive nga risqet dhe kërcënimet të cilat ata nuk mund t’i trajtojnë e zgjidhin në mënyrë individuale.

Ministria e Shëndetësisë bazuar në rekomandimet e OBSH dhe FAO ka hartuar draft udhëzuesin dietetik kombëtar, ku pasqyrohen rekomandime lidhur me ushqyerjen e shëndetëshme, si dhe rekomandime të vecanta për ushqyerjen e foshnjave dhe fëmijëve.

375. Gjatë vitit 2008 ka filluar trajnimi i mësueseve të biologjisë të disa shkollave në lidhje me promovimin e pesë çelsave kryesore të sigurisë ushqimore, i cili do të shtrihet edhe në të gjitha shkollat e tjera. Ndërkohë po hartohen programe nutricionale për nxënësit e shkollave për orët ekstrakurrikulare për të plotësuar lëndët e edukimit shëndetësor.

376. Në vitin 2006 Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Bashkinë e Qytetit të Tiranës, rishikoi dhe përditësoi menunë tip të ushqyerjes së fëmijëve në çerdhe dhe kopshte. Po kështu në bashkëpunim me UNICEF janë përgatitur standartet e fëmijëve në çerdhe, ku përfshihen edhe standartet e ushqimit

Në janar 2009 në bashkëpunim me UNICEF, MSH-së, MBUMK ka filluar punën për përgatitjen e një strategjie për Reduktimin e Kequshqyerjes së Fëmijës dhe një plani veprimesh me ndërhyrje konkrete që synojnë përmirësimin e gjendjes shëndetësore tek foshnjat dhe fëmijët e vegjël në Shqipëri me fokus të veçantë shtresat në nevojë.

377. Në Shqipëri mungojnë të dhënat në nivel kombëtar për pamjaftueshmërinë e vitaminave dhe mineraleve si Vitamina A, hekuri, etj. Në kuadrin e studimit të madh Kombëtar Demografik për Shëndetin do të bëhet për herë të parë vlerësimi i anemisë tek familjet shqiptare si dhe vlerësimi i gjendjes së ushqyerjes të tyre nëpërmjet matjes së peshës dhe gjatësisë në 9000 familje⁵⁰. Në protokollin MSH për ndjekjen e fëmijëve 0-6 vjeç nga Këshillimoret e fëmijëve në vendin tonë ju rekomandohet dhënia e vitaminës A, fëmijëve që kanë probleme kequshqyerje, rakiti, apo infeksione të përsëritura, ndërsa vitamina D rekomandohet e detyrueshme për të gjithë fëmijët e moshës 0-3 vjeç.

378. Pamjaftueshmëria jodike. Shqipëria në vitin 1993, nga një studim kombëtar të kryer nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, u vlerësua si vend me formë të rëndë të pamjaftueshmërisë

⁵⁰ Të dhënat e studimit do të publikohen në nëntor të vitit 2009.

jodike (63% e fëmijve). Mbi këto vlerësime, MSH në bashkëpunim me partnere të saj (UNICEF, OBSH) filloi zbatimin e një strategjie afat gjatë që konsistonte në: 1)Jodizimin universal të gjithë kripës për konsum human dhe shtazor; 2) Monitorimin e vazhdueshëm të pamjaftueshmërisë jodike në popullatë; 3) Zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie komunikimi që të edukoje publikun mbi rëndësinë e kripës së jodizuar dhe përdorimin korrekt të saj, të rrisi ndërgjegjësimin dhe njohuritë midis profesionistëve të fushave të ndryshme për të transmetuar në popullatë mesazhet mbi rëndësinë e përdorimit të kripës së jodizuar. Në kuadrin e ndërhyrjeve afatshkurtra të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Komunikimit të Parandalimit të Çrregullimeve nga Pamjaftueshmëria Jodike (IDD) nga MSH dhe ISHP me mbështetjen e UNICEF u realizua studimi “Njohuritë, Qëndrimet, dhe Sjelljet rreth IDD”⁵¹. Qëllimi i këtij studimi ishte vlerësimi i nivelit të njohurive, qëndrimeve dhe sjelljeve rreth IDD, tek femrat shqiptare të moshës riprodhuese në funksion të hartimit të programeve të përshtatshme të Informim-Edukim-Komunikimit, si dhe krijimit të një base të dhënash (baseline) për monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve që do të kryen në të ardhmen në këtë fushë. Rezultatet e këtij studimi treguan se ekziston një mungesë e njohurive rreth çrregullimeve që lidhen me pamjaftueshmërinë jodike tek femrat shqiptare të moshës riprodhuese, kontingjent ky i cili luan një rol domethënës dhe ka një efekt të madh tek fëmijët dhe familjet e tyre lidhur me përdorimin e kripës së jodizuar. Ligji nr 9942 datë 26.6. 2008 “Për parandalimin e çrregullimeve nga pamjaftueshmëria jodike në organizmin e njeriut” synon eliminimin e pasojave që sjell mungesa e jodit në organizmin e individit veçanërisht tek gratë gjatë periudhës së shtatzënise, ushqyerjes me gji dhe fëmijët e vegjël, nëpërmjet strategjisë së jodizimit universal të kripës për konsum human dhe shtazor. MSH-së po përgatit aktet nënligjore për zbatimin e ligjit. Në protokollet e MSH-së prej vitit 2007 rekomandohet dhënia e tabletave me jod fëmijëve 0-3 vjeç.

Shëndeti i adoleshentëve *Rekomandimi 57/a,b Politikat shëndetësore për adoleshentët, programet e edukatës shëndetësore në shkolla; këshillimin për problemet e ndjeshme të të rinjve*

379. Ligji nr. 8876 datë 4.4.2002 "Për shëndetin riprodhues" parashikon ndër të tjera se shërbimet e kujdesit për shëndetin riprodhues: a) shërbime dhe këshillim, informim, edukim, komunikim për planifikimin familjar: a) shërbime dhe edukim për kujdesin para lindjes, lindjen e sigurt dhe kujdesin pas lindjes veçanërisht ushqyerjen me gji; b)shërbime dhe edukim për fëmijët, adoleshentët; c)parandalimin dhe trajtimin për sëmundjet seksualisht të transmetueshme, HIV/AIDS, e infeksioneve dhe sëmundjeve të traktit riprodhues; d) abortin e sigurt dhe manaxhimin e komplikacioneve lidhur me abortin; e)informim, edukim dhe këshillim mbi seksualitetin dhe shëndetin riprodhues; d)shërbime referimi për planifikimin familjar, komplikacionet e shtatzanisë, abortin, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS etj

380. Shumë studime kanë treguar se akoma ka një mungesë të theksuar të informacionit si dhe keqkuptime lidhur me çështjet e shëndetit seksual e riprodhues sidomos të të rinjve të zonave rurale, si dhe përdorim të sjelljeve me risk, që kontribuojnë në treguesit jo të mirë lidhur me shëndetin seksual e riprodhues të të rinjve.

381. MSH-së në bashkëpunim me UNICEF dhe Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethe ka filluar zbatimin e programit të ngritjes së shërbimeve miqësore për të rinjtë. Këto qendra janë të integruara në shërbimet e Kujdesit të Shërbimit Parësor dhe ofrojnë një rrjet shërbimesh, këshillim, parandalim, testim dhe diagnostikim/trajtim të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (IST) përfshirë HIV/AIDS, planifikim familjar, sjelljet me rrezik, etj. Qendrat kanë një ekip shëndetësor multidisiplinor. Qendra e parë është hapur në Vlorë dhe numri i tyre

⁵¹ Informacion i detajuar lidhur me këtë studim paraqitet në anekset bashkëlidhur këtij Raporti.

është rritur në 4 qarqe. Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë, Sporteve e kanë mbështetur këtë model. Plani Kombëtar i Strategjisë për Rininë synon hapjen e 12 qendrave të tjera brenda 5 viteve të ardhshme në vend.

UNFPA në bashkëpunim me MSH, MASH dhe MRSK po punon nëpërmjet programit për një jetë të shëndetshme për rininë, në disa drejtime: 1) Forcimi i kapaciteteve ekzistuese në shërbim të rinjve (trajnim të personelit shëndetësor psiko-social në shkolla) me qëllim të prezantimit e përdorimit të shërbimeve miqësore për të rinjtë (udhëzuesi bazë që përdoret është paketa orientuese e përgatitur nga OBSH); 2) edukim me bashkëmohatarët, përgatitja e kurrikulës për shkollat e mesme; 3) këshillim për shëndetin riprodhues dhe seksual të të rinjve si një e drejtë e tyre; 4) kontribut në formulimin e strategjive dhe politikave që mbrojnë dhe fuqizojnë rininë.

382. Ndërhyrjet kryesore të MSH-së të parashikuara për përmirësimin e shëndetit të rinjve gjatë periudhës 2009-2015 janë: 1) Trajnimi i profesionistëve që ofrojnë informacion rreth shëndetit seksual dhe riprodhues (SHSR) me qëllim që të rinjtë të mund të informohen drejtë, saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme. 2) Ndërgjegjësimi i komunitetit dhe familjeve për edukimin e fëmijëve që në moshë të vogël mbi SHSR. 3) Ndërtimi i strategjive, politikave dhe ndërhyrjeve për metodat kontraceptive duke përfshirë edhe kontracepsionin e emergjencës, kjo përfshin: përmirësimin e kurrikulës shkollore, trajnimin e stafëve mjekësore, realizimin e fushatave mediatike dhe rritjen e aksesit për kontracepsionin e emergjencës. 4) Zbatimi i strategjive kombëtare të edukimit bashkëmohatar si ndërhyrje mjaft efektive për përmirësimin e shëndetit riprodhues të të rinjve. 5) Promovimi tek të rinjtë shtyrja e marrëdhënieve seksuale në një moshë sa më të rritur dhe forcimi i marrëdhënieve të qëndrueshme me një partner. 6) Hartimi i strategjive për ndërhyrje të bazuara në fakte shkencore për ndryshimin e praktikave dhe qëndrimeve në lidhje me përdorimin e prezervativit dhe rritjen e aksesit ndaj tij midis të rinjve. 7) Qëndrat e planifikimit familjar dhe shoqatat rinore duhet të orientojnë punën e tyre informuese, si dhe të rrisin aksesin drejt shërbimeve miqësore ndaj të rinjve, veçanërisht ndaj adoleshentëve 8) Rishikimi i kurrikulave duke përfshirë në proces të gjithë aktorët e interesuar (politikëbërës, zbatues, ekspertët dhe përfituesit). 9) Përdorimi i strategjive të ndryshimit të sjelljes në fushtat mediatike për shëndetin seksual dhe riprodhues të të rinjve. 10) Trajnimi i mësuesve për shëndetin riprodhues dhe planifikimin familjar të të rinjve duke u bazuar në metodat e ndryshimit të sjelljes. 11) Trajnimi i personelit shëndetësor për shëndetin riprodhues dhe planifikimin familjar të të rinjve duke u bazuar në metodat e ndryshimit të sjelljes.

383. Ligji nr.9952, datë 14.07.2008 “Për parandalimin e HIV/ AIDS-it në RSH-së, përcakton si politikë shtetërore parandalimin dhe kontrollin në marrjen e masave për HIV/AIDS.

Ky ligj parashikon rregullat për parandalimin dhe kontrollin, kujdesin, trajtimin dhe mbështetjen për personat që jetojnë me HIV/AIDS.

384. Ligji nr. 9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit” ka si qëllim parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumimi i alkoolit, nëpërmjet përdorimit të pijeve alkoolike nga të miturit.

385. Ligji nr. 9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” ka si qëllim mbrojtjen e shëndetit publik, nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit të tyre. Ky ligj përcakton një sërë masash kufizuese për personat nën 18 vjeç.

386. Edukimi shëndetësor, duke përfshirë jetën familjare dhe edukimin seksual është bërë pjesë e kurrikulës të shkollave nëntëvjeçare që nga viti 1994.

Në kuadrin e reformës së arsimit, si në arsimin parauniversitar (klasat I – XII), u rikonceptua e gjithë kurrikula në arsimin parauniversitar ku përfshihen dhe ndërhyrje të planifikuara në fushën e

edukimit shëndetësor. Në arsimin bazë 9-vjeçar lënda e biologjisë është konceptuar së bashku me atë të edukimit shëndetësor. Por është gjykuar që edukimi shëndetësor të shihet si një fushë me shumë peshë edhe në kurrikulat e arsimit të mesëm. Në kurrikulën e re të shkollës së mesme krahas trajtimit kroskurrikular të kësaj çështjeje përmes lëndëve biologji, qytetari, psikologji, kjo problematikë është planifikuar të trajtohet më vete në kuadrin e lëndës “Aftësi për jetën” me fokus shëndetin. Në programin e kësaj lënde nxënësit do të marrin informacione të thelluara për një jetë të shëndetshme. Ndërkohë shkollat kanë tashmë hapësirën e nevojshme kohore, atë të kurrikulës në bazë shkolle (me zgjedhje), e cila mundëson që problematikën sociale të jetës së përditshme të mund të trajtohen nga vetë ato. Shkolla tani mund të ndërmarrë lehtësisht një sërë veprimtarish apo projektesh të ndryshme në lidhje me drogat, e pavarur apo në bashkëpunim me organizma të tjera që punojnë për këtë problematikë. Element pozitiv në këtë drejtim është dhe formulimi i standardeve të edukimit shëndetësor për arsimin parauniversitar, që do të shërbejnë si kornizë për zhvillimin e kurrikulës së edukimit shëndetësor në arsim dhe që do të mundësojnë arritje të dëshiruara në fushën e shëndetit për të gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar.

387. Programi i Shërbimeve miqësore për të rinjtë: UNICEF në bashkëpunim me MSH dhe Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethe nga viti 2004 e në vazhdim ka zbatuar programin e ngritjes së shërbimeve miqësore për të rinjtë. Këto qendra janë të integruara në shërbimet e Kujdesit të Shërbimit Parësor dhe ofrojnë një rrjet shërbimesh: Këshillim; Parandalim, testim dhe diagnostikim/trajtim të IST përfshirë HIV/AIDS; Planifikim Familjar; Prindërit; Sjelljet me rrezik; Shëndet mendor. Qëndrat kanë një ekip shëndetësor multidisiplinor. Aktualisht funksionojnë 5 qendra në Tiranë, Vlorë, Shkodër, Elbasan. Plani Kombëtar i strategjisë rinore synon në hapjen e 12 qendrave të tjera brënda 5 viteve të ardhshëm në të gjithë vendin.

388. Programi “Për një jetë të shëndetëshme për rininë”: UNFPA në bashkëpunim me MSH, MASH dhe MTKRS nga viti 2004 e në vazhdim, po punon në disa drejtime me qëllim sigurimin e një jete të shëndetshme për të rinjtë. Programi parashikon këto aktivitete: a) forcimin e kapaciteteve ekzistuese në shërbim të të rinjve (trajnim të personelit shëndetësor dhe atij psiko-social në shkolla) me qëllim të prezantimit dhe përdorimit të shërbimeve miqësore për të rinjtë (udhëzues bazë që përdoret është paketa orientuese e përgatitur nga OBSH). b) edukim me bashkëmoshatar; c) përgatitja e kurrikulës për shkollat e mesme. d) këshillim për shëndetin riprodhues dhe seksual të të rinjve si një e drejtë e tyre; e) kontribut në formulimin e strategjive dhe politikave që mbrojnë rininë

Shëndeti i adoleshentëve: Rekomandimi 57/c Studime i rasteve dhe shkaqeve të vetëvrasjeve

389. Çrregullimet mendore dhe të sjelljes hasen shpesh gjatë periudhës së adoleshencës. Në Shqipëri, lëvizjet demografike, janë shoqëruar me vështirësi në kohezionin social të grupimeve me origjinë të ndryshme krahinore, ekonomike, apo sociale. Rrjedhimisht, adoleshentët përballen me fenomene të izolimit social që përbëjnë faktorë shpërthyes për një sërë çrregullimesh të sjelljes.

Në Studimin “Vlerësimi i sjelljeve me risk tek të rinjtë e shkollave të mesme” (ISHP 2005), rreth 17% e të rinjve 15-19 vjeç pohonin se kishin probleme me gjumin, ndërsa 33% shihnin ëndërra të këqija. Të paktën 14% e tyre deklarorin se ndjeheshin të vetmuar, dhe 31-50% pohonin se ndjeheshin nervozë, apo të tensionuar. Po në të njëjtin studim të kryer nga ISHP në 2005, u evidentua një përqindje e konsiderueshme e të rinjve të cilët pranonin se ishin të ndjerë të pashpresë për 2 javë rresht (23%). Fenomeni tenton të jete më i shprehur tek femrat, gjë që reflektohet sidomos në diferencën gjinore në afirmimin e mendimeve serioze për të kryer vetëvrasje (8.4% e femrave dhe 5.5% e meshkujve). Më shumë se 1 në 10 femra të grupmoshës 15-19 vjeç në Tiranë pranojnë të kenë pasur mendime serioze për të kryer vetëvrasje. Shifrat dëshmojnë për efektet negative të urbanizimit të shpejtë në shëndetin mendor të të rinjve.

Shëndeti i adoleshentëve: Rekomandimi 57/d Aksesi në informacion për shëndetin riprodhues dhe planifikimin familjar.

390. Planifikimi familjar. Aktualisht shërbimet e planifikimit familjar në Shqipëri ofrohen në sistemin shëndetësor publik dhe privat në: qendrat shëndetësore dhe ambulancat në sistemin shëndetësor publik; qendrat e planifikimit familjar të përfshira në maternitetet e rretheve në sistemin shëndetësor publik; klinika shëndetësore private; Shërbime të ofruara nga OJF që punojnë në fushën e shëndetit të gruas. Shërbimet e planifikimit familjar të ofruara nga Ministria e Shëndetësisë janë të shpërndara në tre nivelet e kujdesit shëndetësor. Sektori Publik ofron shërbime të Planifikimit Familjar në 430 qendra-maternitete, poliklinika, qendra shëndetësore dhe në disa ambulanca fshati. Në nivelin e kujdesit shëndetësor parësor janë krijuar Qendrat e Planifikimit Familjar që gjenden në të gjitha qytetet e vendit të integruara në Këshillimoret e nënës. Këto qendra janë të furnizuara me disa lloje kontraktivësh; kanë personel të trajnuar për ofrimin e metodave moderne kontraktive dhe dhënien e informacionit e këshillimit mbi planifikimin familjar. Në qendrat shëndetësore të komunave në fshat personeli shëndetësor është trajnuar për planifikimin familjar dhe ofron informacion, këshillim dhe disa metoda kontraktive të planifikimit familjar. Të dhënat e raportuara tregojnë se numri i qendrave shëndetësore publike që ofrojnë planifikim familjar ka një rritje të ndjeshme. Aktualisht, niveli i shërbimit parësor të PF përfaqësohet nga 430 qendra shëndetësore që ofrojnë planifikimin familjar që ndodhen në konsultore të gruas, maternitete dhe qendra shëndetësore në nivel komune. Në nivelin e dytë të kujdesit shëndetësor, të gjitha maternitetet e spitaleve të vendit kanë të përfshirë edhe shërbimin e Planifikimit Familjar dhe ofrojnë të gjitha llojet e metodave moderne kontraktive si dhe informim e këshillim mbi planifikimin familjar. Në nivelin më të lartë spitalor planifikimi familjar ofrohet në qendrat e gruas pranë spitaleve universitare obstetrik-gjinekologjike nr. 1 dhe 2 në Tiranë.

391. Shërbimet që ofrojnë Planifikim Familjar mbështeten mbi këto parime: Zgjedhje e informuar. Respektimi të drejtave të klientit. Ofrimi një sërë metodash të PF. Integrimi me shërbimet dhe programet e Shëndetit të nënës dhe fëmijës. Për Shërbimet e ofruara në të gjitha qendrat e PF MSH-së ka realizuar: i) Trajnim të personelit shëndetësor në metodat e PF. ii) Pajisje e qendrës me materiale informuese për popullatën dhe personelin shëndetësor. iii) Furnizim me sasi të duhura të kontraktivëve. iv) Integrimin e qendrës në sistemin kombëtar të informimit për manaxhimin logjistik të informacionit mbi kontraktivët. v) Këshillimin si një element të rëndësishëm të këtij shërbimi. Në vitin 2003 Ministria e Shëndetësisë miratoi strategjinë kombëtare për sigurimin e kontraktivëve. Kjo strategji ka dy objektiva kryesore: 1) Sigurimin e kontraktivëve nëpërmjet furnizimit të garantuar afatgjatë me kontraktivë cilësorë 2) Arritjen e pavarësisë kontraktive: përballimin nga vendi me burimet e veta financiare të nevojave për kontraktivë pa qenë nevoja për dhurues të jashtëm për të blerë kontraktivë apo për logjistikë dhe asistencë teknike të lidhur me blerjen. Në kuadrin e kësaj strategjie Ministria e Shëndetësisë ka bërë rregullimet e nevojshme të politikave dhe buxhetit në mënyrë që të arrijë sigurimin e kontraktivëve. Duke filluar që nga viti 2005, Ministria e Shëndetësisë ka filluar kontributin e saj financiar për blerjen e një pjese të nevojave vjetore në sektorin publik për kontraktivë me fondet e buxhetit të shtetit dhe do të arrijë pavarësinë e plotë financiare në vitin 2010, ku të gjitha kontraktivët e nevojshëm për shërbimet shëndetësore do të blihen me buxhetin e shtetit.

Aborti ofrohet vetëm në nivel spitalor dhe në disa klinika private të licensuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe bëhet vetëm nga staf i trajnuar obstetrik-gjinekolog.

392. Strategjia e Ministrisë së Shëndetësisë ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor që ofrojnë abort të sigurt dhe synon në: Përshtatjen e kujdesit për abortin e

sigurt për çdo grua sipas nevojave të saja sociale dhe individuale. Përmirësimin e punës për ofrimin e këshillimit dhe informacionit të duhur që mbështet gratë në zgjedhjen e tyre. Përdorimin e teknologjive mjeksore të rekomanduara bashkëkohore. Zgjerimin e shërbimeve të planifikimit familjar pas abortit, përfshirë kontracepsionin e emergjencës, për të ndihmuar gruan të parandalojë shtatzaninë e padëshiruar, të praktikojë hapësirën midis lindjeve dhe të mënjanojë abortet e përsëritura. Integrimin me shërbime të tjera të Shëndetit Riprodhues si skenimi e diagnoza e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme, këshillimi mbi dhunën, shërbimet për adoleshentët.

393. Programi Kombëtar i UNFPA: ALB2R201 “Mbështetje për Shëndetin Riprodhues dhe Planifikimin Familjar në Shqipëri”. Në bashkëpunim me UNFPA, që nga vitit 1993, MSH-së po zbaton programe bashkëpunimi 5 vjeçare. Aktualisht është duke u zbatuar programi për periudhën 2006-2010. Objektivat kryesore të këtij programi janë: 1) Mbështetja e MSH për të krijuar paketën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor, përfshirë standartet e monitorimit dhe supervizimit, si edhe treguesit e të dhënave. 2) Mbështetje për ngritjen e sistemeve për të përmirësuar performancën, duke mbështetur trajnimin e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e performancës për të dhënë një gamë më të gjerë shërbimesh cilësore të shëndetit riprodhues dhe planifikimit familjar për t’iu përgjigjur nevojave të pambuluara (Logjistika e Manaxhimit të Sistemit të Informacionit mbi kontraceptivët, survejanca e abortit, survejanca e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme, survejanca e keqformimeve të lindura. 3) Mbështetje për trajnim të vazhdueshëm mbi shëndetin riprodhues të specialistëve të familjes dhe infermiereve, infermiereve të komunave dhe doktorëve të familjes. 4) Përmirësimi i komponentit të shëndetit riprodhues në kurrikulat e shkollave mjekësore, sidomos për kategoritë e përmendura më sipër. 5) Hartimi i protokolleve të kujdesit prenatal dhe postnatal. 6) Promovimi dhe forcimi i partneriteteve midis institucioneve qeveritare, OJF-ve dhe agjensive financuese për të siguruar kordinim në fushën e shëndetit riprodhues, përmes grupeve tematike të punës nën drejtimin e Komitetit Kombëtar për Shëndetin Riprodhues dhe organeve të tjera ndërministrorë. Të gjitha proceset do të shoqërohen nga fushata sensibilizuese, përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve, posterave, fletëpalosje, etj.

Standarti i jetesës (neni 27, paragrafët 1-3): Rekomandimi 59. Përmirësimi i standarteve të jetesës për fëmijët dhe sigurimin e ndihmës materiale dhe programeve të mbështetjes

394. Lidhur me nenin 27 paragrafët 1-3 Standarti i Jetesës dhe në zbatim të rekomandimit 59, me qëllim sigurimin e ndihmës ekonomike dhe programeve të mbështetjes në përputhje me nenin 27 të Konventës në zbatim të ligjit nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Sociale”, përfitues të ndihmës ekonomike janë: 1) Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme; 2) Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, të familjeve në nevojë. Rregullat e përfitimit të ndihmës ekonomike kanë tavan të përcaktuar 2.5 herë të nivelit të pagesës bazë të papunësisë për çdo familje përfituese. Përfitimi i ndihmës ekonomike bazohet në strukturën e familjes: (i) kryefamiljari merr 95% e pagesës bazë së papunësisë; (ii) të moshuarit dhe anëtarët me aftësi të kufizuara marrin 95% të pagesës bazë të papunësisë; (iii) anëtarët nën moshën e punës, fëmijët marrin 25% të pagesës së kryefamiljarit dhe (iv) anëtarët në moshë pune 20% të pagesës së kryefamiljarit. Familjet me të ardhura të pakta, mund të përfitojnë një pagesë të pjesshme.

395. Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale, mbështetet në prioritetet që kanë lidhje me reduktimin e varfërisë, përmirësimin e cilësisë së jetës së grupeve në nevojë dhe fuqizimin e tyre për t’u përfshirë në zhvillimet komunitare.

Reformimi i skemës së ndihmës ekonomike dhe pagesave të tjera, mbështetet në identifikimin e nevojave të familjeve të varfëra mbi bazën e treguesve të varfërisë absolute, mbulimin më të mirë të

nevojave me fonde dhe sigurimin e nje niveli dinjitoz jetese për familjet, personat me aftësi të kufizuar dhe përfitues të tjerë. Në fushën e shërbimeve shoqërore, reforma ka në themel të saj ngritjen e shërbimeve në nivel komunitar, atje ku janë përfituesit dhe lindin nevojat e tyre, për të mbështetur dhe ndihmuar individin, familjen, grupin ose komunitetin që të vet-funksionojnë, të jenë të pavarur dhe të përfshihen si të barabartë me anëtarët e tjerë të shoqërisë. Synimi i Strategjisë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale, është të sigurojë një politikë të qartë për reformimin e sistemit të pagesave dhe shërbimeve shoqërore, jo vetëm për grupet në nevojë, por për të gjithë shoqërinë. Objektivat kryesorë të saj për pagesat në cash janë: (i) reduktimi i shkallës së varfërisë për fryme në 10% të popullsisë deri në vitin 2013, në përputhje me rezultatet e LSMS⁵²; (ii) përmirësimi i targetimit të përfituesve në skemën e ndihmës ekonomike dhe mbulimi i nevojave të familjeve të varfra në përputhje me vijën e varfërisë absolute, sipas LSMS; (iii) rritja e masës mesatare të ndihmës ekonomike; (iv) kushtëzimi i shpërndarjes së ndihmës ekonomike me punë komunitare në të gjithë vendin; (v) përmirësimi i administrimit të subvencionit për energjinë elektrike; (vi) përmirësim i sistemit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara; (vii) përshkallëzim i pagesave për Personat me aftësi të kufizuar në varësi të gjendjes dhe kushteve sociale.

396. Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale ka gjithashtu si qëllim të arrijë këto synime strategjike, sipas prioriteteve strategjike: 1) Zbutja e varfërisë; 2) Reduktimi i shkallës së varfërisë absolute për frymë në 10% deri në 2013 sipas rezultateve të vëzhgimit të nivelit të jetesës së familjes. 3) Rritja e buxhetit për programin e ndihmës ekonomike. 4) Rritja e mbulimit të familjeve të varfëra nga ndihma ekonomike sipas rezultateve të vëzhgimit të nivelit të jetesës së familjes. 5) Reduktimi i numrit të familjeve jo të varfra që marrin ndihmë ekonomike 6) Rritja e pageses mesatare të ndihmes ekonomike. 7) Shtrirja e kushtëzimit të përfitimit të ndihmës ekonomike nëpërmjet punës, në një numër sa më të madh bashkish dhe komunash. 8) Reformimi i sistemit të shërbimeve shoqërore. 9) Mbështetja e grupeve në rrezik të përjashtimit social.

397. Strategjia Ndërsektoriale e Përfshirjes Sociale 2007-2013 (miratuar me VKM nr.218 datë 3.02.2008), ka si qëllim të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre. Kjo strategji fokusohet në varfërinë dhe përjashtimin social, rreziqe që mbeten edhe pas rritjes ekonomike dhe është në përputhje të plotë me strategjitë sektoriale dhe në veçanti me politikat dhe strukturat institucionale të përshkruara në keto strategji, të cilat kanë synim të ndihmojnë personat vulnerabël, familjet dhe grupet në komunitet, që të mund të të sigurojnë të ardhura dhe të kenë të njëjtat të drejta si dhe pjesëtarët e tjerë të shoqërisë.

398. Një studim i kryer nga një grup specialistësh të INSTAT-it, PNUD-it dhe Bankës Botërore, (i publikuar në prill 2009) nxori si rezultat se Shqipëria vazhdon të provojë ulje të ndjeshme të varfërisë në periudhën 2005-2008. Studimi bazohet në të dhënat e mbledhura nëpërmjet Anketës për Matjen e Nivelit të Jetesës nga një kampion familjesh përfaqësuese për gjithë popullsinë. Në anketat e kryera në periudhat prill-qershor të vitit 2002, maj-qershor 2005 dhe qershor-gusht 2008, u intervistuan afërsisht 3600 familje. Rezultatet për 2008 tregojnë se 12.4% e popullsisë është e varfër kundrejt 18.5% në 2005, dhe 25.4% në 2002. Kjo tregon se rreth 200,000 persona nga rreth 575,000 që ishin të varfër në 2005 kanë dalë nga varfëria vetem gjate periudhes 2005 deri në 2008. Varfëria është përkufizuar si pamundësia e personave për të shpenzuar të paktën 5722 lekë në muaj për frymë në vitin 2008 (ose 4891 lekë për frymë në muaj në 2002).

⁵² Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës së Familjes.

Niveli i lartë i rritjes ekonomike që ka përjetuar Shqipëria në 11 vitet e fundit është mesatarisht 7.1% rritje në vit që nga 1998 - së bashku me një rritje mesatare të pagave (në terma reale) prej 36.5 % në vitet 2005-2008 dhe të pensioneve në vitet 2005-2007 me 17.4 %, ka kontribuar në këto rezultate. Si rezultat konsumi mesatar për frymë në terma reale është rritur me 7.0 % që nga 2005. Rezultatet e anketës tregojnë një ulje të ndjeshme të varfërisë në zonat rurale në periudhën 2005-2008. Zvogëlimi i shpejtë i varfërisë në zonat rurale nënkupton që varfëria mund të mos përbëjë më një problem kryesisht rural. Zona të tjera të Shqipërisë vazhdojnë të provojnë ulje të rëndësishme të nivelit të varfërisë. Zonat Qëndrore kanë patur uljen më të madhe të nivelit të varfërisë që nga viti 2005. Sidoqoftë, të dhënat tregojnë një ngadalësim të dukshëm të reduktimit të varfërisë në zonat malore, ku varfëria vazhdon të shfaqë nivelin më të lartë si dhe ulje jo të rëndësishme që nga 2005. Përafërsisht, 3.5 përqind e shqiptarëve vazhdojnë të jetojnë në varfëri ekstreme (me më pak se një dollar në ditë) dhe ekzistojnë pabarazi të dukshme midis zonave rurale dhe atyre urbane. Roli i rëndësishëm i rritjes së qëndrueshme ekonomike si dhe i reformave ekonomike, që kanë çuar në qëndrueshmërinë makroekonomike, qeverisjen e përmirësuar, zhvillimin e investimeve në sektorin privat, përftimin e shërbimeve sociale publike (arsim, shëndetsi dhe mbrojtje sociale), si dhe infrastrukturën e zgjeruar duhet të vazhdojnë të mbahen në të njëjtat nivele në mënyrë që të mbahen të ulëta edhe nivelet e varfërisë. Duke i drejtuar përpjekjet në zgjidhjen e problemeve të Zonës Malore, do të arrihet një ulje më e shpejtë e varfërisë në të ardhmen. Qeveria po adreson pabarazitë rajonale dhe nevojat e grupeve të brishta përmes strategjive, duke shënuar arritje të dukshme në lidhje me programeve për varfërinë me politikatat kombëtare ekonomike dhe financiare.

399. Në anekset bashkëlidhur Raportit, paraqiten karakteristikat e të varfërve sipas Anketës për Matjen e Standartit të jetesës 2002-2005 (Leaving Standart Measurement –LSMS).

b) Zbatimi i programeve kombëtare dhe monitorimi i tyre.

Mekanizmat e krijuara për zbatimin e të drejtave të parashikuara nga Konventa (nenet 6, 18 paragrafi 3,23,24,26 dhe 27 paragrafët 1-3), si dhe për monitorimin e saj.

400. Mekanizmat e krijuara për zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kuafizuara janë:

1) Këshilli Kombëtar për Çështje të Aftësisë së Kufizuar (krijuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 196, dt. 12.12.2005). 2) Sekretariati Teknik për Aftësinë e Kufizuar në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (krijuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 40, datë 23.03.2006), ka për detyrë monitorimin e progresit të objektivave të Strategjisë nga sektorët përgjegjës, mbledhjen e të dhënave në fushën e aftësisë së kufizuar, koordinimin e punës me pikat e kontaktit në ministrinë e linjës, pushtetin vendor dhe me shoqërinë civile. 3) Drejtoria e Politikave për Shanset e Barabarta në MPÇSHB. 4) Koordinatorët e ministrive. 5) Shërbimi Social Shtetëror dhe Zyrat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. 6) Njësitë e Pushtetit Vendor.

401. Mekanizmat për zbatimin e të drejtës për kujdesin shëndetësor:

Ministria e Shëndetësisë është ofruesi kryesor i kujdesit shëndetësor. E drejta për shëndet dhe mbijetesë garantohet në pjesën më të madhe nga shërbimet shëndetësore publike në nivelet e kujdesit shëndetësor parësor dhe spitalor.

Shërbimet e shëndetit publik dhe promocionit të edukimit shëndetësor që ofrohen në kuadrin e shëndetit parësor, mbështeten dhe mbikqyren nga Instituti i Shëndetit Publik.

402. Qendra Kombëtare për Mirërritjen dhe Zhvillimin e Fëmijëve, (krijuar në bazë të VKM nr. 325 datë 23.06.2000), institucion në varësi të MSH-së, u ngrit si një qendër diagnostikuese e trajtuese për problemet e zhvillimit dhe si një qendër trajnimi dhe kryerje studimesh shkencore në lidhje me mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Qendra ka një staf

multidisiplinar dhe nëpërmjet protokolleve klinike identifikon dhe trajton aftësinë e kufizuar që në fëmijërinë e hershme.

403. Sektori privat është akoma në hapat e para dhe mbulon pjesën më të madhe të shërbimit farmaceutik, shërbimit stomatologjik dhe disa klinika diagnostikuese, të cilat janë përqëndruar kryesisht në Tiranë. Sipas të dhëna të MSH-së, 84 klinika mjekësore ushtrojnë aktivitet privat për shëndetin e nënës dhe fëmijës dhe një pjesë e këtyre klinikave ofrojnë shërbimet e obstetrisë-gjinekologjisë, pediatriisë.

403. Në zbatim të ligjit “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjithëse prej vitit 1995 është krijuar Komiteti Kombëtar i Vaksinimit me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë. Ky Komitet drejtohet nga Zv Ministri i Shëndetësisë.

404. Me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë (nr. 58, datë 15. 02. 2008), është riorganizuar Komiteti Kombëtar i Shëndetit Riprodhues ku ndër detyrat e këtij Komiteti është vlerësimi dhe analizimi në vazhdimësi i situatës së shëndetit riprodhues në vend dhe në veçanti të shëndetit të gruas dhe fëmijës, pra i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë amtare dhe fëmijore. Komiteti i drejtuar nga Zëvendës Ministri i Shëndetësisë, ka në përbërjen e tij përfaqësues të institucioneve kryesore shëndetësore si dhe nga disa ministri të linjës që punojnë për të drejtat e fëmijës, si Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhe partnerë dhe organizata vendase dhe ndërkombëtare e të Kombeve të Bashkuara, si psh OBSH, UNICEF, USAID, UNFPA, etj

405. Qendra për edukimin e personelit mjeksor e krijuar në vitin 2008 po punon për të organizuar punën në trajnimin periodik të personelit shëndetësor, përcaktimin e kurrikulave të trainimit, etj. Gjatë periudhës 2004-2008 janë zhvilluar çdo vit trainime 2-3 ditore, dy javore, më personelin shëndetësor të shërbimeve të kujdesit për fëmijët në lidhje me shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve.

- **Masat ligjore dhe administrative për zbatimin e nenit 24 Kujdesi Shëndetësor**

406. Shëndeti i fëmijës, si një e drejtë bazë shëndetësore konsiderohet si prioritet në të gjitha politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Shëndetësisë. Kuadri ligjor i Sektorit të shëndetësisë, i cili garanton edhe të drejtën e fëmijës për kujdes shëndetësor:

407. Ligji për Kujdesin Shëndetësor nr. 3766, datë 17.12.1963 me ndryshimet e përkatëse paraqet kuadrin e përgjithshëm të organizimit dhe funksionimit të sektorit të shëndetësisë. Në këtë ligj kuadër parashtrrohet nocioni i përdorimit falas të kujdesit shëndetësor në të cilin përfshihen edhe fëmijët. Gjatë vitit 2008 MSH ka filluar punën për përgatitjen e një projekt ligj të ri kuadër për kujdesin shëndetësor.

408. Ligji nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për Shërbimin Spitalor në RSH-së” përcakton shërbimet në spitalet publike që duhet të ofrohen në nivel bashkie si dhe shërbimet e pediatriisë, obstetrik-gjinekologjisë.

409. Ligji për Sigurimin Shëndetësor 1993, (i ndryshuar në vitin 2002) përcakton kuadrin e përgjithshëm të financimit të sektorit të shëndetësisë, dhe Institutin e Sigurimit Shëndetësor si institucion të pavarur publik me buxhet të pavarur dhe cakton fazën e sigurimit të detyrueshëm kombëtar shëndetësor. Në ligj parashikohet se Shteti kontribuon edhe për fëmijët, nxënësit dhe studentët. VKM nr.383, datë 19.6.2004 “Për miratimin e procedurave, tarifave dhe masën e mbulimit të shërbimeve ekzaminuese unikalë, terciare të përfshira në sigurimin shëndetësor” përcakton se ISKSH mbulon shpenzimet për shërbimin e ekzaminimeve 100% për fëmijët 0-12 vjeç.

410. VKM nr. 84, datë 13. 2. 2003, për administrimin dhe mbulimin e shërbimeve nga personeli mjekësor, i përfshirë në skemën e sigurimeve shëndetësore përcakton se: 1) Kujdesi shëndetësor parësor jepet nga mjeku i përgjithshëm, mjeku i familjes, mjeku specialist dhe infermierët, që punojnë në shërbimin shëndetësor parësor. Mjeku i përgjithshëm, u jep shërbim shëndetësor të përgjithshëm të gjithë personave me moshë mbi 14-vjeç, në qytet. Mjeku i përgjithshëm për moshat 0-14 vjeç u jep shërbim shëndetësor të përgjithshëm të gjithë fëmijëve të kësaj moshe.

411. VKM nr. 419, datë 19.6.2003, "Për trajtimin e jetimeve me shërbim shëndetësor dhe me barna", përcakton se personat që kanë statusin e jetimit, që nuk janë në marrëdhënie pune, kanë të drejtë të përfitojnë shërbim shëndetësor dhe barna falas.

412. Ligji nr 7761, datë 19.10.1993 "Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse (i ndryshuar me ligjin nr 8484, 10.05.1999) ka për qëllim parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve dhe përfshin masat për zbulimin në kohë, evidentimin e shfaqjes, ndalimin e përhapjes dhe mjekimin e tyre. Në ligj përcaktohet se në raste të dyshimit të sëmundjeve ngjitëse në institucionet shkollore dhe parashkollore, mjeku i institucionit është i detyruar të njoftojë organet përkatëse dhe të kujdeset që sëmundjet të mos prekin fëmijët e tjerë, si dhe fëmijët e sëmurë të marrin kujdesin e duhur shëndetësor. Ligji parashikon se MSH harton dhe zbaton programin e gjërë të imunizimit (vaksinimit), si dhe përcakton kalendarin e vaksinimit të detyrueshëm kundër sëmundjeve të difterisë, kollës së mirë, tetanozit, fruthit, poliomiellit, tuberkulozit si dhe mënyrën e ruajtjes, të transportimit dhe të aplikimit të vaksinave. Ligji përcakton se vaksinimi i detyrueshëm realizohet në moshat 0-15 vjeç dhe në gratë shtatzëna nga këshillimoret nga mjeku i familjes, nga ambulancat dhe qendrat shëndetësore. Institucionet duhet të sigurojnë evidentimin e saktë të kontigjenteve që i nënshtrohen vaksinimit, planin e vaksinimit dhe sasi të nevojshme të vaksinave të ruajtura në kushtet e "zinxhirit të ftohtë". Për çdo fëmijë që hyn për herë të parë në shkollë (6-7 vjeç), detyrohet pajisja e tij prej institucioneve shëndetësore me një dokument që provon vaksinimin e kryer sipas kalendarit. Në vitin 2000 është miratuar Strategjia Kombëtare për Vaksinimin e cila është rishikuar dhe përditësuar në vitin 2009-2010. Në Institutin e Shëndetit Publik, zbatohet Programi Kombëtar për Vaksinimin.

413. Ligji nr. 8876 datë 4.4.2002 "Për shëndetin riprodhues" përcakton dhe garanton mbrojtjen e të drejtave riprodhuese të çdo individit në RSH-së. Ky ligj parashikon se mëmësia e sigurt kupton të drejtën që çdo grua të marrë kujdesin që i nevojitet për të pasur një shëndet të mirë nga shtatzënia deri në lindjen e fëmijës. Elementet kryesore për të siguruar mëmësinë e sigurt përfshijnë aksesin për kujdes me cilësi të lartë përpara lindjes, gjatë dhe pas lindjes, parandalimin e shtatzënive të padëshiruara, parandalimin e abortit të pasigurt dhe të lindjes së parakohshme. Ligji parashikon të drejtën e individit dhe çifteve që të përfitojnë nga përdorimi i metodave të sigurta, të përbalueshme dhe të pranueshme të planifikimit familjar. Kjo mbron veçanërisht gruan nga një shtatzëni e padëshiruar që mund të ketë pasoja mbi shëndetin e saj fizik (aborti) dhe mendor dhe shëndetin e fëmijës. Ligji parashikon se të gjithë individët dhe çiftet kanë të drejtë të përfitojnë shërbime të përshtatshme të kujdesit shëndetësor për të pasur shtatzani dhe lindje të sigurt dhe një fëmijë të shëndetshëm. Shërbimet e planifikimit familjar, duhet të përdoren dhe promovohen si mjet për shmangien e shtatzënive të padëshiruara. Çdo grua ka të drejtën për mbrojtje shëndetësore gjatë shtatzënisë së saj, asistencë gjatë lindjes dhe të përfitojë zbatimin e metodave që minimizojnë rrezikun për shëndetin e saj, ose shëndetin e fetusit dhe të porsalindurit dhe fëmijës. Ligji parashikon gjithashtu se mëmësia dhe fëmijëria kanë të drejtën për kujdes shëndetësor dhe mbështetje të veçantë. Të gjitha gratë shtatzana përfitojnë falas ndjekjen periodike mjekësore të shtatzanisë, lindjes dhe pas lindjes, veçanërisht ekzaminimet e paralindjes dhe paslindjes, të detyrueshme. Gratë shtatzëna kanë të drejtë të kryejnë pa pagesë ekzaminimet e detyrueshme të

përshkruara nga mjeku dhe të marrin falas fletoren personale të ndjekjes së shtatzënisë. Të gjithë fëmijët 0-6 vjeç përfitojnë masa parandaluese shëndetësore, si dhe kontroll e ndjekje mjeksore falas.

414. Gjithashtu është miratuar: 1) Rregullorja e Shërbimeve të Shëndetit Riprodhues në Kujdesin Shëndetësor Parësor (nr. 147, datë 11.04.2003) e cila përcakton strukturat dhe shërbimet e shëndetit riprodhues në Kujdesin Shëndetësor Parësor; rregulloret e funksionimit të tyre dhe detyrat e stafit shëndetësor që punon në këto shërbime. 2) Udhëzimi Ministrit të Shëndetësisë nr. 146 datë 11.04.2003 lidhur me ndjekjen dhe kontrollin periodik të detyrueshëm mjekësor të shtatzanisë, lindjes dhe pas lindjes, si dhe ekzaminimet dhe kontrollet që duhen kryer për fëmijët 0-6 vjeç. 3) Kartela e këshillimores së gruas, e cila do të shërbejë si një dokumentacion i unifikuar për tu përdorur nga të gjitha shërbimet shëndetësore publike dhe private për ndjekjen e gruas gjatë shtatzënisë; 4) Kartela e këshillimores së fëmijës, që do të shërbejë si një dokumentacion i unifikuar për tu përdorur nga të gjitha shërbimet shëndetësore publike dhe private për ndjekjen e rritjes dhe zhvillimit të femijeve 0-6 vjeç; 5) Fletorja personale e gruas shtatzënë e cila sipas nenit 24 të ligjit duhet t'i jepet falas gruas shtatzënë; 6) Fletorja personale e shëndetit të fëmijës që jepet falas për çdo fëmijë të porsalindur, gjatë vizitave të kontrollit për mirërritjen dhe zhvillimin.

415. Për zbatimin e ligjit për Ushqyerjen me gji janë miratuar Urdhri nr 157, datë 9.04.2002 për mbrojtjen e ushqyerjes me gji dhe Udhëzimi për krijimin e Shërbimeve Mik të Fëmijës, Nr 1262/1, datë 9.04.2002.

416. Ligji "Për shërbimin Shëndetësor stomatologjik", datë 9.06.2008 parashikon mjekimin falas të fëmijëve 0-18 vjeç.

417. Ligji nr. 9518, datë 18.4.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit" ka si qëllim parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumimi i alkoolit, nëpërmjet përdorimit të pijeve alkoolike nga të miturit. Ligji parashikon ndalimi dhe shitja ose ofrimi falas i pijeve alkoolike të miturve, apo konsumimi i tyre në vende publike nga të miturit, në shkollë dhe mjediset shkollore. Gjithashtu, përveç rasteve kur është i shoqëruar nga prindi ose kujdestari i tij, një i mitur nuk mund të frekuentojë, nga ora 22.00 deri në orën 6.00, një bar apo lokal nate, në të cilin tregtohet pije alkoolike. Ligji parashikon se ndalohet çdo lloj reklamimi i pijeve alkoolike në institucionet arsimore për të mitur. Për më tepër ndalohet çdo formë reklame e pijeve alkoolike, që u drejtohet të miturve, si dhe ndalohet çdo reklamë e pijeve alkoolike në sallat e kinemave apo teatrove, gjatë shfaqjes për të mitur.

418. Ligji nr. 9636, datë 6.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", ka si qëllim mbrojtjen e shëndetit publik, nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit të tyre. Ligji përcakton ndalimin e shitjes ose furnizimit, për qëllime tregtimi, i produkteve të duhanit personave nën moshën 18 vjeç. Gjithashtu ndalohet shitja e produkteve të duhanit në mjediset publike, që përfshin: institucionet shëndetësore; institucionet arsimore; institucionet sportive etj. Ligji mbron nga ekspozimi në mënyrë të pavullnetshme ndaj tymit të duhanit, duke ndaluar pirjen e duhanit në mjediset e punës; institucionet shëndetësore; institucionet arsimore; mjetet e transportit publik; mjediset tregtare, bare, restorante, diskoteka, mjediset e tjera publike. Në zbatim të këtij ligji, janë organizuar disa aktivitete në nivel kombëtar. 1) Në institucionet shëndetësore dhe Inspektoriatin Sanitar Shtetëror, përgjegjës për kontrollin e zbatimit të ligjit, është bërë njohja me ligjin si dhe hartuar rregulloret përkatëse me detyrimet që kanë këto institucione për zbatimin e tij. 2) Promocioni në media lidhur me ligjin, lidhur me ndalimin e reklamës së produkteve të duhanit, për ndalimin e reklamave radiofonike dhe televizive etj. 3) Gjithashtu janë shpërndarë materiale promocionuese fletë palosje, postera, janë organizuar emisione televizive lokale dhe seminare edukimi dhe informimi me nxënës të shkollave të mesme, për njohjen

me Ligjin . 4) Në vijim të kësaj iniciative Ministria e Shëndetësisë, më datë 07.02.2008, ka urdhëruar caktimin e një Koordinatori Lokal në rreth dhe ngritjen e Grupeve Rinore Vullnetare për luftën kundër drogës, duhanit dhe alkoolit. Këto grupe funksionojnë në të gjitha rrethet e vendit, pranë Drejtorive të Shëndetit Publik dhe rezultat e para janë optimiste. 5) Në zbatim të Urdhrit nr.39.datë 07.02.2008 “ Për Koordinatorët Lokalë mbi Luftën kundër Drogës, Duhanit, Alkoolit”, 419. Instituti i Shëndetit Publik, Sektori i Abuzimit me Substancat ka kryer trajnime për grupet rinore lokakë dhe specialistë të shëndetit , të cilët tashmë janë funksionalë në të gjitha shkollat e vendit. Gjithashtu po kryhen trajnime edhe me studentët e Fakultetit të Mjeksisë e Infermierisë në Tiranë dhe në rrethe. Janë tashmë të trajnuar 620 të rinj në 5 rrethe të vendit, të cilët do të jenë në një farë mënyre paraprijës së bashkëmoshatarëve të tyre dhe do të drejtojnë fushatat antiduhan në vendin tonë. 6) Janë kryer një sërë aktiviteteve sidomos me të rinjtë e shkollave. Janë shpërndarë materiale informative nga Instituti i Shëndetit Publik dhe drejtoritë e shëndetit publik dhe janë trajnuar grupe mjekësh dhe të rinjsh. 7) Në 2008 nënkomisioni parlamentar mbi çështjet sociale në bashkëpunim me Këshillin e Europës, UNICEF, Ministrinë e Kulturës dhe parlamentet rinore kanë nisur një fushatë me logon “jeto shëndetshëm”. Qëllimi i fushatës është rritja e ndergjegjësisimit midis adoleshentëve me qëllim praktikimin e një stili të shëndetshëm të jetesës, përfshi parandalimin e duhanit, alkoolit dhe drogave.

420. Ligji nr 9942, 26/6. 2008 “Për parandalimin e çrregullimeve nga pamjaftueshmëria jodike në organizmin e njeriut”, synon në eliminimin e pasojave që sjell mungesa e jodit në organizmin e individit veçanërisht tek gratë gjatë periudhës së shtatzënisë, ushqyerjes me gji dhe fëmijët e vegjël, nëpërmjet strategjisë së jodizimit universal të kripës për konsum human dhe shtazor.

421. Ligji nr.10139, datë 11.05.2009 “Për shëndetin Publik” ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe promovimin e jetesës së shëndetshme të popullsisë. Në ligj janë përfshirë disa dispozita në mbrojtje të shëndetit të fëmijëve, imunizimin, Komitetin Kombëtar të Imunizimit, mbrojtjen e shëndetit nga përdorimi i duhanit dhe alkoolit. Gjithashtu në ligj përcaktohet se fëmijët dhe gratë gjatë shtazanisë, lindjes dhe paslindjes kanë të drejtën e përfitimit të kujdesit shëndetësor, pavarësisht nga aftësia e tyre për të paguar.

422. Për mbrojtjen e shëndetit të fëmijës nga rreziqet e mjedisit në kuadrin e Strategjisë “Për mbrojtjen e fëmijës dhe mjedisit (CEHAPE)” është aderuar në Protokollin e Kyotos lidhur me cilësinë e ajrit (dhjetor 2004) janë nënshkruar nga Parlamenti Shqiptar, Ligji për aderimin e Shqipërisë në Protokollin e Kyotos, më 16 dhjetor 2004. Në vitin 2004 është ratifikuar nga Shqipëria, Konventa e Stokolmit për reduktimin e sëmundjeve nga ekspozimi ndaj lëndëve të rrezikshme, agjentëve biologjike dhe ambienteve të rrezikshme të punës. Lidhur me cilësinë e ujit të pijshëm është ratifikuar protokollin për ujin dhe shëndetin (me ligjin nr. 8849, datë 27 dhjetor 2007).

423. Në kuadrin e reformës në Kujdesin Shëndetësor Parësor në janar të 2009 u miratua Paketa Bazë e Shërbimeve në Kujdesin Shëndetësor Parësor, ku një pjesë të rëndësishme zënë shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijët dhe kujdesi për shëndetin riprodhues për gratë e mëmësinë e sigurt. VKM “Për Financimin e Shërbimeve Shëndetësore Spitalore nga Skema e Detyrueshme e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor” (i vitit 2008) përcakton financimin nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore të shërbimeve të ofruara në spitalet publike ku parashikohet edhe shërbimi pediatrikë së përgjithshme dhe lista e specialiteteve për fëmijë që përfshihen në këtë shërbim spitalor (urgjencat pediatrike, pediatria infektive, pediatria e specialiteteve, kirurgjia infantile, reanimacioni pediatrik, etj). Aktualisht MSH-së është duke punuar për përgatitjen e paketës së shërbimeve spitalore që do të financohen nga kjo skemë, rishikimin e treguesve të matjes së performancës spitalore, dhe standarteve të cilësisë, përcaktimin e sistemeve të referimit, për përcaktimin e kategorive të shtetasve që do të kontribuojë shteti (fëmijët deri në 18 vjeç, gratë shtatzëna, etj)

423. Në SKF janë parashikuar një sërë objektivash lidhur me realizimin e të drejtës së fëmijës për shëndet e zhvillim, konkretisht: 1) Përmirësimi i kujdesit për shëndetin e nënës dhe fëmijës; 2) Përmirësimi i edukatës dhe promocionit të shëndetit tek fëmijët; 3) Përmirësimi dhe ndjekja e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve; 4) Fuqizimi i shërbimit publik dentar dhe përmirësimi i aksesit dhe cilësisë ndaj këtij shërbimi; 5) Zbatimi dhe monitorimi i Strategjisë Kombëtare të HIV/AIDS, reduktimi i transmetimit të virusit HIV nga nëna tek fëmija; 6) Përmirësimi i ushqyerjes së fëmijës; 7) Një mjedis më i mirë për fëmijë më të shëndetshëm. Për realizimin e këtyre objektivave janë përcaktuar një sërë masash: 1) Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe sëmundjeve parandaluese të fëmijërisë me anën e vaksinave, duke rritur mbulesën vaksinale dhe zgjeruar kalendarin bazë të vaksinimit me vakcina të reja. 2) Vaksimi i plotë dhe në kohë i të gjithë fëmijëve simbas kalendarit kombëtar të vaksinimit, zgjerimi i skemës kombëtare të kalendarit të vaksinimit nëpërmjet futjes së vaksinave të reja. 3) Hartimi dhe zbatimi politikave për arritjen e grupeve me rrezik të lartë, grupeve të marginalizuar në skemën e vaksinimit. 4) Pakësimi rasteve të sëmundjeve kryesore të fëmijërisë që janë shkaktarët kryesore për vdekshmërinë dhe sëmundshmërinë feminare, nëpërmjet strategjisë së manaxhimit të integruar të sëmundjeve kryesore të fëmijërisë. 5) Përmirësimi i gjëndjes ushqyese të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël nëpërmjet: nxitjes të ushqyerjes me qumësht gjiri për 6 muajt e parë të jetës së foshnjës, përmirësimit të praktikave të ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve të vegjël për të mënjnuar kequshqyerjen tek këto grup moshë. 6) Parandalimi i pamjaftueshmërive nga lëndët ushqyese, mineralet e vitaminat; si psh pamjaftueshmërisë nga mungesa e jodit, vitaminës D, hekurit, etj. 7) Nxitja e zhvillimit të shëndetshëm fizik, psikoemocional dhe social të fëmijës. Edukimi familjes dhe komuniteteve, veçanërisht të zonave rurale mbi praktikën bashkëkohore për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijës. 8) Rritja e njohurive të personelit të kujdesit shëndetësor për nënën dhe fëmijën, veçanërisht të punonjësve të kujdesit shëndetësor parësor lidhur me ndjekjen e rregullt dhe të vazhdueshme të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve 0-6 vjeç. 9) Trajnimi i personelit shëndetësor lidhur me zhvillimin dhe shëndetin e të rinjve dhe nevojat e veçanta të kësaj moshe. 10) Përcaktimi i standarteve të shërbimeve miqësore për të rinjtë dhe sigurimi i aksesit për këto shërbime. 11) Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi, braktisja, shfrytëzimi dhe dhuna. Parandalimi i praktikave në familje që nxisin diskriminimin me bazë gjinore.

424. Ligji nr. 9952, datë 14.7.2008 “Për parandalimin e HIV/AIDS-it në RSH-së”, përcakton si politikë shtetërore për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS, mbështetjen për parandalimin dhe kontrollin e transmetimit nga nëna tek fëmija. Ky ligj përcakton detyrimet institucionale arsimore publike dhe private për nxënësin, studentin me HIV/AIDS. Njësitë e qeverisjes vendore si detyrë për të mbështetur dhe kujdesur për personat me HIV/AIDS e familjet e tyre duke lehtësuar integrimin në komunitet dhe shoqëri, nëpërmjet programeve dhe shërbimeve të caktuara. Ligji përcakton parandalimin e kontrollit të transmetimit të HIV/AIDS nga nëna tek fëmija. Gjithashtu personat nën 18 vjeç të infektuar me HIV/AIDS përfitojnë ndihmë shoqërore në të holla, ose shërbime. Fëmijët e infektuar me HIV/AIDS të cilët janë të braktisur dhe ata që kanë humbur lidhjet me familjet e tyre ose aftësinë për të punuar, merren në përkujdesje nga institucionet e shërbimeve sociale shtetërore (institucionet rezidenciale të përkujdesjes sociale) ose private.

425. Strategjia e Promocionit dhe Edukimit Shëndetësor përfshin objektivat dhe aktivitetet për promocionin dhe edukimin shëndetësor lidhur me shëndetin e nënës, fëmijës (aktualisht është në proces rishikimi dhe përditësimi). Politikat dhe strategjitë e MSH synojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të shëndetit të grave dhe fëmijëve dhe të cilësisë së jetës së tyre, duke ndikuar në uljen progresive të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë së tyre. Gjatë kësaj periudhe ndërhyrjet kryesore për të garantuar një shëndet më të mirë për fëmijët kanë konsistuar në: 1) përmirësimin dhe integrimin e strukturave të shërbimit shëndetësor të gruas dhe fëmijës në të tre nivelet e kujdesit; 2) përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të nënës dhe fëmijës në tre nivelet e kujdesit, nëpërmjet unifikimit të

protokolleve standart për ndjekjen e shëndetit të gruas dhe fëmijës; 3) përmirësimin e nivelit shkencor dhe teknik të njohurive të personelit shëndetësor nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të gjithë personelit shëndetësor që punon në këto shërbime. 4) plotësimin dhe përforcimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e shëndetit të gruas dhe fëmijëve. 5) sensibilizimin, edukimin dhe mobilizimin e gjithë shoqërisë, mas medias, etj, për të kuptuar se kujdesi për gruan dhe fëmijën përbën një prioritet kryesor. Rekomandimet e MSH për kujdesin për fëmijën mbas lindjes së fëmijës, ofrojnë kujdes pas lindjes për nënën dhe foshnjën, që duhet të përfshijë këshillimin rreth ushqyerjes me gji, ushqyerjen dhe planifikimin familjar.

426. Imunizimi i fëmijëve është një nga prioritetet e MSH-së. Shqipëria ka një skemë vaksinimi të detyrueshëm kundër sëmundjeve kryesore të fëmijërisë të parandalueshme me vaksinat: (Difteria, Tetanozi, Pertusi, TBC, Polio, Fruthi, Rubeola, Parotiti Hepatiti B, Hb). Studimet kanë treguar se mbulesa vaksinale për këto sëmundje është e lartë mbi 97% të fëmijëve (ISHP). Gjatë vitit 2002 u zhvillua dhe përfundoi me sukses edhe Programi Kombëtar i Vaksinimit të Femrave në moshë riprodhuese (16 – 35 vjeç) me vaksinën Fruth/Rubeolë. Në vitin 2002 Shqipëria u çertifikuua nga OBSH si vend pa poliomielit dhe është duke zhdukur fruthin (gjatë vitit 2002 dhe në vitin në vazhdim nuk është raportuar asnjë rast). Në vitin 2005 në vaksinën Fruth –Rubeolë u shtua komponenti i vaksinës së parotitit, fruth-Rubeolë-Parotit(FRP). Në vitin 2008 MSH aplikoi pranë Aleancës Globale për Vaksinat (GAVI), dhe fitoi duke i shtuar skemës së detyrueshme të vaksinimit edhe një komponent tjetër të vaksinës së Haemophilus influenzae tip b ose Hib e cila mbron moshat e fëmijëve të vegjël kundër sëmundjes së meningitit që shkakton një vdekshmëri të lartë tek këto grup moshë. Në këtë mënyrë bëhet e mundur të fillojë futja e saj në kalendarin kombëtar të vaksinimit në 3-mujorin e parë të vitit 2009, kur fillon përdorimi i saj si pjesë përbërëse e vaksinës së kombinuar pentavalente DTP-HepB-Hib. Shqipëria ka një Plan Kombëtar Veprimi për Imunizimin dhe po përgatit Strategjinë e re të Imunizimit për periudhën 2009-2015. Që nga viti 2004 të gjitha vaksinat blihen me fondet e shtetit shqiptar.

427. Politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Shëndetësisë e konsiderojnë shëndetin e gruas dhe të fëmijëve si një pjesë shumë të rëndësishme dhe e vendosin atë në qendër të shërbimeve të shëndetit riprodhues duke synuar të integrojnë shërbimet shëndetësore të shëndetit riprodhues në tre nivelet e kujdesit shëndetësor me prioritet kujdesin shëndetësor parësor. Shërbimet shëndetësore të kujdesit për gruan ofrohen falas në tre nivelet e kujdesit dhe janë të integruara në shërbimet tona shëndetësore si më poshtë: 1. Në Kujdesin Shëndetësor Parësor: Në zonat rurale: a) ambulancat ku punon mamia që ndjek gruan gjatë shtatzënisë lindjen normale dhe pas lindjes. b) Qendrat shëndetësore në nivel komune ku shërbejnë mjeku i familjes, dhe infermieret e mamite që ndjekin shëndetin riprodhues të grave përfshirë edhe shëndetin amtar. 3) Në qytet -Konsultoret e nënës ku janë përfshirë edhe Qendrat e planifikimit familjar. Detyrat e Konsultoreve të gruas janë: a) Ndjekja antenatale e gruas shtatzënë; b) Edukimi shëndetësor, për shëndetin riprodhues; c) Parandalimi, Zbulimi, Trajtimi dhe Ndjekja e Patologjive në Sistemin Riprodhues. 4)Këshillimi dhe ofrimi i metodave kontraceptive. Edukimi shëndetësor për Planifikimin Familjar. 2) Në kujdesin shëndetësor spitalor- Maternitetet e spitaleve të rretheve. Në të gjitha spitalet e rrethit ekzistojnë repartet e maternitetit-neonatologjisë dhe për vitin 2007 në nivel vendi janë gjithsej 37, ndërsa reparte neonatologjie janë në 25 spitale të vendit. Numri i shtretërve obstetrikës për vitin 2005 ishte 1077, dhe gjinekologjisë 472, ndërsa për vitin 2007 raportohen 1267, shtretër të obstetrikës dhe 524 gjinekologjisë, ndërsa numri i shtretërve të neonatologjisë të përfshira në maternitetet e vendit është 549 për vitin 2006 dhe 703 për vitin 2007. 3. Në kujdesin shëndetësor tretësor- Spitalet Universitare të Obstetrik-Gjinekologjisë në Tiranë. Në të gjitha shërbimet shëndetësore për gruan ofrohet edhe informacion, këshillim edukim për shëndetin e gruas, amësinë, shëndetin riprodhues, metodat kontraceptive, etj. Kujdesi antenatal ka si qëllim të ofrojë përkrahje dhe udhëzime për gruan shtatzëninë, partnerin dhe familjen e saj, duke i ndihmuar në periudhën e tranzicionit që ata presin të

bëhen prinder. Protokollin e kujdesit paralindjes në Shqipëri përfshin vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut, nëpërmjet disa ekzaminimeve dhe analizave laboratorike, depistimin për infeksione seksualisht të transmetueshme, izoimunizimi Rh, edukimin shëndetësor për shenjat e rrezikut gjatë shtatzanisë, ushqyerjes, ushqyerja me gji, etj. Në paketën e kujdesit para lindjes të ofruar nga shërbimet shëndetësore të kujdesit për nënën një komponent me rëndësi është shpërndarja e informacionit shëndetësor. Këshillimi përfshin informacionin mbi sjelljet e nënës ndaj ekspozimeve që mund të prekin shëndetin e fetusit, ushqyerjen, pushimin dhe shenjat e simptomat e herëshme të komplikacioneve të shtatzanisë. Më tej me afrimin e kohës së lindjes këshillimi duhet të përgatisë gruan për atë që ato do të përballen kur të lindin, të shpërndajë informacion të saktë në lindje me aktivitetin e lindjes. Gjithashtu gjatë periudhës para lindjes fillon këshillimi rreth ushqyerjes me gji dhe planifikimit familjar mbas lindjes dhe me kujdesin pas lindjes.

428. Në vitin 2002 Ministria e Shëndetësisë aprovoi Strategjinë e Shëndetit Publik dhe të Promocionit të Shëndetit “Drejt një vendi të shëndetshëm me njerëz të shëndetshëm”. Në strategjinë theksohet rëndësia e promocionit në fushën e shëndetit të nënës dhe fëmijës. Në vitin 2008 u bë rishikimi i strategjisë me qëllim përmirësimin sidomos të shëndetit të nënës dhe fëmijës ku zë vend të veçantë : 1) Rritja e njohurive të personelit shëndetësor mbi informimin, edukimin, këshillimin për ruajtjen apo, përmirësimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës. 2) Rritja e njohurive të nënave, fëmijëve mbi informimin, edukimin, këshillimin për ruajtjen, apo përmirësimin e shëndetit të tyre . 3) Përfshirja në kurrikulën shkollore e tematikave për sjellje të shëndetshme të fëmijëve, etj. 3) Trajnime të mësuesve për problemet e ruajtjes, apo përmirësimin e shëndetit të fëmijëve. 4) Riorientimin e shërbimeve shëndetësore, kryesisht të kujdesit parësor edhe në informimin, edukimin, këshillimin e pacientëve.

429. Gjatë periudhës 2004 -2008 janë zhvilluar një sërë aktiviteteve promovuese për shëndetin e nënës dhe fëmijës. 1) Kryerja e aktiviteteve sensibilizuese si për ushqyerjen me gji të fëmijës, ushqyerjen e fëmijës. 2) Kryerja e aktiviteteve ndërgjegjësuese për sigurinë rrugore pranë shkollave mbasi vdekjet e fëmijëve deri në 14 vjeç për shkak të këtyre aksidenteve zënë rreth 13 % të aksidenteve në tërësi. Zgjidhja e vëmendjes së fëmijëve bën që të nxisin politikat që të orjentojnë më mirë nga ana e të drejtave të tyre dhe të qytetarëve për më shumë siguri në rrugë. 3) Workshop me mediat si duhen trajtuar vetvrasjet. 4) Trajnime të medias për probleme të ndryshme të shëndetit publik si problemet e duhanit, drogës, alkoolit, shëndetit mendor, IST, etj. 5) Përdorimi i të gjitha formave të mass-medias si, biseda në televizion, në radio, shkrime në gazetat e ndryshme të vendit, revistat e ndryshme për tematika të ndryshme që lidhen me shëndetin e nënës dhe fëmijës. 6) Fletë palosje apo libertha për ushqyerjen me gji, gruaja dhe bebi në bark e saj, broshura për përdorimin e kripës së jodizuar, etj që janë shpërndarë në komunitete dhe shkollave të rretheve të vendit. 7) Konkurse midis nxënësve në shkollat nëntë vjeçare të disa rretheve për kripën e jodizuar. 8) Trajnime me mësueset e biologjisë sidomos të zonave më të prekura nga deficienca jodike si qarku i Elbasanit dhe Pogradeci gjatë vitit 2008. 9) Aktivitete informuese në komunitet nga organizmat (projekte) si USAID, UNICEF, UNFPA, Kryqi i Kuq Amerikan, Kryqi i Kuq Shqiptar, Korpusi i Paqes, Caritasi shqiptar, etj si dhe OJF të ndryshme që veprojnë në fushën e shëndetit. Aktivitetet e tyre kryesisht kanë qënë për rëndësinë e ushqyerjes me gji, avantazhet e gjirit, planifikim familjar, kujdesin para lindjes dhe pas lindjes, etj. 10) Trajnime të personelit të kabineteve të edukimit në 36 rrethe të vendit për problemet e shëndetit të nënës dhe fëmijës. Këtu duhet thënë se ende punonjësit e promocionit nuk mbulojnë të gjitha bashkitë, apo komunat, veçanërisht në ato rurale. 11) Nga viti 2008, botohet Revista e Shëndetit riprodhues, çdo tre muaj me tematikë për shëndetin e nënës, fëmijës, adoleshentëve, shtatzaninë, ushqyerjen e tyre, zhvillimin e fëmijës, etj. 12) Trajnime nga personeli i kabineteve të edukimit në pesë qarqe të vendit si në Shkodër, Berat, Korçë, Lezhë, Dibër në bashkëpunim me projektin e Pro Shëndetit–USAID në komunitet për probleme të ushqyerjes së fëmijëve, mirërritjes së tyre dhe planifikim familjar.

430. Në masat për përmirësimin e sistemit të edukimit dhe të trajnimit të personelit shëndetësor mund të përmendim: Trajnime të herë pas herëshme nga organizmat si USAID, UNICEF, UNFPA, Kryqi i Kuq Amerikan, Kryqi i Kuq Shqiptar, Korpusi i Pages, Caritasi shqiptar, etj si dhe OJF të ndryshme që veprojnë në fushën e shëndetit në zonat më problematike për problemet e shëndetit të nënës dhe fëmijës si zonat veri- lindore. Gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2008 u hartua paketa e shërbimit të promocionit dhe edukimit të shëndetit që duhet të ofrojë një qëndër shëndetësore në vendin tonë. Paketa përmban dy programe: 1) Programi i trajnimit të personelit shëndetësor për problemet e informimit, edukimit e këshillimit të nënës dhe fëmijës. 2) Programi me tematikat që personeli i qëndrës shëndetësore duhet ti ofrojë prindërve, fëmijëve, nënave, komunitetit. Sipas kësaj pakete në kujdesin parandalues dhe edukimin për fëmijën personeli shëndetësor duhet të ofrojë informim, edukim e këshillim të nënës dhe fëmijës lidhur me këto çështje: 1) Monitorimin e rritjes dhe zhvillimit të fëmijës: a) ndjekja, kontrolli i shëndetit dhe zhvillimi i fëmijëve si dhe edukimi, këshillimi dhe informimi i familjes dhe komunitetit, lidhur me kujdesin për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijës; b) zbatimi i një programi të veçantë, intensiv për ndjekjen dhe kontrollin e fëmijëve me kequshqyerje (nën peshë dhe obezë). c) zbatimi i programeve kombëtare për parandalimin e insuficiencës jodike. 2) Depistimin e problemeve të dëgjimit dhe shikimit: a) referimi i të gjithë fëmijëve deri në 3 vjeç tek specialisti për vlerësimin e dëgjimit dhe bërjen e audiogramës; b) vlerësimi i mprehtësisë së pamjes në moshën 6 vjeç dhe referimi tek specialisti për saktësim diagnoze dhe korigjimin përkatës. 3) Kryerja e aktivitetit në përputhje me Programin Kombëtar të Imunizimit. 4) Menaxhimi në shtëpi të sëmundjeve më të zakonshme tek fëmijët . a) këshillimi i prindërve për parandalimin e aksidenteve në shtëpi, sigurinë në makinë (vendi për fëmijët, rripi i sigurimit) parandalimn e helmimeve aksidentale si dhe për ndihmën e parë që duhet të jepet sipas rastit; b) vlerësimi i fëmijës në çdo vizitë për shenja të dhunës fizike dhe asaj psikologjike; trajtimi sipas mundësisë, plotësimi i dokumentacionit sipas rregullave në fuqi dhe referimi në rast nevojë. c) këshillimi i adoleshentëve gjatë vizitës mbi rreziqet e duhanit dhe drogës (duke e dokumentuar).

431. Shërbime të vecanta të promocionit në komunitet që duhen ofruar janë: a) Edukimi në lidhje me parandalimin e abuzimit tek fëmijët. b) Edukimi në lidhje me parandalimin e duhan pirjes. c) Edukimi në lidhje me parandalimin e abuzimit me droga. d) Edukimi në lidhje me sigurinë në makinë. Promocioni lidhur me kujdesin parandalues dhe edukimin e nënave dhe komunitetit për: planifikimin e shtatzanive dhe kontracepsionin, kujdesin antenatal dhe postnatal, edukimin në lidhje me parandalimin e HIV dhe IST, manaxhimi i dhunës në familje, edukimi në lidhje me ushqyerjen e shëndetëshme, kontrollin e peshës, me duhan pirjen, përdorimin e alkolit dhe drogave.

432. Mbështetur në numrin e personave të diagnostikuar dhe raportuar Shqipëria vazhdon të mbetet një vend me prevalencë të ulët të infeksionit HIV. Megjithatë vërehet një tendence në rritje e numrit të rasteve të reja dhe vlerësimet sugjerojnë për një numur më të madh të rasteve të padiagnostikuara. Nga ana tjetër, vlerësimet e ndryshme që janë bërë, tregojnë se vendi ynë mund të përballet me një rritje të shpejtë të numrit të rasteve, nëse nuk merren masat e duhura për parandalimin e epidemisë e në mënyrë të veçantë te grupet me risk më të lartë dhe me vulnerabël të popullatës.

433. Duke reflektuar dhe përshtatur zhvillimet intensive të zbatimit të strategjisë së mëparshme u bë rishikimi i saj dhe u hartua Strategjia e re për Kontrollin e HIV/AIDS në Shqipëri. Duke filluar nga viti 2007 me mbështetjen e financiare të Fondit Global u bë e mundur ngritja e qëndrave të Këshillimit dhe Testimit Vullnetar në disa rrethe (Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Korçë, Lezhë, Shkodër, Gjirokastrë, Berat dhe Elbasan). Ofrimi i këtij shërbimi ka ndikuar në rritjen e numrit të personave të testuar vullnetarisht. Vëmendje i është kushtuar zgjerimit të shërbimeve të ofruara për grupet vulnerabël, nëpërmjet forcimit të rrjetit të partnerëve dhe me pjesëmarrjen aktive të tyre.

Janë zgjeruar programet e reduktimit të dëmit për përdoruesit e drogave me injektim. Tashmë katër NGO ofrojnë shërbime të tilla në Tiranë, ndërkohë që po punohet dhe për shtrirjen e tyre në rrethe të tjera. Këtë vit u bë e mundur dhe hapja e një qëndre të re për Terapinë Zëvendësuese me Metadon në qytetin e Durrësit dhe po planifikohet për hapjen e qëndrave të reja dhe në dy rrethe të tjera. Në Tiranë është bërë e mundur hapja e një drop-in center për MSM dhe një qëndër këshillimi.

434. Ministria e Shëndetësisë në kuadrin e masave për përmirësimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës ka disa programe kombëtare bashkëpunimi me qeveri të huaja, organizma dhe agjensi të Kombeve të Bashkuara. Programi: Ta bëjmë Shtatzaninë të Shëndetshme MPS, Promovimi efektiv i Kujdesit Perinatal (PEPC) (Making Pregnancy Safer/Promoting effective Perinatal Care (OBSSH/UNICEF/UNFPA). Ky Program ka si synim t'u sigurojë fëmijve një fillim të shëndetshëm në jetë duke reduktuar sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë amtare dhe perinatale nëpërmjet promovimit të mëmësisë së sigurt. Komponentët e këtij programi kombëtar që ka filluar në vitin 2002 n janë: Trajnimi i Punonjësve të shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor (KSHP) për nënën dhe të porsalindurin, për kujdesin antenatal dhe postnatal dhe kujdesin për të porsalindurin dhe ushqyerjen me gji. Hartimi i protokolleve të unifikuara për kujdesin para dhe pas lindjes, kujdesin për të porsalindurin për kujdesin shëndetësor parësor. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit dhe supervizionit të shërbimeve të nënës dhe fëmijës në KSHP. Gjatë zbatimit të këtij programi për periudhën 2004-2008 janë zhvilluar trajnime me personelin shëndetësor të disa rrethëve të vendit si Shkodër, Vlorë, Korçë. Janë trajnuar gjithsej 70 mjek familje dhe 30 personel shëndetësor. Janë përgatitur protokollat e kujdesit antenatal për gratë shtatzëna. Janë zhvilluar materiale promocionale për shëndetin e nënës, në disa rrethe të vendit.

435. Programi për nxitjen e ushqyerjes me gji dhe krijimin e spitaleve mike të fëmijës (SMF) 1996 e në vazhdim: UNICEF-MSH ka si objektiva: Përmirësimi i praktikave të ushqyerjes me gji, trajnimit të personelit shëndetësor dhe Informimi, Edukimit promovimi i lidhur me rëndësinë ushqyerjes me gji. Zgjerimi i rrjetit të Spitaleve Mike të Fëmijës në rrethe. Zbatimi dhe monitorimi i ligjit për Ushqyerjen me gji. Në kuadër të këtij programi janë organizuar trajnime çdo vit të stafit për ushqyerjen me gji për 36 rrethet e vendit. Janë përgatitur materiale për edukimin shëndetësor për ushqyerjen me gji. Janë vlerësuar dhe çertifikuar spitalet mike të foshnjave. Janë monitoruar treguesit e ushqyerjes me gji në vend.

436. Programi “Shëndeti i nënës dhe fëmijës” periudha 2006-2010 midis MSH dhe UNICEF, përmban disa aktivitete për shëndetin e nënës dhe fëmijës të cilat caktohen çdo vit sipas prioriteteve dhe nevojave që ka MSH. Këto aktivitete parashikojnë ndërhyrje në: Zhvillimin e politikave, përpunimin e standarteve dhe forcimin e partneriteteve për shëndetin e nënës dhe fëmijës në kuadrin e procesit të reformës në shëndetësi. Ngritjen e kapaciteteve të personelit shëndetësor në rajonet (Kukës, Tropojë, Shkodër, Elbasan) për menaxhimin e shërbimeve shëndetësore, sistemin e mbikqyrjes bazuar në paketën e përgatitur për KSHP. Vazhdimin e zbatimit të strategjisë së Menaxhimit të Integruar Të Sëmundjeve të Fëmijërisë (MISF) në komunitet në rrethet Kukës, Tropojë . Mbështetje për pjesmarrjen e komunitetit në menaxhimin e qëndrave shëndetësore nëpërmjet grupeve komunitare vullnetare të shëndetit. Ngritja e kapaciteteve të MSH dhe aktorëve të tjerë për vlerësimin e situatës së ushqyerjes dhe hartimin e planit të veprimit për ushqimin dhe ushqyerjen. Forcimi i sistemit të monitorimit dhe zbatimit të kuadrit ligjor për jodizimin universal të kripës (për përdorim human, industrinë ushmore dhe për kafshët). Monitorimi i progresit drejt arritjes së jodizimit universal të kripës. Ndërgjegjësimi i familjeve dhe komuniteteve për përmirësimin e praktikave të ushqyerjes dhe reduktimin e shkallës së kequshqyerjes tek fëmijët. Ngritja e kapaciteteve të personelit shëndetësor në këshillimin për ushqyerjen

437. Programi Kombëtar i Imunizimit EPI, 1993 e në vazhdim UNICEF-ISHP ka si objektiva: Sigurimin vaksinave. Kontrollin dhe mbajtjen e zinxhirit ftohës. Trajnimin e personelit. Hartimi dhe zbatimi i politikave të imunizimit për grupet me rrezik të lartë.

438. Programi Kombëtar për Manaxhimin e Integruar të Sëmundjeve të Fëmijërisë, (MISF) 2001 e në vazhdim UNICEF/OBSH/MSH. Menaxhimi i integruar i sëmundjeve të fëmijërisë (MISF) është një strategji globale e OBSH/UNICEF e cila synon të: rrisi efektivitetin e kujdesit; pakësojë kostot e shërbimit për të arritur 2 objektivat e kryesore të shëndetësisë: 1) Pakësimin e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë që lidhet me shkaqet më kryesore të sëmundjeve të fëmijërisë; 2) Promovimin e rritjes dhe zhvillimit të shëndetshëm të foshnjës. Gjatë periudhës 2001-2004 është arritur: 1) Ngritja e struktures manaxhuese në nivel qendror dhe lokal. 2) Prodhimi i materialeve të trajnimit të adaptuara nga departamentet e pediatriisë së fakultetit të mjeksisë. 3) Trajnimi i profesionistëve shëndetësor (mjek, infermier) në nivel qendror dhe në rrethet pilot Pogradec, Bulqizë, rreth 80 persona gjithsej. 4) Futja e strategjisë së MISF në kurrikulat e pediatriisë, mjekut të familjes, të Fakultetit të Mjekësisë. Faza e zgjerimit ka filluar në vitin 2004 dhe në vazhdim është e duke u zbatuar në prefekturat verilindore në Diber, Elbasan, Kukës, Has, Tropojë. Komponenti komunitar ka filluar zbatimin e MISF në Kukës dhe Diber.

439. Programi i mbijetesës së fëmijës MSH-USAID, Kryqi i Kuq Shqiptar dhe Amerikan periudha 2003-2008 ka patur si objektiva: Përmirësimin e gjëndjes shëndetësore të fëmijëve 0-59 muajsh dhe grave të moshës riprodhuese në prefekturën e Dibrës. 2) Rritjen e përdorimit të shërbimeve të Nënës dhe Fëmijës në strukturat e shërbimit parësor. 3) Rritjen e zbatimit të praktikave kyçe mbi shëndetin e fëmijës në nivel bërthame familjare. 4) Përmirësimi i vazhdimësisë së këtyre aktiviteteve në komunitet nëpërmjet forcimit të partneritetit. Ndërhyrjet kryesore të projektit janë: Ushqyerja (ushqyerja me gji, ushqyerja komplementare mbi 6 muaj, etj). MISF komunitar në qarkun Diber. Planifikimi Familjar

440. Projekt bashkëpunimi midis Ministrisë së Shëndetësisë, Organizatës Botërore të Shëndetësisë, dhe Agjencisë Sanjolle për Bashkëpunim dhe Zhvillim “Reforma në Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës” 2008-2010. Objektivat kryesore të këtij Projekti janë: Përmirësimi i gjëndjes shëndetësore të grave, foshnjeve dhe fëmijëve duke përforcuar Kapacitetet dhe funksionin drejtues MSH-së dhe shërbimet e shëndetit të nënës dhe fëmijës në kujdesin shëndetësor parësor dhe dytësor. Për arritjen e këtij objekti, ndërhyrjet dhe aktivitetet që zbatohen në nivel qendror dhe rajonal janë fokusuar në: 1) Reformimin dhe riorganizimin e shërbimeve të shëndetit të nënës dhe fëmijës. 2) Përmirësimin e cilësisë dhe vazhdimësisë së kujdesit të shërbimeve të nënës dhe fëmijës

441. Gjithashtu MSH gjatë periudhës 2004-2008 ka patur edhe projekte bashkëpunimi me OJF vendase dhe të huaja për shëndetin e fëmijës si me shoqatën CRCA, për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe keqtrajtimi, Save the children për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijëve të vegjël, me Shoqatën Shqiptare për Popullsinë dhe Planifikimin Familjar lidhur me Planifikimin familjar dhe shëndetin e adoleshenteve, etj.

c) Alokimi i buxhetit dhe i burimeve të tjera.

442. Nga analiza operative e MSh rezulton se për shëndetin e nënës dhe fëmijës buxheti i fëmijës nga MSH ka qenë: Viti 2005: 1 miliardë e 858 milionë lekë (11%); Viti 2006: 2 miliardë e 243 milionë lekë (11,5%); Viti 2007 2 miliardë e 630 milionë lekë (11,7%).

Shpenzimet e ndara të këtij buxheti janë: a) Shpenzimet e Personelit 69%; Shpenzimet Operative 13%; Investimet 10%; Vlera e medikamenteve të rimbursuara 6% (për fëmijët 0-14 vjeç, gratë në periudhën e shtatzënisë); Blerje vaksinash 1%; Blerje kontraceptivësh për nevoja të planifikimit familjar 1%.

Tabela e të ardhurave të buxhetit të shtetit për sektorin shëndetësor.

Vitet	2005	2006	Rritja në %	2007	Rritja në %	2008	Rritja në %
Buxheti shtetit për sektorin shëndetësor	18.473.728	19.218.000	4	22.449.000	17	24.409.008	9
Përqindja ndaj Buxhetit të shtetit	11.6%	12%		11.4%		10.5%	
Përqindja ndaj PBB		1.96		2.29		2.3	

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Tabela e shpenzimeve publike për realizimin e të drejtës për kujdes të veçantë të fëmijëve të familjeve të varfëra, 2006-2008

Vitet	Ndihma	Nr. Familjeve	Nr.	Nr. i	Buxheti
	Ekonomike (000 lekë)	Përfituese	Personave në këto familje	Fëmijëve në këto familje	për fëmijët (000 lekë)
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>C</i>	$d = c * 4.2$	$e = c * 2.2$	$f = (b / d) * e$
2006	2,800,000	115,000	483,000	253,000	1,466,667
2007	2,600,000	110,000	462,000	242,000	1,361,905
2008	3,300,000	93,000	390,600	204,600	1,728,571

Burimi: Ministria e Financave, 2006-2008

443. Tabelat e mësipërme paraqesin informacion mbi shpenzimet publike për fëmijët me aftësi të kufizuara, si edhe për fëmijët e familjeve të varfëra. Ndonëse shifrat jepen në vlerë absolute, ato dëshmojnë për rritje të vëmendjes ndaj nevojave të grupeve sociale të veçanta dhe të rrezikuara. Megjithatë, analiza duhet të thellohet më tej, jo vetëm në krahasimet e vlerave

absolute, por edhe në matjen e efektshmërisë së fondeve të shpenzuara, pra duke e krahasuar me nivelin e nevojave të plotësuara për çdo fëmijë.

VII. Arsimimi, koha e lirë dhe aktivitetet kulturore (nenet 28,29,31)

Arsimimi përfshirë trajnimin profesional (neni 28).

a) **Follow-up. Masat e ndërmarra për zbatimin e Vëzhgimeve Përfundimtare**

Arsimimi, Argëtimi dhe Aktivitetet Kulturore (nenet 28, 29, 31: Rekomandimi 61/a Trajnimi i mësuesve dhe rritja e buxheteve destinuar për arsimin.

444. Në SKF një ndër objektivat është “Formimi dhe trajnimi i mësuesve” (objektivi 10). Gjatë kësaj periudhe janë rritur përpjekjet për rritjen e nivelit cilësor të mësimdhënies. Krijimi i një sistemi arsimor cilësor është i lidhur me përmirësimin e kurrikulave, trajnimin profesional të mësuesve dhe infrastrukturën e nevojshme. Qendra e Kualifikimit dhe Trajnimit për Arsimin ka përgatitur sistemin e kualifikimit të mësuesve mbi bazën e shkallës së karrierës dhe po harton standardet e mësuesit. Kjo Qendër ka hartuar një plan pune vjetor ku përfshihen periodikisht veprimtari kualifikuese për mësuesit sipas specialitetit dhe shkallës së formimit të tyre profesional.

445. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, planifikon çdo vit trajnimin e mbi 3000 mësuesve, ku në themel të këtij trajnimi janë promovimi i metodologjive të reja dhe njohja me programet e reja, në arsimin parauniversitar. Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit është institucioni përgjegjës për realizimin e politikave të MASH, në drejtim të reformimit të përmbajtjes së shkollës dhe trajnimit të mësuesve. Futja e kurrikulës së re në arsimin bazë, është shoqëruar me një veprimtari të pasur trajnuese, të gjithë mësuesve që do të zbatonin kurrikulën dhe tekste të reja shkollore. Nëpërmjet sistemit kaskadë, pothuajse të gjithë mësuesit e arsimit bazë kanë marrë trajnimin e nevojshëm për realizimin me cilësi të kurrikulës mësimore. Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit ka trajnuar 3102 drejtorë shkollash të arsimit për përdorimin e “Manualit të drejtorit dhe mënyrën e përdorimit”.

446. Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit ka hartuar materiale ndihmës për mësuesit dhe prindërit, për gjithpërfshirjen e fëmijëve në sistemin arsimor. Gjatë vitit 2008 në kuadër të projekteve për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla normale, janë trajnuar rreth 400 mësues të arsimit parashkollor dhe arsimit të detyruar 9-vjeçar dhe 80 mësues në DAR Shkodër.

447. Në kuadrin e zbatimit të Master planit për “Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit në shkollë” është parashikuar edhe trajnimi i mësuesve.

Në lidhje me investimet publike për ndërtimin dhe rikonstruktimin e shkollave konstatohet rritje. Pozitiv është fakti se shpërndarja e investimeve është bërë duke marrë në konsideratë nevojat e rajoneve në kushte më të vështira si zona rurale apo të varfëra të vendit.

448. Për të përmirësuar në vazhdimësi sistemin arsimor, në vitin 2008 janë rritur shpenzimet e arsimit ndaj shpenzimeve të buxhetit publik në 10.1% dhe shpenzimet e arsimit kombëtar ndaj shpenzimeve të buxhetit publik në 11.6%. Buxheti i MASH për vitin 2008 ka qenë 36 miliard lekë me një rritje prej 10% ndaj buxhetit të vitit 2007. Për të ndihmuar nxënësit e shtresave të

defavorizuara të ndjekin shkollën, në buxhetin e arsimit janë alokuar 850 milion lek për bursa studimi dhe për transportin e nxënësve.

449. Në të gjithë vendin, shërbimi arsimor mbulohet në 100% të territorit. 17% e buxhetit të MASH shpenzohet për ndërtimin dhe rikonstruktimin e institucioneve arsimore. Për përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe uljen e numrit të nxënësve për klasë, është realizuar studimi në 18 bashkitë më të mëdha të vendit duke përcaktuar nevojat për ndërtimin e shkollave dhe konvikteve të reja në ato zona ku migrimi i brendshëm ka qenë më i madh dhe ka sjell rritjen mbi normën e numrit të nxënësve për klasë.

450. Ndër objektivat e SKF është “Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe baza materiale didaktike” (objektivi 11). Në kuadër të projektit, “Përmirësimi i standardeve ndërtimore në arsim” është në proces standardizimi i mirëmbajtjes së objekteve shkollore. Buxheti i MASH për investime (rikonstruktim, ndërtim godinash të reja, pajisje) është rritur 4 miliard lekë në 2008 nga 3.3 miliard lekë në 2007. Janë ndërtuar 72 objekte shkollore të reja dhe janë rikonstruktuar 413 objekte shkollore të arsimit parauniversitar. Janë përcaktuar standardet e objekteve shkollore për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe po punohet për zbatimin e tyre.

451. Buxheti i MASH për bazën materiale didaktike të shkollës është rritur nga 260.000 milion lek në 2007, në 380.000 milion lek në vitin 2008. Në buxhetin e MASH është përcaktuar si zë më vete mjetet didaktike për kopshtin. Gjatë vitit 2007, janë pajisur me: Laboratorë fizike dhe dituri për natyrën 38 shkolla 9-vjeçare. Laboratorë Biologji – Kimi 61 shkolla 9-vjeçare. Pasurimi i shkollave me laboratorë të informatikës, bëhet në kuadër të masterplanit TIK.

452. Në SKF është parashikuar si objektivi “Përmirësimi i aksesit ndaj teknologjisë së informacionit TIK”. MASH po punon në lidhje me zbatimin e Masterplanit për “Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit në shkollë”, i cili është hartuar në bashkëpunim me UNDP e partnerë të tjerë dhe zhvillohet në kuadrin e memorandumit të mirëkuptimit të qeverisë shqiptare me UNDP. Masterplani i TIK-Shkollave mundëson edukimin e nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) Information and Communication Technology (ICT), si dhe shërbimeve të internetit. Programi i informatizimit ka për qëllim t'u mësojë nxënësve aftësitë e duhura në përdorimin e internetit. Ata do të mund të përfitojnë nga teknologjitë moderne të informacionit dhe komunikimit në një mënyrë të re, dinamike, gjithashtu edhe argëtuese. Nga projekti parashikohet të përfitojnë rreth 1749 shkolla 9-vjeçare dhe 384 shkolla të mesme, të cilat do të pajisen me laboratorë kompjuterash. Deri tani janë pajisur me kabinet informatike të gjitha shkollat e mesme të vendit, gjithsej 379 kabinet informatike. Në 37 shkolla të mesme ka nga 2 kabinete. Gjatë vitit 2008 janë ngritur 353 kabinete informatike në shkollat e arsimit bazë. Deri në fund të këtij viti do të pajisen me kabinete informatike të gjitha shkollat 9-vjeçare të vendit. 2000 laborator virtual (një laptop dhe një projektor) do të shpërndahen në të gjitha shkollat e arsimit të mesëm dhe arsimit bazë.

Me kurrikulën e re, lënda e informatikës do të kryhet edhe në arsimin bazë duke filluar nga klasa e 5-të. Në vitin 2008 ka përfunduar përgatitja dhe shpërndarja e programit të informatikës për klasat 7 - 12 si dhe ka filluar puna për trajnimin e mësuesve të informatikës.

Arsimimi, Argëtimi dhe Aktivitetet Kulturorë (nenet 28, 29, 31) Rekomandimi 61/b. Masat për uljen e përsëritjes së klasave, përqindjet e braktisjes së shkollës.

453. Në kuadrin e rritjes së pjesëmarrjes në arsimin bazë nënvizohet se në shkollë kombëtare braktisja e shkollës ka ardhur duke rënë. Niveli i regjistrimit në shkollë për arsimin e detyrueshëm (cikli i ulët) është 89 %, ndërsa për ciklin e lartë të arsimit të detyrueshëm është 94 %. Ndërsa niveli

i përfundimit të shkollës, si edhe përqindja e fëmijëve të cilët fillojnë klasën e parë dhe përfundojnë klasën e pestë është 98 %⁵³.

454. Në të gjitha aktet nënligjore të nxjerra nga MASH, nga viti 2004 dhe në vazhdim parashikohen dispozita për marrje masash apo zhvillim të veprimtarive që ndikojnë në uljen e braktisjes së shkollës nga fëmijët e shtresave vulnerabël dhe të marginalizuara, kryesisht romë. Në zbatim të politikave të saj, ka vazhduar reforma legjislativë dhe ajo institucionale në drejtimit e mëposhtme: Prej vitit 2004 ka vazhduar monitorimi i zbatimit të Udhëzimit nr. 34, datë 08.12.2004, “Për zbatimin e projektit “Shansi i dytë” “Për arsimimin e nxënësve që kanë braktisur shkollën dhe atyre të ngjuar për shkak të gjakmarrjes”. Ky Udhëzim i adresohet kryesisht fëmijëve romë dhe atyre nga familjet e marginalizuara. Zbatimi e monitorimi efektiv i tij ka çuar në përmirësime ligjore dhe marrjen e masave për të kthyer nxënësit në shkollë. Numri i nxënësve nga familjet në nevojë dhe të marginalizuara që braktisin shkollën ka ardhur nga viti në vit në rënie.

454. Për të bërë të mundur ndjekjen e arsimimit të fëmijëve që i përkasin minoritetit rom, në Udhëzimin nr. 6 datën 29.03.2006, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës janë parashikuar masat për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindje. Nëpërmjet Udhëzimit Nr. 22, datë 01.09 .2006, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për zbatimin e planeve, programeve dhe teksteve mësimore të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2006-2007”, u kërkohe të gjitha DAR (Drejtorive Arsimore Rajonale) dhe ZA (Zyrave të Arsimit), të raportojnë me shkrim dy herë në vit për zbatimin e Strategjisë “Për përmirësimin e kushteve të jetesës të minoritetit rom”, lidhur me objektivat për arsimimin e këtij minoriteti të parashikuara në strategji.

455. Në zbatim të Urdhrit i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 410, datë 08.11.2006, “Për identifikimin e situatës dhe masat që duhen marrë në luftën kundër analfabetizmit”, MASH ka realizuar studimin “Shkaqet që favorizojnë analfabetizmin dhe masat që duhen marrë në luftën kundër kësaj dukurie”. Në mbështetje të realizimit të objektivit kryesor të studimit u identifikuan edhe këto objektiva specifike: 1) Evidentimi i numrit të nxënësve që kanë braktisur shkollën si dhe i fëmijëve jashtë sistemit arsimor, të ndara këto sipas kategorive që favorizojnë analfabetizmin. 2) Hartimi i një fondi të dhënash për evidentimin e fëmijëve analfabetë brenda detyrimit shkollor. 3) Evidentimi i masave që shkolla ka marrë në zbutjen e dukurisë së analfabetizmit. 4) Evidentimi i nevojave të mësuesve për kualifikim lidhur me zbutjen e dukurisë së analfabetizmit.

456. Bazuar në Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 321, datë 11.10.2004 “Për eksperimentimin e shërbimit psikologjik në sistemin arsimor parauniversitar”, MASH ka bërë vlerësimin e eksperimentimit të shërbimit psikologjik në sistemin arsimor parauniversitar. Në vijim me qëllim futjen në sistemin arsimor të këtij shërbimi është miratuar Urdhri i Ministrit të Arsimit nr. 170, datë 21.04.2008 “Për funksionimin e shërbimit psikologjik shkollor në sistemin arsimor parauniversitar” është mimitatoi futjen në sistem të këtij shërbimi. Ky shërbim funksionon për të gjithë nxënësit dhe në mënyrë të veçantë për fëmijët me probleme social-ekonomike Ky shërbim ka qenë mjaft efektiv edhe për fëmijët romë.

457. Në Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 32, datë 28.08.2008 “Për zbatimin e strukturave shkollore, planeve, programeve dhe teksteve mësimore të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2008-2009” theksohet se ulja e numrit të nxënësve që kanë braktisur shkollën dhe që kanë tendencë braktisjeje është një nga objektivat kryesore të shkollave të arsimit bazë për këtë vit, që

⁵³ Informacion sipas Raportit Vjetor 2007-2008 për Zbatimin e objektivave të Strategjisë për Fëmijët (Burimi – Ministria e Arsimit: Statistika Vjetore 2005-2006).

është dhe një ndër kriteret e vlerësimit të punës së mësuesve dhe drejtuesve të shkollave. Për këtë qëllim Drejtorive Arsimore Rajonale (DAR) dhe Zyrave Arsimore (ZA) në të gjithë vendin ju kërkohet të marrin këto masa: 1) Trajnimi i mësuesve që punojnë me nxënës që kanë braktisur shkollën dhe që kanë tendenca braktisjeje. 2) Hartimi i programeve të veçanta pune në nivel klase dhe shkolle me qëllim sensibilizimin e prindërve për rëndësinë e shkollimit. 3) Sektorët e Inspektimit në DAR, të inspektojnë të paktën dy herë në vit çdo ZA dhe shkollë që ka nxënës braktisës apo jashtë sistemit arsimor. 4) Në çdo DAR/ZA ngarkohet një specialist që të merret me problemet e arsimit të shtresave të marginalizuara. Ky specialist harton një plan pune dhe raporton dy herë në vit, me shkrim për realizimin e tij. Drejtori i DAR/ZA dërgon dy herë në vit, pranë Drejtorisë së Kurrikulës në MASH, një progres raport për realizimin e planit të punës dhe problemet që kërkojnë ndërhyrje jashtë kompetencave të tyre, me qëllim zbutjen e fenomenit të analfabetizmit.

458. Në zbatim të Urdhrit nr.37, datë 9.03.2009 të Kryeministrit, është ngritur “Grupi ndërministror i punës për ndjekjen dhe zbatimin e strategjisë kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”. Si pjesë e këtij grupi, MASH ka hartuar një plan veprimi shtesë, për të cilin ka filluar puna për zbatimin e tij. Ndjekja dhe realizimi i këtij plani do të ndihmojë në përmirësimin e aksesit të fëmijëve romë në kopshte dhe shkolla.

459. Vlerësimi i eliminimit të përjashtimit social të fëmijëve në arsim⁵⁴. Lidhur me aksesin në arsim, fëmijët e familjeve të varfëra kanë më pak mundësi për arsimim, sesa fëmijët e tjerë. Shumë prej tyre nuk mund të vazhdojnë arsimin bazë, sepse familjet e tyre nuk mund të përballojnë shpenzimet. Shumica detyrohen të punojnë e të kontribuojnë në ekonominë familjare. Në zonat rurale, një tjetër shkak i braktisjes shkollë është edhe distanca e madhe që fëmijët duhet të ecin çdo ditë për të shkuar në shkollë⁵⁵. Në të gjitha qarqet funksionojnë klasat ku përfshihen nxënës që kanë braktisur shkollën më parë ose që kanë tendencë ta braktisin.

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 410, datë 08.11.2006, “Për identifikimin e situatës dhe masat që duhen marrë në luftën kundër analfabetizmit”, MASH ka realizuar në vitin 2007 studimin në nivel vendi për “Shkaqet që favorizojnë analfabetizmin dhe masat që duhen marrë në luftë kundër kësaj dukurie”. Lidhur me sa më sipër në vitin 2008 është hartuar plani i veprimit, me buxhetet përkatëse:

460. Ndër masat konkrete evidentojmë: 1) Hartimi i planeve të veçanta trajnimi për mësuesit lidhur me punën me nxënësit e marginalizuar, bazuar në problemet specifike individuale. 2) Hartimi i platformave për çdo Drejtori Arsimore Rajonale apo Zyrë Arsimi që ka fëmijë jashtë sistemit arsimor, janë hartuar platforma për tërheqjen në shkollë dhe realizimin e programeve mësimore suplementare (parashikimi i punonjësve mësimorë shtesë, norma mësimore të reduktuara, si dhe përcaktimi i mënyrës së shpërblimit të mësuesve që punojnë me nxënësit e marginalizuar). 3) Përcaktimi i shkollave me kohë të reduktuar në çdo njësi administrative vendore. 4) Për ndërtimin e 10 konvikteve të reja për zonat në nevojë, në vitin 2008 janë financuar shtatë konvikte dhe 3 janë planifikuar për vitin 2009. Për fëmijët jetim, të verbër, paraplegjik e tetraplegjikë ishte parashikuar që në vitin e ri shkollor 2008 – 2009, tekstet shkollë të jepen falas.

Për vitin shkollor 2007-2008, Bashkia Tiranë ka mbështetur me mjete didaktike 200 fëmijë me nevoja të veçanta social-ekonomike. Ka shpërndarë gjithashtu edhe bursa për nxënësit me nota shumë të mira. Përfitues të kësaj burse ishin 1.583 nxënës gjithsej, nga të cilët 1.250 në shkollat 9-vjeçare dhe 333 në shkollat e mesme.

⁵⁴ Sipas Raportit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët 2007-2008.

⁵⁵ Studimi “Measuring Child Poverty and Social Exclusion”, Nëntor 2006.

461. Vlerësimi i përfshirjes së fëmijëve romë në arsim. Përfshirja e fëmijëve romë në arsimin parashkollor dhe në arsimin e detyruar 9-vjeçar është trajtuar me prioritet. Sipas analizës së një studimi të HDPC dhe UNICEF në vitin 2008, rezultoi se 54 përqind⁵⁶ e fëmijëve romë frekuentojnë arsimin parashkollor dhe të detyrueshëm. Megjithatë, sigurimi i përfshirjes së plotë të fëmijëve romë mbetet një çështje kritike. Në të gjithë shkollat e vendit është zbatuar Udhëzimi i MASH “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me çertifikatë lindje”, me qëllim sigurimin e gjithëpërfshirjes në arsim të fëmijëve romë. Megjithë përpjekjet e MASH për të siguruar plotësimin e të drejtës së të gjithë fëmijëve romë për arsimim, mbetet problem identifikimi i fëmijëve romë që nuk janë të regjistruar dhe nuk përfundojnë arsimin e detyruar. Për këtë arsye, MASH në bashkëpunim me UNICEF, Save the Children, Qendrën e Zhvillimeve Humane dhe shoqatat rome, ka ndërmarrë studimin për “Mbledhjen e të dhënave të fëmijëve romë, parashkollor dhe shkollor brenda dhe jashtë sistemit”. Studimi kishte si qëllim mbledhjen e të dhënave statistikore për fëmijët romë të përfshirë dhe jo të përfshirë në arsimin parashkollor dhe arsimin e detyruar. Studimi analizoi situatën e arsimimit të fëmijëve romë në vendin tonë. Nëpërmjet evidentimit të përvojave pozitive në drejtim të edukimit të fëmijëve romë, studimi konkludon me masat që duhen marrë për përmirësimin e cilësisë së arsimimit të tyre. Nga të dhënat e studimit rezultoi se në vendin tonë janë 4.654 fëmijë romë në moshën 3-16 vjeç, nga të cilët 1.099 në moshën 3-6 vjeç dhe 3.555 në moshën 6-16 vjeç. Në zbatim të rekomandimeve të studimit, po përgatiten planet e ndërhyrjes në Korçë Gjirokastrë, Tiranë, Elbasan dhe Berat.

462. Me qëllim integrimin, edukimin dhe argëtimin e fëmijëve të ardhur romë Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale Tiranë, Shoqatën e Prindërve dhe OJF që veprojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve kanë zbatuar projektin “Të mësojmë duke punuar”, duke mundësuar hapjen e shkollave verore në zonat periferike të Tiranës. Nga projekti përfituan 1600 fëmijë të moshës 10-14 vjeç, të zonave më të varfëra të njësisë Bashkiake Nr.2, Nr.3, Nr.5, Nr.6, Nr.7, Nr.9 dhe Nr.11, nga të cilët 300 fëmijë në nevojë. Ky projekt kishte si synim plotësimin e të drejtave të fëmijëve për mësim, argëtim dhe edukim qytetar duke realizuar aktivitete kulturore, sportive, artistike. Informimin e fëmijëve për edukimin shëndetësor dhe mjedisor; Ofrimin e shërbimeve multidisiplinare, psiko – sociale për fëmijët që kanë braktisur shkollën; Shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet shkollave duke organizuar aktivitete sensibilizuese me komunitetin; Zbutjen e problemeve sociale si: braktisja e shkollës, dhuna, droga dhe parandalimi i punës së fëmijëve; Rritjen e përgjegjësisë dhe forcimin e rolit të pushtetit vendor në vendimmarrjen e shkollave.

463. MASH në kuadër të reformës në hartimin e kurrikulave, ka hartuar edhe kurrikulat e reja gjithëpërfshirëse, që mbulojnë disa ndryshime në përpjekje për të ndihmuar dhe orientuar mësuesit që të jenë më selektivë dhe më receptivë ndaj nxënësve që ndeshin vështirësi, favorizojnë proceset gjithëpërfshirëse, por nuk ofrojnë instruksione për proceset integruese. Përveç kësaj, tekstet shkollore të arsimit të detyruar nuk përmbajnë akoma konceptet e reja që do të favorizonin proceset gjithëpërfshirëse. Çdo fëmijë që merr shërbime apo edukim të specializuar për shkak të aftësisë së kufizuar, duhet të ketë një Plan Edukativ Individual (PEI). PEI hartohet për çdo nxënës me aftësi të kufizuara dhe duhet të jetë një dokument i individualizuar, sipas nevojave të fëmijës për edukim. MASH ka miratuar një akt normativ që rregullon punën me PEI-n, duke përcaktuar procedurat dhe mënyrën e vlerësimit të nevojave të veçanta të fëmijës dhe po testohet në disa shkolla gjithëpërfshirëse në vend. Në shkollat e edukimit special, shumë prej nxënësve, por jo për të gjithë, kanë një PEI, ndërsa në shkollat e zakonshme kjo përqindje është më e ulët.

⁵⁶ Studim i HDPC dhe UNICEF.

464. Përfshirja e fëmijëve të ngjuar në arsim. Në vijim të zbatimit të projektit “Shansi i Dytë”, është planifikuar në vazhdimësi mbështetja e mësuesve që punojnë me nxënësit që kanë braktisur shkollën apo që kanë tendencë braktisje. Të gjithë nxënësit e ngjuar vazhdojnë të marrin mësim në kushtet e shtëpisë.

464. Arsimitimi i fëmijëve të minoriteteve. Duke e vlerësuar të drejtën e edukimit në gjuhën amtare si një element bazë të identitetit të minoriteteve kombëtare, në Republikën e Shqipërisë tregohet një kujdes i veçantë e i vazhdueshëm për arsimimin e minoriteteve. Përprjekjet për reformimin e arsimit janë drejtuar në hartimin e një kuadri të plotë ligjor për garantimin e të drejtave arsimore të personave të që u përkasin minoriteteve dhe në përpunimin e programeve të reja shkollore. Kushtetuta, ligji "Për sistemin arsimor parauniversitar", vendimet e Këshillit të Ministrave si dhe udhëzime të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, garantojnë dhe sigurojnë mbrojtjen, zhvillimin e të drejtave arsimore të minoriteteve kombëtare.

Në këtë kuadër nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe e Shkencës (MASH) është punuar në drejtim të plotësisht të kuadrit ligjor dhe nënligjor, si dhe marrjes dhe zbatimit të masave konkrete në fushën e arsimit. 1) Ministria e Arsimit dhe Shkencës MASH ka hartuar Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004 – 2015., ku sigurohet arsimimi i të gjitha shtresave të shoqërisë shqiptare. 2) Urdhri nr.170, datë 21.04.2008. “Për eksperimentimin e shërbimit psikologjik në sistemin arsimor parauniversitar”, që siguron shërbimin psikologjik në shkollë për të gjithë nxënësit e në mënyrë të veçantë për fëmijët me probleme social ekonomike, përfshirë edhe fëmijët romë. 2) MASH ka nxjerrë Udhëzimin “Për zbatimin e projektit “Shansi i dytë” për arsimimin e nxënësve që kanë braktisur shkollën dhe nxënësve të ngjuar për shkak të gjakmarrjes”. Kjo iniciativë përfaqëson një hap të rëndësishëm për integrimin arsimor e social të fëmijëve romë.

465. Në kuadrin e procesit të reformimit të kurrikulës është hartuar plani mësimor për sistemin e ri 9-vjeçar. Gjithashtu është hartuar plani i ri mësimor 9-vjeçar i minoriteteve në bashkëpunim me përfaqësues të këtyre minoriteteve. Theksojmë që për hartimin e këtij plani mësimor, MASH ka organizuar takime me mësues, drejtues shkolle, specialistë lokalë të minoritetit, si dhe është konsultuar edhe me Komitetin Shtetëror të Minoriteteve. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës ka përcaktuar edhe raportet e zhvillimit të mësimin në gjuhën shqipe dhe në gjuhën e minoritetit. Këto raporte nuk janë të ndryshme për minoritete të ndryshëm, por janë të unifikuara. Kështu në klasat I-IV 82% e lëndëve zhvillohet në gjuhën minoritare dhe 18% e lëndëve në gjuhën shqipe. Në klasat V-VIII 63% e lëndëve zhvillohen në gjuhën minoritare dhe 37% e lëndëve në gjuhën shqipe. Gjithashtu futja e arsimit të detyrueshëm 9 vjeçar këtë vit diktoi që edhe programet e klases së IX të shvillohen 60% në gjuhën minoritare dhe 40% në gjuhën shqipe.

466. Në planin mësimor dhe në programet lëndore krijohen mundësi që nxënësit e minoriteteve në këto njësi shkollore të studiojnë historinë, traditat dhe kulturën e kombit të tyre. Në kriteret e hartimit të teksteve, që tashmë në vendin tonë janë liberalizuar, theksohet krijimi i shanseve të barabarta për të gjitha kategoritë e nxënësve. Gjithashtu për shkak të tirazhit të vogël të teksteve shkollore për minoriteti, botimi i një libri për nxënësit minoritarë kushton 2200 lekë, ndërsa botimi i një libri për nxënësit shqiptarë kushton 200 lekë. Pra kostoja e botimit të një libri për nxënësit minoritarë është 11 herë më e madhe. Në shkollat e minoritetit kombëtar grek raporti nxënës/mësues është afërsisht 7.8/1, ndërkohë që në shkollat e republike ky raport është 18.2/1. Pra, kostoja e arsimimit të një nxënësi minoritar është afërsisht 2.3 herë më e lartë se kostoja e arsimimit të një nxënësi shqiptar. Ndërsa në shkollat e minoritetit kombëtar maqedonas raporti nxënës/mësues është afërsisht 12.6/1 dhe kostoja e arsimimit të një nxënësi minoritar është afërsisht 30% më e lartë se kostoja e arsimimit të një nxënësi shqiptar. Në arsimin e minoriteteve kombëtare greke dhe maqedonase në Shqipëri, vitet e fundit janë shënuar arritje të dukshme në planet, në programet

mësimore dhe në tekstet e posaçme për këto shkolla. Në shkollat e minoriteteve janë futur edhe lëndët e reja: “Njohuri për historinë e popullit grek/maqedonas” në arsimin 8-vjeçar dhe “Gjuha greke/maqedonase” në vitin e parë dhe të dytë të shkollës së mesme. Vitet e fundit është futur si provim lirimi në klasën e tetë edhe leximi dhe gjuha amtare (me shkrim dhe me gojë). Në planin e ri mësimor të arsimit të detyruar 9-vjeçar të minoriteteve, në ndryshim nga plani mësimor ekzistues, është parashikuar si lëndë e re dhe mësimi i gjeografisë amtare. Gjithashtu, në planin ri mësimor janë përfshirë lëndë me zgjedhje, ku vetë pjesëtarët e minoriteteve kombëtare, nëpërmjet bordeve të prindërve në shkolla vendosin lëndët që do të kenë. Kjo krijon mundësinë për minoritetet që në programet mësimore të futen si lëndë me zgjedhje gjuha e tyre. Në kuadër të organizimit të Maturës Shtetërore për vitin 2006, MASH ka marrë të gjitha masat për sigurimin e lehtësirave për nxënësit minoritarë. Për fëmijët e minoritetit grek ka përfunduar hartimi i programeve të reja mësimore për të gjitha klasat e arsimit të detyruar. Në bazë të Marrëveshjes së nënshkruar midis MASH dhe Ambasadës Greke në Tiranë është në proces përkthimi i teksteve mësimore në gjuhën greke.

467. Lidhur me përgatitjen e mësuesve për shkollat e minoritetit grek, në qytetin e Gjirokastrës, në shkollën e mesme pedagogjike funksionon edhe dega "Mësuesi" për minoritetin grek.. Kjo shkollë, edhe pse ka një numër të vogël nxënësish është mbajtur e hapur. Në Universitetin "Eqerem Çabej", në Gjirokastrë (në vitin 1993), është hapur dega e Gjuhës Greke. Në vitin 1997, në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja është hapur dega për Gjuhën Greke. Trajnimi i mësuesve, në përgjithësi dhe atyre të minoritetit në veçanti, është një ndër kërkesat kryesore, lidhur me rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Duhet të theksojmë se deri tani trajnimi i mësuesve të minoritetit është bërë nga ana e Drejtorive Arsimore Rajonale, si dhe trajnime të cilat zhvillohen në kuadër të vetë shkollës. Brenda një periudhe të shkurtër, MASH ka planifikuar decentralizimin e plotë të buxhetit për trajnimet e mësuesve, duke e çuar atë sa më pranë nevojave të mësuesve.

468. Në Shqipëri, deri me tani, nuk është hapur ndonjë institucion arsimor privat (privat) për fëmijët që u përkasin minoriteteve, por funksionojnë shkolla jopublike, të cilat frekuentohen edhe nga fëmijë minoritarë. Përsa i përket hapjes së shkollave private, çdo person juridik ka të drejtë kundrejt plotësimit të kërkesave ligjore të hapë një shkollë private. Shkollat private në gjuhën shqipe i licencohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, ndërsa shkollat në gjuhë të huaj dhe ato fetare licencohen nga Këshilli i Ministrave pasi janë përgatitur procedurat nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. MASH dhe Drejtoritë Arsimore të rrethëve ku funksionojnë edhe shkollat e minoriteteve i kushtojnë një kujdes të veçantë plotësimit të institucioneve arsimore të minoriteteve me personelin mësimor, dhe përzgjedhjen e personelit dhe kualifikimin e tij shkencor dhe metodik.

469. Vlerësimi i përfshirjes së fëmijëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe e Teknologjisë së Kosovës, kanë filluar organizimin e seminarëve kombëtar për mësimin e gjuhës shqipe jashtë atdheut dhe në korrik u mbajt seminari i 3-të kombëtar. Morën pjesë specialistë të arsimit si dhe mbi 100 mësues që punojnë me mësimin plotësues të gjuhës shqipe në Evropë dhe më gjerë. Po punohet me autoritetet dhe shoqatat shqiptare në vendet ku ka emigrantë shqiptarë, për të nxitur kultivimin dhe ruajtjen e identitetit kombëtar nëpërmjet mësimdhënies së gjuhës dhe të kulturës shqipe. Për këtë MASH ka ofruar falas tekste në gjuhën shqipe, për të mundësuar organizimin e kurseve të gjuhës shqipe në Itali dhe Greqi, ku pas viteve '90 numërohet numri më i madh i emigrantëve shqiptarë, por edhe në vende të tjera. Kryesisht bëhet fjalë për botime të abetares, gjuhë-leximit, por edhe tekste si historia, gjeografia apo folklori shqiptar. Në të dy këto shtete, ka eksperiencën e ndryshme të mësimin dhe ruajtjes së gjuhës e kulturës shqiptare. Në Greqi fëmijët mësojnë gjuhën shqipe në kurse të hapura nga mësues shqiptarë, falë përkushtimit të prindërve dhe shoqatave të shqiptarëve atje. Mësimdhënia kryhet në shtëpi të marra

me qira, të cilat përshtaten si shkolla. Në disa rajone të Italisë, në shkollat ku dhe përqëndrimi i shqiptarëve është më i madh, është vendosur një mësues i gjuhës shqipe, i cili paguhet nga komuna. Fëmijët shqiptarë mund të marrin në shkollë, mësimin e gjuhës shqipe si lëndë me zgjedhje. Është e nevojshme të përgatiten materiale edukative në shqip, si plan-programe, libra metoda për mësimin e gjuhës shqipe për për të huajt, apo për fëmijët shqiptarë që nuk dinë të flasin shqip.

*Arsimimi, Argëtimi dhe Aktivitetet Kulturore (nenet 28, 29, 31) Rekomandimi 61/c.
Përmirësimi i cilësisë së arsimimit;*

470. Një ndër objektivat e SKF lidhur me të drejtën e arsimimit është “Sigurimi i një sistem arsimor cilësor” (objektivi 9), i cili përfshin analizën e funksionimit të sistemit të arsimit parashkollor dhe të detyrueshëm, si edhe nivelin e përfshirjes të grupeve shoqërore në nevojë të veçantë. Sistemi ynë arsimor vazhdon të jetë në ndryshim të vazhdueshëm, që synon rritjen e cilësisë së arsimimit, transparencës, efikasitetit të menaxhimit, të shoqëruar me zgjerimin gradual të autonomisë shkollore. Aktualisht Instituti i Kurrikulave dhe Trainimeve ka filluar rishikimin e kornizës kurrikulare dhe kurrikulës së arsimit bazë dhe të mesëm.

Për këtë arsye janë ngritur grupe të ndryshme pune që kanë si qëllim: 1) Rishikimin e bazave teorike të kurrikulës 1-12 dhe të mësimdhënie-mësimnxënies bashkëkohore. 2) Rishikimin e standardeve të arsimit bazë. Këtë vit ka filluar puna për vlerësimin e kurrikulës mësimore në arsimin fillor. 3) Rishikimin e standardeve të arsimit të mesëm të përgjithshëm.

471. Janë hartuar parimet sipas të cilave do të hartohen këto standarde, kriteret që duhet të përmbushin ato, si dhe mënyra se si do të bashkëpunohet me mësuesit.

Për të siguruar një arsim cilësor për fëmijët, është e nevojshme të rritet kohëzgjatja e edukimit të fëmijëve brenda sistemit të arsimit të detyruar dhe kjo kërkon krijimin e një shkolle të mesme konform dimensioneve bashkëkohore të arsimimit dhe të tregut të punës. Është realizuar studimi “Përcaktimin e strukturës së arsimit të mesëm”. Bazuar në rekomandimet e studimit, MASH ka përgatitur dokumentin politik “Mbi reformën e strukturës së arsimit të mesëm të përgjithshëm të lartë” në të cilin propozohet një reformë në arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Sipas kësaj reforme, do të kalohet nga sistemi aktual i profilizimit dhe në larminë e itinerarëve kurrikularë individual, të cilët vendosen nga nxënësi dhe prindërit e tyre. Kurrikula e re përbëhet nga kurrikula bërthamë e detyrueshme për të gjithë nxënësit dhe ajo opsionale që përzgjidhet nga nxënësit. Kurrikula opsionale përbëhet nga lëndët me zgjedhje me dy nivele. Në nivelin e parë janë lëndët me zgjedhje dhe projektet kurrikulare. Në nivelin e dytë janë veprimtaritë ekstakurrikulare si angazhime në komunitetin shkollor. Bazuar në Udhëzimin e MASH nr. 9, datë 28.2. 2008 “Për strukturën e re në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe tekniko-profesionale”, ka filluar puna për përgatitjen e planeve mësimore dhe kurrikulave përkatëse për arsimin e mesëm 3-vjeçar.

Reforma e ndërmarrë nga MASH, “Alteretekst 2”, ka si qëllim konsolidimin e procesit të liberalizimit të teksteve dhe të afrimit me rregullat e tregut.

*Arsimimi, Argëtimi dhe Aktivitetet Kulturore (nenet 28, 29, 31) Rekomandimi 61/d.
Parashikimi i një viti të detyrueshëm në sistemin parashkollor;*

472. Një objektivi i rëndësishëm i MASH dhe i SKF, është tërheqja më përparësi e fëmijëve 5-6 vjeçarë në kopsht. Për të arritur këtë objektivi MASH ka marrë masa që krahas rritjes së numrit të kopshteve në të gjithë vendin, të vlerësojë me përparësi tërheqjen e fëmijëve 5-6 vjeçarë në kopsht për të siguruar parapërgatitjen e tyre për shkollë. Gjatë vitit shkollor 2006-2007, në të gjithë vendin u hapën klasa përgatitore, pranë shkollave, për fëmijët 5-6 vjeçarë. Ky proces do të vazhdojë edhe në të ardhmen derisa të sigurohet përfshirja e të gjithë 5-6 vjeçarëve që nuk shkojnë në kopsht në

këtë vit përgatitor. Sipas objektivave të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët, synohet që 70% e fëmijëve 3-5 vjeçarë të përfshihen në arsimin parashkollor për të siguruar parapërgatitjen e tyre për shkollë. Deri tani vlerësohet se 50 % e tyre frekuentojnë kopshtin. Për të rritur përqindjen e frekuentimit të arsimit parashkollor, gjatë vitit shkollor 2008-2009 u parashikua hapja e 50 klasave përgatitore pranë shkollave të arsimit të detyruar për fëmijët 5-6 vjeçarë.

Arsimimi, Argëtimi, Aktivitetet Kulturore (nenet 28, 29, 31) Rekomandimi 63. Argëtimi i fëmijëve

473. Bashkia Tiranë po zbaton projektin “Dua të Luaj”, i cili synon që me pjesëmarrjen e komunitetit, të ndërtojë minifusha, kënde të vogla sportive në hapësirat komunitare të kryeqytetit, në mënyrë që fëmijët të gjejnë një hapësirë të mbrojtur dhe argëtuese.

b) Zbatimi i programeve kombëtare dhe monitorimi i tyre.

Nenet 28, 29 Arsimit.

474. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në sistemin arsimor shqiptar garantohet nga Kushtetuta e RSH-së, “Ligji për arsimin Parauniversitar”, si dhe një sërë aktesh nënligjore në bazë dhe për zbatim të ligjit. Në zbatim të ligjit për arsimin parauniversitar janë miratuar akte nënligjore që synojnë ngritjen e strukturave dhe parashikojnë masat për zbatimin e tij. Dispozitat Normative të Arsimit Parauniversitar (DNAP) të miratuar në vitin 2002, përbëjnë aktin nënligjor themelor që rregullon funksionimin e gjithë procesit mësimor edukativ të shkollës, marrëdhëniet e prindërve dhe fëmijëve me mësuesit dhe administratën shkollore, të drejtat dhe detyrat e nxënësve, mësuesve, prindërve etj. Ky akt nënligjor legjitimon të drejtat e fëmijës të parashikuara në Konventën për të Drejtat e Fëmijës (nenet 27, 28, 31). Arsimit parauniversitar zhvillohet në bazë të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004 - 2015 (miratuar me VKM Nr. 538, datë 12. 08. 2004). Objektivat kryesor të kësaj strategjie janë garantimi i aksesit në të gjitha nivelet e arsimit dhe reforma kurrikulare dhe strukturore e arsimit parauniversitar, për zgjatjen e arsimit të detyruar nga 8 - 9 vjet. Realizimi i objektivave të strategjisë të arsimit parauniversitar lidhet drejtpërdrejtë me përmirësimin cilësor të arsimit për fëmijët.

475. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (MASH) ka formuluar si drejtim themelor politik afatgjatë zhvillimin e sistemit arsimor sipas standardeve arsimore europiane. Objektivat specifike të sektorit të arsimit vazhdojnë të mbeten: 1. rritja e rregjistrimeve dhe pjesëmarrjes në arsimin e detyrueshëm e të mesëm, kryesisht profesional dhe në zona të varfëra e të thella të vendit; 2. përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies; 3. zgjerimi i arsimit profesional dhe përshtatja me nevojat e tregut; 4. rritja e efektivitetit të arsimit dhe efikasitetit të sistemit arsimor.

476. Strategjia Kombëtare për Fëmijët si dokument politik në përputhje të plotë me objektivat strategjike të SKZHI për arsimin synon rritjen e efektivitetit të administrimit publik dhe të efikasitetit financiar të sistemit arsimor, duke garantuar të drejtën e fëmijëve për arsim cilësor. Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), janë përcaktuar drejtimet themelore të masave të përmirësimin cilësor e sasiar të treguesve të arsimit, konkretisht: a) Inkurajimi i pjesëmarrjes së komunitetit; b) përmirësimi i aksesit dhe barazisë; c) përmirësimi i cilësisë; d) përmirësimi i kapacitetit menaxhues, e) përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve.

Objektivat e SKF lidhur me realizimin e së drejtës për arsimim janë: 1) Sigurimi i një sistemi arsimor cilësor. 2) Rritja e nivelit të formimit dhe trajnimit të mësuesve. 3) Përmirësimi i infrastrukturës shkollore. 4) Përmirësimi i aksesit të fëmijëve ndaj teknologjisë së informacionit. 5) Pasqyrimi i të

drejtave të fëmijëve në veprimtarinë e shkollës. 6) Përmirësimi dhe menaxhimi i sistemit të informacionit në sektorin e arsimit. 7) Krijimi i kushteve për argëtimin e fëmijëve.

477. Ndër masat më të rëndësishme që ka ndërmarrë MASH në zbatim të Strategjisë Kombëtare të arsimit dhe Strategjisë Kombëtare të Fëmijëve (SKF) është sigurimi i funksionimit të një sistemi arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës. Aktualisht ka përfunduar ristrukturimi i arsimit parauniversitar. Është realizuar kalimi nga arsimi bazë 8-vjeçar në atë 9-vjeçar dhe nga arsimi i mesëm 4 vjeçar në atë 3 vjeçar. Kjo masë reflekton drejtpërdrejtë realizimin e një prej të drejtave themelore atë të arsimimit duke rritur kohën e arsimimit të detyruar .

Përmirësimi cilësor i procesit mësimor edukativ, në arsimin parauniversitar, është realizuar në sajë të reformës tërësore në arsimin parauniversitar në përmbajtje dhe strukturë. Është hartuar dhe po zbatohet në të gjithë sistemin kurrikula e re e arsimit bazë 9-vjeçar si dhe është hartuar kurrikula e re e arsimit të mesëm. Në vitin e ri shkollor, fillon sistemi i ri dhe kurrikula e re e shkollës së mesme (gjimnazit) 3 vjeçar.

478. Reforma kurrikular në arsim u shoqërua dhe me reformën thellësisht novatore për arsimin shqiptarë, atë të liberalizimit të teksteve shkollore. Kjo është një reformë e suksesshme që nxit dhe mbështet konkurrencën e lartë në hartimin e teksteve shkollore, për rrjedhojë rrit cilësinë e tyre si dhe siguron alternativa tekstesh në treg. Në drejtim të rritjes së cilësisë së teksteve dhe në zbatim të reformës së liberalizimit të teksteve shkollore, krahas teksteve alternativë të botuesve të vendit, në procesin e konkurrimit janë futur edhe botues të huaj. I gjithë sistemi arsimor parauniversitar punon tashmë me tekste alternativ në të gjitha lëndet. Procesi i liberalizimit të teksteve shkollore që shënon kalimin nga përdorimi i një teksti në përzgjedhje të tekstit mësimor nga vetë mësuesi ka shënuar një hap të rëndësishëm përpara në rritjen cilësore të procesit mësimor edukativ.

479. Objektivi shumë i rëndësishëm i Qeverisë Shqiptare, i MASH dhe i SKF që ka të bëjë me përmirësimin e aksesit të fëmijëve ndaj teknologjisë së informacionit, ka gjetur një realizim të kënaqshëm. Në kuadër të projektit TIK (Teknologjia e informacionit dhe komunikimit), me një buxhet të konsiderueshëm prej 59 milion Euro, MASH synon të pajisë të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar me internet, me laboratorë të informatikës dhe të trajnojë të gjithë mësuesit e sistemit që japin informatikë. Në vitin 2008 të gjitha shkollat e arsimit të mesëm në vend janë pajisur me kabinete të informatikës gjithsej 379 nga 259 kabinete që kishte në vitin 2007. Në arsimin bazë 9-vjeçar aktualisht janë ngritur 353 kabinetet të informatikës dhe vazhdon puna për sigurimin dhe instalimin e 665 kabineteve të tjera duke plotësuar brenda 6 mujorit të parë të vitit 2009 pajisjen e të gjitha shkollave të arsimit bazë. Për zhvillimin e lëndës së informatikës në shkollat e mesme dhe vënien në efikasitet të laboratorëve të informatikës, është realizuar trajnimi i të gjithë mësuesve që japin informatikë në shkollën e mesme. Po kështu po vazhdon procesi i trajnimit të mësuesve të informatikës së shkollave të arsimit bazë.

480. Objektivi tjetër i SKF për arsimin është përfshirja e të drejtave të fëmijës në kurrikulën shkollore dhe në veprimtaritë ekstrakurrikulare. Për realizimin e këtij objektivi, MASH ka përfshirë në kurrikulën e të gjitha shkollave të arsimit parauniversitar (klasa I – XII), në forma të ndryshme kurrikulare si pjesë të një lënde, si kroskurrikul dhe si veprimtari ekstrakurrikulare.

Si kurrikul, në lëndën e edukimit shoqëror dhe qytetar ka një linjë kurrikulare me vete që lidhet me të drejtat e njeriut, e cila fillon që në klasën e parë përmes lëndës së edukatës shoqërore dhe vijon deri në klasën e pestë të ciklit fillor. Këtu trajtohen kategoritë e të drejtave të fëmijëve që bazohen thellësisht në Konventën e të Drejtave të Fëmijës. Në klasën e gjashtë deri në klasën e nëntë në lëndën edukatë qytetare ka përsëri një linjë kurrikulare me vete për të drejtat e njeriut, e cila i trajton këto në marrëdhënie me grupin, me komunitetin, si dhe me edukimin e fëmijëve për të jetuar në një

shoqëri demokratike dhe globale. Në klasën e tretë të shkollës së mesme në profilin shoqëror në lëndën “Njohuri për shoqërinë” ka përsëri një linjë për të drejtat e njeriut që trajtohen në dy kapituj. Si kroskurrikul, në të gjitha lëndët e arsimit bazë, përkatësisht në programet lëndore identifikohen lehtë objektiva që lidhen ngushtë me njohjen, përdorimin dhe krijimin e qëndrimeve qytetare që bazohen tek të drejtat e njeriut. Kjo ka qenë një kërkesë për hartuesit e kurrikulave lëndore.

490. Si veprimtari ekstrakurrikulare, në të gjitha shkollat zhvillohen veprimtari të shumta praktike, për edukimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Institui i Kurikulës dhe Trajnimit, përmes botimeve të tij, ka përgatitur manuale me veprimtari të shumta praktike, të cilat shkollat i përzgjedhin dhe i përdorin në planifikimet e tyre kurrikulare. Kurrikula e sistemit të ri 9-vjeçar, ka krijuar hapësirën që 10% e saj të programohet në bazë shkolle. Në këtë kontekst shkollat sipas nevojave dhe interesave të komunitetit të nxënësve zhvillojnë aktivitete vjetore, të programuara që kanë si objektiv themelor njohjen dhe zbatimin e të drejtave të fëmijëve.

Krijimi i kushteve për argëtimin e fëmijëve përbën një ndër objektivat e SKF-së (objektivi 16). Vlerësimi i ecurisë në zbatimin e këtij objektivi mbështetet në analizën e ndikimit që kanë patur veprimtaritë kulturore, artistike dhe sportive në nxitjen e zhvillimit të fëmijëve. Masat e marra për ristrukturimin e institucioneve kulturore kanë ndikuar në harmonizimin dhe aktiviteteve kulturore si edhe në rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve.

Neni 31- Koha e lirë dhe aktivitetet kulturore.

491. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është institucioni që koordinon politikat për fëmijët, si dhe Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, institucion në varësi të kësaj Ministrie (krijuar me Urdhër të Kryeministrit nr.108, datë 5.07.2008). Pranë QKKF funksionon Drejtoria e Teatrit për Fëmijë dhe Drejtoria e Artit dhe Kulturës. Në zbatim të këtij Vendimi, Qendra Kombëtare Kulturore e Fëmijëve dhe Teatri Kombëtar për Fëmijë u shkrinë në një institucion të vetëm. Nëpër rrethe funksionojnë Qendrat kulturore të fëmijëve që nuk kanë varësi institucionale me QKKF, prandaj në shkurt 2008 është firmosur marrëveshja mes QKKF dhe Ministrisë së Arsimit, për një koordinim më të mirë të punës dhe bashkëpunim mes Qendrave Kulturore për Fëmijë Rajonale dhe Drejtorive Arsimore Rajonale, për organizimin e aktiviteteve kombëtare artistike dhe sportive.

492. Ligji nr.8096 datë 21.03.1996 “Për Kinematografinë” (i ndryshuar) parashikon shfaqjen e filmave në mënyrë të diferencuar sipas moshave të fëmijëve dhe ndalimin e shfaqjes së filmave për fëmijë 14-18 vjeç apo nën 14 vjeç në orë të caktuara.

Ligji nr.9631, datë 30.10.2006 “Për Artin Skenik”, ka si qëllim edhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore për fëmijë me qëllim pjesëmarrjen dhe integrimin e tyre në jetën kulturore. Ky ligj sanksionon detyrimet e institucioneve publike për argëtimin dhe zhvillimin e fëmijëve.

493. Strategjia Kulturore për periudhën shtator 2008-dhjetor 2010 hartuar nga Qendra Kombëtare Kulturore e Fëmijëve (QKKF) argëtimin e fëmijëve dhe përfshirjen e tyre në dinamikën e aktiviteteve artistike të QKKF në raport me kërkesat, shijet dhe prirjet artistike të gjeneratave të fëmijëve.

Një ndër objektivat e SKF është " Krijimi i kushteve për argëtimin e fëmijëve”, objektivi i cili mbështetet në analizën e ndikimit që kanë patur veprimtaritë kulturore, artistike dhe sportive në nxitjen e zhvillimit të fëmijëve. Masat e marra për ristrukturimin e institucioneve kulturore kanë ndikuar në harmonizimin dhe aktiviteteve kulturore si edhe në rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve.

494. Krijimi i fondit për artistët e rinj është një nismë e MKRS dhe QKKF që ka nisur që në vitin 2007 dhe synon të ofrojë artistët e rinj që të kontribuojnë jo vetëm në shtimin e produktit artistik të

këtij institucioni, por edhe në rritjen e cilësisë artistike dhe afrimit sa më pranë të ndjesive dhe mentalitetit të fëmijve shqiptarë. Në hartimin e këtyre projekteve është mbajtur parasysh harmonizimi i të gjitha arteve që promovohen në ambientet e QKKF-së. Këtu përfshihen themelimi i studios së aktrëve të rinj të Teatrit të Fëmijve dhe krijimi i Produksionit të Artistëve të Rinj. Ky fond është i përvitshëm dhe është pothuajse i barabartë me buxhetin e projekteve artistike të QKKF-së.

495. Qendra Kombëtare Kulturore e Fëmijëve, ka për detyrë zhvillimin e aktiviteteve në nivel kombëtar, duke angazhuar strukturat e saj në Tiranë edhe Qendrat Kulturore të Fëmijëve në rrethe. QKKF mban kontakte dhe shkëmbime kulturore me 10 teatro fëmijësh dhe 30 qendra fëmijësh nëpër rrethet e vendit, që janë në varësi të bashkive përkatëse. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është promovimi i fëmijve të talentuar dhe sigurimi i mundësive konkurrimi në nivel kombëtar dhe lokal. QKKF ka rol këshillues, orientues dhe organizativ. Aktivitetet e përbashkëta mbështeten në pjesën më të madhe nga QKKF.

Kalendaret e përvitshme kulturore përmbajnë mbi 25 aktivitete artistike dhe teatrore, të cilat në përgjithësi mbulojnë dhe përfaqësojnë kërkesat bazë të argëtimit, kohës së lirë dhe zhvillimit kulturor të fëmijve. Në këto aktivitete marrin pjesë mesatarisht si protagonistë apo shikues rreth 25 mijë fëmijë. Këto aktivitete janë Festivali Kombëtar i Këngës (në të cilin marrin pjesë një numër i madh fëmijësh, duke promovuar talente në një spektër të gjerë moshash), Festivalin e Zërave të Rinj, spartakiadën sportive, tre premiera të teatrit të fëmijve, pjesëmarrja në aktivitete të rëndësishme të pikturës, teatrit, këngës, baletit, ekspozita të pikturës, festivalin e teatrove amatore për fëmijë, Ditën Ndërkombëtare të Librit për Fëmijë, aktivitete për festën e fundvitit, Maratonën e recitimit, workshope me fëmijët e talentuar të rretheve të pikturës, konkurset e krijimtarive letrare, pikturës, interpretimit etj. Në këtë kontekst mbahet parasysh angazhimi maksimal i fëmijve që vijnë nga shtesa të varfra të popullsisë, fëmijve jetimë, fëmijve me probleme, fëmijve të minoritetit rom. Për këto shtesa fëmijësh, biletat e shfaqjeve artistike dhe detyrimi i pagesës së kurseve ofrohet falas nga QKKF. Gjithashtu janë mbështetur nismat dhe aktivitetet për fëmijë. Për fëmijët me probleme të shikimit dhe dëgjimit janë organizuar një sërë aktivitete, si dhe mesatarisht gjatë vitit zhvillohen rreth 20 shfaqje bamirësie, të ardhurat e të cilave shkojnë për fëmijët me këto probleme. Në bashkëpunim me DART e Drejtoritë Arsimore në rrethe, QKKF organizohen kampionate të fëmijëve në rang kombëtar të futbollit, basketbollit, shahut, volejbollit, aerobisë.

496. Gjithashtu janë organizuar një sërë veprimtarish kulturore në nivel kombëtar si Festivali i 46 i Këngës për Fëmijë i cili solli në skenë kompozitorët më të mirë shqiptarë dhe 500 fëmijë, duke promovuar talente në një spektër të gjerë moshash; Festimet në kuadrin e Ditës Ndërkombëtare të Librit për Fëmijë; Aktiviteti “Unë të takoj ty, kaq të ndryshëm, kaq të barabartë”, me rastin e 9 Majit, Ditës Europiane, me mbështetjen e Këshillit të Europës. Aktiviteti mblodhi fëmijë nga Tirana, Shkodra, Durrësi, Pogradeci, Saranda dhe Prishtina. Fëmijët konkuruan në ese, punim grafik, koreografi dhe këngë. Gjatë sezonit turistik 2008, në bashkëpunim me Bashkinë Sarandë, u organizua “Java kombëtare e kulturës për fëmijë”. Aktivitetet përfshinë: Konkursin Kombëtar të Pikturës, Konkursin Kombëtar të Fragmenteve Dramatike për Fëmijë, Festivalin Mbarëkombëtar të Zërave të Rinj dhe panairin e shtëpive botuese për librin për fëmijë. Në bashkëpunim me DART e Drejtoritë Arsimore në rrethe, QKKF po organizon zhvillimin e kampionateve të fëmijëve në rang kombëtar të futbollit, basketbollit, shahut, volejbollit, aerobisë. Aktualisht po organizohen kampionatet e basketbollit e të futbollit. Pjesëmarrja e vajzave në rrethet artistike është rreth 60% dhe kryesisht nga shtresat e varfra dhe të mesme të popullsisë. Gjithashtu aktivitetet e zhvilluara në shkollat e kryeqytetit apo nëpër rrethe kanë ndihmuar në zhvillimin kulturor të vajzave, veçanërisht në zonat rurale dhe gjeografikisht të izoluara.

497. der organizatat për promovimin e të drejtave të fëmijve përmendim: Festivali i Këngës për Fëmijë, Shkodër; Shoqatat e Fëmijve Kripëmjalhtëzat; Qendra kulturore “Robert Radoja”.

c) Alokimi i buxhetit dhe i burimeve të tjera.

498. Tabela mbi Buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për periudhën 2004-2009

në lekë

Programet Buxhetore në Arsim	Viti 2004	Viti 2005	Viti 2006	Viti 2007	Plani 2008	Plani 2009
Buxheti i Ministrisë së Arsimit	23.976.857	25.440.000	26.188.115	29.752.145	37.008.924	41.464.211
Buxheti i Arsimit Parauniversitar	19.891.971	20.577.130	21.184.769	24.209.198	29.646.973	31.264.211
Buxheti i Arsimit Parauniversitar në % ndaj Buxhetit të MASH	83%	81%	81%	81%	80%	75%
Produkti i Brendshëm (në mijë lekë)	795.035.050	836.879.000	899.700.000	982.200.000		1.180.000.000
Buxheti i Shtetit (në mijë lekë)	220.722.050	232.339.000	266.751.000	300.303.000	354.760.000	384.834.000
Buxheti ti MASH ndaj Shpenzimeve të Buxhetit Shtetit (në %)	9,0%	8,9%	7,9%	8,1%	8,4%	10,8%
Buxheti i MASH ndaj PBB (në %)	3,0%	3,0%	2,9%	3,0%	3,4%	3,5%

VIII. Masat speciale të mbrojtjes (nenet 22, 30, 32-36, 37 b-d, 38,39,40)

a) Follow-up. Masat e ndërmarra për zbatimin e Vëzhgimeve Përfundimtare.

Refugjatët dhe fëmijët e zhvendosur brenda vendit *Rekomandimi 65*.

499. Kushtetuta përcakton se të drejtat dhe lirite themelore si dhe detyrimet e parashikuara në të për shtetasit shqiptare vlejné njëloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi ne territorin e Republikës së Shqipërisë, me perjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në menyre të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive te caktuara. Kjo është një dispozite e përgjithshme që gjen zbatim në ligje të veçanta për fusha të caktuara të të drejtave dhe lirive të njeriut. Në Kushtetutë parashikohet e drejta e cilitdo që të levizë lirisht brenda territorit të shtetit si dhe jashtë tij. Procedurat dhe kriteret e strehimit të të huajve në Shqipëri, rregullohen me ligj të veçantë.

500. Kodi i Familjes i RSH-se parashikon se femijet kane te njejtin banim me ate te prinderve. Ata kane te drejten dhe detyrimin per te qendruar dhe jetuar se bashku. Ligji dhe praktika njuh rastet kur femijet dhe prinderit e tyre nuk jetojne se bashku per shkaqe apo rrethana te ndryshme. Nje nga rastet e ndarjes se femijes prej prinderve ndodh per shkak te emigracionit apo levizjeve nderkufitare te personave. Ne rastin e shtetasve shqiptarë, femijet e te cileve duhet te udhetojne jashte shtetit dhe qe pajisjen e tyre me pasaporte, bazuar ne Kodin e Familjes dhe ne ligjin Nr.8668, datë 23.11.2000 "Per pajisjen e shtetasve shqiptare me pasaporte per jashte shtetit", neni 2, ne cdo rast kerkohet deklarata noteriale e te dy prinderve te cilet shprehin vullnetin e tyre per lejimin e pajisjes se femijes me pasaporte apo per udhëtimin e tij jashte shtetit.

501. Ligji 8432 date 14.12.1998 "Per Azilin ne RSH". Ne nenin 1 te ketij ligji percaktohet se RSH u njeh të drejtën për azil e mbrojtje të përkohshme të gjithë të huajve që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, qofshin këta refugjatë apo persona të tjerë dhe që kërkojnë azil në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me konventat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë. Kushtet, procedurat për dhënien dhe heqjen e azilit si dhe të drejtat e detyrat e refugjatëve dhe të personave nën mbrojtje të përkohshme rregullohen nga ky ligj.

Personat qe perfitojne nga parashikimet e ketij ligji jane refugjatet dhe personat nen mbrojtje te perkohshme me termin "refugjat" me te cilet kuptohet i huaji qe për shkak të frikës së bazuar të persekutimit për arsye të racës, besimit, kombësisë, antarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij dhe nuk ka mundësi, ose për shkak të një frike të tillë nuk ka dëshirë, të kërkojë mbrojtjen e atij vendi, ose kur ai duke mos pasur një shtetësi dhe ndodhet jashtë vendit të mëparshëm të banimit të zakonshëm të tij si pasojë e këtyre ngjarjeve, nuk ka mundësi, ose nuk ka dëshirë të kthehet atje për arsye të kësaj frike. Të drejtën e azilit, me të njëjtin status, e përfitojnë edhe bashkëshorti, fëmijët e moshës nën 18 vjeç dhe çdo i afërm në ngarkim ligjor të refugjatit, të cilit i është dhënë azil, me kusht që ata të banojnë së bashku. Në rastin e zgjidhjes së martesës, ndarjes apo vdekjes së refugjatit që ka përfituar azil, anëtarët e familjes që kanë përfituar azil në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni, do të vazhdojnë të gëzojnë të drejtën e azilit. Ne nenin 16 ky ligj percakton se denohen me burgim per kalim te paligjshem te kufirit te gjithë refugjatet apo azilkerkuesit qe nuk paraqiten brenda 10 diteve ne komisariatet e policise. Nga ky rregull bejne perjashtim refugjatet ose azilkerkuesit e mitur. Në përputhje me normat ndërkombëtare mbi të drejtat e fëmijëve nuk burgosen azilkerkuesit e mitur të pashoqëruar nën moshën 16 vjeç, përveçse në raste ekstreme. Në çdo rast tjetër ndaj tyre merren masat e duhura dhe të përshtatshme për fëmijët.

502. Me VKM Nr.46 datë 7.2.2002 Per Miratimin e Rregullores "Per funksionimin e qendrave te pritjes dhe te trajtimit te perkohshem te te huajve jo azilkerkues" percaktohet se të miturve të pashoqëruar u sigurohet kujdesi i nevojshëm, sic percaktohet në Konventën e OKB-se "Për të drejtat e fëmijëve".

503. Siç është evidentuar edhe më sipër ligji nr. 9098, datë 3.7.2003 " Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kane përfituar azil në RSH", percaktohet se fëmija i pashoqëruar, që ka përfituar azil, ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar. Gjatë shqyrtimit të një aplikimi, Zyra për Refugjatët, Komisioni Kombëtar për Refugjatët dhe gjykatat përkatëse kanë parasysh interesin më të mirë të fëmijës.

504. Ligji "Për të huajt" rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, qarkullimit, punësimit të të huajve në RSH-së, si dhe të daljes së tyre prej territorit të saj.

505. Strategjia kombëtare kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktimat të trafikimit. parashikon se përfshirja e fëmijës viktimë në aktivitetet kriminale nuk duhet të çenojë statusin e tij, si fëmijë dhe si viktimë. Interesi më i lartë i fëmijës, e drejta për mosdiskriminim, respektimi i pikepamjeve të tij, e drejta e informimit dhe e konfidencialitetit si dhe e drejta për qene i mbrojtur. Fëmija viktimë, i cili është në gjendje të formojë pikëpamjet e tij gëzon të drejtën t'i shprehë këto pikëpamje në mënyrë të qartë lidhur me çdo gjë që ka të bëjë me të, si në vendimin e tij lidhur me mundësinë e kthimit në familje ose në vendin e origjinës.

506. Strategjia Kombëtare e Migracionit (miratuar në vitin 2004) ka si synim të sigurojë një politikë sa më të plote për migracionin Kjo për faktin se Shqipëria është një vend që perjeton problemet e

migracionit dhe do të vazhdoje të preket nga një fenomen i tillë. Për zbatimin e strategjisë s[htë miratuar në vitin 2005 Plani Kombëtar i Veprimit. (

507. Ligji “Për Procedurat e Birësimit dhe për Komitetin Shqiptar të Birësimit” përcakton se nuk mund të kryhet birësimi i një fëmije refugjat nëse: a) ka shpresë të arsyeshme për gjetjen e familjes së tij dhe për bashkimin familjar, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës; b) nuk ka kaluar dy vjet nga data e marrjes së azilit, kohë gjatë së cilës janë ndërmarrë të gjitha masat për gjetjen e prindërve ose anëtarëve të tjerë të familjes së fëmijës; c) është në kundërshtim me interesin e fëmijës; d) është i mundshëm në një të ardhme të afërt rikthimi i sigurt dhe me dinjitet në vendin e origjinës dhe nëse mundësitë e fëmijës në vendin e origjinës janë më të mira sesa birësimi në vendin e azilit ose në një vend të tretë. Në procesin e birësimit të fëmijëve refugjatë, Komiteti bashkëpunon me strukturën përkatëse shtetërore që mbulon çështjet e refugjatëve.

Shfrytëzimi ekonomik- Rekomandimi 69 i Vëzhgimeve Përfundimtare

508. Shqipëria ka ratifikuar Konvenat e ILOs, nr. 138 “Për Moshën Minimale”, Konventën nr. 182 “Për Format më të Këqia të Punës së Fëmijëve”. Lidhur me zbatimin e nenit 32 të Konventës, një ndër objektivat e SKF është “Eliminimi progresiv i numrit të fëmijëve që punojnë”. Në zbatim të objektiveve të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët, me qëllim reduktimin e numrit të fëmijëve që punojnë si edhe garantimin e funksionimit të sistemit të mbrojtjes së tyre janë miratuar disa ndryshime në Kodin Penal. Me ligjin nr. nr. 9859, datë 21.01.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal” pas nenit 124/a shtohet neni 124/b “Keqtrajtimi i të miturit”, i cili përcakton shprehimisht se: 1) Detyrimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij dënohet me burgim deri në 4 vjet dhe me gjobë nga 50 mijë deri në një milion lekë. 2) Kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e të miturit, dënohet me burgim nga 10 deri në 20 vjet”.

509. Gjithashtu në nenin 117 “Pornografia” të Kodit Penal është shtuar një paragraf që dënon përdorimin e të miturit për prodhimin e materialeve pornografike, si dhe shpërndarjen apo publikimin e tyre.

Bazuar në nenin 128/b “Trafikimi i të miturve” tashmë penalizohet me ligj jo vetëm rekrutimi, fshehja, pritja etj, por edhe shitja e të miturve.

510. Siç është evidentuar edhe në Raportin e parë, Kodi i Punës dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij përcaktojnë masa dhe detyrime për punëdhënësin lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në punë. Dispozitat ligjore të Kodit të Punës për punën e fëmijëve parashikojnë: i) Ndalimin e të gjitha formave të punës së detyruar; ii) Moshën minimale të marrjes në punë e fëmijëve, e cila është mosha 16 vjeç. Bëjnë përjashtim rastet e fëmijëve 14-16 vjeç, të cilët në periudhën e pushimeve shkollore, merren në punë që nuk dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre, jo më shumë se 30 orë në javë. iii) Mundësinë e punësimit të fëmijëve nga mosha 16-18 vjeç në punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin dhe formimin e tyre. iv) Ndalimin e punës së natës të fëmijëve nën 16-18 vjeç. v) Kohëzgjatjen e punës, e cila është 40 orë në javë dhe 4 javë kalendarike pushime.

511. Lidhur me rekomandimin 69/c, për ngritjen e mekanizmave kontrollues për të monitoruar shtrirjen e fenomenit të punës së fëmijëve pranë Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është ngritur Njësia për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (shkurt 2002). Kjo njësi po zbaton një program kombëtar për eliminimin e punës së fëmijëve që synon realizimin e objektiveve si: 1) Forcimi i kapaciteteve institucionale për një adresim të drejtë të çështjes së punës dhe trafikimit të fëmijëve. 2) Harmonizimi i legjisllacionit kombëtar me standartet ndërkombëtare për këtë çështje. 3) Rritja e kapaciteteve të inspektorëve të punës dhe partnerëve të tjerë për t’iu

përgjigjur sistematikisht dhe në mënyrë të gjithanëshme formave më të këqia të punës së fëmijëve si në sektorin formal dhe veçanërisht në atë joformal. 4) Rritja e sensibilizimit të përgjithshëm mbi çështjen e punës dhe trafikimit të fëmijëve si një nga format më të këqia të punës së fëmijëve;

512. Inspektorati Shtetëror i Punës, i cili ka si qëllim të sigurojë zbatimin e legjislacionit të punës nga subjektet, mbi të cilat vepron ky ligj, në përputhje me procedurat e kryerjes së inspektimit në punë, ka kontrolluar punën e të miturve në subjekte të ndryshme shtetërore dhe private. Nga inspektimet e Inspektoriatit Shtetëror të Punës në subjekte në të gjithë territorin e RSH-së për vitin 2008, janë evidentuar 540 fëmijë që punojnë në sektorin formal, nën moshën 18 vjeç. Përqindja më e madhe e fëmijëve punojnë në ndërmarrjet prodhuese konkretisht rreth 40% në ndërmarrjet e përpunimit të peshkut, në prodhimin e këpucëve rreth 30%, në rrobaqepsi 23% dhe në sektorin e ndërtimit rreth 7%. Në përgjithësi vërehet një numër i madh vajzash rreth 89.2% rreth 10.8% meshkujsh⁵⁷.

513. Në kuadër të ndryshimeve që do të pësojë Kodi i Punës janë miratuar VKM "Për kontrollin mjekësor për punëmarrësit e mitur nën 18 vjeç para fillimit të marrëdhënies së punës, si dhe VKM "për përcaktimin e orëve të punës të cilat nuk duhet të kalojnë 48 orë në javë përfshirë në këto 48 orë edhe orët suplementare në venedet e punës që paraqesin rrezik.

514. Në dokumentin politik të Strategjise Së Shendetit ne Pune që po hartohet, është parë me prioritet mbrojtja e fëmijëve të punësuar.

Aktualisht po përgatitet Projekt-ligji për Sigurine dhe Shendetin ne Pune, që parashikon dispozita të vecanta për mbrojtjen e të miturve në pune si dhe parandalimin e aksidenteve në pune dhe sëmundjeve profesionale.

Vihet re një ndjeshmëri më e madhe e strukturave shtetërore, por edhe punëdhënësve për zbatimin e legjislacionit dhe mbrojtjen e të miturve të punësuar. ISHP ka organizuar edhe tryeza të rrumbullakëta për mbrojtjen e të miturve ne pune ku morrën pjesë përfaqësues të sindikatës, konfederatës së punëdhënësve, punëmarrësve.

515. Në fund të vitit 2007 përfundoi faza e parë e Projektit "Sistemi i Monitorimit të Punës së Fëmijëve në Shqipëri". Si rezultate të këtij projekti mund të përmenden kthimi në shkollë i 54 fëmijëve për të përfunduar arsimin e detyrueshëm, sigurimi i formimit profesional për 8 të rinj dhe mbështetja e familjeve të fëmijëve. Është ofruar formim profesional në 18 raste për prindërit apo pjesëtarët e rinj të familjeve të fëmijëve që punonin, punësim të prindërve apo pjesëtarëve në moshë të familjes në 57 raste, asistencë ekonomike në 44 raste si dhe shërbime të tjera si këshillim, asistencë juridike, trajtim mjekësor për 95 fëmijë që punonin dhe fëmijë në rrezik për të punuar etj. Faza e dytë e projektit ka filluar në dhjetor 2008 me një shtrirje në pesë rajone të vendit, Tiranë, Elbasan, Korçë, Berat dhe Shkodër.

Gjithashtu po punohet për institucionalizimin e modelit të Monitorimit të Punës së Fëmijëve dhe konsolidimin e këtij modeli nëpërmjet forcimit të strukturave të tij, të cialt janë Komitetet Lokale kundër Punës së Fëmijëve dhe Grupet Monitoruese Multidisiplinare.

516. Lidhur me rekomandimin 69/d, në kuadrin e Memorandumit të Mirëkuptimit me ILO/IPEC dhe bashkëpunimit me IPEC (Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve), është krijuar Komiteti Drejtues Kombëtar "Për eliminimin e punës së fëmijëve", i cili drejtohet nga

⁵⁷ Të dhëna konkrete mbi punësimin formal të fëmijëve jepen në ankeset bashkëlidhur, të cilët janë pjesë e këtij Raporti.

Ministri i Punës dhe pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është krijuar Njësia për Eleminimin e Punës së Fëmijëve.

Shfrytëzimi / abuzimi seksual, trafikimi dhe rrëmbimi Rekomandimi 71/ a. Reduktimi dhe parandalimi i shfrytëzimit seksual, shitjes së fëmijëve dhe trafikimin e tyre, përmirësimi i legjislacionit.

517. Lidhur me rekomandimin 71/a në kuadër të masave mbrojtëse dhe parandaluese ndaj shfrytëzimit të fëmijëve, ligji nr. 8733, datë 24.01.2001 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodit Penal i RSH-së”, ka ndryshuar nenin 7 të Kodit Penal, i cili parashikon zbatimin e ligjit penal për veprat penale të kryera nga shtetas të huaj. Konkretisht shkronja “d” e këtij neni ka ndryshuar: Organizimi i prostitucionit, trafikimi i jashtëligjshëm i njerëzve, fëmijëve dhe grave prodhimi dhe trafikimi i jashtëligjshëm i armëve, drogës, substancave të tjera narkotike e psikotrope, i substancave bërthamore, i materialeve pornografike, si dhe trafikimi i jashtëligjshëm i veprave të artit dhe i objekteve me vlerë historike, kulturore dhe arkeologjike.”

Gjithashtu, me ligjin nr. 8733, datë 24/1/2001 në nenin 15 të tij parashikohet ndryshimi i nenit 100 të Kodit Penal, i cili konsiston në ashpërsimin e masës së dënimit ndaj autorëve të veprës penale të kryerjes së marrëdhënies me dhunë me të mitur. Ky nen përcakton shprehimisht se: 1) “Kryerja e marrëdhënies seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur, që nuk ka arritur moshën 14 vjeç ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga shtatë deri në 15 vjet. 2) Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me dhunë, ose kur i janë shkaktuar fëmijës së dëmtuar pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri 25 vjet. 3) Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se 20 vjet”. Me ligjin e mësipërm është ndryshuar edhe neni 101 i KP, i cili parashikon “kryerjen e marrëdhënies seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç”. Në këtë nen parashikohet se: 1) “Kryerja e marrëdhënies seksuale ose homoseksuale, me dhunë, me fëmijë të mitur në moshën 14-18 vjeç dhe që ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. 2) Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale, me dhunë, kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur fëmijës së dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet. 3) Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se 20 vjet.”

518. Me ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001 është ndryshuar edhe neni 106 i Kodit Penal, në të cilin parashikohet vepra penale e kryerjes së “marrëdhënies seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”. Ky nen parashikon se: “Kryerja e marrëdhënies seksuale ose homoseksuale ndërmjet prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, motrave, ndërmjet personave të tjerë që janë gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie ose të birësimit, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.

519. Gjithashtu, neni 108 i Kodit Penal (vepra të turpshme), i ndryshuar në vitin 2001, parashikon se “kryerja e veprave të turpshme me të mitur që nuk kanë arritur moshën 14 vjeç, dënohet me burgim deri në 5 vjet”.

520. Në nenin 114/a të Kodit Penal parashikohet si një ndër rrethanat rënduese të veprës penale të shfrytëzimit të prostitucionit, kryerja e kësaj vepre me të mitur, e cila dënohet nga 7 deri në 15 vjet burgim. Neni 117 i Kodit Penal parashikon se: “Prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në ambientet e të miturve, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim deri në dy vjet”.

Me ligjin nr. 9859, datë 21.1.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime Kodin Penal”, pas paragrafit të parë të nenit 117, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Përdorimi i të miturit për prodhimin e materialeve pornografike, si dhe shpërndarja ose publikimi i tyre në internet apo në forma të tjera, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në pesë milionë lekë”. Ligji nr.9834, datë 22.11.2007 “Për Aderimin në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin e Fëmijëve dhe Pornografinë e Fëmijëve”, ka qënë shtysa kryesore për ndryshimin e nenit 117 “Pornografia” të Kodit Penal.

521. Masat e ndërmarra për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të fëmijve. Në Shqipëri, si edhe në vendet e tjera të rajonit, fenomeni i trafikimit të njerëzve i ka fillimet pas viteve `90. Fenomeni i trafikimit erdhi duke u organizuar dhe është rritur sidomos gjatë periudhës 1997-2001. Duke patur parasysh ekzistencën e këtij fenomeni, duke filluar prej vitit 2001, janë ndërmarrë një sërë masash për goditjen e tij. Masat e para të ndërmarra kanë të bëjnë me ndryshimet në Kodin Penal duke ashpërsuar dënimet për trafikantët. Lufta ndaj trafikimit të qënieve njerëzore erdhi duke u intensifikuar dhe në periudhën 2004-2005 dhe në vazhdim janë ndërmarrë një sërë masash kryesisht të karakterit ligjor, por edhe institucional.

522. Kuadri ligjor. Trafikimi i qënieve njerëzore për herë të parë parashikohet si vepër penale në Kodin Penal të RSH-së në vitin 2001. Ratifikimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, si dhe dy protokolleve të saj shtesë, në vitin 2002, u pasua me ndryshime të rëndësishme në Kodin Penal në lidhje me trafikimin dhe kontrabandimin e personave. Në përputhje me Konventën dhe dy protokollin e saj shtesë, Kodi Penal i RSH-së u ndryshua me ligjin nr. 9188, datë 12.02.2004 duke amenduar nenet 110/a “Trafikimi i personave”, 114/b “Trafikimi i femrave”, 128/b “Trafikimi i fëmijëve”, si dhe 298 “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”. Duhet theksuar fakti se, me këto ndryshime, përmbajtja e neneve që kanë të bëjnë me veprën penale të trafikimit është në përputhje të plotë me nenin 3 të Protokollit të Palermos. Shqipëria ishte një ndër vendet e para që ka zbatuar detyrimet që rrjedhin prej saj menjëherë pas nënshkrimit.

523. Me ligjin nr. 9188, datë 12/2/2004 në Kodin Penal është parashikuar si vepër penale (neni 128/b “Trafikimi i të miturve”), i cili përcakton konkretisht: a) “Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplatimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga 7 deri në 15 vjet dhe me gjobë nga 4 milionë deri në 6 milionë lekë. b) Në paragrafin e dytë të këtij nenin parashikohet se: organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohen me burgim nga 10 deri në 20 vjet dhe me gjobë nga 6 milion deri në 8 milionë lekë. c) Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim dhe e shoqëruar me keqtrajtme dhe ushtrime të dhunës fizike ose psikike, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin shëndetit dënohet me burgim jo më pak se 15 vjet burg dhe me gjobë nga 6 – 8 milionë lekë. d) Në paragrafin e katërt të këtij neni parashikohet se kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se 20 vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë nga 8-10 milionë lekë. e) Në rast se kjo vepër kryhet duke shfrytëzuar funksionin shtetëror ose shërbimin publik, dënimi me burgim dhe gjoba shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.”

524. Gjithashtu, me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007 u miratuan ndryshimet në nenin 298 të Kodit Penal “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, duke mundësuar në këtë mënyrë hetimin e rasteve të kontrabandimit të personave edhe në ato shtete që nuk kanë kufij tokësorë me Shqipërinë.

Me miratimin e këtij neni në Kodin Penal, ndër të tjera, tashmë është bërë i mundur edhe dallimi ndërmjet trafikimit të personave nga kondrabandimi i personave.

Për sa i përket mbrojtjes së fëmijëve, në kuadër të masave mbrojtëse dhe parandaluese ndaj shfrytëzimit të tyre, në muajin mars të vitit 2007 u propozuan disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal, të cilat u miratuan nga Kuvendi me Ligjin nr. 9859, datë 21.01.2008. Më konkretisht, nenet e shtuara janë: 1) Neni 124/b “Keqtrajtimi i të miturve”, i cili ndër të tjera, dënon fenomenin e shfrytëzimit të fëmijëve për punë të detyruar, lypje dhe shërbime të tjera të detyruara. 2) Disa shtesa në nenin 128/b “Trafikimi i të miturve” të Kodit Penal ku penalizohet me ligj jo vetëm rekrutimi, fshehja, pritja etj, por edhe shitja e të miturve.

525. Një hap i rëndësishëm në drejtim të plotësimit të kuadrit ligjor për luftën kundër trafikimit, është edhe ratifikimi i Konventës së Këshillit të Evropës “Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”, (me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006).

526. Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit, si dhe Planet përkatëse të Veprimit (miratuar me VKM nr. 1083, datë 23.07. 2008).

527. Qeveria shqiptare por edhe të gjitha strukturat dhe agjensitë shtetërore dhe joshetërore të përfshira në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore kanë ushtruar veprimtarinë e tyre në bazë edhe të një bashkëpunimi dhe koordinimi midis tyre në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Ky dokument ka ekzistuar që në vitin 2001 dhe është përmirësuar në vitet në vazhdim. Për të mundur një koordinim të veprimeve antitrafik në vend u hartua dhe u miratua Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit 2005 – 2007. Këto Strategji kanë shërbyer si instrument shumë të rëndësishëm në punën e Qeverisë dhe të gjitha strukturave të përfshira në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Në përfundim të afatit të zbatimit të tyre, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit në Njerëz hartoi një Raport Vlerësues për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005-2007. Raporti përveç aspektit informues shërbeu edhe si një instrument bazë mbi të cilin u punua për hartimin e Strategjisë së re 2008-2010.

528. Lufta kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtja e fëmijëve viktima/viktima të mundshme të trafikimit mbetet një shqetësim kyç i Qeverisë shqiptare. Për këtë qëllim krahas masave të tjera Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010 i bashkëngjitet një strategji më vete dhe një plan veprimi kundër trafikimit të fëmijëve. Ajo përbën një pjesë të pandashme të kësaj strategjie dhe thekson qasjen specifike që nevojitet për trajtimin e fenomenit të trafikimit të fëmijëve duke patur në konsideratë dhe prioritet respektimin dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve.

529. Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit si dhe Planet e Veprimit 2008 - 2010 janë hartuar në një proces të gjatë konsultimesh gjithpërfshirëse. Në këtë proces kanë marrë pjesë përveç strukturave zbatuese të Strategjisë 2005-2007, edhe aktorë të tjerë shtetëror, jo-shtetëror dhe donatorë ndërkombëtarë, ku një rol shumë të rëndësishëm ka luajtur shoqëria civile. Gjatë muajve shkurt-prill 2008, janë zhvilluar rreth 20 takime konsultative dhe 6 seminare mbi tema specifike të Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Seminari i organizuar në muajin prill 2008 ka patur në fokus hartimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit.

530. Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008- u prezantuan zyrtarisht në Konferencën Kombëtare të zhvilluar në muajin maj 2008 dhe njëkohësisht u miratua në parim nga Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Si rezultat i një procesi transparent dhe gjithpërfshirës, Strategjia gëzon mbështetjen dhe angazhimin e plotë të të gjithë aktorëve, në mënyrë të veçantë të shoqërisë civile, e cila tashmë është pjesë aktive në realizimin dhe përmbushjen e aktiviteteve dhe objektivave të parashikuara për periudhën 2008-2010. Kjo strategji përmban një plan kombëtar veprimi në të cilin janë pasqyruar qartë të gjitha masat dhe veprimet që do të ndërmerren gjatë zbatimit të saj si dhe institucionet, strukturat përgjegjëse dhe afatet e realizimit të këtyre masave. Për herë të parë në këtë Strategji parashikohet edhe buxhetimi si një element shumë i rëndësishëm për të bërë të mundur realizimin e saj.

Strategjia parashikon një shkallë më të gjerë angazhimi të agjensive zbatuese shtetërore në nivel qendror dhe vendor. Si rrjedhojë, është zgjeruar gama e agjensive zbatuese duke e vënë theksin tek strukturat në nivel vendor si mënyra më e mirë për të pasur një ndërhyrje efektive dhe sa më afër problematikës reale dhe përfituesve. Synohet që të ndërtohet një rrjet i gjerë bashkëpunimi dhe bashkërendimi duke bërë një ndarje të qartë të roleve, përgjegjësi dhe detyrave të gjithsecilit. Strategjia synon që të ndërtojë dhe të bëjë funksional një sistem gjithpërfshirës nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar Referues për t'u ardhur në ndihmë personave viktimë të trafikimit. Në dokument trajtohen aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me hetimin dhe ndjekjen penale, mbrojtjen sociale dhe integrimin e viktimave të trafikimit, parandalimin e fenomenit si dhe çështje të koordinimit dhe bashkëveprimit. Prioritete të strategjisë do të jenë përfshirja e fëmijëve në shkolla, respektimi i të drejtave të fëmijëve dhe grave, krijimi i mundësive për punësim, mbështetja e vazhdueshme kryesisht për grupet e rrezikuara, rehabilitimi dhe integrimi i viktimave të trafikimit, rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal etj. Aktivitetet e nevojshme mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare 2008-2010 do të planifikohen dhe buxhetohen nga secila Ministri më vete. Gjithashtu, nëpërmjet një plani konkret, nga vetë drejtuesit e dikastereve do të mbikëqyret nga afër me rigorozitet zbatimi i këtyre aktiviteteve. Për realizimin e kësaj Strategjie nevojitet jo vetëm angazhimi i agjensive zbatuese, por edhe një mbështetje dhe bashkëpunim më i gjerë me të gjithë aktorët dhe partnerët vendas dhe ndërkombëtarë. Një rol të rëndësishëm në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe parandalimin do të luajë edhe vetë shoqëria shqiptare, përfshirja dhe kontributi i së cilës është jetik për një përgjigje gjithpërfshirëse dhe efektive ndaj këtij fenomeni.

531. Gjithashtu përse i përket parandalimit të trafikimit të fëmijëve gjatë periudhës 2004-2008 janë realizuar një sërë projektesh nga institucionet shtetërore me ekspertizë të OJF-ve dhe organizatave të huaja. Janë organizuar fushata ndërgjegjësimi kryesisht për grupet vulnerabël (të rinjtë, gratë dhe vajzat, familjet me probleme sociale, me nivel të ulët arsimor, fëmijët rom etj) në formën e takimeve me grupet e interesuara. Për të parandaluar trafikimin tek kategoritë e rrezikuara janë marrë disa masa për përfshirjen dhe integrimin e tyre në shoqëri duke zbatuar ligjin për arsimin e detyrueshëm dhe regjistrimin në zyrat e gjendjes civile, dhe duke ofruar arsimim/trajnim profesional kompensues për ata që kanë braktisur shkollën, nëpërmjet strukturave shtetërore vendore të përfshira në rrjete antitrafik – Komitetet Rajonale të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Një hap i sigurt drejt parandalimit të trafikimit është edhe ndërgjegjësimi i fëmijëve në shkollë. Për këtë qëllim, MASH ka marrë masat për të përfshirë në lëndët që kanë të bëjnë me ndërgjegjësimin gjinor e edukatën shoqërore në të gjitha nivelet shkollë para-universitare të temave mbi trafikimin.

532. Gjithashtu në kuadër të parandalimit një instrument i rëndësishëm në duart e publikut tashmë është hapur dhe është funksionale 24 orë gjatë 7 ditëve të javës linja telefonike kombëtare pa pagesë “Help line” (0800 12 12), për denoncimin e rasteve të trafikimit. Ajo është në funksion të publikut që në muajin nëntor 2006. Janë bërë raportime të vazhdueshme periodike për rastet e denoncuar

nga publiku. Ngritja e linjës fillimisht është mbështetur financiarisht nga UNODC (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimet) dhe Organizata Ndërkombëtare e Migracioni (IOM). Që nga muaji nëntor 2007 dhe në vazhdim kjo linjë mbështetet financiarisht plotësisht nga Ministria e Brendshme.

Shfrytëzimi, abuzimi seksual, trafikimi, rrëmbimi- Rekomandimi 71/b/forcimi i bashkëpunimit me vende nga/ku fëmijët janë trafikuar dhe harmonizimi i legjislacionit.

533. Lidhur me rekomandimin 71/b gjatë periudhës 2004 -2008 janë nënshkruar një sërë Marrëveshesh dhe Konventash të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal në fushën e drejtësisë, bashkëpunimit të policive, ndihmave juridike kundër trafikimit dhe krimit të organizuar, për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktime të trafikimit, mbi ripranimin e personave, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, përgjegjësinë prindërore dhe aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve. Në kuadrin e hartimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve rajonale bilaterale, Zyra e Koordinatorit Kombëtar ka ndërmarrë takime ndërkufitare me vendet fqinje (Maqedoni, Kosovë, Mal i Zi, Greqi), të cilat do të rezultojnë me nënshkrimin e marrëveshjeve dhe protokolleve për bashkëpunim policor dhe kufitar për shkëmbim informacioni në kuadër të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Me vendet fqinje Shqipëria ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi, konkretisht:

534. Në muajin shkurt 2006 është nënshkruar në Tiranë Marrëveshja me Greqinë “Për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktime të trafikimit”, marrëveshje e cila përbën një instrument të rëndësishëm ligjor në drejtim të mbrojtjes së fëmijëve. Ratifikimi i marrëveshjes edhe nga Parlamenti Grek në muajin dhjetor 2008 bën të mundur vënien në zbatim të marrëveshjes si dhe ndërmarrjen e përgjegjësive nga autoritetet shtetërore shqiptare dhe greke për identifikimin, mbrojtjen, rehabilitimin dhe rikthimin e sigurt të fëmijëve shqiptarë të shfrytëzuar në Greqi. Marrëveshja është një dokument mjaft i rëndësishëm në kuadër të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në veçanti të mbrojtjes së këtyre viktimave dhe në këtë rast të fëmijëve viktime të trafikimit, që ndodhen në Greqi, pasi ajo përcakton detyrime konkrete për Palët nënshkruese për të vepruar dhe trajtuar raste konkrete. Kjo marrëveshje është i pari dokument rajonal në këtë drejtim. Me Maqedoninë është nënshkruar Protokollin Shtesë me Ministrinë e Brendshme Maqedonase “Për Intensifikimin e Bashkëpunimit në Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore përmes kufijve shtetërorë dhe për intensifikimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit të viktimave, si dhe personave të dyshuar si viktime të trafikimit të qenieve njerëzore”.

535. Me Kosovën është hartuar dhe është gati për nënshkrim Protokollin Shtesë “Për Intensifikimin e Bashkëpunimit në Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore përmes kufijve shtetërorë dhe për intensifikimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit të viktimave, si dhe personave të dyshuar si viktime të trafikimit të qenieve njerëzore”.

535. Në kuadër të zgjerimit të këtij bashkëpunimi janë nënshkruar dhe ratifikuar një sërë marrëveshesh ripranimi, ku ndër më të rëndësishmet mund të përmendim Marrëveshjen ndërmjet RSH-së dhe Komunitetit Europian, "Për ripranimin e personave", nënshkruar më 14 prill 2005, e cila tashmë ka hyrë në fuqi për shtetasit shqiptarë dhe në një fazë të mëvonshme për personat nga vendet e treta. Marrëveshje dypalëshe të ripranimit janë nënshkruar edhe me: Italinë, Belgjikën, Republikën Federale Gjermane, Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Hungarinë, Maqedoninë, Bullgarinë, Rumaninë, Kroacinë dhe Zvicrën. Gjatë vitit 2006 nga autoritetet policore të vendeve të huaja u deportuan 978 femra, prej të cilave 228 nën moshën 18 vjeç, ndërsa nga strukturat e policisë kufitare janë ndaluar të dalin jashtë vendit 49 femra, ndër të

cilat 8 në moshën 18 vjeç, të cilat dyshoheshin se mund të ishin viktime të trafikut për qëllim prostitucioni.

Me Qeverinë e Republikës së Polonisë, Qeveria Shqiptare ka miratuar në parim, marrëveshjen “Për bashkëpunim në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të tjera” (Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.264, datë, 05.03.2008). Marrëveshja është gati për nënshkrim për palën shqiptare, kurse nga pala polake pritet përgjigja e tyre lidhur me përfundimin e procedurave të brendshme ligjore për nënshkrimin e marrëveshjes.

Shfrytëzimi, abuzimi seksual, trafikimi, rrëmbimi- Rekomandimi 71/c

536. Lidhur me rekomandimin 71/c përveç ndryshimeve të bëra në Kodin Penal, janë hartuar dhe miratuar një sërë ligjesh të tjera, të cilat plotësojnë kuadrin ligjor në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, që garantojnë mbrojtjen e viktimave të trafikimit përfshirë edhe fëmijët. Konkretisht:

537. Ligji nr. 9205, datë 15.03.2004 “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë” përcakton një sërë masash për mbrojtjen e ankuesit dhe dëshmitarit ndaj çdo lloj keqtrajtimi ose kërcënimi si pasojë e ankesës, apo dëshmime të dhëna, si dhe mbrojtjen ligjore dhe fizike të viktimave të trafikimit. Ky ligj rregullon masat e posaçme, mënyrën dhe procedurat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe organizimin, funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara me propozimin, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes. Aplikimi i masave të mbrojtjes. Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve ka filluar aplikimin e masave të mbrojtjes që në muajin prill 2005. Gjatë periudhës prill 2005 – gjatë vitit 2008 janë zbatuar dhe po zbatohen dy lloj masash, masa të përkohshme të mbrojtjes (neni 14 i ligjit) dhe masa të posaçme të mbrojtjes (neni 10 i ligjit). Masat e mbrojtjes janë zbatuar për një numër të konsiderueshëm rastesh, po me një numër të konsiderueshëm personash, ku përfshihen në mbrojtje kategoritë: dëshmitarë drejtësie, bashkëpunëtor drejtësie, persona të afërm dhe të lidhur me ta. Masat e posaçme të mbrojtjes që zbatohen janë: a) ndryshim identiteti; b) ndryshim vendbanimi; c) masa të veçanta mbrojtëse, fizike, teknike në vendin ku qëndron personi i mbrojtur, si dhe gjatë lëvizjeve të tij, përfshirë masat për përmbushjen e detyrimeve ndaj organeve të drejtësisë; d) mbrojtja dhe trajtimi i posaçëm, në rastet kur për kryerjen e një veprë penale, bashkëpunëtorit të drejtësisë i është caktuar masë sigurimi ose është dënuar me burgim; e) mbrojtja e përkohshme e identitetit, e të dhënave dhe dokumentave të personit të mbrojtur; f) dhënia e deklarimeve të dëshmitarit nën një identitet tjetër, administrimi i tyre me mjete të veçanta për deformimin e zërit, të pamjes së vërtetë të tij; g) rehabilitim social; h) ruajtje, ndryshimi, sigurimi i përkohshëm i vendit të punës; j) dhënia e ndihmës financiare; k) rikualifikim profesional; l) ndihmë e specializuar ligjore.

538. Kjo Drejtoria ka krijuar kushtet e nevojshme: a) për vazhdimin e arsimit shkollor, ciklit përkatës, edhe në vendbanimet ku ata janë akomoduar; b) sigurimi i kontrollit mjekësor; c) sigurimi i mbrojtjes ligjore për çështje civile që nuk kanë lidhje me faktin për të cilin personi është marrë në mbrojtje, (rasti i vendosjes së kujdestarisë ndaj dëshmitarit të drejtësisë); d) sigurimi i ndihmës psikologjike, për shkak të gjendjes së stresit që kanë kaluar. Në zbatim të ligjit, Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve ka buxhetin e saj, të përfshirë në buxhetin e Policisë së Shtetit, me qëllim zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes. Shpenzimet financiare për këto raste përballohen nga buxheti i saj.

539. Ligji Nr. 9284, datë 30.09.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, i parashikon konfiskimin e pasurisë së autorëve të kësaj vepre penale, si dhe kompensimin e viktimave të trafikimit nga pasuritë e konfiskuara të trafikantëve.

540. Ministria e Shëndetësisë ka filluar punën për përgatitjen e ndërhyrjeve konkrete, të cilat synojnë në parandalimin e pasojave imediate dhe afat gjata të dhunës në familje dhe në veçanti të dhunës ndaj grave, vajzave dhe fëmijëve, ku prioritet ka parandalimi i dëmtimeve, i sëmundjeve dhe i pasojave shëndetësore që vijnë nga keqtrajtimi i grave, vajzave dhe fëmijëve. Këtu futet edhe abuzimi seksual. Të gjitha Drejtoritë e Shëndetit Publik janë udhëzuar që të ngrejnë ekipin përgjegjës të përbërë nga mjekë (Inspektori i Shëndetit Riprodhues), infermier (Specialisti i Kujdesjeve infermiore) si dhe punonjësi social, ose psikologu kur ata i kanë në strukturë. Ky ekip ka për detyrë të manaxhojë dhe supervizionojë zbatimin e ligjit Ligjit nr 9669, datë 18 /12/ 2006, “Për masa ndaj dhunës në mardhëniet familjare” dhe të akteve nënligjore e rregulloreve të nxjerra nga MSH. Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare të Punonjësve Social po vazhdon trajnimin e punonjësve të shëndetësisë (mjek dhe infermier të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor) mbi dhunën me bazë gjinore, abuzimin seksual, ku vemendje u kushtohet edhe grupit target të vajzave dhe fëmijëve. Gjatë fazës së parë janë trajnuar 160 personel shëndetësor përkatësisht në rrethet Tiranë, Vlorë, Shkodër, Peshkopi dhe Pogradec. Faza e dytë e trajnimeve vazhdon në rrethet Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë dhe Kukës. Gjatë kësaj faze është parashikuar të trajnohen rreth 400 punonjës të shëndetësisë për dhunën me bazë gjinore. Strategjia Kombëtare për Shëndetin Riprodhues që do të miratohet këtë vit parashikon ndisa ndërhyrje për mbrojtjen e fëmijëve kundër të gjitha formave të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, përfshirë edhe brenda familjes për periudhën 2009-2015.

541. Bashkëpunimi me shoqërinë civile në luftën kundër trafikimit. Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore ka bashkëpunuar ngushtë dhe ka gjetur një mbështetje të vazhdueshme tek të gjithë aktorët e përfshirë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore por në mënyrë të veçantë me shoqërinë civile. Një kontribut të veçantë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, dhe sidomos në parandalimin e këtij fenomeni kanë dhënë OJF-të vendase dhe të huaja që ofrojnë shërbime rehabilituese apo parandaluese për viktimat e trafikimit dhe të gjitha grupet e rrezikuara në mënyrë të veçantë fëmijët. Në fund të vitit 2007 Zyra e Koordinatorit Kombëtar me qëllim zgjerimin e partneritetit antitrafik, ka zhvilluar disa takime dhe ka shkëmbyer informacione të vazhdueshme me Organizata Ndërkombëtare dhe OJF vendase, që në veprimtarinë e tyre luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Këto takime kanë shërbyer edhe për identifikimin e partnerëve të rinj si dhe përfshirjen e tyre në aktivitete të ndryshme si dhe në planifikimet e bëra për të ardhmen. Tashmë në Shqipëri ekziston edhe një koalicion me emrin “Bashkë kundër Trafikimit të Fëmijëve” (BKTF) në përbërje të të cilit janë disa organizata të profilizuara në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të fëmijëve.

Shfrytëzimi, abuzimi seksual, trafikimi, rrëmbimi- Rekomandimi 71/e

542. Lidhur me rekomandimin 71/e për trajnimin e strukturave të zbatimit të ligjit, me qëllim rritjen e njohurive dhe ndërgjegjësimin e personave që punojnë me viktimat e trafikimit janë organizuar dhe vazhdojnë të organizohen në bashkëpunim të ngushtë edhe me organizatat ndërkombëtare trajnime për të gjitha strukturat e zbatimit të ligjit (Punonjësit e policisë, Gjyqtarët, Prokurorët, OJF-të, Shërbimin Social Shtetëror etj.) të përfshira në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Këto trajnime janë zhvilluar mbi tema dhe çështje specifike në lidhje me çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore; zbatimit të Mekanizmit Kombëtar të Referimit; njohjes me kuadrin ligjor,

Strategjinë Antitrafik; në fushën e dhënies së ndihmës ligjore dhe psikologjike ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, dëshmitarëve ose atyre që janë në rrezik trafikimi; si dhe për njohuri mbi të drejtat e njeriut dhe viktimat e trafikimit duke u fokusuar në mënyrë të veçantë mbi të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre nga trafikimi. Njësia Antitrafik ka qenë koordinator, bashkëorganizator dhe trajnues në të gjitha trajnimet e organizuara nga organizata të tilla si IOM, UNICEF etj. Vetëm gjatë vitit 2008 nën kujdesin e veçantë të Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Njesisë Antitrafik janë trajnuar gjithsej: 150 (specialistë të seksioneve antitrafik, policisë kufirit dhe policimit në komunitet); 20 gjyqtarë dhe prokurorë; 100 punonjës të shërbimit social shtetëror dhe të OJF-ve; 60 punonjës të strukturave përbërëse të Komiteteve Rajonale Antitrafik në tre qarqe të vendit (vazhdojnë trajnimet me qarqet e tjera).

Shfrytëzimi, abuzimi seksual, trafikimi, rrëmbimi- Rekomandimi 7/ f ratifikimi i Protokollit Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, “Mbi shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve”.

543. Në zbatim të rekomandimit 71/f, Shqipëria ka aderuar në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, “Mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijët” (me ligjin nr. 9834, datë 22/11/2007)⁵⁸.

Fëmijët e rrugës Rekomandimi 73.

544. Një nga objektivat e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët është edhe mbrojtja e fëmijëve dhe ulja e numrit të fëmijëve që lypin. Në kuadër të kësaj strategjie janë ngritur Njësitet e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF) në bashki. Njësitet kanë për detyrë të identifikojnë fëmijët në rrezik (përfshirë këtu edhe fëmijët e rrugës) dhe pasi të kenë vlerësuar situatën e fëmijës dhe familjes së tij, të krjojnë grupe multidisiplinare për hartimin e një programi ndërhyrjeje për se cilin rast. Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve bashkëpunon me administratorët shoqërorë sipas ndarjeve administrative të bashkisë, psikologët e shkollave, mjekun e familjes, policinë anti-trafik dhe policinë e rendit, punonjësit social të qendrave të shërbimeve publike e jopublike në territorin e bashkisë. Për çdo fëmijë të identifikuar si fëmijë në rrezik, punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve organizon një ekip multidisiplinar sipas nevojave dhe situatës së fëmijës. Ekipi vlerëson rastin, nivelin e rrezikut, përcakton hapat që do të ndiqen dhe detyrat e secilit aktor. Fëmija dhe familja e tij monitorohen në mënyrë të vazhdueshme nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve deri atëherë kur fëmija konsiderohet “jo në rrezik”. Strukturat për Mbrojtjen e Fëmijëve në bashki shërbejnë edhe si drop - in center, ku fëmijët dhe familjet mund të marrin informacion apo të referohen tek shërbime të tjera mbështetëse, sipas nevojave

545. MPCSSHB në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, Bashkinë e Tiranës, OSBE, si dhe shoqërinë civile ka organizuar fushata sensibilizimi dhe spote publicitare kundër fenomenit të lypjes dhe punës së detyruar të fëmijëve, si një nga format më të rënda të punës së fëmijëve në Qershor 2007 dhe Qershor 2008.

Ky fenomen jo vetëm që shkel të drejtat e fëmijëve duke i përjashtuar ata nga e drejta për arsim e zhvillim, por i bën ata më vulnerabël ndaj dhunës dhe abuzimit. Fushatat synuan të sensibilizonte publikun e gjerë mbi fenomenin dhe pasojat negative të tij, me sloganin “Monedhat tuaja ushqejnë shfrytëzimin e fëmijëve”.

⁵⁸ Pas depozitimit të instrumenteve të aderimit, sipas faqes zyrtare të Komitetit CRC, Shqipëria ka aderuar në datën 5 shkurt 2008.

546. Në kuadër të Programit kombëtar për eliminimin e punës së fëmijëve Njësia për Eliminimin e Punës së Fëmijëve në MPCSŠHB po zbaton Projektin “Sistemi i Monitorimit të Punës së Fëmijëve në Shqipëri”. Në fund të 2007 përfundoi faza e parë e Projektit e shtrirë në 3 qarqe. Si rezultate të këtij projekti mund të përmenden kthimi në shkollë i 54 fëmijëve për të përfunduar arsimin e detyrueshëm, sigurimi i formimit profesional për 8 të rinj dhe mbështetja e familjeve të fëmijëve. Është ofruar formim profesional në 18 raste për prindërit apo pjesëtarët e rinj të familjeve të fëmijëve që punonin, punësim të prindërve apo pjesëtarëve në moshë të familjes në 57 raste, asistencë ekonomike në 44 raste si dhe shërbime të tjera si këshillim, asistencë juridike, trajtim mjekësor për 95 fëmijë që punonin dhe fëmijë në rrezik për të punuar. etj. Faza e dytë është miratuar në Shkurt 2009 dhe do të zgjasë për 9 muaj. Projekti po zbatohet në Tiranë, Korçë, Berat, Elbasan dhe Shkodër duke ndërmarrë veprime dhe aktivitetet konkrete për tërheqjen nga puna, riintegrimin e fëmijëve dhe parandalimin e fenomenit. Projekti synon në eliminimin progresiv të formave më të këqija të punës së fëmijës në Shqipëri duke i propozuar Qeverisë modelin “Sistemi I Monitorimit të Punës së Fëmijëve” i testuar më parë në pesë qytete. 315 fëmijë të përfshirë në format më të këqija të punës, veçanërisht fëmijë që punojnë në rrugë, në bujqësi, fëmijë viktime dhe në rrezik të trafikimit e shfrytëzimit seksual, do të tërhiqen nga puna. Fëmijët e targetuar do të monitorohen derisa të jetë siguruar integrimi i tyre. Për fëmijët që do të trajtohen në kuadrin e këtij Projekti do të sigurohet: 1) Arsimi formal si dhe arsim jo-formal në klasa me mësues të specializuar për 265 fëmijë. Për këta fëmijë do të sigurohet edhe mbështetje me mjete mësimore. 2) Në zbatim të planit individual të trajtimit që do të hartohet për çdo fëmijë do të sigurohen shërbime ndihme e këshillimi si: këshillim psiko-social, këshillim ligjor, udhëzime për karrierë, aktivitetet rekreative, mbështetje për të marrë përfitimet ligjore që u takojnë, trajtim mjekësor etj. 3) Për 50 fëmijë që kanë mbushur moshën do të sigurohet formim profesional për një periudhë 3-6 muaj duke i pajisuar me licencë përkatëse. 4) Për 15 fëmijë që kanë ndjekur dhe përfunduar formimin profesional do të sigurohen pajisjet për fillimin e një aktiviteti në fushën e kualifikimit të tyre duke ndihmuar kështu edhe familjen. 5) Për anëtarët e rritur dhe prindërit e fëmijëve që do të trajtohen, do të ofrohen mundësi të formimit profesional përkundrejt kthimit të fëmijëve në shkollë dhe tërheqjes nga puna. 6) Sigurimi i të paktën 300 prindërve me informacion mbi skemat ekzistuese për ndihmës sociale, ngritjes së vetëdijes mbi pasojat e punës së fëmijëve dhe nevojën e ndërmarrjes së veprimeve konkrete për mbrojtjen e fëmijëve të tyre.

Abuzimi me drogat *Rekomandimi 75.*

547. Në kuadrin e masave kundër trafikimit të substancave narkotike, nga viti 2004 janë bërë përmirësime në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale dhe ka patur arritje në goditjen e rrjeteve kriminale të lidhura me trafikimin e drogave.

Në vitin 2001 u miratua nga Parlamenti Shqiptar Ligji Nr 8750 “Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit ilegal të narkotikëve dhe substancave psikotrope”. Ky ligj parashikon edhe funksionimin e Komitetit Kombëtar për koordinimin e luftës kundër drogave.

Në vitin 2002 është miratuar ligji nr 8874 “Për kontrollin e substancave që mund të përdoren në prodhimin ilegal të narkotikëve”. Në vitin 2004 dhe në vitin 2006 është përmirësuar me dy amendime ligji i vitit 1995 “Për substancat narkotike dhe psikotrope”.

548. Në maj të vitit 2004, grupi ndërministerial hartoi Strategjinë Kombëtare të Luftës kundër Drogave 2004-2010. Strategjia përfshin si reduktimin e kërkesës për drogë ashtu edhe reduktimin e ofertës me drogë. Një plan aksioni në funksion të strategjisë është miratuar gjithashtu me urdhrin nr 156 të vitit 2004. Gjithashtu po rishikohet Strategjia dhe Plani i Veprimit për drogat e cila do të këtë një vëmendje më të madhe lidhur me parashikimin e ndërhyrjeve konkrete për fëmijët. Strategjitë për parandalimin e drogave të fëmijëve lidhen edhe me alkolin dhe duhanin (abuzimi me alkolin duhanin, drogat dhe substancat psikotrope). Klinika Toksikologjike në Spitalin Ushtarak ofron

trajtim për përdoruesit e drogave, por ka një kapacitet të kufizuar me 15 shtretër. MSH në programin e saj të bashkëpunimit bashkëpunim me qendrën Emanuel, rehabiliton personat që dalin nga përdorimi i drogave. Po kështu në bashkëpunim me OJF-në Aksion Plus, zbaton programin e reduktimit të dëmit duke ofruar falas terapinë me metadon. Pranë Institutit të Shëndetit Publik është vendosur linja pa pagesë 0800 47 47, e cila është në dispozicion të mirinformimit të popullatës mbi substancat abuzive.

549. Në vitin 2004-2005 është kryer nga ISHP studimi i sjelljeve të rrezikshme tek të rinjtë e shkollave të mesme (14-18 vjeç) në një kampion prej pothuaj 4000 personash dhe rezultatet kanë shërbyer për të matur prevalencën e përdorimit (life-time prevalencë) të disa drogave apo substancave psikotrope. Gjatë vitit 2009 ky studim do të përsëritet me të njëjtën metodologji duke prodhuar për herë të parë një sistem të monitorimit periodik të përdorimit të drogave midis të fëmijëve dhe adoloshentëve⁵⁹.

550. Gjatë vitit 2008 nuk ka patur asnjë rast të përfshirjes së fëmijëve nën 15 vjeç në shpërndarjen e lëndëve narkotike. Gjithashtu nuk është i vërtetë fakti se drogat shpërndahen lirshëm nga shpërndarësit. Është bërë një punë shumë e madhe për goditjen e rrjeteve të shpërndarjes së drogës dhe për rritjen e efikasitetit të policisë në arrestimin e shpërndarësve të drogës.

551. Me qëllim rritjen e bashkëpunimit me institucione të tjera në këtë drejtim në vitin 2009 është nënshkruar një aktmarrëveshje trepalëshe, “Për parandalimin e shpërndarjes së drogave në mjediset shkollore e universitare” midis Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

552. Nga viti 2006 në sistemin shkollor shqiptar është futur profesioni i psikologut me synim ndihmën kur është e nevojshme të fëmijëve dhe familjeve të tyre.

Edukimi për parandalimin e duhanit, alkoolit dhe drogave në arsimin parauniversitar është konsideruar i rëndësishëm dhe pjesë e natyrshme e edukimit dhe formimit të fëmijëve dhe të rinjve në shkollë. Arsimi i ka paraprirë këtij problemi me futjen në kurrikulat shkollore të njohurive, të aftësive dhe të qëndrimeve të nevojshme për parandalimin e drogave. Format kurrikulare në të cilat shkolla ka trajtuar dhe trajton këto probleme kanë qenë: si lëndë më vete, si kroskurrikul përmes lëndëve shkollore dituri natyre dhe edukatë shoqërore në arsimin fillor, biologji, edukatë qytetare në arsimin bazë dhe biologji, kimi, sociologji, psikologji në arsimin e mesëm; si veprimtari ekstrakurrikulare.

Drejtësia për të rinjtë (neni 40)

Administrimi i drejtësisë për të miturit. Rekomandimi 77.

553. Lidhur me zbatimin e standarteve të drejtësisë për të miturit, veçanërisht përsa i përket zbatimin e neneve 37,39,40 të Konventës, si dhe rekomandimin 77 të Komitetit CRC përsa i përket administrimit të drejtësisë për fëmijët informojmë:

Ligji nr. 9749 datë 4.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, parashikon se kur i shoqëruari është i mitur, në çdo rast njoftohet menjëherë personi përgjegjës për mbikëqyrjen e tij. Të miturit shoqërohen në mjedise të veçanta nga ato të të rriturve. Në bazë të këtij ligji, në masat që ndërmerr policia e shtetit për ruajtjen e rendit parashikohet se nëse cënimi i rendit dhe sigurisë publike ka ardhur si pasojë e veprimeve të një personi të mitur nën 14 vjeç, përveç masave të marra ndaj tij, punonjësi i Policisë

⁵⁹ Të dhëna lidhur me këtë studim paraqiten në anekset bashkëlidhur këtij Raporti.

njofton prindin ose kujdestarin e të miturit nën 14 vjeç për ndërprerjen e veprimeve të paligjshme të të miturit. Në këtë ligj përcaktohet se punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në mjediset e policisë, ose në organin urdhërdhënës, për mbikqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent. Personeli i Policisë së Shtetit është përgjegjës për sigurimin, trajtimin e të ndaluarve, arrestuarve deri në momentin e caktimit të masës së sigurimit “arrest me burg” nga organet e gjykatës.

554. Në ligjin “Për Policinë e shtetit” (neni 101/3) përcaktohet se “mbajtja e personave të shoqëruar në ambiente dhe zyra të policisë deri në verifikimin e çështjes për të cilën është shoqëruar nuk mund të zgjasë më shumë se 10 orë”. Gjatë kësaj periudhe prej 10 orësh kryen verifikime, sqarime, grumbullime të provave dhe në përfundim të kësaj periudhe për ata që nuk vërtetohen dyshimet, nuk grumbullohen provat lihen të lirë dhe për ata që verifikohet (ka prova) se janë autorë të veprave penale pas 10 orëve merret masa e arrestit në flagrancë apo masa e ndalimit.

555. Në Urdhrin e Ministrit Brendshëm “Për garantimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut gjatë shoqërimit në ambientet e policisë dhe në sistemin e paraburgimit” (nr. 2191, datë 25.09.2006) përcaktohet se, për personat që ndalohen dhe arrestohen periudha paraprake e verifikimit prej 10 orësh llogaritet në afatet e ndalimit e arrestimit (koha e ndalimit apo e arrestimit dokumentohet dhe llogaritet duke filluar nga koha e heqjes së lirisë të personit dhe jo duke filluar nga koha e përpilimit të procesverbalit të arrestimit apo ndalimit). Në këto raste nuk ka shtesë prej 10 orësh mbi 48 orëshin. Pas kësaj periudhe (48 orë) i ndaluari e arrestuari vihet para organeve të gjykatës për të shqyrtuar, vlerësuar dhe caktuar masën e sigurimit nëse do të trajtohet “në arrest me burg” apo do të lihet i lirë.

556. Trajtimi i të miturve në ambientet e komisariateve të policisë bëhet konform kërkesave të Kodit të Procedurës Penale. Në rastet e ndalimit të tyre, për një periudhë 48 orë deri në miratimin e shqyrtimit të masës së sigurimit nga gjykata, të miturit mbahen në ambientet e sigurisë (ndaluarve/arrestuarve) në komisarariatet e policisë, të cilat kanë kapacitetet e nevojshme për të siguruar veçimin e të miturve nga të rriturit, duke pasur parasysh numrin e vogël dhe kohën e shkurtër të rasteve të personave të mitur të arrestuar apo ndaluar. Strukturat vendore të Policisë së Shtetit deri në përfundim të procesit të transferimit të sistemit të paraburgimit pranë Ministrisë së Drejtësisë, kanë patur nën administrim këtë sistem, në të cilin trajtoheshin të gjithë kategoritë e personave të ndaluar/arrestuar. Me përfundimin e këtij procesi në vitin 2007, aktualisht në mjediset e sigurisë që administroheshin nga Policia e Shtetit, mbahen personat e ndaluar/arrestuar vetëm në momentin e parë rreth 48 orë deri në shqyrtimin e masës së sigurisë nga gjykata dhe më pas ata transferohen në sistemin e paraburgimit të Ministrisë së Drejtësisë. Aktualisht nuk ka raste të mbajtjes së të miturve në të njëjtat ambiente ndalimi me të rriturit, pasi mjediset janë të mjaftueshme. Në Rregulloren e Disiplinës së Policisë së Shtetit” (miratuar me VKM nr. 786, datë 4.6.2008), parashikohet detyrimi dhe norma e sjelljes gjatë detyrës/shërbimit, të punonjësit të policisë për trajtimin e veçantë të të miturve.

557. Në bazë të VKM nr.327 datë 15.05.2003 “Për kalimin e sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë” u vendos kalimi i sistemit të paraburgimit, përfshirë mjediset dhe paisjet nga administrimi i komisariateve të Ministrisë së Rendit Publik në administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Miratimi i këtij vendimi është një përpjekje dhe hap cilësor për kalimin e paraburgimeve nën administrimin e Ministrisë së Drejtësisë, proces i cili ka hasur në vështirësi të shumta. Kalimi i sistemit të paraburgimit nën përgjegjësinë administrative të Ministrisë së Drejtësisë përbën një hap para në përmirësimin e standarteve të sistemit penitenciar në vendin tonë. Në muajin shkurt 2007 ka përfunduar plotësisht

procesi i kalimit i të gjitha paraburgimeve në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Një pjesë e paraburgimeve funksionojnë në seksione të veçanta pranë Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

558. Në bazë të nenit 13 të Kodit të Procedurës Penale (i ndryshuar), gjykimi i të miturve bëhet nga seksionet përkatëse, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, të përcaktuara me dekret të Presidentit. Dekreti i Presidentit nr. 5351, datë 11.06.2007 “Për krijimin e seksioneve të veçanta penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore”, i ndryshuar me dekretin nr. 5559, datë 27.12.2007, krijon 6 seksione të veçanta penale për gjykimin e të miturve në gjykatat e rretheve gjyqësore, Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë. Kompetenca territoriale e këtyre seksioneve do të jetë e barazvlefshme me atë të gjykatave të Apelit, përkatësisht sipas qyteteve të përcaktuara në dekret. Këto seksione do të shqyrtojnë çështjesh në shkallë të parë në lidhje me veprat penale të kryera nga i mituri. Çështjet ku të pandehur janë të mitur dhe të rritur në kryerjen e një ose të disa veprave penale, duhet të gjykohen nga këto seksione. Pranë çdo seksioni do të jenë 3 gjyqtarë të specializuar që do të shqyrtojnë çështjet penale për të miturit.

559. Projektdekreti i përgatitur (i dërguar për shqyrtim e miratim tek Presidenti), mbi krijimin e seksioneve penale për gjykimin e të miturve, ndër të tjera, reflekton sugjerimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për krijimin një seksioni për gjykimin e të miturve në Gjykatën e Elbasanit, duke e shkëputur atë si rreth gjyqësor nga kompetenca territoriale e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Pas analizës së këtij sugjerimi të ballafaquar me statistikat zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, vlerësohet se ky sugjerim është i bazuar. Duke iu referuar të dhënave statistikore për vitet 2007 dhe 2008, seksioni penal në rrethin gjyqësor Durrësit, i cili gjykon edhe çështjet e të miturve përbëhet nga 6 gjyqtarë dhe ka gjykuar respektivisht 75 të mitur në vitin 2007 dhe 176 të mitur në vitin 2008. Këto statistika tregojnë një rritje tepër të ndjeshme të vëllimit të punës në këtë rreth gjyqësor për çështjet penale me të mitur pas momentit të krijimit të seksionit të veçantë penal. Krijimi i seksionit për gjykimin e të miturve në gjykatën e Elbasanit do shkurtonte distancën gjeografike për familjarët e të pandehurve të mitur, që banojnë në rrethet Elbasan, Gramsh, Librazhd e Peqin, për të marrë pjesë në gjykim në gjykatën e Durrësit.

560. Prokurori i Përgjithshëm, në vijim të Dekretit të Presidentit, ka nxjerrë një urdhër në vitin 2008 për krijimin e seksioneve të veçanta penale për hetimin dhe ndjekjen penale të të miturve në 6 prokuroritë e rretheve gjyqësore pranë gjykatave të rretheve gjyqësore të mësipërme.

561. Në Kodin e Procedurës Penale parashikohet se të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon.

562. Në bazë të këtij Kodi, të miturve në çdo fazë të procedimit penal (hetimit, gjykimit, ekzekutimit të vendimit penal) asistohen nga mbrojtësi i tyre. Në rastet kur të miturit ose familjarët e tyre nuk kanë mundësi për të përballuar shpenzimet financiare lidhur me mbrojtjen e tyre, kjo realizohet falas nga shteti.

563. Në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, kur ka arsye për të besuar se i pandehuri është i mitur, organi procedues bën verifikimet e nevojshme dhe kur është rasti urdhëron ekspertimin. Kur, edhe pas verifikimeve dhe ekspertimit, mbeten dyshime për moshën e të pandehurit, prezumohet se ai është i mitur. Organi procedues merr të dhëna për kushtet e jetesës personale, familjare dhe shoqërore të të pandehurit të mitur me qëllim që të sqarojë përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë, të vlerësojë rëndësinë shoqërore të faktit si dhe të caktojë masa të përshtatshme penale. Organi procedues mbledh informacione nga personat që kanë patur marrëdhënie me të miturin dhe dëgjon mendimin e ekspertëve.

564. Kodi i Procedurës Penale parashikon se kur i pandehuri është nën moshën 18 vjeç ose me të meta fizike a psikike që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme. Kur disa nga procedimet e lidhura ndërmjet tyre i përkasin kompetencës së gjykatës së zakonshme dhe të tjerat gjykatës që shqyrton çështjet me të mitur, kompetente për të gjitha procedimet është kjo e fundit, përveç rasteve kur gjykata çmon se ato duhen veçuar. Kur i pandehuri në kohën e gjykimit është madhor, por një ose disa vepra i ka kryer kur ka qenë i mitur, çështja gjykohet nga gjykata që shqyrton çështjet me të mitur. Gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe i fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të mitur, të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale. Gjykata mund të lejojë publikimin vetëm kur e kërkojnë interesat e të miturit ose kur i mituri ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç. Gjithashtu, gjykata vendos që shqyrtimi gjyqësor ose disa veprime të tij të zhvillohen me dyer të mbyllura kur gjykohet e nevojshme në pyetjen e të miturve.

565. Sipas Kodit të Procedurës Penale nuk mund të jenë dëshmitarë për të vërtetuar përmbajtjen e një akti procedural të miturit deri 14 vjeç dhe personat që kanë sëmundje të dukshme mendore ose që janë në gjendje të rëndë dehjeje ose intoksikimi me lëndë narkotike e psikotrope, si dhe nuk pranohen në seancë të miturit nën moshën 16 vjeç.

566. Në nenin 180/1/a të këtij Kodi parashikohet se nuk mund të kryejë detyrën e ekspertit i mituri ose ai që ka ndalim ligjor ose i është hequr zotësia juridike për të vepruar ose vuan nga një sëmundje mendore. Gjithashtu, kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete. Në kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg, Kodi parashikon se të miturit nuk mund të arrestohen kur akuzohen për kundërvajtje penale.

567. Gjithashtu, gjykata vendos që shqyrtimi gjyqësor ose disa veprime të tij të zhvillohen me dyer të mbyllura kur gjykohet e nevojshme në pyetjen e të miturve.

Gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore, para se të fillojë pyetja, kryetari e paralajmëron dëshmitarin për detyrimin dhe përgjegjësinë ligjore që ka për të thënë të vërtetën, me përjashtim të rasteve kur dëshmitari është i mitur deri 14 vjeç. Gjithashtu, pyetja e dëshmitarëve të mitur mund të bëhet nga kryetari, mbi kërkesat dhe kundërshtimet e palëve. Kryetari mund të ndihmohet nga një familjar i të miturit ose nga një specialist i fushës së edukimit të fëmijëve. Kur çmohet se pyetja e drejtpërdrejtë e të miturit nuk e dëmton gjendjen psikologjike të tij, kryetari urdhëron që pyetja të vazhdojë. Urdhri mund të revokohet gjatë pyetjes.

568. Në Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 2, datë 8. 03. 2007 “Për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut në procesin penal” përcaktohet gjithashtu se Prokurorët e shkallës së parë, duhet të bëjnë kujdes në vlerësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për caktimin e masave të sigurimit, për të zgjedhur dhe kërkuar në gjykatë masa të përshtatshme të sigurimit personal, duke shmangur çdo masë sigurimi në kundërshtim me ligjin, si dhe duke reduktuar kohëzgjatjen e masës së arrestit në rastet kur kjo masë është urdhëruar për të garantuar marrjen ose vërtetimin e provës. Në Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 3, datë 8. 03. 2007 “Për përmirësimin e punës dhe kontrollit të prokurorit në ndjekjen penale” përcaktohet se: 1. Në rastet kur të pandehurit janë të arrestuar në flagrancë hetimet të përfundohen nga prokurori brenda 48 orëve dhe të kërkohet bashkë me caktimin e masës së sigurimit edhe gjykimi i drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur prokurori vlerëson se duhet të bëhen hetime të tjera. 2. Në të njëjtën mënyrë sa më sipër duhet vepruar nga prokurori edhe kur i pandehuri ka pohuar kryerjen e veprës penale dhe fajësia e tij është e qartë, duke përfunduar hetimet brenda 15 ditëve dhe duke kërkuar gjykimin e drejtpërdrejtë.

569. Në ligjin nr. 9888, datë 10.3.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, të ndryshuar”, parashikohet se në institucionet e paraburgimit ndalohet mbajtja e të miturve në një dhomë me të rriturit, ose vendosja e të miturve vajza me të mitur djem në një dhomë. Gjithashtu, në ndryshimet e këtij ligji parashikohet se të miturit vendosen në dhoma e seksione të veçuara, duke u krijuar mundësinë e një trajtimi të veçantë. Të miturat vajza mbahen nën mbikëqyrjen dhe kujdesin vetëm të një personeli femëror. Të miturit e dënuar apo të paraburgosur, trajtohen në seksione të vecanta në burgje. Në ambientet e paraburgimeve të miturit trajtohen në seksione të vecanta, në dhoma, qeli, pa patur kontakte me të rriturit e paraburgosur në ambientet e paraburgimeve.

Me qëllim përmirësimin e trajtimit të të miturve të dënuar me burgim (në IEV Penale Vaqarr) dhe kualifikimin e stafit në kontakt me të miturit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka bashkëpunuar me organizata të ndryshme. Gjithashtu janë marrë masat e nevojshme (nëpërmjet urdhrimit të Ministrisë së Drejtësisë), në mënyrë që në të gjitha burgjet të miturit e dënuar të mos kenë mundësi komunikimi dhe kontakti me të rriturit e dënuar.

570. Ligji nr. 10024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, synon të përcaktojë krijimin dhe funksionimin e një mekanizmi konkret “Shërbimin e provës”, si një mekanizëm i ri në Shqipëri, duke zgjidhur në këtë mënyrë problemin ligjor për zbatimin e dënimeve alternative në praktikë në sistemin e ekzekutimit të dënimeve alternative, duke synuar që këto dënime të shndërrohen në stimuj për përmirësimin e standarteve për personat që kryejnë vepra penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore. Pavarësisht se këto ndryshime ligjore nuk janë specifike vetëm për të miturit, në hartimin e dispozitave mbi ngritjen dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe masave alternative që do të mbikëqyrë ky Shërbim, kryesisht janë marrë në konsideratë mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin dhe ri-integrimi social e shoqëror i tyre.

571. Ligji nr. 10.039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, sunon të rregullojë ndihmën juridike që shteti u ofron personave me mundësi të pamjaftueshme ekonomike, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave tyre të ligjshme në gjykata apo organe të tjera shtetërore. Ky akt zgjeron fushën e dhënies së ndihmës juridike duke përfshirë për herë të parë edhe procedurat civile dhe procedurat e këshillimit për dhënien e ndihmës juridike. Në këtë ligj është parashikuar dhënia e ndihmës juridike të miturve në konflikt me ligjin. Në këtë ligj përcaktohet shprehimisht se “ndihmën juridike e përfitojnë edhe të miturit, për të cilët mbrojtja në procedimin penal dhe në gjykim është e detyrueshme me ligj”. Ky parashikim është bërë në plotësim të parashikimeve të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale (neni 35 i KPP “Ndhimja që i jepet të pandehurit të mitur”, i cili në pikën 1 të tij parashikon se “të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit.....”, si dhe neni 49 i K.Pr.P. “Mbrojtësi i caktuar”, i cili në pikën 2 të tij parashikon se “kur i pandehuri është nën moshën 18 vjeç....., ndihma nga një mbrojtës është i detyruar”), si dhe në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

572. Rregullorja e Paraburgimit (miratuar me urdherin nr.3705/1 datë 11.05.2006 të Ministrisë së Drejtësisë) ka si objekt trajtimin njerëzor pa asnjë lloj diskriminimi, bazuar në standartet ndërkombëtare duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e njeriut, gjatë procesit të mbajtjes në institucionet e paraburgimit. Në të përcaktohen standarte më të larta lidhur me të drejtat e të paraburgosurve, veçanërisht përsa i takon shtimit të kontakteve me familjarët dhe të afërmit (nga 3 është bërë 4 takime në muaj), si dhe është mundësuar, për herë të parë e drejta për informim duke lejuar shfrytëzimin e organeve të shtypit elektronik dhe të shkruar në ambientet e paraburgimit. Me administrimin e plotë të sistemit të paraburgimit nga Ministria e Drejtësisë, rregullorja e miratuar nga Ministri i Drejtësisë zbatohet për të gjithë të paraburgosurit. Aktualisht në të gjitha Institucionet

e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, zbatohen në praktikë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore për garantimin e të drejtave të të dënuarve dhe të paraburgosurve të mitur.

573. VKM nr. 303, datë 25.3.2009 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve” parashikon mënyrën e realizimit të drejtave dhe detyrimeve të burgosurve, të dënuar me burgim apo të paraburgosur, organizimin e jetës së tyre, mënyrën dhe kushtet e ekzekutimit të vendimeve penale me burgim, zhvillimin e aktivitetit të punës dhe shpërblimin për punën e kryer në përputhje parimet bazë për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

574. Me ndryshimet e fundit e bëra në Kodin Penal gjatë vitit 2008 janë parashikuar dënimet alternative me burgim si, gjysmëliria, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë, qëndrimi në shtëpi dhe pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik.

Një nga kushtet për dhënien e dënimeve alternative me burgim është moshë e re dhe detyrimet për arsimim, që zakonisht i kanë fëmijët. Dënimet alternative janë parashikuar në nenet 58, 59, 59/a dhe 63 të Kodit Penal, si vijon:

Neni 58: “Për dënimin deri në një vit burgim, gjykata, për shkak të detyrimeve të personit të dënuar për punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor, mund të vendosë ekzekutimin e vendimit me burgim me gjysmëliri”.

Neni 59: “Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin dhe dënimin, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale”.

Neni 59/a: Ndër të tjera përcakton se “Për dënimet me burgim deri në dy vjet ose kur kjo kohë është pjesë e mbetur e dënimin, sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi, gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimin të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik: Për të rinj, nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësiive familjare”.

Neni 63: “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik”, parashikon se: Gjkata, për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, kur ka caktuar një dënim deri në një vit burgim, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik. Puna me interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një pune, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik, shoqatës së caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga 40 deri në 240 orë”.

575. VKM nr. 302, datë 25.3.2009 “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin e funksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative” parashikon rregulla për mënyrën dhe funksionimin e Shërbimit të Provës. Funksionimi i këtij institucioni mbështetet mbi parimin e ligjshmërisë, parimin e objektivitetit, si dhe mbi parimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Shërbimi i Provës siguron që në veprimtarinë e tij të mos ketë diskriminim mbi bazën e racës, ngjyrës, gjinisë, lindjes, gjuhës, kombësisë, etnisë apo origjinës sociale, mendimeve politike apo të tjera, fesë, kushteve fizike apo mendore, statusit ekonomik apo çdo statusi tjetër. Shërbimi i provës gjatë veprimtarisë së tij respekton dinjtetin e personit nën hetim, të pandehurit dhe të të dënuarit. Në veprimtarinë e tij, ky shërbim përpiqet të zhvillojë ndjenjën e përgjegjësisë së të dënuarit ndaj

komunitetit dhe viktimës, si dhe të mbështesë e inkurajojë riintegrimin social të të dënuarit nëpërmjet një qëndrimi korrekt ndaj punës, shtetit ligjor dhe rregullave të ndërveprimit social.

576. Ndryshimet në ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” (të miratuara në vitin 2008) u garantojnë të paraburgosurve dhe të burgosurve mbrojtjen e të drejtave të tyre, si dhe atyre u njihet e drejta e ankimit pranë gjykatës ku ndodhet vendi i vuajtjes së dënimit në rastet kur ankesa nuk është zgjidhur në rrugë administrative. Me këtë ligj është shtuar kohëzgjatja e lejeve shpërblyese për të dënuarit e mitur dhe konkretisht nga jo më shumë se 20 ditë në vit është bërë jo më shumë se 45 ditë në vit.

577. Në lidhje me rekomandimin 77/ii mbi trajnimin e punonjësve të policisë, prokurorëve dhe personave të tjerë të përfshirë në proceset e fëmijëve në konflikt me ligjin informojmë:

Personeli i strukturave të policisë trajnohet në mënyrë të vazhdueshme për njohjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut përfshirë të drejtat e fëmijëve. Çdo vit Drejtoria e Përgjithshme e Policisë harton një program për zhvillimin e trajnimeve me të gjithë punonjësit e policisë. Me hyrjen në fuqi të ligjit të Policisë së Shtetit, (në vitin 2007) të gjithë efektivat e policisë (niveli zbatues) po i nënshtrohen një trajnimi tremujor në Akademinë e Policisë. Pjesë përbërëse e tematikës së këtyre trajnimeve është njohja e të gjithë punonjësve të policisë me aktet ndërkombëtare, aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat normojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

578. Trajnimi i personelit të sistemit të burgjeve. Ngritja e kapaciteteve profesionale të personelit të sistemit të burgjeve, në mënyrë që ata t`u përgjigjen nevojave të të gjitha kategorive të të dënuarve, si dhe ndryshimeve cilësore që po pëson sistemi i burgjeve dhe paraburgimeve, është prioritet i strukturave të DPB. Qendra e Trajnimit të Burgjeve, ndër të tjera organizon trajnime specifike për stafin që punon me grupe të veçanta të burgosurish të mitur. Lidhur me formimin bazë të punonjësve të sistemit të burgjeve në programet e trajnimit janë përfshirë tema të veçanta mbi trajtimin e grupeve specifike, si të miturit. Gjithashtu janë evidentuar arritje konkrete lidhur me trajnimin e personelit të sistemit të burgjeve, edhe si rezultat i mbështetjes të vazhdueshme të Organizatave ndërkombëtare dhe Shoqërisë Civile në fushën e të drejtave të Njeriut (konkretisht Këshilli i Evropës, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Klinika Ligjore e të Miturve etj). Stafet e edukimit të strukturave të burgjeve kanë marrë pjesë në një sërë trajnimesh dhe vizitash studimore brenda dhe jashtë vendit dhe mbështetur në njohuritë dhe eksperiencën e fituar është parashikuar që të organizohen trajnime në mënyrë të vazhdueshme për personelin, si dhe për personat të cilët vuajnë dënimin. Në kuadër të Programit CARDS të BE-së (2004), në muajin maj të vitit 2007 ka filluar zbatimi i projektit “Drejtimi human i burgjeve”, me qëllim përmirësimin e respektimit të të drejtave të personave të paraburgosur dhe të dënuar, rritjen e profesionalizimit të stafit të burgjeve.

Në vitin 2007 është organizuar trajnimi me temë: “Mbrojtja e fëmijëve në çështjet familjare“, në bashkëpunim me OSBE dhe Shkollën e Magjistraturës.

Në vitin 2007 është organizuar trajnimi “Trajnim trajnerësh“ në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit. Qëllimi ishte ngritja e një grupi trajnerësh të cilët mund të përdorin një manual trajnimi për trajtimin e të miturve. Në këtë manual trajtohet edhe nene të veçanta të Konventës. Këta trajnerë gjatë 2008 kanë trajnuar stafin civil dhe të sigurisë në institucione ku janë të akomoduar të mitur.

Në vitin 2008 është organizuar trajnimi me pjesëmarrës psikologë e punonjës social nga burgjet, me temë “Roli i avokatit, psikologut e Punonjës Social për zbatimin e të drejtave të fëmijëve në drejtësinë penale për të mitur“.

Në vitin 2008 është organizuar trajnimi i stafeve të edukimit në institucionet e ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Në vitin 2008 në bashkëpunim me QSHRT është organizuar trajnimi me temë “Njohja me Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën e të Drejtave të Fëmijëve“ ku u trajnuan 60 punonjës të sektorit të sigurisë dhe atij social. Gjithashtu Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ka bashkëpunuar me organizata promovuese të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve si Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, Unicef, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës, Komiteti Shqiptar i Helsinkit etj. Trjanimet e zhvilluara kanë patur si qëllim njohjen me dispozitat e Konventës duke synuar rritjen e cilësisë së shërbimit dhe standardeve të trajtimit në institucionet e vuajtjes së dënimit.

Bashkëpunimi ka konsistuar edhe në rritjen e ndërgjegjësimit përmes projekteve si Fushata Kombëtare “ Qielli është i të Gjithëve“ dhe botimeve respektive (manuale si: Një Botë e denjë për Fëmijët, Parandalimi i torturës, botime periodike si Qielli është i të gjithëve, etj).

579. Trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në Shqipëri nuk ka gjyqtarë të specializuar për çështjet e të miturve prandaj fillimisht gjyqtarët do t`i nënshtrohen trainimeve për çështje të drejtësisë për të mitur. Shkolla e Magjistraturës, realizon formimin profesional të magjistratëve (gjyqtarë, prokurorë), i cili përfshin programin e formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë dhe të formimit vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Programi ka si objektiv formimin e prokurorëve, gjyqtarëve mbi të drejtat e njeriut konform angazhimeve ndërkombëtare. Në kuadër të trajnimit vazhdues, Shkolla e Magjistraturës në vitin 2005 në bashkëpunim me OSBE-në organizoi një trajnim me temën “Drejtësia për të Mitur”. Në këtë trajnim u përfshinë jo vetëm gjyqtarë, prokurorë por dhe punonjës të shërbimeve sociale dhe oficerë të policisë gjyqësore. Pjesën kryesore të trajnimit e zyri informacioni mbi Konventat dhe Rregullat Ndërkombëtare për të miturit si: Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve, Rregullat e Pekinit, Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve të Privuar nga Liria, Direktivat e Rijadit, Direktivat e Kombeve të Bashkuara mbi Drejtësinë për të Miturit Viktima dhe Dëshmitarë të Krimin, Rekomandime të Keshillit të Evropës. Në Programin e Trajnimit Vazhdues 2006-2009, një nga kurset trajnuese është “Drejtësia për të Mitur”, që ka si qëllim trajnimin e gjyqtarëve lidhur me dispozitat e legjislacionit të brendshëm dhe ndërkombëtar në mbrojtje të fëmijëve.

580. Në zbatim të nenit 40 paragrafi 1 dhe Rekomandimit 77/b/iii, masat e marra për të promovuar riaftësimin fizik dhe psikologjik dhe riintegrimin social të fëmijës të përfshirë në sistemin e administrimit të drejtësisë për fëmijë, synojnë të garantojnë që ky riaftësim dhe riintegrim, të zhvillohet në një mjedis që nxit dhe garanton shëndetin, vetërespektin dhe dinjitetin e fëmijës. Trajtimi i të miturve bëhet nga shërbimi i edukimit në bashkëpunim edhe me shërbimet e tjera të institucionit, si: punonjësi socialë, juristë, mjekë etj. Ky trajtim synon të reduktojë në minimum elementët negative që vijnë si pasojë e ambientit ku ata kanë jetuar. Të miturit marrin pjesë në programet e individualizuara të trajtimit dhe të ndërhyrjes, në programet arsimore formale dhe joformale dhe kurset profesionale. Të gjitha aktivitetet trajnuese e rehabilituese kryhen në ambiente të vecanta e të përshtatura vetëm për të miturit. Programet e Individualizuara të Trajtimit dhe të Rehabilitimit të janë hartuar në bashkëpunim me ekspertë penitenciarë të huaj, në kuadër të projekteve të ndryshme⁶⁰. Shërbimet psiko-sociale dhe aktivitete kulturore-sportive ofrohen nga një staf i profilizuar e të trajnuar të përbërë nga psikologë, punonjës social dhe edukatorë. Gjithashtu të miturve i garantohet një shërbim shëndetësor i specializuar, si dhe ambiente fizike dhe infrastrukturë e përshtatur me nevojat fiziologjike e psikologjike të të miturve.

⁶⁰ Bashkëpunimi me Agjencinë Spanjolle për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim.

Të miturit e përfshirë në sistemin e drejtësisë për të mitur, marrin pjesë në programet trajtuese dhe rehabilituese pavarësisht racës, ngjyrës, fesë, gjuhës, paaftësisë, prejardhjes familiare apo çdo gjendje e tjetër e fëmijës apo prindërve të tij apo përfaqësuesve të tij ligjore.

581. Nga ana e strukturave të sistemit të burgjeve është bashkëpunuar me shoqërinë civile, e cila ofron asistencë psikologjike dhe juridike falas për këtë kategori. Kjo asistencë u jepet të gjithë të miturve pavarësisht racës, ngjyrës, fesë, gjuhës, paaftësisë, prejardhjes familiare apo çdo gjendje e tjetër e fëmijës apo prindërve të tij apo përfaqësuesve të tij ligjore. Për sigurimin e ndihmës ligjore një rol të rëndësishëm ka luajtur dhe po luan OJF Klinika Ligjore për të Miturit, e cila ofron asistencë ligjore falas për këtë grup moshe.

Gjithashtu në bashkëpunim me OJF-të, është siguruar ofrimi i kurseve profesionale formale dhe joformale.

582. Arsimimi i të miturve të dënuar: Me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin të fëmijve të dënuar, në shoqëri nga ana e strukturave përkatëse të DPB (Sektori i Problemeve Sociale) janë bërë përpjekje për arsimimin e të dënuarve, të mitur, (jo vetëm të dënuarit e mitur që janë subjekt i arsimit të detyrueshëm, por edhe të dënuarit e tjerë të mitur). Në bazë të marrëveshjes me MASH në vitin 2000, ka funksionuar shkolla për të miturit e dënuar që ndodhen në I.E.V.Penale në Vaqarr. Gjatë vitit 2008 u çertifikuan 8 të mitur.

Gjithashtu janë bërë përpjekje për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e të dënuarve për rëndësinë e arsimit. Në vitin 2006 u bënë përpjekje për hartimin dhe nënshkrimin e një marreveshje të re, për shtrirjen e procesit arsimor në të gjitha I.E.V.Penale bazuar mbi praktikatat e ndjekura për funksionimin e shkollës në Vaqarr.

Sektorët e Edukimit në burgje dhe paraburgime, me mbështetjen e organizatave të ndryshme kanë kryer vazhdimisht një proces joformal arsimimi duke u fokusuar tek të dënuarit analfabetë. Në paraburgimin në qytetin e Durrësit është krijuar një klasë me dy mësuese të sistemit arsimor, për të paraburgosurit analfabetë, që kanë treguar interes për t'u arsimuar.

Në I.E.V.Penale Vaqarr ofrohet mundësia për të ndjekur arsimin 9- vjeçar dhe për t'u pajisur me dëftesat përkatëse për çdo vit akademik të përfunduar. Për të miturit që ndodhen në paraburgime zhvillohen kurse informale që ofrojnë formim elementar akademik.

Gjatë muajit dhjetor 2008 është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për arsimimin e paraburgosurve dhe të dënuarve duke përfshirë edhe fëmijët e ndaluar, të arrestuar apo të dënuar, në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale sipas programeve mësimore të miratuara nga MASH.

Në janar 2009 është inaguruar një shkollë fillore në burgun e Peqinit.

583. Ligji nr. 9381, datë 28.4.2005 "Për kompensimin e burgimit të padrejtë", parashikon ndër të tjera se të drejtën e paraqitjes së kërkesës për përfitimin dhe të kompensimin për burgim të padrejtë, përfshirë arrestin në shtëpi për personin e mitur, këtë të drejtë e ushtron kujdestari ligjor.

584. Institucione të posaçme për të miturit që vuajnë dënimin. Në lidhje me institucionet ku qëndrojnë të miturit e ndaluar dhe të dënuar nëpërmjet urdhërit nr. 3185, datë 28.04.2008 të ministrit të drejtësisë "për kategorizimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve penale" janë kategorizuar si institucione me një seksion për të mitur në I.E.V.penale, si vijon: 1) I.E.V.Penale Vaqarr; 2) I.E.V.Penale Fushë-Krujë; 3) I.E.V.Penale Tepelenë; 4) I.E.V.Penale Rrogozhinë; 5) I.E.V.Penale Lezhë; 6) I.E.V.Penale Korçë; 7) I.E.V.Penale "Jordan Misja" Tiranë; 8) I.E.V.Penale Vlorë; 9) I.E.V.Penale Durrës.

585. Hapja e një institucioni të posaçëm për trajtimin e të miturve të dënuar me burgim është trajtuar me prioritet nga ana e Ministrisë së Drejtësisë. Në fund të vitit 2007, me mbështetjen financiare të Programit CARDS të BE-së ka filluar puna për ngritjen e këtij institucioni të posaçëm për fëmijët e moshës 14-18 vjeç në qytetin e Kavajës. Me vënien e plotë në funksionim të këtij institucioni, (në vitin 2009) të miturit e dënuar me burgim do të trajtohen në një institucion të posaçëm edukativ në kushte stimuluese dhe zhvilluese për moshën e tyre, si dhe do të trajtohen nga një personel i specializuar.

Gjatë vitit 2009 pritet vënia në funksionim e Institutit për Ekzekutimin e Vendimeve Penale ndaj të Miturve në Kavajë, projekt i cili është realizuar.

586. I mituri gëzon të drejtën e korrespondencës (së shkruar ose verbale) dhe takimit me familjen. Ai ka të drejtën e kryerjes së 8 telefonatave në muaj, të drejtën e katër takimeve me familjarët (këto mund të shtohen edhe me aprovimin e drejtuesve të institucioneve për raste të vecanta). Me financimin e UNICEF-it është bërë rikonstruksioni i plotë i seksionit për të paraburgosurit e mitur, në I.E.V.Penale në Tiranë, duke përmirësuar në një shkallë të konsiderueshme trajtimin e tyre.

Në I.E.V.Penale, paraburgimet Vlorë, dhe Tiranë, kushtet janë konform standarteve ndërkombëtare. Në I.E.V.Penale Vaqarr, kushtet janë më pak të favorshme për shkak të infrastrukturës. Me hapjen në 2008 të institucionit të ri të Vlorës ku ka një seksion minorene dhe me rikonstruksionin e ambienteve të seksionit të minoreneve në prill të 2008 me një financim të UNICEF, BE dhe SIDA-s, janë siguruar kushte konform standarteve ndërkombëtare të trajtimit të të miturve. Për zhvillimin fizik, mendor, psikologjik, social, etj.

587. Përmirësimi i normës ushqimore për të dënuarit dhe të paraburgosurit. Me qëllim përmirësimit të strukturës së të ushqyerit të të dënuarve dhe të paraburgosurve, bazuar në rekomandimet e organizatave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, nga ana e strukturave shtetërore përgjegjëse është propozuar dhe miratuar e norma e re ushqimore. Në këtë drejtim ka patur bashkëpunim me OBSH dhe FAO. Nga muaji qershor 2007 ka filluar zbatimi i normës së re ushqimore në gjithë sistemin e burgjeve dhe paraburgimeve. Në sistemin e burgjeve dhe paraburgimeve të dënuarit dhe të paraburgosurit trajtohen me normë ushqimore sipas ndarjes, të burgosur normal, të burgosur të punësuar dhe të burgosur të sëmurë. Efektet e zbatimit të normës së re të ushqimit kanë lidhje me ndryshimin e strukturës së normës së ushqimit në sasi, cilësi dhe asortiment. Në strukturën e normës së ushqimit janë përfshirë 17 artikuj nga 12 artikuj në normën e vjetër. Kjo normë ushqimore është cilësisht më e mirë dhe në raport me të vjetrën ka trefishuar kaloritë ditore që përfitojnë personat e burgosur, sipas normave standarte.

588. Monitorimi i trajtimit të të miturve në I.E.V.Penale bëhet nga shumë aktorë si: Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra Shqiptare kundër Torturës, Qendra Shqiptare e Mrojtjes së të Drejtave të Njeriut, etj. dhe mekanizma të tjerë promovuese të të drejtave të fëmijëve, si CRCA dhe UNICEF. Gjithashtu në D.P.Burgjeve ngrihen në mënyrë periodike grupe pune për monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe atyre të fëmijëve në veçanti.

589. Lidhur me zbatimin e nenit 40 “Administrimi i Drejtësisë për të miturit”, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë është përfshirë në dhënien e konsulencës dhe ekspertizës lidhur me reformën në sistemin e drejtësisë për të mitur. Ky është një program që synon ngritjen dhe funksionimin efektiv të një sistemi drejtësie për të miturit, në kuadrin e një përpjekjeje të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë, Komisionit Evropian (Programi CARDS 2004), Sida-s (Agjensia Ndërkombëtare e Zhvillimit të Suedisë) dhe UNICEF-it. Misioni i programit është vendosja e themeleve të një sistemi që mbron standardet ndërkombëtare të të drejtave për të miturit që janë në

konflikt me ligjin, nëpërmjet propozimeve për ndryshime legjislativë dhe hartimin e politikave adekuate, ngritjes dhe forcimit të kapaciteteve institucionale, hartimit të programeve për masa alternative ndaj të miturve që janë në konflikt me ligjin, mbrojtjen dhe integrimin e tyre.

590. Qendra Fëmijët Sot po përgatit një set me tre manuale informative për fëmijët mbi “Çfarë janë gjykatat”. Manualët synojnë të japin në një gjuhë shumë fëmijore dhe më figura informacion mbi gjykatat dhe sistemin gjyqësor në Shqipëri

- **Mekanizmat e krijuara për zbatimin e të drejtave të parashikuara nga Konventa (nenet 22, 30, 32-36, 37 b-d, 38,39,40), si dhe për monitorimin e saj.**

591. Strukturat policore të specializuara për të miturit. Në Drejtorinë e Luftës Kundër Akteve Terroriste dhe Krimeve të Hapura, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, në muajin tetor 2004 u krijua -një strukturë e posaçme për të miturit “Sektori për Mbrojtjen e Fëmijëve”, me mision realizimin e mbrojtjes së fëmijëve nga veprimtaritë kriminale në drejtim të tyre dhe krimet që kryejnë vetë fëmijët. Në funksion dhe varësi të këtij sektori në të gjithë Drejtorinë e Policisë në Qarqe, në Seksionin e Analizë-Kordinimit për Krimet e Hapura, u emëruan specialistë, me funksion mbrojtjen e fëmijëve nga veprimtaritë kriminale në drejtim të tyre dhe ndjekja e specializuar e krimeve që kryejnë vetë fëmijët, në përputhje me legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar të ratifikuar nga shteti shqiptar. Siç është evidentuar edhe më sipër⁶¹, me miratimin e strukturës të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, korrik 2007 dhe në zbatim të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, u ngritën struktura të veçanta policore në mbrojtje të fëmijëve dhe viktimave të dhunës në familje. Në nivel qendror është krijuar Sektori për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunës në Familje në Drejtorinë Kundër Krimeve të Rënda të Departamentit për Hetimin e Krimeve dhe nivel vendor janë krijuar Seksione për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunës në Familje, në Drejtorinë e Policive në Qarqe, të cilët kanë për funksion jo vetëm parandalimin dhe luftën ndaj dhunës në ambientet familjare, dhunën ndaj të miturve, por edhe mbrojtjen e të miturve të përfshirë në aktivitet kriminal, si dhe mbledhjen në mënyrë sistematike të të dhënave statistikore, lidhur me këto fenomene. Gjatë vitit 2008 u punua për vënien në efikasitet të plotë të këtyre strukturave në nivel vendor.

➤ **Përmirësimi i kuadrit institucional**

592. Në të gjithë vendin janë ngritur dhe funksionojnë struktura dhe agjensi të mirëfillta për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në veçanti për mbrojtjen e fëmijëve të rrezikuar nga trafikimi. Për të koordinuar punën në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore është ngritur që në vitin 2005 Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, pranë së cilës vepron Njësia Antitrafik me Urdhrin e Kryeministrit nr. 203, datë 19.12.2005 “Për funksionimin e Njesisë Anti-Trafik”. Koordinatori Kombëtar është pika qendrore e koordinimit të punëve ndërmjet ministrive të ndryshme në luftën kundër trafikimit, si dhe të gjithë strukturave të tjera shtetërore dhe joshetërore si në nivel kombëtar, ashtu dhe në atë ndërkombëtar. Janë marrë masa për krijimin e strukturave në të gjitha nivelet, duke filluar nga niveli i hartimit të politikave deri në atë të zbatimit dhe të veprimit, në bazë të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit.

⁶¹ Komentet lidhur me nenin 19 dhe rekomandimin 49.

593. Në Shqipëri që nga viti 2004 tashmë vepron Gjykata dhe Prokuroria për Krimet e Rënda, me juridiksion në të gjithë territorin e vendit. Kjo gjykatë ushtron kompetencat në gjykimet në shkallë të parë, si edhe për gjykimin në shkallë të dytë.

594. Në nivelin administrativ, Shqipëria ka vënë në funksionim struktura të posaçme në polici për të luftuar krimin e organizuar, përfshirë këtu edhe krijimin e një departamenti të ri në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë në të cilën një ndër sektorët më të rëndësishëm është Sektori i Luftës kundër Trafiqueve të Paligjshme. Ky sektor operon në çdo Drejtori Policie në të dymbëdhjetë qarqet e Shqipërisë. Me reformimin e Policisë së Shtetit në zbatim edhe të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” në Drejtorinë e Policisë së Shtetit është ngritur një Seksion i veçantë për mbrojtjen e fëmijëve dhe dhunën në familje. Seksione të veçanta janë ngritur edhe në të gjitha qarqet e vendit si pjesë e Drejtorive të Policisë së Qarkut. Këto struktura tashmë janë plotësuar me personel dhe janë funksionale.

595. Me Urdhër të Kryeministrit nr. 139, datë 19.06.2006 “Për krijimin e Komiteteve Rajonale të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore”, janë ngritur dhe funksionojnë në 12 qarqet e vendit Komitetet Rajonale Anti-trafik. Ngritja e këtyre strukturave ka për qëllim mbikëqyrjen dhe bashkërendimin e veprimeve qeveritare dhe joqeveritare, në nivel rajonal/vendor, për parandalimin e fenomenit të trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

596. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në bashkëpunim me USAID dhe UNICEF kanë bërë të mundur ngritjen dhe vënien në funksionim të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve (CPU), si pjesë e Seksioneve të Ndihmës Ekonomike dhe Shoqërore në strukturat e pushtetit vendor. Kjo strukturë ka të punësuar me kohë të plotë një punonjës social i cili është përgjegjës për trajtimin e fëmijëve me probleme në territorin e njësisë së pushtetit vendor. Kjo strukturë luan një rol shumë të rëndësishëm përsa i përket vlerësimit dhe monitorimit të situatës së fëmijëve dhe familjeve të rrezikuara nga fenomene të ndryshme përfshirë edhe trafikimin. Struktura të tilla janë ngritur tashmë në Bashkitë: Durrës, Elbasan, Pogradec, Korçë, Fier, Gjirokastrë, Shkodër, Kukës dhe Sarandë. Në planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit 2008-2010 është parashikuar që struktura të tilla të ngrihen në të gjitha bashkitë.

597. Përsa i përket zbatimit të nenit 34, me qëllim parandalimin e shfrytëzimit seksual të fëmijëve, gjatë vitit 2007 u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Promovimin dhe Zbatimin e Kodit të Sjelljes për parandalimin e Shfrytëzimit Seksual të Fëmijëve në Turizëm ndërmjet Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ministrisë së Turizmit Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MTKRS) dhe Ministrisë së Brendshme. Nëpërmjet këtij memorandumi përcaktohen format bashkëpunimit mes të tre palëve në funksion të zbatimit të Kodit të Sjelljes për parandalimin e Shfrytëzimit Seksual të Fëmijëve, kur favorizohet nga operatorët e shërbimeve turistike. Në vijim të zbatimit të këtij Memorandumi, 24 operatorë të shërbimeve turistike (agjenci turistike dhe njësi akomoduese hoteliere), nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e Kodit gjatë veprimtarive që ata ushtrojnë. Duke e konsideruar Kodin e Sjelljes si pjesë të rëndësishme të Kodit Global të Etikës në Turizëm, si edhe një detyrim të parashikuar në Memorandumin e Mirëkuptimit mes tre Institucioneve, MTKRS ka iniciuar ngritjen e grupit të punës ndër-institucional për monitorimin e zbatimit të Kodit nga operatorët turistikë. Grupi do të përbëhet nga përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA). Do të kryesohet nga MTKRS, nën asistencën e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

- **Mekanizmat për mbrojtjen e fëmijëve, viktimat të mundshme të trafikimit.**

598. Një ndër masat më të rëndësishme për mbrojtjen e viktimave të trafikimit është Marrëveshja e Bashkëpunimit për Krijimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) për Identifikim dhe Asistencë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikut të Qenieve Njerëzore e nënshkruar korrik 2005. Marrëveshja u firmos nga autoritete të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale /Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit, Ministria e Brendshme/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ministria e Punëve të Jashtme/Drejtoria e Shërbimeve Konsullore, Organizata Jo-Fitimprurëse “Vatra”, Organizata Jo-fitimprurëse “Tjetër Vizion” dhe Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM). Marrëveshja përcakton një kuadër të qartë bashkëpunimi midis aktorëve kyç në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore; përcakton përgjegjësitë që palët e përfshira kanë në identifikimin, referimin, akomodimin, asistencën dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit. Thelbi i marrëveshjes është ngritja e një rrjeti kombëtar funksionues midis disa agjensive shtetërore dhe jo shtetërore; konkretisht policia, shërbimi social, shërbimi diplomatik dhe konsullor, si dhe qendrat pritëse dhe rehabilituese për viktimat e trafikimit, për të mundësuar identifikimin, sigurimin, referimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit në vend.

Qendrat janë një nga kontribuesit më të rëndësishëm për mbështetjen e viktimave të trafikimit. Qendrat luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin e llojeve të shërbimeve për të cilat kanë nevojë viktimat e trafikimit përfshirë edhe fëmijët. Një nga strehëzat “Tjetër Vizion” Elbasan ka një seksion të veçantë për trajtimin e fëmijëve viktimat/viktima të mundshme të trafikimit.

Aktualisht, Shqipëria ka 5 qendra të licensuara për ofrimin e shërbimeve për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, ku ka dhe ambiente, shërbime të veçanta dhe staf të trajnuar posaçërisht për viktimat e trafikimit dhe fëmijët: 1) Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimave e Trafikimit (Tiranë). 2) Qendra “Vatra” (Vlorë). 3) Qendra “Tjetër Vizion” (Elbasan). 4) Qendra “Të Ndryshëm dhe të Barabartë” (Tiranë). 5) Qendra “Jetë dhe Shpresë” (Gjirokastrë).

599. Me ligjin nr. 9888, datë 10.03.2008 (neni 36), janë shtuar disa dispozita në ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” (nenet 74/1,74/2,74/3), të cilat parashikojnë krijimin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar pranë Institucionit të Avokatit të Popullit. Në këto dispozita përcaktohen qartë kompetencat, garancitë në veprimtaritë e këtij Mekanizmi Kombëtar, si dhe format e mbikqyrjes lidhur me zbatimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të dënuarve, lidhur me parandalimin e torturës, keqtrajtimit etj.

Mbikqyrja e Mekanizmit Kombëtar realizohet edhe nëpërmjet: a) kërkimit të informacioneve nga administrata e institucionit; b) verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve ose mjediseve, që kanë lidhje me të dënuarin ose me të paraburgosurin, brenda dhe jashtë institucionit. c) marrjes së informacionit nga individë që kanë statusin e vizitorit apo të organeve shtetërore ose organizatave joqeveritare, të cilat kanë kontrolluar apo vizituar institucionin, sipas kompetencës që u njeh ligji, si dhe nga avokati i të dënuarit ose të paraburgosurit;

Për realizimin e procesit të mbikqyrjes, Mekanizmi Kombëtar mund të marrë edhe specialistë të fushave përkatëse. Në çdo rast dhe pavarësisht nëse konstatohen shkelje e parregullsi gjatë verifikimit, specialistët e këtij mekanizmi mbajnë procesverbal, i cili nënshkruhet nga drejtori i institucionit ose i ngarkuari prej tij, me të drejtën e pasqyrimit të vërejtjeve.

600. Ligji “Për ndihmën juridike” parashikon ngritjen e Komisionit të Ndhmës Juridike, i cili si një organ i posaçëm, do të realizojë dhënien e kësaj ndihme edhe për të miturit.

601. VKM nr. 302, datë 25.03.2009, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimit të shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, mbikqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”, përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e institucionit të

Shërbimit të Provës dhe rolin e këtij institucioni në çdo fazë të procedimit penal.

602. Ndryshimet në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, të miratuara në vitin 2008, parashikojnë krijimin dhe funksionimin e një mekanizmi konkret “Shërbimi i Provës”, i cili do të mbikqyrë zbatimin e dënimeve alternative dhe do të përcaktojë raportet që ai krijon me institucionet shtetërore dhe me gjykatën. Aktualisht, me urdhrin e Kryeministrit është miratuar struktura e re e institucionit të Shërbimit të Provës, dhe është duke u proceduar për rekrutimin e stafit të këtij institucioni.

603. Në bazë të ligjit nr.9090, datë 26.03.2003 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në bashkëpunim me Fondacionin “Për Zgjidhjen e Konfliktëve dhe Pajtimin e Mosmarrëveshjeve”, ka pilotuar në 4 Qarqe, një projekt lidhur me zgjidhjen e konfliktëve penale ndërmjet të miturve dhe të rinjve të moshave 14-21 vjeç, duke shmangur përballjen e këtyre grupmoshave me policinë dhe organet e drejtësisë, si dhe zbutjen e pasojave të padëshirueshme sociale të mosmarrëveshjeve.

604. Baza e të dhënave për viktimat e trafikimit. Një masë tjetër e rëndësishme ka qenë edhe ngritja dhe vënia në funksionim e një baze të dhënash për viktimat e trafikimit me të dhëna nga policia, shërbimi diplomatik dhe konsullor shqiptar, shërbimi social shtetëror, si edhe qendrat e përmendura më sipër. Baza e të dhënave mundëson analizimin e informacionit për të patur një tablo të qartë të situatës së trafikimit në vend dhe për të mundësuar evidentimin në kohë të tendencave të fenomenit në mënyrë që edhe përgjigja e strukturave përgjegjëse ndaj tij të jetë e shpejtë dhe efektive. Baza e të dhënave për viktimat e trafikimit është vënë tashmë në funksion. Operatorët vazhdojnë të hedhin të dhëna rast pas rasti. Zyra e Koordinatorit Kombëtar monitoron në mënyrë të vazhdueshme tendencat e trafikimit të qënieve njerëzore duke u bazuar në dy burime të rëndësishme, informacionin e ardhur nga raportimet e Komiteteve Rajonale Antitrafik dhe të dhënave të gjeneruara së fundi nga baza e të dhënave për viktimat e trafikimit. Gjatë periudhës janar 2008 – janar 2009, bazuar në standardet dhe kriteret e parashikuara në MKR janë regjistruar gjithsej në bazën e të dhënave 108 persona (viktima trafikimi dhe viktima të supozuara përfshirë edhe fëmijët). Nga këto 17 janë fëmijë.

605. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, zbaton plane pune të veçanta për trajtimin e specializuar të të miturve në konflikt me ligjin, bashkëpunon me strukturat psiko-sociale, të cilat janë ngritur në të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (I.E.V.P.), hartojnë programe dhe organizojnë aktivitete për të miturit të cilët ndodhen në ambjentet e paraburgimit dhe në institucionin e vuajtjes së dënimit. Aktivitetet e organizuara për të miturit janë të karakterit kulturor, edukativ dhe sportiv dhe synojnë gjallërimin e jetës dhe menaxhimin e stresit në institucionet ku aktualisht të miturit presin gjykimin apo vuajnë dënimin. Për realizimin e tyre është bashkëpunuar me disa prej organizatave jofitimprurëse të cilat veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe që që operojnë prej kohësh pranë I.E.V.Penale.

606. Aktualisht, shoqatat të cilat bashkëpunojnë me I.E.V.Penale për zbatimin e programeve rehabilituese, këshilluese si dhe mbështetje ekonomike, janë si vijon:

- Agjencia Spanjolle e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (AECID) – Programi pilot me kurse të formimit profesional në dy qendra të vuajtjes së dënimit (Fushë – Krujë dhe Vlorë) ku do të realizohen programet PIT (Programi i Individualizuar Trajtimi) dhe MII (Modeli të Individualizuar Intervenimi) për të paraburgosurit;
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) – Puna e tyre ka konsistuar në trajnimin e stafit civil në drejtim të ngritjes së kapaciteteve për trajtimin e të miturve;

- Klinika Ligjore për të Mitur – Mbështetje psikologjike dhe mbështetje ligjore për të miturit në konflikt me ligjin në I.E.V.Penale "Jordan Misja" dhe Vaqarr;
- UNICEF dhe CRCA po aplikojnë për projektin "Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijët në Shqipëri".

Kujdes nga stafi i I.E.V.Penale është treguar në respektimin e të drejtës së të miturve për të mbajtur kontakte me familjarët. Të miturve që ndodhen në I.E.V.Penale u krijohen kushtet për të kontaktuar me familjarët e tyre përmes takimeve dhe telefonatave, siç e parashikon rregullorja. Në rastet kur marrëdhëniet e tyre me familjen janë ndërprerë për arsye të caktuara, stafi i Shërbimit të Kujdesit Social, me mbështetjen e drejtuesve të institucioneve, ndërmjetëson për rivendosjen e kontakteve mes të miturit dhe të afërmeve të tij.

607. Programi ditor që aplikohet për të miturit që ndodhen në këto institucione varion sipas specifikave të secilit institucion. Në institucionet e reja, të konceptuara sipas standardeve europiane, infrastruktura ofron më shumë mundësi për aplikimin e programeve ditore të larmishme. Në programet ditore janë përfshirë: a) kurse aftësimi profesional (në I.E.V.Penale Vlorë); b) kurse informale për të miturit e paarsimuar; c) veprimtari sportive; d) literaturë; e) asistencë psiko-sociale; f) organizimi i diskutimeve në grup të fokusuara në trajtimin e temave të ndryshme sociale.

Programet ditore janë ndërtuar duke i dhënë përparësi rehabilitimit të të miturve, duke e konsideruar rehabilitimin si një proces që nuk mund të përfundojë në momentin e përfundimit të dënimit, për shkak të kompleksitetit të faktorëve dhe stimujve, si pasojë e të cilave i mituri ka vepruar në konflikt me ligjin.

Nga strukturat përgjegjëse në I.E.V.Penale është insistuar që të punohet për zbatimin e Programeve Individuale të Trajtimit, në mënyrë që për çdo të mitur të vendosen objektiva trajtimi sipas nevojave psiko-sociale që identifikohen për secilin rast.

Fëmijët e refugjatëve (neni 22).

608. Ligji nr. 9959 datë 17.7.2008 "Për të Huajt"⁶² parashikon se të huajt trajtohen në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga RSH-së, duke respektuar parimin e reciprocitetit, të mosdiskriminimit dhe trajtimit jo më pak të favorshëm se shtetasit shqiptarë. (neni 2). Në bazë të këtij ligji përcaktohet se "i huajt" është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar. Ligji jep kuptimin e termit "Anëtarë të familjes", të cilët janë bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët nën 18 vjeç, fëmijët e birësuar ose në kujdestarinë e të huajit, fëmijët e bashkëshortit/bashkëshortes së tij/saj, etj. Ky ligj rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, punësimit, trajtimit dhe të daljes së të huajve në/nga RSH-së dhe përcakton funksionet dhe kompetencat e autoriteteve shtetërore dhe të subjekteve të tjera, publike dhe private, shqiptare ose të huaja, të cilat kanë të bëjnë me të huajt (neni 1). Subjekt i këtij ligji janë të huajt, të cilët hyjnë ose synojnë të hyjnë në RSH-së, me qëllim qëndrimin, transitimin, punësimin, studimin ose ripranimin dhe ky ligj garanton të drejtat dhe detyrimet e të huajve që punojnë dhe jetojnë në Shqipëri.

Gjithashtu hyrja, qëndrimi dhe trajtimi i të huajve në RSH-së rregullohet edhe në bazë të akteve nënligjore dhe normative: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 362 datë 01.04. 2009 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe dokumentacionin për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në R.SH".

⁶² Ky ligj ka shfuqizuar ligjin nr. 8492 datë 27.05.1999 "Për të Huajt" dhe ka hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2008.

609. Ligji nr. 8432, datë 14.12.1998 “Për Azilin në RSH-së” u njeh të drejtën për azil apo mbrojtje të përkohshme të gjithë të huajve që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, refugjatë apo persona të tjerë dhe që kërkojnë azil në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me konventat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë. Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurat për dhënien dhe heqjen e azilit në RSH-së, si dhe të drejtat e detyrat e refugjatëve dhe të personave nën mbrojtje të përkohshme. Ligji nr.10006, datë 26.01.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8432, datë 14.12.1998” jep përkufizimin e të miturve të pashoqëruar dhe parashikon caktimin për ta të një kujdestari ligjor në përputhje me legjislacionin shqiptar.

610. Fëmijët e refugjatëve dhe azilkërkuesve: a) mbështeten plotësisht me të gjitha kostot e arsimit të tyre publik fillor dhe të mesëm; b) mbështeten plotësisht me shërbime shëndetësore; c) marrin ndihmesë me strehim nga RSH-së në Qendrën Pritëse për Azilkërkuesit, si dhe nga UNHCR në strehimet private për rastet më të cënueshme; d) marrin ndihmën e nevojshme në ushqim, në Qendrën Pritëse për Azilkërkuesit (QPA), si dhe nga UNHCR në strehimet private për rastet më të cënueshme; e) marrin ndihmesë në artikuj jo ushqimorë nga UNHCR, si në QPA, ashtu edhe në strehimet private; f) marrin ndihmesë me këshillim social si nga personel i specializuar i qendrës pritëse, ashtu edhe nga ai i organizatave partnere që ofrojnë këtë shërbim. Fëmijve refugjatë në shkolla e kopshte, u ofrohet mbështetje shëndetësore psiko – sociale kur është e nevojshme, vizita dhe vëzhgimi i gjendjes në qendrën kolektive dhe në strehimet private ku banojnë refugjatët dhe azilkërkuesit, si dhe fushata informative e ndërgjegjësuese për të drejtat e fëmijëve.

611. Shërbimet shëndetësore të të gjitha llojeve, mbulohen nga UNHCR, përmes një organizate joqeveritare. Parashikohet që duke filluar nga viti 2010 deri në vitin të mund të përballohen shërbimet shëndetësore ndaj refugjatëve e azilkërkuesve sipas skemës të sigurimit dhe shërbimeve shëndetësore.

612. Për sa i përket numrit të fëmijëve që shkojnë në shkollë, ai është 20 dhe përfshin edhe persona që kanë kaluar moshën 18 vjeç por për shkak të kushteve të krijuara nga ardhja e tyre si refugjatë, ndërprerja e shkollës në vendin e origjinës, janë mbështetur për të përfunduar të paktën arsimin fillor (ose atë të mesëm nëse ishte nisur tashmë para ardhjes në RSH-së).

613. Me qëllim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijve të refugjatëve, është bashkëpunuar me UNICEF dhe UNHCR. Praktikrat më të mira të UNHCR në punën me fëmijët refugjatë si edhe njohuri të tjera në këtë fushë shpërndahen rregullisht mes partnerëve që ofrojnë shërbime për refugjatët dhe azilkërkuesit.

Fëmijët në konflikte të armatosura (neni 38/3).

614. Në ligjin nr. 9047, datë 10.7.2003 “Për Shërbimin Ushtarak në RSH-së”, i ndryshuar me ligjin nr. 9999, datë 25.9.2008, përcaktohen rregullat për kryerjen e shërbimit ushtarak në RSH-së, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shtetasve, të organeve shtetërore e subjekteve private për mobilizimin dhe shërbimin ushtarak, parashikohet se personi deri në moshën 19 vjeç, është i lirë të zgjedhë nëse do t’u nënshtrohet detyrimeve ushtarake në shtetin tjetër, shtetas i të cilit është. Në lidhje me përcaktimin e moshës për kryerjen e shërbimit ushtarak ky ligj parashikon se shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv dhe alternativ kryhet nga shtetasi shqiptar mashkull i moshës 19 deri në 27 vjeç, dhe thirrja e shtetasit për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv dhe alternativ fillon sapo mbush moshën 19 vjeç e deri në moshën 26 vjeç. Gjithashtu, në rast mobilizimi të përgjithshëm ose të pjesshëm, me ligj ose me dekret të Presidentit të Republikës, thirret për shërbim ushtarak edhe shtetasi i moshës 18 vjeç.

Ndër të tjera ligji parashikon se nuk thirret për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv dhe alternativ shtetasi që ka nën kujdestari prindër ose pjesëtarë të familjes, invalidë të plotë, që kanë nevojë për përkujdesje dhe që nuk kanë përkujdesje tjetër, si dhe shtetasi kryefamiljar, i martuar dhe me dy e më tepër fëmijë të mitur. Gjithashtu, shtetasi në shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ lirohet para kohe nga ky shërbim në rastet kur për fatkeqësi familjare të rënda, kur prindi ose bashkëshortja bëhet invalid ose vdes dhe fëmijët mbeten pa përkujdesje.

Në rastin e marrjes së shtetasit në evidencë, parashikohet se evidentimi i shtetasve meshkuj, si burime njerëzore për kryerjen e detyrimit të shërbimit ushtarak aktiv, fillon në moshën 17 vjeç dhe ka në këtë moshë për detyrë të paraqitet në qendrën e rekrutim-mobilizimit për kontrollin e aftësive fizike e shëndetësore, për t'u marrë në evidencë ushtarake. Kuadri ligjor për forcat e armatosura, rregullon edhe shërbimin ushtarak vullnetar. Ky rregullim është parashikuar jo vetëm në ligjin nr. 9047, datë 10.07.2003, por edhe në ligjin nr.9171, datë 22.01.2004 për gradat dhe karrierën në Forcat e Armatosura të RSH-së dhe në ligjin nr.9210, datë 23.03.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të armatosura në RSH-së. Ligji nr.9171 datë 22.01.2004 përcakton se "oficer, nënoficer dhe ushtar aktiv me pagesë pranohet shtetasi shqiptar që ka moshën 19-30 vjeç dhe plotëson kriteret e parashikuara nga ky ligj.

Fëmijët e minoriteteve (neni 30)

615. Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të minoriteteve kombëtare ka zënë një vend të rëndësishëm në politikën e Qeverisë Shqiptare. Shqipëria ka patur dhe vazhdon të ketë një angazhim të përhershëm, përta i përket përmirësimit të vazhdueshëm të standarteve, lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pjesë përbërëse e të cilave janë dhe të drejtat e minoriteteve. Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës "Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare", e cila pas ratifikimit është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm shqiptar, përbën bazën mbi të cilën mbështetet hartimi dhe zbatimi i politikave për minoritetet në Shqipëri. Shqipëria e konsideron respektimin e dispozitave të Konventës Kuadër "Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare", jo vetëm si një detyrim që buron nga zbatimi i normave të legjislacionit të brendshëm, por edhe si një nga angazhimet më të rëndësishme të ndërmarra në kuadrin e procesit të Stabilizim-Asociimit në Bashkimin Evropian. Në këtë kuadër, politika e shtetit shqiptar ngrihet mbi dy boshtet themelore që përcaktojnë instrumentat ndërkombëtare për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare: 1) garantimin ligjor dhe zbatimin në praktikë të të drejtës për një trajtim jodiskriminues të personave që u përkasin minoriteteve në gëzimin e plotë të të gjitha të drejtave njerëzore, si dhe të drejtave civile e lirive politike, që Kushtetuta dhe legjislacioni u njohin të gjithë shtetasve shqiptare; 2) garantimin ligjor dhe marrjen e masave konkrete për të mbrojtur dhe respektuar të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve, si: e drejta për të shprehur lirisht përkatësinë e tyre, për të ruajtur e zhvilluar identitetin e tyre, duke ushtruar lirisht dhe në ato elemente të veçanta që karakterizojnë jetën e komunitetit të tyre si minoritet, mësimin e gjuhës amtare, veprimtarinë kulturore, ushtrimin e kultit fetar etj.

616. Legjislacioni shqiptar, duke filluar me Kushtetutën e Shqipërisë dhe aktet e tjera ligjore, garanton zbatimin në praktikë të të drejtave të minoriteteve, duke reflektuar frymën e Konventës Kuadër. Kushtetuta e Shqipërisë i ka cilësuar minoritetet si pjesë të pandarë të shoqërisë shqiptare, duke u njohur atyre të gjitha të drejtat, sikurse dhe shtetasit e tjerë shqiptarë, duke u garantuar kushtet për të ruajtur dhe zhvilluar identitetin e tyre kombëtar, kulturor e fetar.

617. Në Shqipëri tradita historike ka ecur në rrugën e njohjes si minoritet kombëtar të atyre grupeve të individëve që kanë një komb amë, me të cilin kanë karakteristika të përbashkëta, si: gjuhën, kulturën, zakonet e traditat, besimin fetar etj. Minoriteti grek, maqedonas dhe serbo-malazez janë

njohur si minoritete kombëtare, ndërsa romët dhe vllahët/arëmunët janë njohur si minoritete etno-gjuhësore.

618. Në situatën ligjore ku përkufizimi i minoritetit kombëtar mungon, Shqipëria procesin e njohjes së minoriteteve kombëtare e bazon në kriteret e përcaktuara nga konventat ndërkombëtare siç janë kriteret objektive të cilat kanë të bëjnë me egzistencën e karakteristikave etnike, kulturore, fetare, linguistike të veçanta dhe të qëndrueshme, nga pjesa tjetër e popullsisë të këtij grupi, si dhe me shfaqjen e vullnetit për të ruajtur kulturën, traditat, fenë, gjuhën e tyre, si dhe kriterin që nënkupton zgjedhjen personale për të qënë pjesë e minoritetit. Statusi i minoritetit kombëtar apo etno-gjuhësor nuk ka ndonjë efekt negativ apo diskriminues lidhur me zbatimin e dispozitave të Konventës Kuadër “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, si dhe me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të këtyre minoriteteve.

- **Fëmijët e minoritetit rom**

620. Strategjia kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Rom” (miratuar me VKM nr. 633, dt. 18.09.2003) parashikon objektiva në fushat e: 1) Arsimit, formimit profesional dhe punësimit, Kujdesit shëndetësor, Mbrojtjes shoqërore dhe shërbimeve sociale, Strehimit, transportit, Përfshirjes në jetën shoqërore dhe kulturës, etj.

Si rezultat i masave të marra ka një rritje të frekuentimit të kopshteve dhe shkollave nga ana e fëmijve rom. Rritja e frekuentimit në të dy nivelet është mundësuar nga disa faktorë si përmirësimi i infrastrukturës, zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuere, marrja e masave nxitëse dhe heqja e barrierave kufizuese.

Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit për rregjistrimin e nxënësve rom nëpër shkolla kur nuk janë të pajisur me certifikatë lindje ka përmirësuar situatën e regjistrimit në shkolla në qarqe si Tirana, Durrësi, Korça, etj dhe ka eliminuar pengesat ligjore në këtë drejtim.

Për të zbutur fenomenin e braktisjes së shkollës janë ndërmarrë iniciativa me ndikim të madh dhe të qëndrueshëm, të cilat synojnë tërheqjen e fëmijve rom në shkollë përmes programeve speciale, ofrimit të shërbimeve të veçanta, sensibilizimit të familjeve dhe punës së veçantë me prindërit. 50 për qind e nxënësve që kanë përfituar nga projekti “Shansi i dytë” janë fëmijë rom.

Përmirësimi i kurrikulës, investimet për bazë materiale didaktike dhe reformat e ndërmarra për të favorizuar shpërndarjen e teksteve shkollore për shtresat në nevojë kanë ndikuar në afrimin e fëmijve rom në shkolla. Për vitin 2007-2008 këto familje kanë paguar vetëm 10 për qind të vlerës së librave. Organizimi i shkollave verore, me nxënës rom dhe joromë, ka rritur përfshirjen sociale të këtij komuniteti dhe ka thyer barrierat përmes organizimit të aktiviteteve kulturore dhe sportive.

Reforma në fushën e kurrikulave ka krijuar hapësirat e nevojshme për mësimin e gjuhës rome në shkollat ku numri i nxënësve është i madh, hapësirë e cila nuk është shfrytëzuar siç duhet nga komuniteti rom, për shkak të mungesës së informacionit.

Përgjithësisht kanë munguar iniciativat konkrete për të drejta studimi dhe bursa për komunitetin romë, por ndërkohë reformat e ndërmarra në drejtim të arsimit të lartë kanë rritur mundësinë e nxënësve romë për t’u pranuar në degët e hapura të universiteteve dhe për të përfituar bursa nga fondet publike.

621. OJF-të rome kanë dhënë kontribut konkret në njohjen e familjes dhe traditave rome, përmes fushatave ndërgjegjësuere, programeve të veçanta për forcimin e pozitës së gruas rome në familje, programeve të nxitjes së punësimit, etj.

623. Kultura dhe tradita rome janë përfshirë në paketën e projekteve kombëtare të trashëgimisë kulturore ku përfshihet dhe përfshirja e traditës muzikore rome në kolanën muzikore zyrtare të trashëgimisë shpirtërore në CD.

Shoqatat rinore rome dhe aktivistët e tyre u përfshinë aktivisht në procesin e konsultimit të strategjisë për rininë, duke kontribuar realisht në përcaktimin e masave prioritare dhe aktiviteteve që do të ndihmonin në integrimin dhe pjesëmarrjen aktive të rinisë rome në jetën e vendit.

624. Aksesi i minoritetit rom në media është i vogël. Ka mungesë të programeve dhe iniciativave konkrete nga institucionet shtetërore, ndërkohë që ka patur iniciativa të OJF-ve të specializuara në fushën e medias të cilat kanë realizuar emisione të posaçme apo kanë ndikuar në rritjen e kapaciteteve të medias për të adresuar problematikën e këtij komuniteti.

625. MPCSSHB ka ndërmarrë nisma konkrete për nxitjen e punësimit për komunitetin rom në përgjithësi dhe për gratë rome në veçanti. Por në të ardhmen duhet të ndiqen politika më proaktive të cilat do të krijojnë perspektiva më të mira punësimi për këtë komunitet.

Qëndrat e formimit profesional dhe politikat e ndjekura për grupet në nevojë kanë rritur aksesin e romëve në kurset e formimit profesional. Në vitin 2005, 73 për qind e numrit të përgjithshëm të përfituesve ishin romë. Megjithatë në këtë drejtim duhet të rritet bashkëpunimi ndërmjet qendrave të formimit profesional, zyrave të punësimit dhe komunitetit rom për të rritur numrin e përfituesve nga këto skema.

Përhapje të madhe kanë marrë qëndrat ditore të shërbimeve në komunitet të cilat ofrojnë shërbime për fëmijët, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, vajzat dhe gratë në nevojë. Janë ngritur 17 qendra në qarqet e Tiranës, Durrësit, Shkodrës dhe Vlorës dhe po punohet për ngritjen e 27 qendrave në qarqet e tjera. Shfrytëzimi më i mirë i kapaciteteve të krijuara nga komuniteti rom kërkon organizimin e fushatave njohëse në radhët e këtij komuniteti.

Komuniteti rom gëzon të drejta të barabarta në fushën e mbështetjes sociale. Nxjerrja e një akti administrativ nga MPCSSHB iu mundëson familjeve rome marrjen e asistencës nga pushteti vendor për plotësimin e dokumentacionit për të përfituar ndihmë ekonomike.

626. Vaksinimi i fëmijëve nga 0-14 vjeç realizohet në shkallë vendi në masën 95 për qind. Në disa rrethe ku popullsia rome është e madhe ky nivel raportohet në masën 99,8 për qind. Megjithatë problem mbetet vaksinimi i fëmijëve për atë pjesë të popullsisë rome që lëviz nga një rajon në tjetrin apo që emigron. Në fushën e shëndetit riprodhues dhe të planifikimit familjar ka patur shumë iniciativa nga ana e OJF-ve, por që shpesh herë nuk janë të evidentuara nga institucionet shtetërore përgjegjëse në këtë fushë. Trajtimi me medikamente falas për familjet e varfëra rome, vlerësimi i morbozitetit dhe mortalitetit janë masa që nuk janë zbatuar. Realizimi i një pjese të tyre mund të bëhet vetëm në nivel kombëtar dhe nuk mund të adresojë vetëm komunitetin rom, ndërkohë që sipërmarrje të tilla kërkojnë fonde, kohë dhe investime në fushën e teknologjive të informacionit.

Baza ligjore ekzistuese nuk krijon premisa për diskriminim të romëve në fushën e strehimit dhe të shërbimeve të tjera bazë. Ka përfunduar vlerësimi i nevojave për strehim, ujësjellës-kanalizime dhe rrjetin e brendshëm rrugor në të gjitha njësitë e pushtetit vendor ku ka popullsi rome. Tirana dhe Elbasani janë dy qytetet që kanë respektivisht 33,3 për qind dhe 24 për qind të nevojave totale për ndërtimin e banesave të reja, si dhe 19,1 për qind dhe 35,5 për qind të nevojave për rehabilitimin e banesave ekzistuese.

627. Në kuadrin e projektit “Për ndërtimin e banesave me qëllim social” krijohen hapësira dhe për komunitetin rom, por familjet rome kanë nevojë për asistencë ligjore që të përfshihen në këtë skemë. MB ka ndërmarrë fushatën për mbrojtjen e fëmijëve dhe heqjen e tyre nga rruga, duke ndërmarrë disa iniciativa ligjore. Gjithashtu janë ndërmarrë masa për të kontrolluar trafikimin e fëmijëve brenda vendit dhe denoncuar rastet e trafikimit siç është vendosja e linjës telefonike kombëtare pa pagesë, nënshkrimi i marrëveshjes me qeverinë greke për rikthimin, rehabilitimin dhe kujdesin për fëmijët e trafikuar, ku një pjesë e konsiderueshme e këtyre fëmijëve janë rom, etj.

Iniciativat shtetërore në këtë fushë janë mbështetur dhe nga organizatat e shoqërisë civile përmes krijimit të koalicionit “Bashkë kundër trafikimit të fëmijëve”.

628. Në zbatim të strategjisë “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Rom”, u krijua Sektori i Monitorimit të Strategjisë “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Rom” pranë MPÇSSHB.

629. Angazhimi i madh i Qeverisë Shqiptare është anëtarësimi në 2008 në Dekadën e përfshirjes së Romëve. Kjo është një iniciativë qeveritare e vendeve të Evropës Qendrore dhe Juglindore mbështetur nga Banka Botërore, UNDP dhe Instituti i Shoqërisë së Hapur, për të përmirësuar gjendjen sociale të minoritetin Rom në fushat e Arsimit, Punësimit Shëndetësisë dhe Strehimit. Shqipëria është bërë vend anëtar në këtë Iniciativë në muajin prill 2008 Shkurt dhe mori statusin e vendit anëtar në Korrik 2008. Me anëtarësimin në Dekadën e Përfshirjes së Romëve Korrik 2008, MPÇSSHB u ngarkua nga Kryeministri me Përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit për zbatimin e “Dekadës së Përfshirjes së Romëve”. Për hartimin e Planit u ngrit një grup ndërministror dhe drafti është përgatitur dhe do të miratohet brenda vitit 2009 Plani Kombëtar i Veprimit dhe i Dekadës për Romët përfshin 6 fusha të tilla si arsimit, trashëgimia kulturore, integrimi në tregun e punës, përmirësimin e aksesit në shërbimet shëndetësore, përmirësimi i kushteve të strehimit dhe infrastrukturës si dhe parandalimi dhe ulja e rasteve të diskriminimit social dhe institucional ndaj Romëve. Drafti përfundimtar do të përfshijë gjithashtu edhe një guidë për zbatimin dhe monitorimin dhe monitorimin e tij në nivel qendror dhe lokal si dhe një hartë me donatorët potencial për çdo fushë. Dekada e Përfshirjes së Romëve 2005-2015, që është iniciativa më e plotë për përmirësimin e jetës së romëve, vë një theks të veçantë në arsimimin e fëmijëve romë si një nga rrugët kryesore të integritit të tyre në shoqëri.

Vlen për tu theksuar kontributi i Organizatave Romë që nga mbledhja e të dhënave, identifikimi i nevojave dhe shkaqeve të tyre deri tek formulimi i masave të propozuara.